



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

**I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, TË MBAJTUR
MË 21 KORRIK 2011**

**SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA, ODRŽANE
21. JULA 2011. GODINE**

**KORRIK – JULI
2011**

E enjte, 21.7. 2011, ora 10:00

Drejton seancën: Kryetari i Kuvendit të Kosovës, zoti Jakup Krasniqi

KRYETARI: Të nderuar deputetë, ministra,
I hap punimet e seancës plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës.
Në seancë janë të pranishëm 66 deputetë, që mund t'ia fillojmë punës.

Të nderuar deputetë,
Para se të fillojmë me rendin e ditës, ju njoftoj se me vendim të presidentes së Republikës së Kosovës, është bërë zëvendësimi i deputetes së ndjerë Nekibe Kelmendi, me deputeten e re, Kimete Bytyçi, nga radhët e subjektit politik të Lidhjes Demokratike të Kosovës, të cilës i dëshirojmë punë të mbarë.

Fillojmë me pikën e parë të rendit të ditës:

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës

Koha për deklarime jashtë rendit të ditës është e kufizuar deri në 30 minuta. Diskutimi në emër të grupit parlamentar zgjat 5 minuta, ndërsa diskutimi i deputetit deri në 3 minuta. Andaj, kërkoj nga deputetët e paraqitur për diskutim, të deklarohen se në çfarë cilësie kërkojnë fjalën. Replika nuk ka në këtë pikë të rendit të ditës.

Fjalën e ka kërkuar deputetja Duda Balje.

DUDA BALJE: Zahvaljujem, gospodine prededavajući!
Vlast preko lokalne uprave nije pružena jedino bošnjačkoj i goranskoj manjinskoj zajednici, koja je na nivou Kosovo odmah iza srpske zajednice po brojnosti, a u opštinama Prizren, Dragaš, Peći i Istog ubedljivo najveća ne većinska zajednica. Da vas posetim da što se tiče upravo ne većinskih zajednica, do sada je formirano 6 opština za srpsku i jedna opština za tursku zajednicu. Moja zajednica je po svemu sudeći kvalitetno ignorisana i pored toga što je ispunjavala sve zakonom propisane uslove za formiranje opština na teritorijama gde živi.

Da bi vam približila upravo te uslove koje sam napomenula, citiraću član 12.4. Ahtisarijevog plana, koji glasi: „Kosovo je dužno da se uključi u konsultacije sa ne većinskom zajednicom gde takva zajednica čini najmanje 75% stanovništva u koncentrisanom naselju, koje ukupno ima najmanje 5 hiljade stanovnika, sa ciljem da se obrazuju nove opštine“. Molila bi da se na momenat zadržimo na cifru od 5 hiljade stanovnika, kao jedan od uslova za formiranje novih opština. U Župi, mesto na kome tražimo formiranje opštine, živi oko 15 hiljade stanovnika, u Gori oko 12 hiljada, identičan je slučaj i sa Vitomiricom koja isto nadmašuje cifru 5000 hiljada, što automatski znači da bi imali pravo u odnosu na te uslove da tražimo formiranje dve ili više opština. Međutim, mi kao skroman narod nemamo takve zahteve, što naravno ne znači da nismo svesni zakona i onoga šta nam pripada i te razlike koja se pravi između nas i drugih ne većinskih zajednica. Ovome bih dodala da što se tiče uslova da sva mesta na kojima tražimo formiranje novih opština po već rađenim studijama izvodljive su i finansijski održive i kompletno spremne za preduzimanje odgovornosti za funkcionisanje lokalne vlasti.

Mnogi predstavnici kompetentnih institucija su nam do sada kroz mnoštvo pozitivnih signala smirivala naše zahteve i davala razna obećanja ali bez konkretnih poteza i aktivnosti i opet naravno na našu štetu, jer smo posle svega na kraju ostali bez onoga što smo tražili.

Hoću da istaknem jedno. Tražimo formiranje opštine u Župi, Gori i Vitimirici, jer nam to pripada. Ne tražimo da se zbog toga stvaraju novi zakoni, niti krše postojeći, već da se ispoštuje ono što je uzeto u obzir kada su formirane opštine za srpsku i tursku ne većinsku zajednicu, da se uzmu u obzir validni zakoni koji su važili za sve, pa se nadam da ne postoji razlog da ne važe i za nas.

Učeni iskustvom minulih godina i nemogućnosti odgovornih osoba za datu problematiku ili možda pak nedovoljne želje za ispunjavanjem zahteva za moga naroda za započinjanjem i okončavanjem aktivnostima za stvaranje novih opština koje nam, ponovo ponavljam, po svim zakonima pripadaju, apelujem na Vladu i sve odgovorne osobe da uzmu u obzir se postojeće fakte, da uzmu u obzir našu brojnost naše prioritete, da uzmu u obzir naše potrebe i naš lakši opstanak i život na Kosovu.

Ja u ovom sazivu Skupštine prvi put javno molim Vladu za konkretne aktivnosti na polju stvaranja novih opština i apelovaću onoliko puta koliko bude potrebno da se prekine sa diskriminacijom moga naroda i da najzad dobijemo opštine koje su za nas prioritet. Dobijanje novih opština za nas će značiti početak dinamičnog i energičnog lokalnog ekonomskog razvoja u cilju povećanja privrednog kapaciteta naših područja, većeg broja zaposlenih i mnogo toga drugog....jednom rečju, poboljšanje privredne budućnosti i kvaliteta života svih žitelja.

KRYETARI: Faleminderit!
Fjalën e ka deputeti Rexhep Selimi.

REXHEP SELIMI: Nuk jam në emër të grupit, por si deputet.
I nderuar kryetar,
Kolegë, zonja e zotërinj deputetë,

Tash e dy muaj, pranë objektit të Qeverisë së Kosovës po vazhdon greva e rreth 50 veteranëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Për dy muaj me radhë ata kanë vetëm një kërkesë drejtuar Qeverisë, procedimin e Ligjit për veteranët e luftës së UÇK-së në Parlamentin e Kosovës, për amendamentim dhe aprovim, si e drejtë e të gjithë veteranëve dhe si nevojë e domosdoshme për trajtim dinjitoz të veteranëve të luftës.

Për kaq kohë sa veteranët grevistë u përballën me vështirësitë objektive të të qenit në grevë, për aq kohë sa atyre iu desh të përballen me egërsinë e motit, herë të mbytur në ujërat e shirave të rrëmbyeshëm e herë të pjekur në temperaturat e korrikut përvëlues, për aq kohë sa grevistët lanë shtëpitë e tyre dhe familjet e tyre në gjendje shumë të rëndë ekonomike, për aq kohë sa shumica prej tyre duke qëndruar në kushte greve përfunduan në Qendrën Emergjente, të sëmurë rëndë, si pasojë e grevës dhe e plagëve të luftës, pra, për 2 muaj rresht grevistët morën vetëm një përgjigje nga Qeveria e Kosovës, injorimin e kërkesave të tyre.

Zotërinj deputetë,

Nën ato tenda qëndrojnë ushtarë me plagë lufte, e sipër atyre tendave qëndrojnë shumë prej tyre, shumë prej shokëve të tyre të dikurshëm, tani në zyrat luksoze të Qeverisë.

Në javën që lamë pas, atyre u është dhënë një premtim nga shefi i Qeverisë, premtimi ishte publik dhe zyrtar. Pra, Qeveria u premtoi atyre që ligji do të procedohet në Kuvend, më datën 15 korrik, ditë e premtë, ose eventualisht më së largu, më datë 20 korrik, ditë e mërkurë.

Duke i besuar këtij premtimi publik, grevistët e anuluan protestën e paralajmëruar për javën e kaluar.

Pra, sot jemi më 21 korrik, ditë kur prapë veteranët grevistë i mashtroi Qeveria, nuk e procedoi ligjin.

Është për t'u admiruar dhe përkrahur niveli i lartë i përgjegjësisë së veteranëve grevistë, të cilët asnjëherë nuk ranë në provokimet e Qeverisë për t'i nxjerrë ata nga kontrolli dhe vetëpërmbajtja.

Kolegë deputetë,

Përballë këtyre dy qëndrimeve të skajshme, në mes grevistëve dhe Qeverisë, qëndrojmë ne deputetët dhe Kryesia e këtij Kuvendi, që duhet të reagojë menjëherë e të mos e përsërisë gabimin që po e bën Qeveria karshi kërkesave të veteranëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Njëkohësisht, propozojmë që kryetari dhe Kryesia e Parlamentit apo edhe vetë shefat e grupeve parlamentare t'i kontaktojnë menjëherë grevistët dhe t'i hapin vetes rrugën e zgjidhjes për ta. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Deputeti Ardian Gjini e ka fjalën. Lë të më tregojë në cilën cilësi?

Në emër të Grupit.

ARDIAN GJINI: Faleminderit, zoti kryetar!

Sot po bëhet një vit qysh se kryetari i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës dhe ish- kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, po mbahet në Hagë, pa u gjykuar.

Ndërkohë, gjatë këtij viti, prej sa ai është atje, në Kosovë ka ndodhur shumëçka, mirëpo asgjë që mund të ishim thirrur në sukses ose në diçka që mund të lavdërohem.

Ne sot edhe një herë duhet të themi se largimi i tij nga Kosova dhe ndalja në Scheveningen, pas shpalljes i pafajshëm nga të gjitha akuzat një herë, po ndodhë edhe pse prapë po shihet qartë që prokurorisë i është dashur një vit e më tepër për t'u përgatitur për ta filluar gjykimin. Kjo na bënë të besojmë edhe të dyshojmë në fakt se ndalja e tij atje po ndodhë për shkak se dikujt i është dashur për të mos e pasur në Kosovë, e jo pse kanë qenë të gatshëm për gjykim e jo pse kanë dashur diçka tjetër, jo pse kanë pasur fakte.

Po e shfrytëzoj rastin edhe një herë, për të mos e zgjatur më tepër në emër të grupit, për ta shënuar do të thotë këtë ditë, që të mos shkojë në harresë, që është njëvjetori i asaj ngjarje, hiq të mirë për Kosovën, as për politikën as për qytetarët, që t'ju falënderoj edhe një herë për atë që ka ndodhur në seancën e jashtëzakonshme, të cilën e ka thirrur Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, kohë më parë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!
Deputetja Flora Brovina e ka fjalën.

FLORA BROVINA: Unë flas edhe në emër të Grupit të Grave Parlamentare.
Më lejoni, zoti kryetar, të nderuar kolegë dhe kolege,
Tema për të cilën do të flas sot, sigurisht që është aktuale gjithnjë pas luftës, edhe pse sot kemi disa tema tjera që ndoshta ia marrin aktualitetin, zbatimi i Ligjit për barazinë gjinore dhe pikërisht në emërimin e shkollave dhe rrugëve, në kohën kur po emërohen këshillat për emërimin e rrugëve dhe të shkollave të reja gjatë këtij fillim viti shkollor që fillon në shtator.

Në bazë të një studimi që u dha para disa ditësh, u konstatua se duke e konsideruar kontributin e gruas gjatë kohës në arsimim, në shëndetësi sidomos kontributin e saj në bërjen e lirisë së Kosovës dhe ndërtimin e pavarësisë edhe sakrificën e saj të shumtë gjatë kësaj kohe, gratë nuk janë të përfaqësuara në emërimin e rrugëve dhe të institucioneve kulturore, arsimore krahas kontributit të tyre.

Nga 576 shkolla fillore në Kosovë, vetëm 10 ose 02% mbajnë emrat e grave të shquara. Në shkollat e mesme vetëm 15 ose 17%, duket pak më mirë, por në numër fare pak janë. Aspak më mirë nuk qëndron situata në emërimin e rrugëve, ta zëmë në kryeqytetin tonë nga 477 rrugë, vetëm 16 mbajnë emrat e grave të shquara ose 3% : në Ferizaj 8%, në Prizren 4%, në Gjiilan 6%, në Mitrovicë 7%, në Gjakovë 5%, madje ka raste sikur është rasti në Gjakovë kur emri i rrugës, emëruar, domethënë, të një gruaje të shquar për kontributin e saj dhe rezistencën e saj gjatë periudhave të ndryshme, ndërrohet me një emër, natyrisht të shquar të një burri.

Këto të dhëna le të flasin vetë dhe të dëshmojnë se gruaja nuk është respektuar sa duhet sa i përket emërimit të rrugëve, nuk është respektuar sakrifika dhe kontributi i saj kombëtar, natyrisht edhe kontributi në të gjitha lëmit që i përmenda.

Unë për t'i kontribuar ekipeve që punojnë në emërimin e rrugëve në komuna dhe emërimit të shkollave, do t'i përmend disa emra për ...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Faleminderit!
Hajt përmendi, regjia!

FLORA BROVINA: Atëherë: Shote Galica, Xheve Lladrovci, Hyre Emini, Katarina Jopipi, motrat Qirijazi, Marie Shllaku, Ganimet Tërbeshi, Zahide Jashari, Rukie Beqiri, Fatime Krasniqi, Ylfete Humolli, Shukrie Obërtinca, Sadete Mekuli, Nëna Ajshe Gërvalla, Bije Vokshi, Hyrie Hana, gratë e Baliqit të Ferizajit, Marshi i Bukës ose Marrshi i Grave për Drenicën, deputetja Gjini nga Mitrovica, pastaj gratë që pajtuan gjaqet: Myrvete Maksutaj, Edit Durham, Merlin Olbrajt, Elena Gjika, Misine Kokollari, Marie Kraja, Natasha Kandiç, Sonja Biserko, gratë në të zeza të Beogradit, që u ngritën kundër mbylljes së shkollave dhe kundër luftës në Kosovë: Doris Pack, Kristin Folcon, Eva Bentley, Melihate Ajeti, Xhamfize Keko dhe sigurisht do t'i përmend gratë e Qirezit, vajzat e Qirezit, që u

hোধhēn nē pus dhe shumë, Yllka Domi dhe shumë emra të tjerē qē do t'ua dorēzojmē komunave veç e veç. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!
Deputeti Lutfi Haziri e ka fjalēn.

LUTFI HAZIRI: Zoti kryetar,
Tē nderuara ministra, zēvendēskryeministēr,
Sot nē emēr tē Grupit Parlamentar do tē nxjerr shqetēsimin e letrēs qē Avokati i Popullit ia ka dērguar Kuvendit, Qeverisē dhe institucioneve tjera, pērfshirē edhe ato ndērkombētare. Nē faqen 4, Avokati i Popullit thotē dhe flet rreth rrēnimit tē pavarēsisē sē institucionit tē Avokatit dhe problemeve tjera. Ky shqetēsimi ynē dhe brengosja ka tē bējē me angazhimet konkrete qē Kuvendi mund tē ndērmarrē ta detyrojē Qeverinē qē tē pērmirēsojē kushtet dhe mundēsitē qē institucioni i Avokatit tē funksionalizohet, pa pasur nevojē ta pērmend qē kēta kanē probleme teknike, nuk kanē hapēsirē, nuk kanē ambient, tash kanē mbetur edhe pa zyre dhe kanē edhe probleme tjera.

Zoti kryetar,
Nuk ēstē e tepērt tē pērmend se institucioni i Avokatit tē Popullit ēstē njēri nga institucionet qē vlerēsohet nē Raportin e Progresit. Kemi edhe pak ditē deri nē fillim tē shtatorit nēse arrijmē t'i zbatojmē disa nga rekomandimet qē janē propozuar kētu, nē mēnyrē qē tē pasqyrohet sē paku veprimi pozitiv qē nē raport me institucionin dhe pavarēsinē e Avokatit tē Popullit, Kuvendi ta marrē vlerēsimin pozitiv, nē tē kundērtēn, po shihet qē ky institucion po degradohet. Nē letēr pērmendet edhe shqetēsimi se asnjē ministēr, asnjē komunē nuk i adreson problemet dhe nuk i adreson problemet dhe nuk i adreson kērkēsat qē Avokati i Popullit, ua adreson, ua paraqet dhe ua kērkon nē mēnyrē qē tē ndērhyyhet nē realizimin e zbatimit tē ligjit dhe kērkēsave qē vijnē nē forma tē ndryshme te ky institucion.

Duke besuar shumë qē do tē ndermirēn veprime konkrete dhe do tē zbatohen disa nga rekomandimet sē paku dhe tē ruhet ky institucion, shpresoj shumë nē rolin e Kuvendit tē Kosovēs dhe nē detyrēn qē Qeveria ka karshi realizimit tē kērkēsave qē ēstē paraqitur nga Avokati. Faleminderit, shumë!

KRYETARI: Faleminderit!
Myzejene Selmani e ka fjalēn.

MYZEJENE SELMANI: Faleminderit, kryetar!
Pērshēndetje pēr zēvendēskryeministrin dhe ministrat e Kabinetit qeveritar dhe gjithē deputetēt,
Duhet tē ngre njē çēshtje nē emēr tē Grupit Parlamentar tē Koalicionit pēr Kosovē tē Re. Edhe njē herē dēshiroj tē tērheq vēmendjen e Qeverisē lidhur me protestēn e veteranēve, njē problem qē duhet tē gjejē zgjidhje nga vetē Qeveria jonē.

Premtimet qē u jepen atyre nuk kanē rezultuar me sukses dhe kjo po zgjat agoninē e tyre. Qeveria duhet tē dalē me njē bilanc real lidhur me pakon e mbēshtetjes sē veteranēve, tē cilēt duhet tē pērfshihen nē prioritet ata qē kanē nevojē dhe ata qē kērkojnē qē tē ketē njē mbēshtetje tē tyre pēr anēn morale tē luftēs. Nē kētē mēnyrē edhe kontesti nē mes tē FMN-sē dhe Qeverisē nē lidhje me kētē çēshtje do tē zgjidhej pēr arsye tē kērkēsēs sē veteranēve qē kjo kērkēsē e tyre qē tē gjejē hapēsirē edhe nē hapēsirēn ekzistuese tē buxhetit tē Kosovēs.

Për arsye që e kemi ministrin e Financave këtu, kërkoj që në mënyrë të denjë të di si është gjendja reale e buxhetit të Kosovës që këta veteranë të hiqen prej tendave sot edhe një herë e përgjithmonë para lokaleve të Qeverisë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Deputeti Liburn Aliu, në emër të grupit e ka fjalën.

LIBURN ALIU: I nderuar kryetar,
Të nderuar deputetë,

Nga fundi i muajit qershor të këtij viti, në Paris, Komiteti i Trashëgimisë Botërore i UNESCO-s e mbajti mbledhjen e rregullt vjetore, mbledhje në të cilën trajtohet trashëgimia kulturore botërore. Dhe, ajo që e bën tejet me interes për Kosovën është fakti që viteve të fundit, me iniciativë të SHBA-ve dhe këtë vit, me iniciativë të delegacionit francez, u propozua riemërimi i katër monumenteve ortodokse të Kosovës, nga emri aktual serbe, në të Kosovës.

Nga institucionet e Kosovës nuk është bërë asgjë përgjatë këtyre viteve e as këtë vit në drejtim të përkrahjes dhe furnizimit me informacione të këtyre nismave pozitive.

Trashëgimia kulturore ortodokse në Kosovë sot trajtohet gabimisht dhe me dashakeqësi si serbe. Ky trajtim nacionalist i monumenteve të ndërtuara para se të ekzistojë kombi serb, i ka hapur gjithmonë rrugën shovinizmit serb karshi shqiptarëve, pasi ishte argumenti i vetëm që Serbia ka përdorur në arsyetimin e pushtimit të Kosovës dhe krimeve të kryera në Kosovë.

Trajtimi i tillë nacionalist i monumenteve fetare edhe sot vazhdon t'i hapë rrugën urrejtjes në baza etnike e fetare dhe është mjaft i rrezikshëm dhe këto monumente në vend të ndërtesave të shërbimit fetar, i shndërron në burim të ndarjeve dhe urrejtjes përkundër që historikisht u ruajtën dhe u respektuan si objekte të besimit.

Pasojat e kësaj politike, këtij trajtimi nacionalist, tanimë kanë filluar të duken qartë.

Pranë qytetit të Prishtinës sot kemi një zonë të tillë të mbrojtur, zonën e Gazimestanit, dhe monumentin e ndërtuar në vitet '50 e që trajtohet si trashëgimi nacionale serbe e që lidhet me betejën e Kosovës, që ndodhi në vitin 1389. Trajtimi nacionalist i kësaj beteje, ku morën pjesë popujt e Ballkanit, ishte ndër argumentet kryesore të politikës pushtuese serbe që nga viti 1912 dhe këtu te ky monument filloi lansimi i politikës shoviniste serbe të viteve '90, të udhëhequr nga kriminel i Millosheviq. E edhe sot ky monument vazhdon të trajtohet i tillë, njëjtë pra në të gjitha kohët. Kjo nuk është asgjë tjetër veçse inkurajim i ndarjeve, urrejtjes dhe i jostabilitetit në të ardhmen. Tanimë që po kemi incidente po shihet qartë çdo vit. Tolerimi i politikës së bazuar në historinë e politizuar më nacionalizëm, e bën këtë gjë.

Duhet ta bëjmë të qartë që këto elemente ndarëse do të shkojnë gjithnjë në rritje nëse vazhdon t'u lihet dera e hapur. Për Serbinë do të jetë e lehtë çdo herë të trazojë Kosovën përmes këtyre mundësive që ia lë pakoja e Ahtisarit, e për thellimin e ndarjeve u hap kjo derë që në Vjenë.

Pra, sot këtë çmenduri të Grupit të Unitetit gjatë negociatave në Vjenë dhe të pakos së Ahtisarit, po përpiqen ta përmirësojnë vende që dëshirojnë paqen dhe stabilitetin afatgjatë në Kosovë.

Të duash paqen e qëndrueshme dhe stabilitetin afatgjatë, elementet e tilla që bëjnë ndarje në baza etnike e fetare, duhet eliminuar.

Dhe, nga institucionet e Kosovës në vend se të përkrahen konkretisht nismat e tilla, këtu po synohet që të procedohen më tutje ligjet për zonat e mbrojtura përreth monumenteve ortodokse në Kosovë e që nuk bëjnë asgjë tjetër përpos ndarjes dhe pengimit me çdo kusht të integritetit të pakicës serbe në Kosovë.

Lëvizja “Vetëvendosje” e ka kundërshtuar më kohë dhe vazhdon t’i kundërshtojë këta hapa negativë që Kosovës nuk i sjellin asgjë tjetër veç se jo stabilitet në të ardhmen.

Në trashëgiminë kulturore ortodokse të Kosovës, bashkëtrashëgimtare është edhe popullata e besimit islam, pasi në të kaluarën paraardhësit tanë i ndërtuan dhe i kryen shërbimet e tyre fetare në këto objekte, i mbrojtën e i respektuan këto monumente si monumente të tyre, madje edhe pas konvertimit. Ishte trajtimi nacionalist, pra trajtimi politik nacionalist dhe krimet e bëra në emër të tyre që sollën ndarjet.

Ne si Grup Parlamentar i Lëvizjes “Vetëvendosje”, kërkojmë nga kryetari i Kuvendit që t’i shkruajë letër Këshillit të Kosovës për Trashëgiminë Kulturore dhe të kërkojë nga ky këshill, që të grumbullojë dhe sistemojë fakte dhe të informojë shtetet përkatëse, me synim të ndalimit të trajtimit nacionalist të trashëgimisë kulturore në Kosovë, të gjejë mundësitë e bashkëpunimit me organizma të tjerë, si në Tiranë e kudo në vendet tjera.

T’i drejtohem Këshillit pasi Këshilli i raporton Kuvendit drejtpërdrejt dhe janë profesionalisht kompetentë për trashëgiminë kulturore.

E sa i përket Qeverisë, mendoj se nuk do të duhej t’i drejtoheshim për këtë çështje pasi nuk është e besueshme, për shkak të bashkëpunimit që ka me Institutin e Mbrojtjes së Monumenteve në Beograd, përmes projektit të njohur si RIK, që në shqipe i bie Komisioni për Implementimin e Ndërtimeve. Ju faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka deputeti Ramiz Lladrovci.

RAMIZ LLADROVCI: Faleminderit, kryetar!

I nderuar kryeministër,

I nderuar Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Dje në takimin e radhës të Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike të Parlamentit të Kosovës, derisa po i shqyrtonim raportet e Auditorit të përgjithshëm për pasqyrat financiare të Radiotelevizionit të Kosovës dhe të Administratës së Kuvendit të Kosovës, ishte edhe prania e rregullt e gazetarëve që po i përcillnin punimet e Komisionit.

Ajo që dua të potencoj këtu është një moment i pakëndshëm që u krijua nga pozicionimi i pavend i një gazetari gjatë punës së Komisionit dhe që për çudi reagimi im në atë rast u bë tregim i rëndësishëm në televizionin privat Kohavizion. Ky televizion, i respektuar nga unë, i dha një konotacion krejt tjetër insistimit tim që gazetari i Radio Kosovës, zoti Muharrem Qarangjoli, të

ulet në vendin e gazetarëve e jo të qëndrojnë si badiguard pas kokës sime dhe të kryetarit të Komisionit, derisa edhe unë, ashtu si të gjithë anëtarët tjerë të Komisionit po e kryenim punën tonë transparente dhe të hapur para gazetarëve.

Në atë rast unë nuk kam kërkuar që gazetari të largohet, por vetëm që ai të zë vendin e tij. Aty nuk kam shprehur kurrfarë urrejtje ndaj askujt e aq më pak ndaj gazetarit.

Personalisht e çmoj punën e gazetarëve dhe gjithë atyre që e kryejnë me korrektësi dhe profesionalizëm këtë punë. Gjatë gjithë jetës sime jam munduar të ndërtoj raporte të mira me media dhe gazetarë të vendit dhe ndërkombëtarë.

Gjatë luftës së Kosovës kam bashkëpunuar dhe kam mbështetur edhe gazetarë të huaj, në sensibilizimin ndërkombëtar të zhvillimeve në Kosovë. Po i përmend vetëm disa prej tyre gazetarë të çmuar e me renome si: zoti Maik Beqer, nga SNN, me seli në Atlanta, pastaj zoti Rober Zhil, po nga SNN, me seli në Londër, që ishte përgjegjës për Evropën Juglindore, zotin Wolwang Smith, nga BBS, doktor Klaus Reiter nga SDEF e shumë të tjerë. Edhe sot kam raporte të mira me gazetarë vendorë e ndërkombëtarë.

Do të doja që të njëjtat raporte t'i kultivojmë edhe më tej, por në kuadër të korrektësisë, të kodit dhe të etikës gazetareske, të cilën në këtë rast e ka shkelur gazetari i KTV-së, duke shtrembëruar të vërtetën. Me të parë kronikën e KTV-së, të gjithë anëtarët e Komisionit parlamentar e kanë shprehur gatishmërinë që të reagojmë bashkërisht ndaj kësaj të pavërtete që sajoi KTV-ja. Ata i falënderoj personalisht për sinqeritetin dhe korrektësinë e treguar. Po e përsëris edhe një herë, në konceptin tim nuk ekziston urrejtja si formë e të menduarit e aq për gazetarët, siç ka raportuar KTV-ja, por nuk lejoj që të tjerët ...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Faleminderit!

Kjo pikë e rendit të ditës nuk është për marrëdhëniet dhe punën e komisioneve.

Fjalën e ka deputeti Burim Ramadani.

BURIM RAMADANI: Faleminderit, kryetar!

Të nderuara deputete,

Të nderuar deputetë,

Qeveria e Kosovës dje ka marrë vendim për vendosjen e masave të reciprocitetit në raport me mallrat që vijnë nga Serbia dhe Bosnja e Hercegovina. Shumë shkurtimisht s'po dua t' i them dy herë bravo, bravo e para është për atë që e ka dëgjuar më në fund edhe Aleancën edhe opozitën edhe bravo e dytë është që janë vonuar edhe vetë e kanë pa që janë vonuar sikurse që janë të vonuar për shumë çështje edhe thuaja çdo gjë që është në të mirë të qytetarëve të Kosovës.

Është e qartë se ne do ta përcjellim zbatimin e këtij vendimi, sepse vendimet mund të merren, po ato duhen të zbatohen dhe në të njëjtën kohë do t' i themi prapë bravo sa herë që ka nevojë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Fjalën e ka deputetja Rita Hajzeraj – Beqaj.

RITA HAJZERAJ- BEQAJ: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar deputetë,

Sot dua ta ngre një çështje që ka të bëjë me një premtim të ministrit të Bujqësisë, i cili e ka dhënë në vitin e kaluar dhe dihet se sot zhvillimi ekonomik në Kosovë, po thuaj se është në shkallë minimale dhe kjo vjen si pasojë e mos angazhimit të duhur të Qeverisë së Kosovës, që të krijojë kushte të favorshme për biznese të vogla dhe të mesme në Kosovë.

Andaj, unë dua t'i bëj thirrje Qeverisë së Kosovës që të merret më shumë me çështjet sociale dhe zhvillimin ekonomik, i cili është jashtëzakonisht në shkallë të ulët, krahasuar me vendet e rajonit. Domethënë sot edhe pas dy vjetëve të shpalljes së pavarësisë së vendit tonë ne ende nuk mund të mburremi as për fillimin e një zhvillimi ekonomik sado të vogël që të jetë.

Unë dua ta ngre një çështje e cila ka të bëjë me lëndën e parë për produktet e qumështit, të cilin premtim e ka dhënë edhe ministri i Bujqësisë, që taksa doganore do të hiqet sikurse edhe në vendet e rajonit. Ju e dini shumë mirë që disa vende të rajonit siç janë: Shqipëria, Maqedonia dhe Mali i Zi, nuk kanë fare taksë doganore për produktet e qumështit, domethënë, për lëndën e parë të produkteve të qumështit, ndërsa ministrat tuaj, zoti kryeministër, kanë premtuar, por ende ky premtim nuk është realizuar.

Kërkoj dhe bëj thirrje që këto premtime t'i realizoni dhe t'u përgjigjeni kërkesave të qytetarëve.

KRYETARI: Faleminderit!

Deputeti Visar Ymeri e ka fjalën.

VISAR YMERI: I nderuar kryetar,

Të nderuar deputetë,

Javëve të fundit, Policia e Kosovës po zbaton një vendim të çuditshëm në Mitrovicë, që një kohë të gjatë të gjithë e dimë që në veri të lumit Ibër funksionojnë pikat e karburanteve, të cilat shesin të gjitha llojet e karburanteve për të gjithë të interesuarit, me një çmim më të ulët se në pjesën tjetër të territorit të Kosovës, me qenë se atje nuk paguajnë tatimet e parapara me ligj.

Në javët e fundit Policia e Kosovës po i ndalon veturat në Urën e Ibrit, shumica e atyre veturave të vozitura nga qytetarët shqiptarë dhe po iu konfiskon karburantet e blera në veri, nën pretekstin se ata nuk paskan kuponë fiskal për karburantet e blera. Për më tepër, ata edhe po dënohen me gjoba të majme për këtë çështje.

Së pari, në aspektin ligjor ky vendim i Qeverisë është i jashtëligjshëm, sepse nuk ka bazë ligjore e cila e lejon konfiskimin e mallit për shkak të mungesës së kuponit fiskal. Po ashtu, në qoftë se një biznes nuk lëshon kuponë fiskal, përgjegjës mbahet biznesi e jo konsumatori. Kësisoj autoritetet tatimore dhe policore pamundësinë për t'u marrë me thelbin e problemit në veri, pra regjistrimin e bizneseve dhe mbledhjen e tatimeve atje, po e kompensojmë me dënime mbi popullatën edhe ashtu të varfër shqiptare në jug të lumit Ibër. Në rrafshin politik kjo është edhe më e rrezikshme.

Me konfiskime dhe me dënime të tilla, Qeveria veçse po e konfirmon edhe një herë vijën e ndarjes në lumin Ibër, sepse po vendos edhe një lloj kufiri administrativ aty. Po ndalohen qytetarët që të

blejnë mallra në gjithë territorin e Kosovës, ndërsa ai territor po konsiderohet si një shtet tjetër ku administrata nuk ka qasje. Konfiskimet po bëhen sikurse Ura e Ibrit të ishte një pikë doganore.

Kërkojmë nga Qeveria e Kosovës, nga Policia dhe nga Administrata Tatimore e Kosovës, që kjo politikë të ndalet së zbatuari menjëherë dhe që autoritetet të merren sa më parë me zgjidhjen e problemit të vërtetë, i cili është ushtrimi i autoritetit të Republikës së Kosovës në gjithë territorin e Kosovës.

Ky Kuvend i ka votuar me shumicë dërmuese votash dy pikat e fundit të mocionit të parashtruar nga Lëvizja “Vetëvendosje” më 5 mars në seancën ku kishit ftuar në interpelancë kryeministri Thaçi, për negociatë me Serbinë.

Këto dy pika e obligojnë Qeverinë që të ndërmarrë masa konkrete për ta shtrirë autoritetin e vet në pjesën veriore të vendit dhe t’i raportojë Kuvendit për këto masa çdo 3 muaj.

Mos përfshirja në obligime tatimore për biznese që operojnë në pjesën veriore të vendit dhe dënimi i qytetarëve të Kosovës, me ta kaluar lumin Ibër, tregon se Qeveria po vepron saktësisht në kundërshtim me vendimet e Kuvendit.

Të gjitha bizneset duhet t’i paguajnë tatimet për funksionimin e tyre, pa marrë parasysh se në cilën komunë apo në cilën pjesë të territorit të Kosovës operojnë ato. Ky është rendi dhe ligji për të cilin po flasim për çdo ditë, ai ushtrohet në secilin cep të territorit të Kosovës dhe vetëm atëherë nëse ushtrohet në secilin cep të territorit të Kosovës, mund ta quajmë rend dhe ligj të mirëfilltë. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Deputeti i fundit për sot, Shaip Muja e ka fjalën.

SHAIP MUJA: I nderuar kryetar,

I nderuar kryeministër, Kabinet qeveritar,

Më lejoni që në këtë 3 minutash të përshëndes vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës për futjen e reciprocitetit në Doganat e Kosovës dhe ngritjen e kapaciteteve shtetërore për identifikimin e plotë të shtetësisë në gjithë territorin e Republikës së Kosovës.

Ky është një hap i cili duhet të përshëndetet dhe i cili duhet të marrë mbështetje edhe nga qytetarët e Republikës së Kosovës, jo vetëm nga institucionet e Republikës së Kosovës, sepse siç e dini bartës të zhvillimeve ekonomike në Kosovë janë shumica- qytetarë të Kosovës dhe kanë marrë pjesë edhe marrin pjesë shpeshherë edhe në plasimin e produkteve serbe. Prandaj, thërras që Ministria e Industrisë të bëjë një plan të detalizuar për menaxhimin e produkteve të brendshme në një afat kohor të konsumit, ndërsa kontrollat doganore të cilat do të jenë të jenë në nivel shumë më të shtuar së bashku me institucionet e EULEX-it dhe me kapacitetet e institucioneve tona të doganave, të cilat duhet të jenë më prezent në pikat doganore që është kërkesë e kamotshme.

Po ashtu kërkoj nga bashkësia ndërkombëtare, nga Bashkimi Evropian ka disa deklarime të cilat i kam dëgjuar dhe nga disa të tjerë që mos të demotivojnë aktivitetet e Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe angazhimin e Kuvendit të Republikës së Kosovës, që është duke treguar se është atraktiv, koperabil të bashkëpunojë dhe t’i standardizojë të gjitha ligjet dhe standardet sipas

kushteve që i kërkon edhe Bashkimi Evropian. Prandaj, kjo duhet të ndihmohet, të fasilitohet dhe jo të pengohet ose të paragjykohet si një diçka e dëmshme.

Njëkohësisht prodhuesit vendorë e kanë përkrahur dhe do ta përkrahin këtë aksion, sepse do të ketë stimulim direkt edhe të prodhimeve vendore të cilat do të kenë mundësi të stimulojnë prodhuesit e vegjël dhe të rritet konsumi i produkteve vendore. Ju falënderoj!

KRYETARI: Me këtë do të thotë përfundon edhe koha e planifikuar për deklaratimet jashtë rendit të ditës.

Urdhëro, ministër!

Ministri Bedri Hamza, ka kërkuar fjalën për deklaratimet e Qeverisë.

MINISTRI BEDRI HAMZA: Faleminderit, zoti kryetar!

Luftimi i informalitetit në Kosovë është qëllim i gjithë neve edhe ka shumë anë pozitive. E para krijimin e parakushteve për konkurrencë lojale dhe të barabartë dhe e dyta kontribuon në ngritjen e të hyrave për buxhetin e Kosovës.

U ngrit këtu çështja e luftimit të informalitetit dhe kontrabandës në pjesën veriore të Kosovës dhe kjo duhet të përshëndetet edhe do të inkurajohen institucionet që janë duke bërë këtë punë. Unë i ftoj të gjithë ata që i kanë lexuar ligjet e ndoshta s'i kanë parë disa nene të atyre ligjeve apo nuk i kanë lexuar ligjet mirë, që t'i lexojnë ligjet që nuk është veç kupon fiskal po çfarëdo dëshmie se ku është furnizuar një konsumator. Dhe, është obligim i biznesit që të lëshojë dëshmi për mallrat e shitura, po është edhe obligim i konsumatorit që të jetë i pajisur me dëshmi se ku është furnizuar ato mallra dhe nëse konsumatori nuk mund të dëshmojë me ndonjë dokument valid siç e sheh ligji edhe procedurat se ku është furnizuar me to mallra, atëherë sigurisht se kemi të bëjmë me rastin e kontrabandës dhe institucionet kompetente në këtë rast edhe Policia e Kosovës edhe Doganat e Kosovës, edhe Administrata Tatimore e Kosovës, kanë të drejtë që të veprojnë konform ligjeve që i rregullojnë këto çështje. Sigurisht se janë të shkurtër me informacione, mirëpo institucionet e Kosovës çdo ditë e më tepër jo në masën e duhur, por çdo ditë e më tepër, janë duke e shtrirë fushëveprimtarinë e tyre në tërë territorin e Kosovës. Kontrabanda, ilegaliteti do të luftohet në çdo pjesë të Kosovës dhe ne inkurajojmë institucionet që janë përgjegjëse për zbatimin e ligjit që të vazhdojnë me aktivitetet e tyre brenda ligjit dhe brenda fushës së përgjegjësisë së tyre. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, ministër!

Vazhdojmë me pikën e dytë të rendit të ditës-

Unë mendoj që kjo çështje është kryer dhe të mos vonohemi për një çështje, që është e qartë. Merrni ligjet dhe ligjet i përcaktojnë detyrat e secilit.

2. Koha për pyetje parlamentare

Në pajtim me nenin 45.1 të Rregullores së Kuvendit, koha për pyetjet e deputetëve për Qeverinë është e kufizuar në 60 minuta. Deputeti për një seancë mund të parashtrojë më së shumti 2 pyetje. Ne po vazhdojmë sipas renditjes edhe pse një pjesë e ministrave që do të duhej të përgjigjeshin nuk janë këtu, po shkojmë sipas radhës.

Deputetja Ganimete Musliu, pyetje për ministrin Enver Hoxhaj.

Deputete e ke fjalën, ministri s'është këtu.

GANIMETE MUSLIU: I nderuar kryetar,

I nderuar kryeministër,

Të nderuar kolege dhe kolegë deputetë,

Të nderuar të pranishëm,

Me qenë se ministri Hoxhaj edhe sot nuk është këtu, unë pyetjen time do ta bart në seancën tjetër, nëse ka mundësi, ose do të kërkoj përgjigje me shkrim. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Deputeti Enis Kervan, pyetje për ministrin Memli Krasniqi.

Deputeti s'është këtu, vazhdojmë me pyetjen e radhës.

Deputetja Alma Lama pyetje për kryeministrin zotin Hashim Thaçi.

Deputete e ke fjalën.

ALMA LAMA: Okej, Faleminderit, kryetar!

Pyetjen unë e kam bërë herën e kaluar, ishte në lidhje me faktin nëse Qeveria e Kosovës do të pranonte që marrëveshjet të cilat janë arritur me Serbinë, do të implementoheshin, pa miratimin e Kuvendit të Kosovës. Radhën e kaluar ishte zëvendëskryeministri, ai nuk pat guxim t'i përgjigjet pyetjes, por me qenë se u zhvillua seanca e jashtëzakonshme në lidhje me këtë çështje, mendoj që pyetjes i ka humbur aktualiteti. Faleminderit! E kemi marrë përgjigjen, domethënë, nga seanca.

KRYETARI: Faleminderit!

Kryeministër, po të kursejnë për përgjigje, nëse e do fjalën mund ta marrësh.

E ka fjalën kryeministri Hashim Thaçi.

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: Faleminderit, e nderuara deputete Lama!

I nderuar kryetar Krasniqi,

Të nderuar deputetë,

Unë do të përpiqem të marrë guxim të përgjigjem në pyetjen tuaj.

Kosova ka arritur dhe ka nxjerr konkluzione të përbashkëta, do të thotë shteti i Kosovës, me Serbinë, për tri çështje të caktuara që kemi diskutuar edhe në seancën e jashtëzakonshme të javës së kaluar. Prandaj, dëshiroj të theksoj edhe një herë se ato janë konkluzione të përbashkëta dhe jo marrëveshje dhe çdo marrëveshje që mund të arrihet në të ardhmen për njohjet reciproke mes shtetit të Kosovës dhe Serbisë, do të mund dhe do të ratifikohen patjetër nga Kuvendi i Republikës së Kosovës. Pra, Qeveria e Kosovës do ta respektoj në përpikëri Kushtetutën dhe ligjet e saj. Faleminderit!

KRYETARI: A ke pyetje shtesë?

Urdhëro, deputete!

ALMA LAMA: Faleminderit, zot kryeministër!

Por, ekspertët thonë që edhe ato konkluzione janë marrëveshje. Kjo është ajo që kanë nxjerrë ata, përderisa do të implementohen. Mirëpo, ju keni anashkaluar realisht Kuvendin e Kosovës, ajo që dua t'ju them, më fal, po flas unë këtu, ajo që dua të them tani është që kur u pa që Serbisë nuk i interesonte vërtet të bënte marrëveshje që janë në "dëm të saj", siç ishte rasti i fundit kur u anuluan bisedimet, sepse pat një gjë tjetër për të shitur që ishte arrestimi ose për të bërë tregti me BE-n, që

ishte arrestimi i një kriminelit të luftës Haxhiq, që u arrestua dje. Mendoj që Serbia u tërhoq për faktin që kjo ishte marrëveshje negative për atë, mirëpo marrëveshjet të tjera i ka pranuar, sepse nuk janë negative për atë, por janë negative për shtetin e Kosovës, që faktikisht ka rrjedhur nga sovraniteti i tij me këto marrëveshje ose konkluzione t'i quajmë si duam. Faleminderit!

KRYETARI: Kryeministër!

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: E nderuara deputete,
Këto ishin opinione krejt të lira, unë flas në përputhshmëri me Kushtetutën dhe ligjet e Republikës së Kosovës. Qeveria e Republikës së Kosovës nuk ka nënshkruar, pra e ritheksoj edhe një herë, asnjë lloj marrëveshje ndërkombëtare apo traktati me Serbinë, që do të kishte fuqinë ligjore përkatëse për ratifikim nga Kuvendi i Republikës së Kosovës.

Ndërsa, sa i përket debatit dhe opinionit ... ne kemi shprehur opinionet tona edhe javën e kaluar dhe ju ftoj çdo herë që jam i gatshëm të diskutoj për të gjitha çështjet, por edhe një herë ritheksoj, unë dhe Qeveria e Kosovës, do të respektojmë në përpikëri Kushtetutën dhe ligjet e Republikës së Kosovës.

Ndërsa interpretimet tjera të lira dhe politike, unë i çmoj dhe i vlerësoj, por mbi çdo interpretim të lirë, qëndron realiteti i respektimit të plotë të Kushtetutës dhe ligjeve të Republikës së Kosovës.

KRYETARI: Faleminderit!

Deputeti Xhevdet Neziraj, pyetje për ministrin Mahir Yagcilar. Deputet, ministri nuk është këtu, pyetjen do ta bësh a do ta lëmë për seancën e radhës? Faleminderit!

Vazhdojmë. Deputetja Donika Kadaj- Bujupi, pyetje për kryeministrin Hashim Thaçi.

Deputete e ke fjalën.

DONIKA KADAJ- BUJUPI: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

I nderuar kryeministër,

Në mars të vitit 2007 në këtë Kuvend keni deklaruar që 12 muaj më pas do të zgjidhni problemin e furnizimit me rrymë në Kosovë. Sot, 4 vjet pas nuk pati asnjë progres, përkundrazi këta sektorë humbën peshën e rëndësisë së vet si mekanizma zhvillimor në progresin që duhej ta bënte vendi ynë.

Pyetja është: Çka po ndodhë sot me projektin energjetik për ndërtimin e termocentraleve të reja?

KRYETARI: Zoti kryeministër, e ke fjalën.

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: E nderuara deputete Bujupi,

Ju e dini, në vitin 2007, kur kam filluar të qeveris vendin, Kosova ishte në terr dhe sot është në dritë. Kosova ishte në terr dhe sot jemi në finalizim të fillimit të projekteve që definitivisht do ta rregullojnë çështjen e energjisë elektrike me furnizim për 24 orë në ditë. Pra, stabilizimi i furnizimit me energji elektrike për nevojat të tregut të Kosovës, do të vazhdojë të mbetet një prej prioritetëve kryesorë të Qeverisë së Republikës së Kosovës.

Gjatë viteve të kaluara është shënuar rritje e prodhimit të energjisë elektrike për 25% e gjithashtu edhe prodhimi i linjitit është rritur duke mundur që mbajë të gjitha kapacitetet gjeneruese në

punë dhe janë ulur humbjet e energjisë së transmetuar për 10%, ndërsa vetëm furnizimi është rritur për 40%.

Bazuar në projeksionet për rritje të vazhdueshme ekonomike të Kosovës, do të ketë edhe më tej rritje të kërkesës për energji elektrike, prandaj, për të siguruar furnizim të qëndrueshëm me energji elektrike, Qeveria e Republikës së Kosovës po punon intenzivisht për finalizimin e pakos ofertuese për ndërtimin e termocentralit Kosova e Re. I tërë procesi bazohet në strategjinë e energjisë të aprovuar nga Kuvendi i Kosovës, duke respektuar obligimet ligjore që dalin nga traktati i energjisë e që nënkupton zbatimin e direktivave të Bashkimit Evropian për tregun e liberalizuar të energjisë, konkurrencën dhe standardet mjedisore. Siç jeni në dijeni, pas propozimit të Komitetit drejtues të projektit, Qeveria mori vendim, më 10 gusht 2010, për publikimin e draft- kërkesës për propozime dhe të gjitha draft-marrëveshjeve të projektit të cilat iu dërguam 4 ofertuesve të parakualifikuar, kompanitë e parakualifikuara tregojnë interes të vazhdueshëm për këtë projekt.

Për implementimin me sukses të këtij projekti nevojitet edhe mbështetja nga institucionet financiare ndërkombëtare, përkatësisht nga Banka Botërore, dhe dëshiroj ta falënderoj edhe Bankën Botërore për mbështetje. Pra, kjo kërkon pastaj edhe harmonizimin e qëndrimeve të hisedarëve kryesorë të këtij institucioni.

Progresi në këtë drejtim është gjithashtu i kënaqshëm. Progres të dukshëm kemi bërë edhe projektin për privatizimin e Distribuimit dhe Furnizimit, me 4 investitorë të parakualifikuar dhe me angazhimin e Korporatës Financiare Ndërkombëtare. Ky projekt pritet të përfundojë me sukses deri në fund të këtij viti.

Ajo çka po ndodh është një punë e madhe në përgatitjen dhe harmonizimin e dy projekteve, si nga pikëpamja e përfitimeve ekonomike, konkurrencës, përmirësimeve mjedisore dhe ndikimeve sociale, si nga pikëpamja e punësimit, ashtu edhe nga pikëpamja e ndikimit sa më të ulët në tarifat e energjisë elektrike, si rrjedhojë e zgjerimit dhe modernizimit të sektorit të energjisë.

Unë jam i bindur që së shpejti do të raportojmë edhe në Kuvend për përmbylljen me sukses të këtyre dy projekteve. Pra, përgjigja ime është shumë e qartë, e kemi gjetur Kosovën në terr, sot është në dritë. Kemi furnizim rreth 40% më tepër dhe tash jemi në finalizim të projektit të Kosovës se Re, që do të përmbyllë një herë e përgjithmonë krizën energjetike në Republikën e Kosovës. Ju faleminderit, shumë për interesimin tuaj.

KRYETARI: Faleminderit!

Deputete, a ke pyetje shtesë?

DONIKA KADAJ- BUJUPI: Është në kundërshtim të plotë me atë çka e keni thënë në vitin 2007 dhe jemi 4 vjet më pas dhe ju keni shkaktuar kriza të reja duke shpenzuar 300 milionë euro nga buxheti i Kosovës, për import të energjisë elektrike, para të cilat kanë mund të është dashur të shkojnë në: zhvillim ekonomik, në bujqësi, në shëndetësi dhe në aspektet e tjera zhvillimore. Për më tepër keni humbur mundësinë e daljes nga kriza, sepse keni riinicuar procesin në vitin e krizave globale, përderisa projekti në vitin 2007 ka qenë i gatshëm. Pyetja ime është: Në interes të kujt ka qenë riinicimi i këtij procesi gjatë viteve të krizës globale? Për më tepër neglizhenca e Qeverisë suaj dhe mungesa e kapaciteteve ka bërë që të ikin të gjitha kompanitë e fuqishme perëndimore, sot në parakualifikim kanë mbetur kompani, të cilat nuk do t'i bëjnë nderë vendit nëse kanë monopol mbi

energjinë elektrike, sepse në mesin e tyre ka edhe të atilla që nuk njohin shtetësinë edhe ekzistencën e Republikës së Kosovës. ...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Faleminderit!

Kryeministër, a do të përgjigjesh apo e ke dhënë përgjigjen?

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: Duhet ndarë politika nga ekonomia e lirë e tregut, e nderuara deputete. Dhe ju e dini shumë mirë se 4 konsorciumet që janë të interesuara për projektin e Termocentralit “Kosova e Re” janë prej konsorciumeve më të fuqishme botërore, Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Gjermanisë e vendeve tjera të cilat ju i dini gjithashtu. Ndërsa, interesimin e i investitorëve të ndonjë konsorciumi të ndonjë vendi që është i përbashkët me ndonjë konsorcium tjetër, që ende nuk e ka njohur pavarësinë e Kosovës, nuk është në autoritetin e Qeverisë së Kosovës, të marrë një qëndrim të tillë apo të autoriteteve tjera të energjisë në Kosovë, apo Komitetit drejtues për këtë projekt. Ndërsa, dëshiroj të theksoj se dëmet që i janë shkaktuar sektorit të energjisë nga mandati i juaj, jo 300 milionë, por një miliardë vështirë që e mbulojnë. Faleminderit, shumë!

KRYETARI: Faleminderit!

Vazhdojmë. Deputetja Salihe Mustafa, pyetje për ministrin Nenad Rashiq, ministri s’është këtu deputete.

Regjia, fjalën deputetes Salihe Mustafa.

SALIHE MUSTAFA: Edhe ashtu ministri, s’qenka këtu, por unë vendosa me parashtrua pyetjen, sepse besoj që e dëgjon dhe na përgjigjet në një seancë tjetër.

I nderuari kryetar,

I nderuar kryeministër,

Kabinet qeveritar,

Kolegë deputetë,

Pyetjen ime është për ministrin e Punës dhe Mirëqenies Sociale. Me qenë se s’është ministri, por besoj që e dëgjon. Në Shtime është Instituti Special i tipit social- shëndetësor, i cili vepron në kuadër të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, i cili institut ofron përkujdesje 24 orë për personat me aftësi të kufizuara mendore. Në këtë institucion punojnë 111 punëtorë shëndetësorë, të cilët nuk trajtohen si punëtorë shëndetësorë. Këta punëtorë, përveç punës profesionale, janë të ballafaquar edhe me rrezik për shkak të natyrës së punës në këtë institut. Pyetja ime për ministrin e Punës dhe Mirëqenies Sociale është: Ministër, a keni ndonjë plan konkret në përmirësimin e kushteve të punës në këtë institut dhe konkretisht në zgjidhjen e statusit të punëtorëve shëndetësorë?

KRYETARI: Faleminderit, deputete!

Deputetja Afërdita Berisha – Shaqiri, pyetje për ministrin e Arsimit, Ramë Buja.

AFËRDITA BERISHA – SHAQIRI: I nderuar kryetar,

Kryeministër, ministra,

Të nderuar deputetë,

Të nderuar qytetarë,

Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë ka deklaruar se provimit të maturës i janë nënshtruar gjithsej 25 mijë e 973 maturantë, prej të cilëve kanë kaluar testin 41.96%. Sipas të dhënave statistikore maturantët e gjimnazeve në këtë afat kanë arritur 57.5% kalueshmëri, ndërsa ata të shkollave profesionale 25.2%. Pyetja është kjo: Kalueshmëria 42% e testit të maturës duhet të jetë shqetësim, jo vetëm për Ministrinë, por për të gjithë. Sipas raportit të Ministrisë, shihet që maturantët e gjimnazeve kanë kalueshmëri më të mirë se sa shkollat profesionale. Kalueshmëria prej 25.2% në shkollat profesionale është vërtet shqetësuese. Cilat janë masat që do të ndërmerren si Ministri gjatë mandatit tuaj për të parë, analizuar dhe evituar shkaqet dhe dobësitë në sistemin e arsimit në përgjithësi dhe sidomos në shkollat profesionale?

KRYETARI: Ministër e ke fjalën.

MINISTRI RAMË BUJA: I nderuar, zoti kryetar,
I nderuar zoti kryeministër e Kabinet qeveritar,
Të nderuar dhe të dashur deputetë,
E nderuara deputete Shaqiri, faleminderit, shumë për mundësinë e dhënë për të sqaruar se çfarë kemi ndërmarrë dhe po ndërmarrim në vazhdimësi, ne të Ministrisë, që kemi përgjegjësinë më të madhe për të rritur kualitetin mësimor dhe këtë e kemi deklaruar dhe jo vetëm deklaruar, por edhe po angazhohemi.

Unë kam një material më të gjerë të cilin mund t'ua jap të shkruar, por unë do të përgjigjem më shkurt në pyetjen direkt që më keni bërë. Ato shifra që keni dhënë ju dhe janë publikuar dhe janë shumë të sakta, por se çfarë po bëjmë. Në fakt i kam të regjistruar këtu se çfarë janë synimet tona dhe objektivat tona për punët e vazhdueshme dhe po ju them që ky shqetësim me të drejtë e thatë që është, jo vetëm i Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, por i të gjithëve, por 42% nuk është për t'u shqetësuar, sepse është vlerësimi moral që ka ndodhur ndonjëherë i diturisë apo i nxënies së diturisë së nxënësve në Kosovë.

Jemi përpjekur që këtë gjë ta bëjmë në një mbikëqyrje shumë të shtuar dhe cilësore, në mënyrë që ata t'i pasqyrojnë vërtetë dituritë e tyre, duke angazhuar sivjet edhe Universitetin e Prishtinës, ose 700 punëtorë të Universitetit të Prishtinës dhe të Ministrisë, më shumë seç kanë qenë të angazhuar më herët. Dhe, masat që do t'i ndërmarrim për të rritur këtë cilësi të arsimit, jo vetëm profesional, por edhe të niveleve tjera, janë këto. Krijimi i hapësirave të mjaftueshme shkollore, sepse në fakt standardizimi i numrit të nxënësve në klasë, përkundër faktit që në periudhën 2008 – 2011 janë ndërtuar apo janë në proces ndërtimit 100 shkolla, prapëseprapë ka nevojë për zgjerimin e hapësirave shkollore.

Miratimi i Ligjit për arsimin parauniversitar dhe definimi më i qartë i kompetencave të të gjithë nivelet e pushtetit në fushën e arsimit. Kurrikulumi i ri që është bërë gati dhe tani do ta bëjmë edhe publike.

Furnizimi me mjete e konkretizimit nëpër shkolla dhe shfrytëzimi racional i tyre, rritja e fondit të orëve të lëndëve që janë bazë për studimet e tyre profesionale, kohëzgjatja e vitit shkollor, shtimi i ditëve të mësimi, përpilimi i teksteve shkollore dhe materialet tjera, me theks të veçantë në arsimin profesional. Zhvillimi profesional i obligueshëm për mësimdhënësit bazuar në kriteret e licencimit, zgjatja e orarit të punës së mësimdhënëseve, planifikimi i mësimi plotësues, zhvillimi i lëndëve zgjedhore të përzgjedhura ato të cilat janë me interes për profesionin e caktuar, aktivizimi i

aktiviteteve profesionale, harmonizimi dhe zhvillimi profesional. Eliminimi i mungesave në punë të mësimit, eliminimi i mungesave në mësim të nxënësve, vlerësimi i brendshëm të ketë një standard dhe të jetë në ekuivalencë me vlerësimin e jashtëm, angazhimi i stafit të shkollës dhe i drejtorive komunale të arsimit në krijimin e kushteve dhe atmosferës për mësim, bashkëpunimi brenda dhe jashtë shkollës nxënës – mësimit – prindër, monitorimi i mësimit, monitorimi i brendshëm dhe i jashtëm i tyre, mësimit të ketë bazë mbi standardet dhe rezultatet mësimore, inkurajimi ...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Faleminderit, ministër!

Po e presim pyetjen shtesë.

Deputete, a ke pyetje shtesë?

AFËRDITA BERISHA – SHAQIRI: Ministër!

Edhe përkundër përpjekjeve tuaja për t'i evituar parregullsitë gjatë mbajtjes së provimit të maturës që disa janë edhe evituar, mirëpo hapësira e gjerë ka mundësuar komunikimin e maturantëve në mes tyre dhe rezultatin e bën të themi jo shumë të besueshëm apo diskutabil. Me qenë se jetojmë në epokën e teknologjisë informatike, mendoj si zgjidhje alternative në të ardhme duhet të mendojmë mbajtjen e testit me kompjuter, ku rezultati do të gjenerohet menjëherë automatikisht. Prandaj si mendoni ju, sa janë kushtet për mbajtjen e testit me kompjuter dhe a është e përballueshme për Ministrinë, dhe rezultati i ulët në shkollat profesionale a është pasojë e pajisjes jo të mirë me kabinete pune? Po nisem nga ky fakt, sepse nga një raport që kam lexuar nga një shkollë e mesme teknike e Deçanit, thuhet që është kalueshmëria 81.16% dhe është si rezultat i pajisshmërisë shumë të mirë me kabinete pune në këtë shkollë, natyrisht edhe i ...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Fjalën e ka ministri Ramë Buja.

MINISTRI RAMË BUJA: Faleminderit, e nderuara deputete,

E nënkuptova këtë pjesë që nuk e dëgjova, besoj. Çështjet që përmendët keni të drejtë se janë faktorët që ndikojnë në këtë çështje. E dimë se nuk ka qenë testi i maturës i përkryer, por ka qenë më i mirë se viteve të tjera dhe është shumë e natyrshme që këto dobësi do të eliminohen në gusht, shumica e këtyre, jo të gjitha. Kemi bërë një eksperimentim në Deçan ku është përsëritur testi i maturës dhe janë eliminuar ato dukuri negative që kanë qenë prezent më herët dhe është treguar shumë e suksesshme. Çështja e digjitalizimit, ne jemi të favorizuar në rajon që kemi trajnuar, jo më pak se tetë mijë e pesëqind e sa mësimit për kompjuterin dhe botën kompjuterike, kështu që jemi në favor në këtë gjë, por Ministria aktualisht nuk mund ta përballojë mundësinë e digjitalizimit për aq sa ne dëshirojmë ta bëjmë, vitin që vjen menjëherë, por dy vjetët e më pastajmë besoj po dhe kjo mundësi do të krijohet pa asnjë dilemë. Faleminderit, shumë!

KRYETARI: Faleminderit, ministër!

Deputetja Time Kadriaj, pyetje për ministrin Ferid Aganin.

Deputete e ke fjalën.

TIME KADRIJAJ: Faleminderit, zoti kryetar,

Të nderuar deputetë,

Prej tetorit të vitit 2010 një dikaster shumë i rëndësishëm në Ministrinë e Shëndetësisë siç është Inspektorati Shëndetësor ka mbetur pa kryeinspektor. Në rrethana të krijuara në këtë dikaster është vendosur njëra nga inspektorët shëndetësor. Me Ligjin e Inspektoratit Shëndetësor detyrat e inspektoratit janë: mbikëqyrja e institucioneve shëndetësore private publike dhe humanitare, ndërsa prapë me Ligjin e Inspektoratit Shëndetësor detyrat e inspektorëve shëndetësorë janë mbikëqyrja e respektimit të ligjshmërisë në institucionet shëndetësore dhe të punëtorëve shëndetësorë, respektimi i normave etike dhe humanitare dhe standardet e cilësisë.

Në prill të këtij viti është hapur konkursi për kryeinspektor shëndetësor dhe ende s'është bërë zgjidhja e tij. Pyetja është: Ministër, si mund të monitorohen të gjitha institucionet shëndetësore me kaq pak inspektorë me një ushtrues detyre?

KRYETARI: Faleminderit!

Ministër, e ke fjalën.

MINISTRI FERID AGANI: I nderuar zoti kryetar,

I nderuar kryeministër, anëtarë të Kabinetit qeveritar,

Të nderuar deputetë,

E nderuara zonja deputete,

Pjesa e fundit të pyetjes ka qenë e shkruar dhe e kam të qartë. Faleminderit, për ngritjen e kësaj çështje!

Inspektorati Shëndetësor është një prej organeve ekzekutive të Ministrisë së Shëndetësisë e cila ka përgjegjësi të drejtpërdrejtë në Kabinetin e ministrit të Shëndetësisë, pra i përgjigjet ministrit të Shëndetësisë dhe për këtë arsye e ka pasur një vëmendje të posaçme gjatë mandatit tim. Siç e thatë edhe ju në prill të këtij viti kam kërkuar që të hapet menjëherë konkursi për kryeinspektorin e Ministrisë së Shëndetësisë dhe ky konkurs do të përfundojë sipas informatës që e kam nga shërbimi civil i Ministrisë, deri në fund të këtij muaji, dhe më nuk do të kemi ushtrues detyre në këtë post.

Është fakt se numri i inspektorëve shëndetësorë është tejet i vogël, përpjekjet janë bërë që ky numër të shtohet, por mundësitë buxhetore të vendit janë shumë të ulëta për vende të reja të punës. Këtë çështje po e adresojmë nëpër mjet të riorganizimit të Administratës Publike në Ministrinë e Shëndetësisë dhe rivendosjes së punëtorëve të punësuar aktualisht në Ministri që posedojnë kualifikime të domosdoshme profesionale dhe natyrisht nëpërmjet një procesi të trajnimit dhe rikualifikimi për detyrën e inspektorit të shëndetësisë.

Unë mendoj se puna që po e bën inspektorati shëndetësorë është për çdo lëvdatë është një punë sistematike me numër tejet të vogël të tyre, po ashtu konsideroj se fuqizimi i këtij inspektorati duhet të jetë edhe preokupim edhe i ministrive të tjera të Qeverisë dhe në këtë drejtim jemi duke punuar brenda Qeverisë që të sigurojmë rritjen e numrit të inspektorëve shëndetësorë në vitin 2012, nëpërmjet sigurimit të mjeteve buxhetore për këtë qëllim. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

A ke pyetje shtesë, deputete?

TIME KADRIJAJ: Faleminderit!

Me këtë po shihet se në çfarë shkalle të prioritetit Qeveria e Kosovës e ka vendosur shëndetësinë e Kosovës. Ministër keni thënë që jeni duke punua në organogram, keni punëtorë që vendin e punës e kanë vend pushimi, sistemoni në vendet ku ka më shumë punë. Edhe pyetja është: Mos e politizoni zgjedhjen e kryeinspektorit shëndetësor edhe zgjedhjen e drejtorit të QKUK-së, sepse arsyet e anulimit dhe shtyrjes nuk po kanë as arsyeshmëri ligjore as administrative, po thjeshtë është politike. Faleminderit!

KRYETARI: Ministër, e ke fjalën.

MINISTRI FERID AGANI: Faleminderit, zonja deputete!

Faleminderit, edhe për përkrahjen që ma dhatë, qëndrimi se nëpërmjet riorganizimit të Ministrisë së Shëndetësisë duhet të sigurojmë edhe poste të reja për inspektorë shëndetësorë, sepse mundësitë buxhetore të vendit në këtë aspekt për vende të reja të punës janë shumë të kufizuara.

Ndërsa sa i përket politizimit të sektorit të shëndetësisë e vetmja rrugëdalje prej kësaj situate të pavolitshme është ajo që ne e kemi filluar si ministri, reforma e sistemit shëndetësor. Projektligjet e shëndetësisë dhe sigurimeve shëndetësore janë në Qeveri përpara dhe janë në harmonizim e sipër me Bakën Botërore dhe Fondin Monetar Ndërkombëtar dhe reformimi i sistemit shëndetësor dhe të mundësojë këtë ndarje definitive dhe ndërhyrjen e politikës në sistemin shëndetësor. Nuk ka rrugë tjetër, në të kundërtën do të jemi të ballafaquar me situata të tilla të zhagitjeve të proceseve të zgjedhjes. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, ministër!

Deputeti Niazi Idrizi, pyetje për ministrin Bedri Hamza.

NIAZI IDRIZI: Faleminderit, kryetar!

I nderuar ministër Hamza.

Është fakt i ditur që ATK-ja po jep një kontribut të madh për grumbullimin e të hyrave në buxhetin e konsoliduar të Kosovës. Më intereson ta di: Sa është shuma e atyre të hyrave në përqindje nëpër regjione, sipas regjioneve për vitin 2010 dhe për gjashtëmujorin e vitit 2011 dhe në kontekst të kësaj domethënë nga shuma e përgjithshme, më intereson ta di sa është përqindja e kompanive që janë të pajisura me arka fiskale sipas regjioneve nga numri i përgjithshëm i kompanive? Faleminderit!

KRYETARI: Ministri, e ka fjalën.

MINISTRI BEDRI HAMZA: I nderuar zoti kryetar i Kuvendit,

I nderuar zëvendëskryeministër, ministra,

Të nderuar deputetë,

I nderuar zoti Idrizi, faleminderit, shumë për pyetjen!

Të hyrat të cilat i administron dhe i mbledh Administrata Tatimore në vazhdimësi ka një trend pozitiv. Për vitin 2010 Administrata Tatimore e ka tejkaluar planin për mbledhjen e të hyrave për 2%, ndërsa krahasim me periudhën e njëjtë të vitit paraprakë kemi një rritje prej 7%. Këto të hyra sipas regjioneve të shprehura në përqindje janë kështu: Ferizaj 2.97%, Gjakova 1.59%, Gjilani 2.16%, Mitrovica 2.19%, Njësia e tatimpaguesve të mëdhenj 57.36%, Peja 3.23%, Prishtina I, 20.14%, Prishtina II, 5.80% dhe Prizreni 4.56%.

Për vitin 2011, ne kemi një plan mjaftë ambicioz dhe trendi është mjaftë pozitivë, ky si rezultat i vetë deklarimit dhe vetë pagesës së këtyre tatimeve sepse nga tatimet e paguara të cilat i administrojnë dhe i mbledh Administrata Tatimore mbi 90% prej atyre janë të vetë deklaruara dhe vetë paguara nga tatimpagues. Për periudhën gjashtëmujore të këtij viti kemi një rritje në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit paraprak prej 19.5%, dhe nëpër regjione shprehur në përqindje është kjo: Ferizaj 2.44%, Gjakova, 1.37%, Gjirokastra 2.29%, Mitrovica 1.95%, Njësia e tatimpaguesve të mëdhenj 60.41%, Peja 2.53%, Prishtina I 20.37%, Prishtina II 5.07% dhe Prizreni 3.56%. Sa i përket fiskalizimit të bizneseve deri më tani janë vendosur gjithsej 15 mijë e 795 pajisje fiskale. Objektivi i Administratës Tatimore për vitin 2011 është që të fiskalizohen 19 mijë biznese, që këto 19 mijë biznese kanë qarkullim mbi 5000 euro dhe marrin pjesë mbi 90% në totalin e qarkullimit të përgjithshëm dhe në kuadër të këtij fiskalizimi bën pjesë edhe fiskalizimi dhe pajisja me pajisje elektronike fiskale për pikat e karburanteve. Pjesa tjetër për biznese të cilat kanë qarkullim deri në 5000 euro planifikohet që të fiskalizohen gjatë vitit 2012 dhe 2013.

KRYETARI: Faleminderit, ministër!
A ke pyetje shtesë, deputet?

NIAZI IDRIZI: I nderuar ministër,
Më interesoj si duke paska një raport të drejtë në mes të grumbullimit të të hyrave të tatimeve me furnizimin e kompanive me arka fiskale së paku mua po më del kështu. Dëshiroj ta di cilat masa i keni ndërmarrë që ky trend i rritjes së furnizimit të kompanive me arka fiskale të rritet edhe më tutje me qëllim që të kemi edhe të hyra më të mëdha të tatimeve. Faleminderit! Nëse është kështu, nuk e di a është kështu po duket që po më del qashtu.

KRYETARI: Ministër, e ke fjalën!

MINISTRI BEDRI HAMZA: Në kuadër të Administratës Tatimore janë duke u zhvilluar shumë aktivitete të cilat kanë për qëllim zvogëlimin e informalitetit. Një prej arsyeve që ka ndikuar sigurisht në ngritjen e të hyrave domethënë për 19.5% në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit paraprak është edhe projekti i arkave fiskale. Aktualisht janë të licencuar 4 operatorë të cilët duhet t' i furnizojnë me pajisje fiskale. Procesi është i hapur, nëse çdo moment vërehen se këta operatorë nuk janë në gjendje që t' i furnizojnë tatimpagues me arka fiskale ky proces është i hapur dhe mund të futen edhe tjera dhe sigurisht që Administrata Tatimore ka vazhduar me numra fiskal, ka vazhduar me prejardhjen e mallit dhe mbi të gjitha me ngritjen e shërbimit të edukimit të tatimpaguesve që tatimpaguesit vetë t' i deklarojnë dhe vetë t' i paguajnë tatimet. Ne nuk jem të interesuar që ata t' i ndëshkojmë, por jemi të interesuar që ata të trajtohen barabar dhe t' i kryejnë obligimet e tyre në përputhshmëri me ligjet. Faleminderit!

KRYETARI: faleminderit, ministër!
Deputeti Lutfi Haziri, ka dy pyetje, një ka për ministrin Dardan Gashi, i cili nuk është, ti lexoje pyetjen për ministrin Bajram Rexhepi.

LUTFI HAZIRI: Faleminderit!

Më vjen keq së s' është Dardani këtu për mu përgjigj një pyetje që është shumë në interes të zhvillimit, por në pyetjen e dytë ministri është përgjigj në Komision parlamentar pardje, falënderoj, shumë! Përveç raportimit edhe kjo pyetje është shtjerrë, besoj që sot është e paarsyeshme, e panevojshme të përsëritet. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Deputetja Donika Kadaj – Bujupi, pyetje për kryeministrin Hashim Thaçi, e keni lexuar pyetjen e dytë e jo të parën, tash mund ta lexoni të parën, por kryeministri nuk është këtu, veç zëvendëskryeministri ose ministri nëse donë të përgjigjen.

DONIKA KADAJ – BUJUPI: I nderuar kryetar,

Në fakt unë nuk e di qysh i keni radhitur pyetjet se për një ditë i ka dërguar, të shohim administrata qysh i ka radhitur. Pyetja ime lidhej me dy raportet e fundit Freedom House dhe Bankës Botërore që flasin që Kosova ka degraduar shumë në fushën e biznesit apo ambientit për zhvillimin e biznesit dhe gjithashtu në fushën e mediave. Do të thotë kryeministri Thaçi po vazhdon t'i intimidojë mediat, po vazhdon t'i intimidojë bizneset dhe kështu raportet apo çdo vit është më i keq se viti paraprak. Unë pyetjen desha t'ia bëjë që a ja ka borxh Kosova të dështoj për shkak se ai duhet patjetër të jetë qenë kolltuk, mirëpo duke e ditur përgjigjen e tij optimiste do të kërkoj, do të thotë si deputete e Kuvendit të Kosovës që duke marrë parasysh që realiteti s'po përkon aspak me atë çka po thotë kryeministri, ta bëjë një ekzaminim psikiatrik dhe të na sjell një raport në Kuvend, sepse na mori në qafte, sepse realiteti dhe jeta e qytetarëve të Kosovës është shumë larg asaj çfarë ai po e prezanton dhe po pasqyron këtu. Ju faleminderit! Po më vjen keq që s'është këtu, por besoj ia përcjellin vartësit e tij.

KRYETARI: Deputeti, Niazi Idrizi, pyetje për ministrin Bajram Rexhepi.

NIAZI IDRIZI: I nderuar ministër Rexhepi,

Para tre muaj e gjysmë jo vetëm nga unë, por edhe nga deputetët e tjerë është shtruar brenga e një numri të konsiderueshëm të qytetarëve që vijnë nga: Medvegja, Bujanovci, Presheva, Kumanova dhe ndonjë qytet tjetër i Maqedonisë të cilët janë ndjekur nga luftërat atje dhe aktualisht jetojnë në Kosovë. Këta njerëz nuk janë të pajisur me dokumente valide dhe si të tillë vazhdojnë të qëndrojnë pothuajse gjysmë ilegalisht në Kosovë. Domethënë problem është vetë Ligji mbi nënshtetësinë neni 9 dhe 10, i cili kërkon nga ata që për ta kërkuar nënshtetësinë duhet që të jenë të pajisur me një dëshmi se nuk ndiqen, nuk janë nën hetime në vendet prej nga vijnë. Dëshiroj ta di ky ligj, ky nen a do të ndërmerren veprime me qëllim që këtyre njerëzve t'iu lehtësohet për shkak se këta jetojnë që 11 vjet në Kosovë e të njëjtit të pajisen me nënshtetësi edhe me dokumente të identitetit. Këta njerëz kanë nevoja të mëdha si shëndetësore, kanë nevoja të shkollimit, kanë nevoja të punësimit jashtë në një farë mënyre ata janë të privuar nga ato të drejta. Faleminderit!

KRYETARI: Ministër, e ke fjalën!

MINISTRI BAJRAM REXHEPI: Faleminderit, i nderuar kryetar i Parlamentit!

Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

I nderuar deputet Idrizi,

Në përgjigjet e pyetjes suaj ju japë sqarim vijues. Ligji për shtetësinë e Kosovës nuk bën dallime sa i përket kombësisë në aspekt të plotësimit të kushteve për fitimin e shtetësisë së Kosovës me natyralizim. Pra, të gjithë të huajt pa dallim duhet t'i plotësojnë kushtet për fitimin e shtetësisë, duke përfshirë edhe kushtin që personi të mos jetë i dënuar për vepra penale. Kushti i tillë është standard ndërkombëtar dhe si i tillë është paraparë edhe Ligjin për shtetësinë të republikës së Kosovës.

Ndërsa sa i përket pyetjes lidhur me iniciativën për ndryshimin e Ligjit për shtetësi, ju njoftoj se Ligji për shtetësi është iniciuar për plotësim- ndryshim nga ana e Ministrisë së Punëve të Brendshme, konkretisht Departamentit për Shtetësi, Azil dhe Migracion dhe i njëjti ka kaluar fazën e grupeve punuese dhe së shpejti do të procedohet për miratim në Qeveri dhe pastaj do të procedohet në Parlament. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!
Deputet, a ke pyetje shtesë!

NIAZI IDRIZI: Më intereson ta di i nderuari ministër, në ligjin e ri a do të ketë ndryshime për sa i përket lehtësirave që do të mund t'i përfitojmë një pjesë e qytetarëve të këtyre vendeve që i përmenda e të cilët janë të ndjekur për motive politike, për motive që kanë ardhur nga lufta si rezultat i luftës e luftërave atje janë këtu në Kosovë apo ata do të vazhdojnë të mbeten kështu siç janë? Dëshiroj ta theksoj një fakt këto janë, përgjigja e juaj ka qenë korrekte, ky është një standard, mirëpo edhe në kohërat e më hershme nga Kosova në Perëndim kur ka ekzistuar ky standard ka ikur me mijëra njerëz të cilët kanë pasur mundësi të përfitojnë dokumente në ato vende dhe të jenë shtetas të atyre vendeve. Në këtë pikë dëshiroj ta marr një përgjigje nga ju. Faleminderit!

KRYETARI: Ministër, a ke përgjigje shtesë!

MINISTRI BAJRAM REXHEPI: Unë si thashë ai do të procedohet në Qeveri edhe në Parlament dhe ju si Parlament keni mundësi të provoni ta amendamenti, ne si Qeveri nuk mund të bëjmë dallime të tilla dhe natyrisht që jem fleksibil, ata nuk njekën as penalisht nëpër territor të Kosovës, pavarësisht që nuk e kanë shtetësinë të rregulluar të Kosovës.

KRYETARI: Faleminderit!
Deputeti Lutfi Haziri, pyetje për ministrin Dardan Gashi. A doni ta bëni pyetjen për Dardan Gashin që nuk është këtu.

LUTFI HAZIRI: Nuk është këtu, po e pres, shpresoj në seancën tjetër të jetë, nëse jo atëherë pres përgjigjen me shkrim. Faleminderit!

KRYETARI: Pyetjet e deputetëve që nuk morën përgjigje në dy seanca plenare do të publikohen në revistën e Kuvendit, sipas nenit 45, paragrafi 11 të Rregullores së Kuvendit.

I ramë ziles për të ardhur se na duhet kuorumi i nevojshëm tani.

Pika e tretë e rendit të ditës:

3. Miratimi i procesverbalit të mbledhjeve plenare të mbajtura më 8 dhe 14 korrik 2011

Pyes, a keni vërejtje në këto procesverbale?
Fjalën e ka deputeti Hydajet Hyseni.

HYDAJET HYSENI: Faleminderit, zoti kryetar!
Të nderuar deputetë,

Ndonëse ne këtu shqyrtojmë dhe miratojmë procesverbalin, unë kam një vërejtje në transkript, po transkripti është pjesë e procesverbalit dhe do ta injoroja sikur të mos ishte diçka që është mendoj thelbësore. Në transkript, në pjesën e fjalës që kam mbajtur në mbledhjen e 14 korrikut, është cunguar dhe është shtrembëruar, është humbur, jam i bindur, pa dashje, pa qëllim, kuptimi i pjesës, sidomos vërejtjes, ishte fjala për konkluzat e dakorduara, siç u tha, midis Qeverisë së Kosovës dhe Qeverisë së Serbisë, që lidhen me regjistrin civil, është humbur kuptimi i asaj që është thënë atje dhe është kontestuar, sidomos fjalia: “të dy palët do të bëjnë gjithçka që është e mundur për të plotësuar regjistrat civilë në Kosovë”. Dhe, kjo është në kundërshtim me parimet që kemi miratuar në Kuvend, sepse nuk mund të jetë Serbia palë në çështjet që edhe me Kushtetutën tonë, edhe me ligjet tona, madje edhe me Kushtetutën e Kosovës Autonome kanë qenë kompetencë ekskluzive e Kosovës. Kërkoj që kjo të korrigjohet dhe ofroj bashkëpunimin tim për ta saktësuar. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Dikush tjetër a dëshiron fjalën? Nëse jo, konstatoj se Kuvendi miratoi procesverbalet e mbledhjeve plenare të mbajtura më 8 dhe 14 korrik dhe gjithashtu kërkoj që administrata ta ketë parasysh kërkesën për ndryshimin e stenogramit të këtyre, e kërkuar nga deputeti Hydajet Hyseni. Faleminderit!

Vazhdojmë me pikën e katërt të rendit të ditës:

4. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për bashkëpunim ndërkomunal dhe partneritet

Po vazhdoj me konstatimet derisa t’i kryej unë, pastaj vijnë deputetët edhe e kemi kuorumin në sallë. Tani janë në sallë 63 deputetë.

Komisionet parlamentare kanë shqyrtuar Projektligjin për bashkëpunim ndërkomunal dhe partneritet dhe Kuvendit i kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara.

Para se të procedojmë me votimin e amendamenteve, ftoj raportuesin e Komisionit funksional për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport, Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media, deputetin Sadri Ferati, që para deputetëve të arsyetojë raportin me rekomandime, natyrisht nëse e do fjalën. Nuk është këtu.

Vazhdojmë me votimin e amendamenteve të propozuara sipas radhës së paraqitur në raportin e Komisionit funksional.

Fillojmë votimin e amendamenteve që janë gjithsej 22.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim, dhe votojmë tash amendamentin 1.

Konstatoj se me 49 vota “për”, asnjë “kundër” dhe 8 abstenime, Kuvendi miratoi amendamentin 1.

Amendamenti 2.

Votojmë tash:

Konstatoj se me 52 vota “për”, asnjë “kundër” dhe 9 abstenime, miratohet amendamenti 2.

Amendamenti 3.

Votojmë tash:

Konstatoj se me 46 vota “për”, një “kundër” dhe 9 abstenime, miratohet amendamenti 3.

Amendamenti 4.

Votojmë tash:

Konstatoj se me 56 vota “për”, asnjë “kundër” dhe 9 abstenime, miratohet amendamenti 4.

Amendamenti 5.

Votojmë tash:

Konstatoj se me 52 vota “për”, 2 “kundër”, dhe 9 abstenime, miratohet amendamenti 5.

Amendamenti 6.

Votojmë tash:

Konstatoj se me 57 vota “për”, asnjë “kundër” dhe 9 abstenime, miratohet amendamenti 6.

Amendamenti 7.

Votojmë tash:

Konstatoj se me 57 vota “për”, asnjë “kundër”, dhe 9 abstenime, miratohet amendamenti 7.

Amendamenti 8.

Votojmë tash:

Konstatoj se me 49 vota “për”, asnjë “kundër”, dhe 8 abstenime, miratohet amendamenti 8.

Amendamenti 9.

Votojmë tash:

Konstatoj se me 56 vota “për”, asnjë “kundër”, dhe 8 abstenime, miratohet amendamenti 9.

Amendamenti 10.

Votojmë tash:

Konstatoj se me 60 vota “për”, asnjë “kundër”, dhe 5 abstenime, miratohet amendamenti 10.

Amendamenti 11.

Votojmë tash:

Konstatoj se me 57 vota “për”, asnjë “kundër”, dhe 6 abstenime, miratohet amendamenti 11.

Amendamenti 12.

Votojmë tash:

Konstatoj se me 56 vota “për”, asnjë “kundër”, dhe 6 abstenime, miratohet amendamenti 12.

Amendamenti 13.

Votojmë tash:

Konstatoj se me 52 vota “për”, asnjë “kundër”, dhe 8 abstenime, miratohet amendamenti 13.

Amendamenti 14.

Votojmë tash:

Konstatoj se me 57 vota “për”, asnjë “kundër”, dhe 8 abstenime, miratohet amendamenti 14.

Amendamenti 15.

Votojmë tash:

Konstatoj se me 58 vota “për”, asnjë “kundër”, dhe 10 abstenime, miratohet amendamenti 15.

Amendamenti 16.

Votojmë tash:

Konstatoj se me 56 vota “për”, asnjë “kundër”, dhe 9 abstenime, miratohet amendamenti 16.

Amendamenti 17.

Votojmë tash:

Konstatoj se me 59 vota “për”, asnjë “kundër”, dhe 8 abstenime, miratohet amendamenti 17.

Amendamenti 18.

Votojmë tash:

Konstatoj se me 62 vota “për”, asnjë “kundër”, dhe 10 abstenime, miratohet amendamenti 18.

Amendamenti 19.

Votojmë tash:

Konstatoj se me 60 vota “për”, 1 “kundër”, dhe 10 abstenime, miratohet amendamenti 19.

Amendamenti 20.

Votojmë tash:

Konstatoj se me 60 vota “për”, asnjë “kundër”, dhe 8 abstenime, miratohet amendamenti 20.

Amendamenti 21.

Votojmë tash:

Konstatoj se me 62 vota “për”, asnjë “kundër”, dhe 9 abstenime, miratohet amendamenti 21.

Tani votojmë amendamentin e fundit, amendamenti 22.

Konstatoj se me 60 vota “për”, asnjë “kundër” dhe 9 abstenime, miratohet amendamenti 22.

Tani votojmë ligjin në tërësi. Prezent janë 78 deputetë.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim votojmë tash:

Konstatoj se me 64 vota “për”, një “kundër” dhe 9 abstenime, Kuvendi miratoi Ligjin për bashkëpunimin ndërkomunal dhe partneritet.

Pika e pestë e rendit të ditës:

5. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshim dhe plotësim e Ligjit për themelimin e regjistrit të të drejtave të pronës së paluajtshme

Komisionet parlamentare kanë shqyrtuar Projektligjin për ndryshim dhe plotësim të Ligjit për themelimin e regjistrit të drejtave të pronës së paluajtshme dhe Kuvendit i kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara.

Para se të procedojmë me votim të amendamenteve kryetari i Komisionit funksional, a e do fjalën? Nuk e do fjalën.

Vazhdojmë atëherë me votimin.

Votojmë tri amendamente.

Tani votojmë amendamentin 1.

Konstatoj se me 69 vota “për”, një “kundër” dhe një abstenim, miratohet amendamenti 1.

Amendamenti 2.

Votojmë tash:

Konstatoj se me 68 vota “për”, një “kundër” dhe asnjë abstenim, miratohet amendamenti 2.

Amendamenti 3.

Votojmë tash:

Konstatoj se me 64 vota “për”, një “kundër” dhe asnjë abstenim, miratohet amendamenti 3.

Tash votojmë ligjin në tërësi.

Prezentë 77 deputetë.

Konstatoj se me 71 votë “për”, një “kundër” dhe asnjë abstenim, Kuvendi miratoi Projektligjin për ndryshim dhe plotësimin e Ligjit për themelimin e regjistrimit të drejtave të pronës së paluajtshme.

Drejton seancën nënkryetari i Kuvendit të Kosovës, zoti Xhavit Haliti

KRYESUESI: Faleminderit!

Pika e gjashtë e rendit të ditës-

6. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Këshillin Ekonomiko-Social

Komisionet parlamentare kanë shqyrtuar projektligjin për Këshillin ekonomiko-social dhe Kuvendit i kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara. Para se të procedojmë me votimin e amendamenteve ftoj raportuesen e Komisionit funksional për Shëndetësi, Punë, Mirëqenie Sociale, deputeten Flora Brovina, që para deputetëve ta arsyetoj; raportin me rekomandime.

FLORA BROVINA: Një amendament, të cilin komisioni i ka aprovuar unanimisht, përveç një amendamenti ku shumica ka votuar. Para se të nxirren këto amendamente kemi organizuar debat publik dhe grupi punues ka punuar bashkë me palët e interesuara që janë Qeveria e Kosovës, punëmarrësi dhe punëdhënësi. Kemi marrë në konsiderim debatin e zhvilluar këtu në Kuvend dhe vërejtjet që na janë dhënë nga Oda Ekonomike, dega në Prizren, të cilët na kanë dërguar vërejtje, sugjerime të shkruara. Domethënë, në emër Grupit, Komisionit propozojmë që këto amendamente të aprovohen. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Nuk ka të paraqitur për diskutim.

Shkojmë në miratim të amendamenteve.

Amendamenti 1.

Votojmë tani:

Konstatoj se me 54 vota “për”, asnjë “kundër” dhe asnjë abstenim, miratohet amendamenti 1.

Për amendamentin 2, a ke diçka?

Regjia fjalën deputetes Lama.

ALMA LAMA: Faktikisht e kisha për nenin nr. 5, si për amendamentet. Nëse ka mundësi që të ndryshohet fjalia është pak e pakuptimit unë e kam ashtu rregulluar. A mund ta lexoj. Jo, s' është amendament është neni numër 5 , po unë tani e kam marrë ligjin përfundimtar, kështu që mund ta lexoj.

KRYESUESI: U krye ajo, jo. Është votuar ajo.

Amendamenti 2.

Votojmë tani:

Konstatohet se me 58 vota "për", miratohet amendamenti 2.

Amendamenti 3.

Votojmë tani:

Konstatohet se me 61 vota "për", një abstencion, miratohet amendamenti 3.

Për amendamentin e 4 është paraqitur Rita Hajzeraj- Beqaj.

RITA HAJZERAJ- BEQAJ: Faleminderit, zoti kryesues!

Unë e mora fjalën me qëllim, këtu e kemi nenin 8 të funksionet e KES-it, përpara ku ka funksionuar Këshilli Ekonomiko Social, do të thotë, pa ligj e kemi pasur Ministria e Ekonomisë dhe Financave, ndërsa tash e kemi Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik dhe Financave. Unë konsideroj me qenë se merret Këshilli Ekonomiko- Social me zhvillimin e politikave.

KRYESUESI: Ju lutem, amendamenti 4 është në votim...

RITA HAJZERAJ- BEQAJ: Para se të shkojmë te amendamenti 4, ne i kemi dhënë vërejtjet.

KRYESUESI: Kur vjen te amendamenti 8 ke mund të paraqitesh përpara, nuk është objekt tash amendamenti 4.

RITA HAJZERAJ-BEQAJ: Nuk është amendamenti 8, është neni 8 para amendamentit 4. Është neni 8 që nuk ka ndryshuar, unë kam thënë edhe në seancën e kaluar kemi dhënë vërejtje.

KRYESUESI: Po s'është amendament tash sot të bisedojmë. Pse s'ke bërë amendament?

RITA HAJZERAJ- BEQAJ: Po, në seancën e kaluar kemi dhënë vërejtje për këtë nen.

KRYESUESI: Është dashur të bëjë amendament një komision. Unë tash nuk mund ta ndryshoj situatën.

RITA HAJZERAJ- BEQAJ: Unë po e bëj një propozim...

KRYESUESI: Ka kaluar nëpër të gjitha komisionet, ligji.

RITA HAJZERAJ- BEQAJ: S'ka kaluar nëpër të gjitha komisionet.

KRYESUESI: Ju mund të paraqitni amendament të ri, prapë ta amendamenti ligjin për se dyti.

Amendamenti 4.

Votojmë tani:

Konstatoj se me 53 vota “për”, 4 “kundër” dhe 4 abstenime, miratohet amendamenti 4.

Amendamenti 5.

Votojmë tani:

Konstatoj se me 61 vota “për”, një abstenim, dhe 1 “kundër”, miratohet amendamenti 5.

Te amendamenti 7 është paraqitur deputetja Salihe Mustafa.

Amendamenti 7

Votojmë, tani.

Konstatoj se me 61 vota “për”, 1 “kundër”, asnjë abstenim, miratohet amendamenti 7.

Amendamenti 8

Votojmë, tani.

Konstatoj se me 59 vota “për”, 3 “kundër”, 1 abstenim, miratohet amendamenti 8.

Amendamenti 9

Votojmë, tani.

Konstatoj se me 64 vota “për”, 1 “kundër”, 3 abstenime, miratohet amendamenti 9.

Amendamenti 10

Votojmë, tani.

Konstatoj se me 66 vota “për”, 0 “kundër”, 4 abstenime, miratohet amendamenti 10.

Amendamenti 11

Votojmë, tani.

Konstatoj se me 64 vota “për”, 1 “kundër”, 2 abstenime, miratohet amendamenti 11.

Amendamenti 12

Votojmë, tani.

Miratohet amendamenti 12.

Amendamenti 13

Votojmë, tani.

Miratohet amendamenti 13.

Amendamenti 14

Votojmë, tani.

Miratohet amendamenti 14.

Amendamenti 15

Votojmë, tani.

Miratohet amendamenti 15.

Amendamenti 16

Votojmë, tani.

Miratohet amendamenti 16.

Amendamenti 17

Votojmë, tani.

Miratohet amendamenti 17.

Amendamenti 18

Votojmë, tani.

Miratohet amendamenti 18.

Amendamenti 19

Votojmë, tani.

Miratohet amendamenti 19.

Amendamenti 20

Votojmë, tani.

Miratohet amendamenti 20. Më falni, amendamenti 21 miratohet. Tani votojmë tekstin e Projektligjit në tërësi, me amendamentet e miratuara.

Konstatohet se në sallë janë 79 deputetë.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim, votojmë tani.

Ju faleminderit!

Konstatohet se me 71 vota “për”, 2 “kundër” asnjë abstenim, Kuvendi miratoi Ligjin për Këshillin Ekonomiko-Social.

Pika e shtatë e rendit të ditës:

7. Shqyrtimi i Projektligjit për mbrojtjen nga zjarri

Konstatimet hyrëse: Komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar Projektligjin për mbrojtjen nga zjarri dhe Kuvendi i kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara. Para se të procedojmë me votimin e amendamenteve, ftoj raportuesin e Komisionit funksional për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë të Kosovës, deputetin Xhelili, që para deputetëve ta arsyetojë raportin me rekomandime.

FATMIR XHELILI: Ju faleminderit, kryesues!

I nderuari kryeministër,

Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Pas punës në Grupin punues, Ligji qartë i ka adresuar të gjitha obligimet për instrumentet e shtetit për përcaktimin e masave parandaluese dhe obliguese për mbrojtje nga zjarri, si dhe i ka

përcaktuar detyrat e ndërtimtarëve dhe organizatave të cilat duhet t'i përcaktojnë masat nga zjarri dhe besoj që Ligji është i gatshëm për lexim të dytë.

KRYESUESI: Ju faleminderit!
Fillojmë votimin e amendamenteve.

Amendamenti 1
Votojmë, tani.
Miratohet amendamenti 1.

Amendamenti 2
Votojmë, tani.
Miratohet amendamenti 2

Amendamenti 3
Votojmë, tani.
Miratohet amendamenti 3.

Amendamenti 4
Votojmë, tani.
Miratohet amendamenti 4.

Amendamenti 5
Votojmë, tani.
Miratohet amendamenti 4.

Amendamenti 6
Votojmë, tani.
Miratohet amendamenti 6.

Amendamenti 7
Votojmë, tani.
Miratohet amendamenti 7.

Amendamenti 8
Votojmë, tani.
Miratohet amendamenti 8.

Amendamenti 9
Votojmë, tani.
Miratohet amendamenti 9.

Ju faleminderit!
Tani po votojmë Projektligjin në tërësi.
Votojmë, tani.

Në sallë janë 81 deputetë,
Konstatoj që me 76 vota “për”, asnjë “kundër”, asnjë abstenim, Kuvendi miratoi Ligjin për mbrojtjen nga zjarri.

Pika e tetë e rendit të ditës:

8. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për noterinë

Komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për noterinë dhe Kuvendit i kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamentin e propozuar.

Para se të procedojmë me votimin e amendamentit të vetëm, ftoj kryetarin e Komisionit funksional për Legjislacion, deputetin Arben Gashi që para deputetëve të arsyetojë raportin me rekomandime. Zoti Gashi, e keni fjalën!

Nuk dëshiron ta marrë fjalën. Atëherë, votojmë të vetmin amendament.

Amendamenti 1

Votojmë, tani.

Miratohet amendamenti 1.

Tani votojmë Projektligjin në tërësi.

Votojmë, tani.

Konstatoj se me 74 vota “për”, asnjë “kundër”, asnjë abstenim, Kuvendi miratoi Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për noterinë.

Pika e nëntë e rendit të ditës:

9. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit

Në bazë të nenit 56 të Rregullores së Kuvendit, Komisioni funksional ka shqyrtuar Projektligjin dhe Kuvendit i ka paraqitur raportin me rekomandime për shqyrtim, në parim.

Ftoj ministrin e Zhvillimit Ekonomik, zotin Beçaj, që në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës, para deputetëve dhe Kuvendit ta prezantojë dhe arsyetojë projektligjin.

MINISTRI BESIM BEÇAJ: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Kryeministër, zëvendëskryeministra, ministra,

Të nderuar deputetë,

Më lejoni që në emër të Ministrisë të Zhvillimit Ekonomik t’i paraqes për aprovim Kuvendit të Republikës së Kosovës Projektligjin për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit.

Ky projektligj është rezultat i punës dhe i përkushtimit të Ministrisë të Zhvillimit Ekonomik dhe Qeverisë së Kosovës për kompletimin e infrastrukturës ligjore në sektorin e zhvillimit ekonomik. Nevoja për nxjerrjen e Ligjit për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit është e një rëndësie të veçantë dhe me përfshirjen e këtij Ligji në sistemin juridik të Kosovës do të arrihen qëllimet e shumta, e ndër më të rëndësishmet janë: përmirësimi i kornizës ligjore për çështjet që kanë të bëjnë me procedurat, me rregullat për organizimin, funksionimin, emërimin dhe përbërjen e gjyqtarëve, si dhe shqyrtimet që kanë të bëjnë me të gjitha kërkesat, lëndët, rastet, çështjet e procedurat që do të merret kjo gjykatë.

Dhoma e Posaçme është pjesë e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen ekskluzivisht me Agjencinë e Privatizimit. Duke pasur para sysh kërkesat që lidhen me procesin e privatizimit, kërkesat dhe ankesat që lidhen me të drejtat e punonjësve, kërkesat e përgjithshme të pronësisë dhe të kreditorëve, kërkesat që lidhen me likuidimin e një ndërmarrje të kryer nga AKM-ja më herët, në përputhje me Rregulloren e AKM-së, ose nga Agjencia, në përputhje me Ligjin për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, është paraqitur nevoja për nxjerrjen e këtij ligji. Të vetëdijshëm se të gjitha çështjet dhe ndikimet negative ekonomike të cilat janë shfaqur si rezultat i kësaj pasiguri juridike, në këto ndërmarrje dhe pasurisë së tyre, nxjerrja e këtij ligji përcakton rregullat dhe procedurat pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, për çështjet që lidhen me procesin e privatizimit.

Nxjerrja e këtij ligji është i një rëndësie të veçantë sepse juridiksioni dhe kompetencat e Dhomës së Posaçme, si dhe rregullat mbi organizimin dhe veprimtarinë dhe emërimin e gjykatësve në Dhomën e Posaçme përcaktohen me këtë ligj, i cili shfuqizon dhe zëvendëson Rregulloren e mëhershme të UNMIK-ut për Dhomën e Posaçme. Ky Projektligj nuk cenon parimet e përgjithshme të legjislacionit të Bashkimit Evropian dhe do të ketë kosto të përballueshme për buxhetin e Republikës së Kosovës.

Të nderuar deputetë,

Miratimi i këtij ligji është në funksion të kompletimit të infrastrukturës ligjore në sektorin e zhvillimit ekonomik, si dhe është i një rëndësie të veçantë sepse në mënyrë të detajuar përcakton përbërjen dhe funksionalizimin e Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, andaj ju propozoj që pas procedurave të shqyrtimit, ky projektligj të miratohet në parim. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Sipas radhës, kryetari i Komisionit funksional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, zoti Pajaziti e ka fjalën!

ZENUN PAJAZITI: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, në bazë të nenit 56, paragrafi 2 të Rregullores së Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur me datën 7.7.2011 e ka shqyrtuar në parim këtë Projektligj, e ka trajtuar gjithanshëm në paketë, meqenëse ky projektligj, siç dihet, është në kuadër të një pakoje ligjesh që i shërbejnë privatizimit në përgjithësi dhe Agjencisë së Privatizimit dhe ka vlerësuar se projektligji i plotëson kushtet e parapara në nenin 54 të Rregullores së Kuvendit dhe i rekomandon Kuvendit për miratim, në parim.

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Tani, sipas radhës, përfaqësuesit e grupeve parlamentare ose kryetarët. Në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, deputetja Sala Berisha Shala. Nuk është.

Atëherë, në emër të Grupit parlamentar të LDK-së, deputetja Teuta Sahqatqija.

TEUTA SAHATQIA: I nderuari kryesues,

Kabinet,

Kolegë dhe kolege deputete,

Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me AKP-në. Në Grupin tonë parlamentar ky projektligj është shqyrtuar dhe për privatizimin në Kosovë, e dimë që përfaqëson një proces shumë të komplikuar, me pak rezultate, proces i cili nuk ka arritur të sigurojë as ruajtjen e veprimtarive të ndërmarrjeve shoqërore ekzistuese dhe punësimin, e aq më pak të jetë katalizator i zhvillimit ekonomik të Republikës së Kosovës.

Mungesa e këtij ligji ka shkaktuar konfliktin ligjor për privatizimin e ndërmarrjeve shoqërore në Kosovë, e në mesin e shumë problemeve që dilnin nga kjo, ishin privatizimi me dy titullarë, me atë të institucioneve tona dhe atë të UNMIK-ut, baza ligjore konfuze, konfliktet e tjera pronësore dhe gjërat tjera. Ky ligj mëton të definojë qartë kompetencat e kësaj gjykate, duke i detyruar të njeh ligjet e Kosovës, si ligje të zbatueshme, si dhe të përcaktojë emërimin, organizimin dhe veprimtarinë e gjykatësve.

Ky ligj nuk krijon kolizion me pakon e ligjeve që kanë të bëjnë me privatizimin e ndërmarrjeve shoqërore. Përderisa AKM-ja u shndërrua në AKP me Ligjin adekuat më 2008, Dhoma e Veçantë e Gjykatës Supreme vazhdoi të rregullohet me Rregulloren e UNMIK-ut 2002/13, dispozitat e së cilës nuk e njohin Ligjin e Kosovës, Kuvendin dhe shtetin e Kosovës.

Mungesa e këtij ligji, në përfaqësim të drejtë të palës në procedurat gjyqësore, shkaktoi humbjen e rasteve gjyqësore, sikur që është ai i Fabrikës së Çelikut në Ferizaj.

Ndryshimet më të rëndësishme ndërmjet Ligjit të ri të Dhomës së Posaçme dhe Rregullores së UNMIK-ut, janë: numri i gjyqtarëve ndërkombëtarë është zvogëluar nga 13 në 8 dhe numri i gjyqtarëve vendorë është rritur nga 7 deri në 12, prej 7 në 12. Gjyqtarët ndërkombëtarë tash do të kenë shumicën vetëm në Panelin e Apelit. Kryetari i Dhomës së Posaçme do të zgjidhet me shumicën e votave të gjithë gjyqtarëve dhe Ligji i ri për Dhomën e Posaçme i ndalon Dhomës së Posaçme që t'i referojë një rast një gjykate tjetër.

Dhoma e Posaçme ka referuar shumë raste në gjykata tjera në të kaluarën, duke e lehtësuar punën e saj, por duke e vështirësuar shumë për gjykatat e tjera dhe për Departamentin ligjor të AKP-së. Sipas ligjit të ri, të gjitha rastet që kanë të bëjnë me ndërmarrjet e privatizuara shoqërore dhe asetet e tyre, duhet të zgjidhen në kuadër të Dhomës së Posaçme.

Ligji i ri përmban një aneks i cili parashtron procedurat e Dhomës së posaçme që pritet ta përshpejtojë zgjidhjen e rasteve nëpërmjet shkurtimit të afateve kohore. Në këtë ligj duhet të ceket edhe neni numër 5, neni në të cilin shihet emri dhe mbiemri i ekspertit, i cili ka punuar në ligj. Nuk e di prej kur ka ardhur kjo praktikë që nëpër ligje të shihen edhe të vendosen edhe emra dhe ai emër dhe ai ligj të mbetet gjatë e gjatë në Kosovë. Kjo duhet të shqyrtohet në Komisionin për Zhvillim Ekonomik.

Ky projektligj apo ky ligj, i cili do të dalë prej këtij projektligji, krijon kosto buxhetore për rritjen e numrit të gjyqtarëve dhe numrit të stafit, si dhe do të ketë edhe kosto tjera, të cilat nuk janë paraparë në Ligjin për buxhet dhe kornizën afatmesme të shpenzimeve. Prandaj, Grupi Parlamentar i LDK-së mendon që ky ligj duhet të votohet në parim, por duke kërkuar që Qeveria, gjatë kohës së amendamentimit të ofrojë zgjidhje për mbulimin e kostos buxhetore. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit! Deputetja Berisha, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, a e doni fjalën?

SALA BERISHA SHALA: Ju faleminderit, kryesues!

Përshëndetje kryeministër, zoti Thaçi, dhe Kabinet qeveritar!

Të nderuar deputetë,

Të gjithë ju të pranishëm,

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e ka analizuar me vëmendje Projektligjin për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme për çështje që lidhen me privatizimin dhe e ka shqyrtuar me shumë vëmendje. Ne e kemi mirë pritur këtë pako të projektligjeve që sot i kemi në shqyrtim në Kuvend. Këto projektligje kanë qenë të parapara në strategjinë legjislative të Qeverisë dhe të Kuvendit diku në tremujorin e fundit të këtij viti, por për fat të mirë, Qeveria e ka përshpejtuar dinamikën e punës së vet dhe na e ka sjellë në Kuvend më herët

Shpresoj se ne, edhe si Komision parlamentar, por edhe si Grup parlamentar do ta japim kontributin tonë maksimal në fazën e amendamentimit dhe brenda, më shumë se sa brenda afateve të parapara me Rregullore të Punës së Kuvendit do ta kryejmë punën në këto projektligje.

Qëllimi i këtij ligji është që të zëvendësojë Rregulloren e UNMIK-ut, 2002/13 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme për çështjet që lidhen me AKM-në, si dhe Udhëzimin administrativ të UNMIK-ut 2008/6, që përcakton procedurat themelore të Dhomës së Posaçme. Ligji i ri është i nevojshëm, në mënyrë që Dhoma e Posaçme të funksionojë në pajtim me Ligjin për AKP-në dhe Kushtetutën, si dhe në veçanti me propozimin gjithëpërfshirës. Ligji i ri e zëvendëson Rregulloren e UNMIK-ut dhe përmban një shtojcë e cila zëvendëson Urdhëresën administrative të UNMIK-ut. Ky ligj do të harmonizojë dispozitat e ndryshme që rregullojnë Dhomën e Posaçme me Ligjin për AKP-në dhe me Kushtetutën, duke zgjidhur kështu disa çështje që janë tejet esenciale e që do ta ndihmojnë Dhomën e Posaçme në zgjidhjen më të shpejtë të rasteve para saj.

Ndryshimet më të rëndësishme ndërmjet Ligjit të ri për Dhomën e Posaçme dhe Rregullores së UNMIK-ut, janë:

1. Numri i gjyqtarëve ndërkombëtarë është zvogëluar nga 13 në 8 dhe numri i gjyqtarëve vendorë është rritur nga 7 në 12. Ky ndryshim i cili e ndryshon balancën e gjyqtarëve në Dhomën e Posaçme, është teknikisht në kundërshtim me propozimin gjithëpërfshirës, mirëpo Përfaqësuesi Civil Ndërkombëtar, i cili është përgjegjës për mbikëqyrjen e zbatimit të këtij propozimi, është pajtuar me këtë ndryshim, kështu që kjo është një sinjal se institucionet vendore kanë arritur një besueshmëri të lartë karshi miqve tanë ndërkombëtarë, të cilët na përkrahin në rrugëtimin e Kosovës.

Gjithashtu, gjyqtarët ndërkombëtarë do ta kenë shumicën e vetos në Panelin e Apelit, për dallim nga Rregullorja e UNMIK-ut, sipas të cilës gjyqtarët ndërkombëtarë kishin shumicën edhe në 5 panelet e specializuara. Vlen për ta përmendur se me këtë ligj, kryetari i Dhomës së Posaçme do të zgjidhet me shumicë të votave të të gjithë gjyqtarëve të Dhomës së Posaçme. Pozita e kryetarit nuk është më e garantuar vetëm për një gjyqtar ndërkombëtar.

Ligji i ri për Dhomën e Posaçme ia ndalon Dhomës së Posaçme që t'ia referojë një rast një gjykate tjetër. Dhoma e Posaçme i ka referuar shumë raste në gjykata tjera në të kaluarën, duke lehtësuar punën e saj, por duke vështirësuar shumë për gjykata tjera dhe për Departamentin ligjor të AKP-së.

Sipas Ligjit të ri, të gjitha rastet që kanë të bëjnë me ndërmarrjet publike dhe shoqërore dhe asetet e tyre, duhet të zgjidhen në kuadër të Dhomës së Posaçme. Ky ligj përmban një aneks, i cili parashtrohet procedurat e Dhomës së Posaçme, që pritet ta përshpejtojë zgjidhjen e rasteve përmes shkurtimit të afateve kohore.

Në fund, ne si Grup Parlamentar i Partisë Demokratike e mbështesim në parim dhe ju ftoj juve të gjithë, kolegë deputetë, që kontributin e juaj ta jepni në komisionet funksionale. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar “Vetëvendosje”, deputeti Visar Ymeri e ka fjalën.

VISAR YMERI: Ju faleminderit, i nderuari kryesues!

Edhe ne, natyrisht e kemi shqyrtuar Ligjin për të cilin po flasim këtu, për Dhomën e Veçantë të Gjykatës që ka të bëjë me Agjencinë Kosovare të Privatizimit. Fillimisht dua të them, t'ua tërheq vërejtjen, domethënë, të gjithë deputetëve, se për sa u përket këtyre tri ligjeve që kanë ardhur si paketë ligjesh që merren me çështjen e privatizimit, pra ky për të cilin po flasim, ai për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, si dhe Ligji për riorganizimin e pasurive të ndërmarrjeve të caktuara, kanë kaluar në Komisionin për Zhvillim Ekonomik pa u diskutuar fare dhe kanë kaluar dy ditë pasi që ne, si anëtarë të Komisionit i kishim marrë këto ligje. Pra, duke pasur parasysh rëndësinë e këtyre ligjeve dhe veçanërisht edhe vëllimin e tekstet që kanë këto ligje, të cilat janë, lirisht mund të them, ligjet ndoshta më voluminoze që i kemi parë deri tash, kjo kohë prej dy ditësh ka qenë absolutisht e pamjaftueshme për ta lexuar ligjin, e lëre më për t'i dhënë ndonjë vlerësim atij. Prandaj, konsideroj se kjo praktikë e ngutjes, nganjëherë edhe e paarsyeshme, po e dëmton mundësinë e deputetëve individualë, por edhe Komisionet të Kuvendit, në mënyrë që t'i shqyrtojnë ligjet për të cilat janë të ngarkuar t'i bëjnë ato.

Për sa i përket ligjit në fjalë, dua të ndalem vetëm në një çështje që është shumë e rëndësishme, për shkak se plotë vërejtje tjera këtu u përmendën. Ky ligj, edhe pse konsideroj që qëllimi politik kryesor i tij ka qenë që përfundimisht ta minimizojë dhe ta heqë fuqinë absolute që kanë pasur ndërkombëtarët në Gjykatën Supreme dhe ta kthejë Dhomën e Veçantë në kuadër të sistemit gjyqësor të Kosovës, prapë se prapë e bën një lloj vazhdimi të pranisë dhe fuqisë së gjykatëseve të EULEX-it përbrenda këtij ligji dhe përbrenda kësaj Gjykate, kësaj Dhome të Posaçme.

Për shembull, në nenin 3, në paragrafin 3, thuhet që EULEX-i emëron, riemëron dhe shkarkon gjyqtarët ndërkombëtarë të Dhomës së Posaçme, në pajtim me rregullat dhe procedurat e brendshme të EULEX-it. Pra, i lihet një autonomi absolute e EULEX-it që ta bëjë këtë emërim

dhe riemërim, shkarkimin e gjykatësve dhe në këtë fuqi, EULEX-i është absolutisht i pavarur nga institucionet e Kosovës. Pra, konsiderojmë që kjo është një vazhdimësi e logjikës së njëjtë, e cila ka qenë edhe në kuadër të Rregullores së UNMIK-ut që e ka mbuluar ose që e ka themeluar këtë Dhomë të Veçantë dhe është në kundërshtim me interesat politike të Kosovës për pavarësim dhe sovranitet të plotë. Pra, në njërën anë Qeveria po thotë se është duke u angazhuar në njëfarë mënyre t'ia pamundësojë apo ta qesë EULEX-in nga Kosova, kurse në anën tjetër me ligjet që po na i paraqet këtu, po kërkon që ta vazhdojmë funksionimin e EULEX-it në Kosovë.

Po ashtu, në ligj është ndryshuar, ky ndryshim është për të mirë, duhet ta them, përbërja e gjykatësve të Dhomës së Veçantë, pra vazhdojnë të jenë 20 sish, mirëpo tash janë 12 vendor dhe 8 të tjerë do të jenë gjykatës ndërkombëtar, mirëpo edhe në panele kjo gjë është ndryshuar në favor të gjykatësve vendor, pra më shumë ka vendorë, mirëpo një çështje që nuk është ndryshuar ose mendoj që është shumë e rëndësishme, është te Paneli i specializuar i apeleve, i cili dihet që është paneli përfundimtar, pra për sa i përket vendimeve të Gjykatës, ku është paraparë që prej 3 gjykatësve, 2 të jenë ndërkombëtarë, ndërsa 1 vendor dhe aty është paraparë që të marrë pjesë natyrisht edhe kryetari i gjykatës.

Një çështje tjetër që kisha dashur ta përmendi, është çështja e shpagimit, pra në rast se gjykata e vlerëson se një person, qoftë ai juridik apo fizik është dëmtuar nga procesi i privatizimit dhe procesi i likuidimit, atëherë shpagimi do të jetë i mundshëm vetëm në formë monetare, pra nuk lejohet shpagimi fizik me këtë ligj, gjë që mund ta dëmtojë interesin e personit. Një çështje tjetër që shihet në ligj, është edhe përsheptimi i procedurave të likuidimit të ndërmarrjeve për shkak se shumë afate kohore janë shkurtuar dhe një çështje tejet e rëndësishme që ndërlidhet me atë që e thashë më herët, është që në ligj thuhet që ligji do të jetë përmbi çfarëdo neni, i cili është inkonsistent në çfarëdo rregullore tjetër me ligjin në fjalë, duke përfshirë këtu edhe juridiksionin e EULEX-it, mirëpo po ashtu thuhet se në rast të konfliktit në mes Ligjit dhe Rregullores së UNMIK-ut 2005/48, atëherë ose çfarëdo ligji tjetër, i cili është pasardhës i kësaj Rregulloreje, do të mbizotërojë Rregullorja e UNMIK-ut. Pra, kjo tregon që njëfarë mënyre po vazhdohet ajo logjika edhe po vazhdohet madje edhe ekzistenca ligjore e UNMIK-ut në Kosovë edhe përmes ligjeve të cilat po kërkojnë të votohen nga Kuvendi i Kosovës dhe për ne si Lëvizje “Vetëvendosje”, kjo është e papranueshme për shkak se konsiderojmë se pushteti ekzekutiv ndërkombëtar përmbi Kosovën duhet të përfundojë.

Prandaj, Lëvizja “Vetëvendosje”, në parim nuk e mbështetë këtë ligj për shkak të këtyre arsyeve që i përmenda. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, deputeti Gjini.

ARDIAN GJINI: Ju faleminderit, zoti nënkryetar!

Fillimisht duhet të them se për arsye të cilat do të bëhen të ditura gjatë shqyrtimit të ligjit, i cili menjëherë pason në agjendë, Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, Aleanca e mbështet në parim këtë projektligj.

Disa pyetje fundamentale dalin edhe nga drafti, edhe nga procedimi i këtij ligji. Fillimisht duhet të them se Qeveria nuk po jep shpjegim pse këto tri ligje, të cilat veç e veç duken ndoshta të padëmshme, por kur bashkohen, mund të kenë pasoja interesante për Kosovën, do të thotë, pse këto ligje, cila është arsyeja që këto ligje kanë ardhur me procedurë për të shpejtuar në Kuvendin e

Kosovës, aq të përshpejtuara sa që nuk i kanë dhënë mundësi as administratës së shtetit, do të thotë administratës të Qeverisë që t'i jap mendimet e veta profesionale në lidhje me këto ligje.

Fillimisht, do të thotë është kjo që e thashë, më tepër në ligjin tjetër. Do të thotë, do ta mbështesim në parim procedimin e këtij ligji. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Koalicioni Kosova e Re, deputetja Myzejene Selmani.

MYZEJENE SELMANI: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Përsëritet për Kabinetin qeveritar dhe deputetët e kësaj seance!

Koalicioni për Kosovën e Re e ka shqyrtuar në parim Projektligjin për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës dhe mund të themi se një e mirë që është bërë në fillim të këtij ligji, është se më nuk përdoret Rregullorja e UNMIK-ut, ku shihen mjaft mirë problemet që kanë ndodhur për arsye të kësaj rregulloreje 2005/48. Mirëpo, kemi edhe sugjerimet dhe vërejtjet e tona në këtë projektligj.

Është i nevojshëm precizimi i afateve në rritjen e efikasitetit të punës së Dhomës së Posaçme. Ky jo efikasitet po mban peng, të bllokuar edhe fondet e krijuara nga privatizimi. Megjithatë, këtu ende nevojitet precizim më i saktë i afateve, ministër!

Në nenin 3, paragrafi 1, aty thuhet se kemi një numër më të madh të gjykatësve, mirëpo prapë se prapë këtu mund të potencohet se papë nuk është në frymën e kosovarizimit të kësaj dhome të posaçme, se në Kolegjin e Apelit dominojnë prapë se prapë gjykatësit ndërkombëtarë. Lidhur me paketën shumë të rëndësishme të këtyre tri projektligjeve, të cilat sot do të shqyrtohen në këtë seancë, Koalicioni për Kosovë të Re, deklaroi se do të japë mbështetjen në leximin e parë, mirëpo të gjitha vërejtjet dhe amendamentet të cilat i paraqet Koalicioni për Kosovën e Re, në rast se nuk implementohen në leximin e dytë, atëherë nuk do të ketë votë nga Koalicioni për Kosovë të Re. Ju faleminderit!

KRYESKUESI: Ju faleminderit! “6+”, zoti Damka!

FIKRIM DAMKA: Teşekkür ederim Sayın Meclis Başkanı yardımcısı, Sayın Bakanlar ve Milletvekilleri

Kosova Yuksek Mahkemesinde, Kosova Ozelestirme Ajansina Iliskin sorunlari gorusecek ozel odanin (birinin) kurulmasini on goren bu yasa taslagini dikatklice inceledigimizi ve Kosova Ekonomisinin gelismesi icin onemli oldugunu gormekteyiz.

Kosovada BM- Misiyonu cercevesinde var olan karanamenin duzeltimesi ve degistirmesini on goren bu yasa taslagi ozelistirmede bu gune kadar sirketlerin ve toprak sahiplerinin sorunlarini hukuki zeminde cozecek olan bu Mahkeme onemli bi role saip olacaktir.

Diger taraftan bugune kadar ozelestirilen ve ozelestime sartlarina uymayan sirketlerin uzerinde Kosova halkin haklarini koruyucak ve bu haklarini talep edebilecek bir Hukuksal zemin yaratan bu Mahkeme onemli davalari sonuclandiracaktir.

20 Hakimden olusacak bu Mahkeme heyeti icerisinde cogunluk olmayan diger topluluklarinin da temsil edildigini ve Avrupa standartlarinda bi yasa taslaginin hazirlendigini gormek bizi memnun etmektedir.

6+ PG adina bu kanun taslagini desteklemekteyiz.

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Në emër të grupeve nuk ka tjerë të paraqitur. Zoti Demolli e ka kërkuar fjalën.

HAKI DEMOLLI. Ju faleminderit, i nderuari kryesues i Kuvendit!

I nderuari Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë të Kuvendit të Kosovës,

Unë do të paraqes disa vërejtje lidhur me nenet konkrete të këtij projektligji. Kështu, konkretisht në nenin 3, paragrafi 6, flitet për kushtet që duhet të plotësuar në person apo një kandidat për të shërbyer si gjyqtar në Dhomën e Posaçme, dhe konkretisht në këtë paragraf përdoret një shprehje tejet e përgjithshme, duke theksuar se personi i tillë duhet të ketë arsimim juridik dhe përvojë të gjerë. Mendoj se, në vend të shprehjes “arsimim juridik”, duhet të potencohet që kandidati duhet t’i plotësojë kushtet për të qenë gjyqtar konform legjislacionit në fuqi.

Më tutje, në nenin 3, paragrafi 10, thuhet se kryetari i Dhomës së Posaçme, pas konsultimeve me Presidentin e shtetit apo presidentin e Kosovës dhe EULEX-it, emëron një gjyqtar që të shërbejë si kryetari i kolegjit. Nuk e di se sa është i rëndësishëm posti i kryetarit të kolegjit, që për një çështje të tillë të konsultohet edhe Presidenti i shtetit. Prandaj, vërejtje të njëjtë kam edhe sa i përket emërimit të katër gjyqtarëve të Apelit apo të Kolegjit të apelit, që parashihet në nenin 3.12. Mendoj se nuk do të ishte e nevojshme që për çështje të tilla të konsultohet edhe kryetari i shtetit, por më mirë do të ishte që të konsultohet kryetari i Këshillit gjyqësor të Kosovës.

Më tutje, në nenin 6, përcaktohet apo rregullohet afati për parashtrimin e ankesës, ku thuhet se çdo person që kundërshton një vendim apo veprim të agjencisë, që është ndërmarrë para datës së hyrjes në fuqi të këtij ligji, duhet të parashtrojë kërkesë apo ankesë tek Dhoma e Posaçme jo më vonë se 9 muaj pas ditës kur ai person ka njohuri apo ka ditur për një vendim të tillë apo për një aktgjykim të tillë. Sipas mendimit tim, mirë është që mos të ketë kufizime kohore për ankesë ndaj veprimeve të Agjencisë, që janë marrë para hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Më tutje, në nenin 8, theksohet se çdo person duhet të ofrojë prova dëshmuese, dokumentare apo fizike, që është një terminologji joadekuate profesionale që sigurisht është pasojë e përkthimit dhe mendoj se në vend të kësaj shprehje duhet thënë se nevojiten provat materiale apo personale.

Kurse në nenin 9, apo sipas nenit 9, autorizohet Kolegji i specializuar që të mund të lëshojë urdhër për t’ia deleguar njërit prej anëtarëve apo një nënkolegji, që përbëhet nga dy anëtarë, përgjegjësinë apo autoritetin për të vendosur për një çështje.

Mendoj se për çështje të delegimit, mirë është të vendos Presidiumi i Dhomës së Posaçme, eventualisht kryetari i Dhomës e jo vetë kryetari i Kolegjit apo vetë Kolegji.

Ndërkaq, në nenin 10, paragrafi 6, mendoj se ky paragraf është paksa konfuz, sepse mirë është të lexohet edhe një herë me kujdes, palës që me aktgjykim i hedhet poshtë kërkesa, i jepet e drejta të

parashtrojë ankesë edhe para Kolegjit të apelit, por i jepet e drejtë që të parashtrojë ankesë edhe para Kolegjit të specializuar, respektivisht gjykatësit apo nënkolegjit, që në të vërtetë kolegji i specializuar, gjykatësi apo nënkolegji janë ata të cilët kanë marrë më parë njëmendim të tillë, prandaj është e pakuptimtë që personi i njëjtë t'i drejtohet me ankesë organit apo institucionit i cili ka vendosë më parë për të njëjtën çështje.

Po ashtu, mund të themi se paragrafi 7, i nenit 9, nuk ka nevojë fare të figuroj në këtë draft-ligj për arsye se rregullohen disa çështje që thjeshtë janë fakte notore. Më tutje do të kisha thënë se me draft-ligj hasim edhe disa përkufizime joadekuate, që vërehet se është përkthyer nga ndonjë jo juristë dhe është marrë bukvalisht nga gjuha angleze apo nga ndonjë gjuhë tjetër, besoj nga gjuha angleze.

Kështu, për shembull, kemi një shprehje ku thotë: “nëse Kolegji i apelit vendos që apeli nuk meriton shqyrtim”, kurse në të vërtetë kështu është fjala që “Kolegji vlerëson se apeli a është i arsyeshëm për t’u shqyrtuar apo jo”. Ose kemi një shprehje tjetër, ku thotë: “në rastin kur Kolegji i apelit vendos të pranoj apelin”! Pra, nuk mund të vendos të pranojë apelin, por thjeshtë e vlerëson se a do ta shqyrtojë apo jo një apel të tillë. Dhe në paragrafin 10 të nenit 9, draft-ligji përmban një përsëritje, sepse thotë: “Gjykata e apelit mund ta kthej aktgjykimin apo aktvendimin në plotësi apo pjesërisht tek Gjykata e shkallës së parë”, dhe po ashtu thotë se: “Kolegji i apelit mund ta urdhërojë rigjykimin e kërkesës së lëndës, procedurës apo rastit, që në të vërtetë është një përsëritje.

Kurse në paragrafin e 12-të, flet për afatin kohor kur duhet gjyqtari apo kolegji i specializuar i shkallës së parë të vendosë për kërkesë dhe përdor këtë shprehje: “Dështon ta nxjerrë vendimin brenda një kohe të arsyeshme”. Shtrohet pyetja: Çka konsiderohet me kohë të arsyeshme, a është 1 muaj, a është 2 muaj, 6 muaj apo me vite të tëra? Prandaj, mirë është, ajo që e përmendi edhe kolegja Myzejeqe që afatet të jenë më të qarta dhe më konkrete, në mënyrë që të precizohen brenda të cilës kohe Kolegji duhet të marrë vendim për çështje të caktuara. Ju faleminderit!

KRYESUSEI: Ju faleminderit! Nuk ka të tjerë të paraqitur. Ministri e ka kryer fjalën, nuk do ta marrë prapë.

Në sallë janë prezentë 67 deputetë. Bëhemi gati për votim. Votojmë, tani:

Konstatohet se me 52 vota “për”, 8 “kundër”, 1 abstenim, Kuvendi miratoi në parim Projektligjin për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit.

Kërkohet nga komisioni funksional dhe komisionet e përhershme, që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit, ta shqyrtojnë Projektligjin dhe Kuvendit t’ia paraqesin raportet me rekomandime. Besoj që në qoftë se i kryejnë edhe më shpejtë, nuk bëjnë keq komisionet.

Vazhdojmë me pikën e dhjetë e rendit të ditës:

10. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit

Në bazë të nenit 56 të Rregullores së Kuvendit, komisioni funksional ka shqyrtuar Projektligjin dhe Kuvendit ia ka paraqitur raportin me rekomandime...

(Ndërhyrje)

... unë këtu e kam pikën e dhjetë. Un jam në rregull. Ti e ke ndryshe!

Kuvendi ka paraqitur raportin me rekomandime për shqyrtim, në parim. Ftoj ministrin e Zhvillimit Ekonomik, zotin Beqaj që në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës, para deputetëve të Kuvendit të prezantojë dhe arsyetojë projektligjin. Zoti Beqaj, e keni fjalën!

MINSITRI BESIM BEQAJ: Ju faleminderit, kryesues!

Kryeministër, zëvendëskryeministra, ministra,

Të nderuar deputetë,

Kjo është një paketë e ligjeve, të cilave edhe ju iu referuat më herët. Pra, në shqyrtim sot sjellim gjithashtu Projektligjin për Agjencionin Kosovar të Privatizimit. Nxjerrja e këtij ligji ka një rëndësi të veçantë sepse rregullon çështjet të cilat deri më tani kanë qenë të rregulluara me Rregullore të UNMIK-ut. Me këtë ligj, ne realisht i eliminojmë ato rregullore.

Ky Projektligj rregullon themelimin dhe statusin ligjor të Agjencisë Kosovare të Privatizimit, si organ i pavarur publik, i cili ushtron përgjegjësitë në mënyrë të pavarur. Agjencia Kosovare e Privatizimit ka kompetenca për administrim, shitje, transferim dhe likuidim të ndërmarrjeve shoqërore dhe të pasurive të tyre që ndodhën në territorin e Republikës së Kosovës. Duke pas parasysh se rindërtimi dhe zhvillim ekonomik i Kosovës si dhe mirëqenia e qyfterëve të saj, është me rëndësi jetike dhe kërkon administrim, privatizim dhe likuidim adekuat dhe me kohë të ndërmarrjeve në pronësi shoqërore, ky projektligj do të qartësojë në mënyrë të detalizuar dhe njëkohësisht do ta rregullojë këtë çështje.

Të nderuar deputetë,

Të vendosur për reformën strukturore ekonomike dhe për nxitjen e investimeve në këto ndërmarrje, përmes themelimit apo rithemelimit të Agjencionit Kosovar të Privatizimit dhe delegimit në këtë Agjenci të autorizimeve të gjëra publike, administrative mbi këto ndërmarrje dhe pasurinë e tyre, duke përfshirë por pa e kufizuar mandatin dhe autoritetin për shitjen ose bartjen e këtyre ndërmarrjeve dhe të pasurisë së tyre tek investitorët privat ose likuidimin e tyre përmes të një procesi të hapur, transparent konkurrues dhe pa vonesa, ju ftoj ta miratoni këtë projektligj, i cili nuk cenon parimet e përgjithshme të legjislacionit të BE-së dhe do të ketë kosto të përballeshme për buxhetin e Republikës së Kosovës. Ju faleminderit!

KYESUESI: Ju faleminderit! Unë ju kisha apeluar që, meqenëse ministri është i thirrur që ta prezantojë ligjin, mos ta prezantojmë ne nga dy herë ligjin si deputetë, por të jepen vërejtjet që janë ose të mbështetet ose të mos mbështetet!

Tani, sipas radhës, fjalën e ka kryetari i Komisionit funksional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, deputeti Pajaziti.

ZENUN PAJAZITI: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, në përputhje me Rregulloren e Kuvendit, më 7.07.2011, e ka shqyrtuar këtë Projektligj dhe duke e parë rëndësinë e madhe po ashtu që ka ky projektligj, Komisioni për Zhvillim Ekonomik kohëve të fundit ka punuar me orar të shtuar, i falënderoj, shfrytëzoj rastin për t'i falënderuar të gjithë anëtarët e Komisionit!

Është vlerësuar Projektligji që i plotëson kushtet e parapara me nenin 54 të Rregullores së Kuvendit dhe ia rekomandon Kuvendit për miratim në parim këtë projektligj. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Grupet Parlamentare. Në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, deputetja Sala Berishta Shala.

SALA BERISHA SHALA: Ju faleminderit, kryesues!

Përshëndetje për të gjithë!

Edhe ky ligj është në pakon e ligjeve të sjella nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik të Kosovës, të cilat kërkojnë që të kemi një qasje më serioze. Ligji për AKP-në ka ekzistuar në fuqi që nga viti 2008, mirëpo edhe pse i miratuar nga Kuvendi i Kosovës, e me të cilin është ndryshuar Rregullorja e UNMIK-ut 2002/12 për AKM-në, ky ligj nuk e ka arritur qëllimin e tij për shfuqizimin e kësaj rregulloreje.

Privatizimi në Kosovë është udhëhequr nga një dualizëm institucional, përkatësisht nga UNMIK-u dhe institucionet e Kosovës dhe ky dualizëm i institucioneve në vendimmarrje, në privatizim, ka ndikuar në marrjen e vendimeve jo rrallë të gabuara, me të vetmin aspekt për mosharmonizim të qëndrimeve.

Një situatë e tillë e debatueshme për ekonominë e Kosovës është vetë Fondi i Privatizimit, i cili nuk është pjesë e zhvillimit ekonomik të Kosovës. Prandaj, me sjelljen e këtij projektligji në Kuvend, do të sqarohet konkretisht dhe do të hiqet ky dualizëm, do të shfuqizohet Rregullorja e UNMIK-të për AKM-në dhe fuqitë vendimmarrëse do të kalojnë në institucionet e Kosovës. Pse duhet të mbështetet Ligji për AKP-në:

1. Qëllimi i tij është zëvendësimi i Ligjit ekzistues për AKP-në me një ligj të ri, i cili zgjidh disa probleme serioze të krijuara nga ligji ekzistues. Ligji i ri është i ngjashëm me ligjin ekzistues, por ka disa ndryshime shumë të rëndësishme.

Ligji i ri për AKP-në i eliminon komisionet shqyrtuese në AKP, që janë duke marrë shumë kohë. Këto komisione shumë rrallë kanë funksionuar në mënyrë profesionale dhe efikase. Sipas ligjit ekzistues, një parashtrues i kërkesës, që është i pakënaqur me vendimin e APK-së lidhur me vlefshmërinë ose vlerën e kërkesës, së pari duhet të kërkojë shqyrtimin e kërkesës në AKP nga një komision shqyrtues, që sipas ligjit duhet të kryesohet nga një zyrtar ndërkombëtar i caktuar nga ICO. ICO është deklaruar se nga tani e tutje nuk do t'i financojë këta zyrtarë ndërkombëtarë. Sipas ligjit ekzistues nëse parashtruesi i kërkesës është përsëri i pakënaqur, ai mund të dorëzojë kërkesën në Dhomën e Posaçme. Procesi i shqyrtimit të kërkesave nga komisionet shqyrtuese në AKP dhe paraprkasht në AKM, është konstatuar si shumë joefektiv. Kjo është gjithashtu e kushtueshme edhe për ICO, që duhet t'i paguaj anëtarët ndërkombëtarë të komisionet shqyrtuese.

Nuk ka asnjë arsytim bindës ligjor për ruajtjen e këtyre komisioneve. Sipas Ligjit të ri, tani, parashtruesi i kërkesës që është i pakënaqur me vendimin e AKP-së për vlefshmërinë ose vlerën e kërkesës, mund ta kundërshtojë këtë vendim direkt në Dhomën e Posaçme.

Tjetër, Ligji i ri për AKP-në ka për qëllim përsheptimin e punës së komisioneve të likuidimit. Ligjit të ri për AKP-në i është bashkëngjitur një aneks, i cili e përcakton procesin e likuidimit në mënyrë të hollësishme dhe në pajtim të plotë me praktikën e zakonshme ndërkombëtare. Përmbajtja e këtij

aneksi, paraqet një përmirësim të dukshëm në krahasim me ligjin ekzistues. Sipas ligjit ekzistues, çdo komision i likuidimit duhet të kryesohet nga një zyrtar ndërkombëtar të paguhet nga ICO.

Ligji i ri për AKP-në, kërkon që AKP të angazhojë përmes të një procesi transparent dhe ndërkombëtar të tenderimit, ofrues të shërbimeve profesionale me përvojë, ekspert likuidimi dhe ekspert ligjor për zbatimin e procesit të likuidimit, si dhe për mbështetjen e Departamentit Ligjor në AKP, që kanë nevojë për trajtim më efikas kërkesave të kreditorëve dhe kërkesave pronësore që janë dorëzuar dhe që do të dorëzohen në të ardhmen.

Sa u përket ndërmarrjeve në pronësi shoqërore, asetet e të cilave tashmë janë privatizuar me spinof special, të ardhurat nga ky privatizim, që aktualisht mbahen në Fondin e Mirëbesimit, tashmë janë asete të ndërmarrja në pronësi shoqërore, e cila vazhdon të ekzistojë si person juridik. Kurdo që është e mundshme, këto ndërmarrje duhet të shuhen formalisht dhe fondet që mbahen në Fondin e Mirëbesimit të barikaduara, duhet t'u shpërndahen së pari kreditorëve dhe më pas pronarëve të ndërmarrjeve në pronësi shoqërore. Vëni re, në shumicën dërmuese të rasteve, pronar kryesor i këtyre ndërmarrjeve do të jetë Republika e Kosovës.

Ligji i ri për AKP-në e autorizon Bordin e AKP-së, me mbështetjen e ofruesve të shërbimeve profesionale, gjithmonë, që të derdhë disa fonde në Buxhetin e Kosovës në bazë të një procesi specifik. Kërkesat e kreditorëve dhe ato pronësore që janë paraqitur kundër një ndërmarrjeje ose kundër Fondit të saj të Mirëbesimit, në të cilën ruhen të ardhurat nga privatizimi i aseteve fizike të ndërmarrjeve, së pari duhet të shqyrtohen për të konstatuar nëse ka mjete në fondin përkatës të privatizimit që e tejkalojnë shumën, që arsyeshmërisht pritet se do të jetë e nevojshme për pagimin e këtyre kërkesave.

Në këtë mënyrë mund të identifikohet suficiti, që është shumë i rëndësishëm për buxhetin e Kosovës. Ligji i ri për AKP-në e autorizon Bordin e AKP-së që të shqyrtojë secilin fond të mirëbesimit, si dhe kërkesat përkatëse, në mënyrë që të identifikojë rastet kur ka suficit dhe ky suficit të derdhet në buxhetin e Kosovës.

Vlerësimet e ekspertëve aktualisht të përafërta tregojnë se ky proces mund të rezultojë në derdhjen e 50 deri në 100 milionë euro në Buxhetin e Kosovës në 12 muajt e parë pas hyrjes në fuqi të ligjit të ri, domethënë të Ligjit për AKP-në.

Në fund, Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e mbështet në parim këtë ligj dhe i fton të gjithë kolegët deputetë, që me kontributin e tyre të përshpejtojnë dhe të ndihmojnë në miratimin sa më të shpejtë të këtij ligj. Në të kundërtën, ata që e kundërshtojnë këtë pako të projektligjeve, faktikisht janë që t'u zgjasin jetën ndërkombëtarëve dhe institucioneve tjera që nuk janë të dala nga Kuvendi i Kosovës. Ju faleminderit për vëmendje!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, deputeti Naser Osmani.

NASER OSMANI: Ju faleminderit, kryesues!

Ligji i korigjuar i AKP-së do të përshpejtojë privatizimin dhe likuidimin duke u adaptuar me synimet e politikës së Kosovës lidhur me zhvillimin dhe rindërtimin ekonomik të Kosovës, si dhe me ngritjen e mirëqenies të popullit të saj.

Ndryshimet e Ligjit do të mundësojnë përfundimisht përsheptimin e mundësisë që investitorët e brendshëm dhe ata të huaj që me mundësitë e mira të blejnë asetet aktuale në pronësi të ndërmarrjeve shoqërore, të cilat janë duket ndenjur, kështu që në këtë mënyrë do të kontribuojnë në zhvillimin e përgjithshëm ekonomik të vendit.

Praktikat e deritashme kanë treguar se Ligji ekzistues i AKP-së, që ka buruar prej ligjeve të pakos të presidentit Ahtisari, përmbajnë instanca të pavolitshme për shqyrtimin dhe për ankesa që janë duke shkaktuar bllokada serioze dhe vonesa të dukshme. Këto janë duke vonuar edhe shpërndarjen e të ardhurave që mbahen në mirëbesim të palëve të njëjta. Është me rëndësi që infrastruktura ligjore është rishikuar, në mënyrë që sa më të shpejtë të përshejtohet dhe të ndihmohet procesi i privatizimit dhe në veçanti ai i likuidimit, duke larguar të gjitha procedurat e panevojshme teknike dhe administrative.

Nga ajo që kam mundur të shikoj në këtë ligj, mund të them se ligji përmban, ligji i ri është fjala, përmban këto propozime:

Ligji i thjeshtëzuar dhe i konsoliduar largon nevojën për t'ju referuar dokumenteve të legjislacionit të UNMIK-ut.

Përmirësimi i kompetencave të Agjencisë për të kontrolluar, përsheptuar dhe administruar privatizimin dhe likuidimin.

Ristrukturimi i angazhimeve të Zyrës Civile Ndërkombëtare në Agjenci, që rezulton në një rritje të përgjegjësisë të agjencisë për procesin e likuidimit.

Krijimi i parimeve të reja financiare për Agjencinë me një fleksibilitet për të rritur fondet shtesë nga organizatat donatore, kjo do të zvogëlonte në mënyrë të dukshme pengesën që në buxhetin e Kosovës të zvogëlohet dhe do të krijonte mundësi më të mira që financimi të bëhet nga burimet vetanake, domethënë Agjencioni të financohet nga burimet vetanake, duke u respektuar gjithmonë Ligji mbi menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë.

Do të lehtësojë angazhimin e kompanive profesionale për kryerjen e likuidimit, që do të përsheptonte procesin e likuidimit, duke e zvogëluar sa është tani 42 muaj, në 20 muaj, ashtu siç e parasheh edhe legjislacioni që ka të bëjë me parimet e Bankës Botërore.

Do të mundësojë lirimin më herët të fondeve në mirëbesim ndaj kreditorëve dhe ankesave dhe teprica e mbetur të mjeteve të derdhet në buxhetin e Kosovës.

I gjithë ky ndryshim është imponuar si nevojë e domosdoshme për arsye të një përsheptimi më të mirë të zhvillimit ekonomik në përgjithësi dhe Grupi Parlamentar, duke marrë parasysh të gjitha këto, do ta përkrah dhe do të punojë që në Komisionin për Buxhet dhe Financa, në Komisionin për Zhvillim Ekonomik të japë kontributin e vet, po ashtu edhe në Komisionin për Legjislacion, kuptimin e asaj që ky legjislacion i kësaj pakoje të jetë më funksional dhe më i pranishëm për rrethanat sotme ekonomike. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”, fjalën e ka deputeti Albin Kurti.

ALBIN KURTI: Deputetë të Kuvendit të Kosovës,

Diskutimi në Kuvendin e Kosovës për Projektligjin për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, ndërkohë që nuk bëjmë diskutim dhe vlerësim për vetë procesin e privatizimit, nuk paraqet zgjidhje të drejtë dhe as mënyrë të duhur. Nuk mund t’i ndryshojmë për të mirë marrëdhëniet socio-ekonomike, nuk mund të shpresojmë në situatë të re socio-ekonomike thjeshtë duke diskutuar vetëm për ligje të reja e duke aprovuar ligje të reja. Ligjet janë shprehje e marrëdhënieve dhe e gjendjes ekzistuese, të cilat ndryshohen duke i ndryshuar vetë ato, e jo vetëm ligjet për to. Mbase, nuk është e rastësishme që në Kosovë kemi kaq shumë ligje që nuk zbatohen. Trajtimi i Projektligjit për AKP-në, pa e trajtuar fare privatizimin, që paraqet arsyen pse ekziston AKP-ja, nuk është një punë e arsyeshme, sepse të merresh me pasojën, pa e konsideruar fare shkakun, do të thotë ta mirëmbash problemin.

Kosova i ka më shumë se tri vjet pavarësi, mirëpo ajo ka tri herë më shumë se kaq privatizim. Kuvendi i Kosovës duhet të bëjë debat përmbytësor politik për ekonominë në përgjithësi dhe posaçërisht për procesin e deritanishëm të privatizimit, e mandej t’i shqyrtojmë edhe hollësitë e Projektligjit për AKP-në që e kemi para nesh. Pra, në Kuvendin e Kosovës po mungon një diskutim paraprak për privatizimin, për origjinën, ecurinë, dështimet e sukseset, shembujt dhe rastet e ndërmarrjeve të veçanta dhe për atë se si mendojnë deputetët, si përfaqësues të qytetarëve, se duhet vazhduar më tutje. Një diskutim i tillë është më i nevojshëm kur dihet se ka qenë i mangët edhe në mandatet e mëhershme të Kuvendit, por edhe debati publik për të ka qenë i paktë. Për asnjë temë në Kosovë nuk ka shpërputhje midis rëndësisë së temës dhe rëndësisë që i është dhënë temës, sikurse në rastin e privatizimit.

Dihet që privatizimi në Kosovë nuk ka qenë i drejtuar vetëm te ndërmarrjet joefiçiente, por njëherë te të gjitha ndërmarrjet shoqërore, e tash edhe tek ato publike. Prandaj, e gjithë strategjia e privatizimit realisht ishte kronostrategji, shumë më tepër flitej se kur do të bëhet privatizimi, njoftohej se në cilën valë të privatizimit ndodhej filan ndërmarrja dhe jo aq se çka do të privatizohej e si do të privatizohej. Pyetjet “çka” dhe “si” nuk bëheshin, sepse para se gjithash nuk bëhej pyetja “pse”.

Fuqia e lirë punëtore, mungesa e shqetësimeve për ambientin, sigurinë në punë dhe kujdesin shëndetësor u konsideruan paturpësisht si përparësi e jona, duke besuar se kjo na bënte më joshës për investimet nga jashtë. Privatizimi i këtillë nuk e shndërroi pronën në kapital, por ndodhi e kundërta: kapitali u shndërrua në pronë. Privatizimi nuk e dinamizoi ekonominë, por më parë e ngujoi dhe e rrënoi atë. Privatizimi, po ashtu, nuk e solli as liberalizimin e vërtetë, sepse monopolet publike vetëm sa u bënë monopole private.

Pasi i rreckosën mirë e mirë fabrikat, privatizimi i transformoi ato në qendra tregtare dhe kështu hymë në fazën, të cilën do të mund ta quanim periudhë e kapitalistëve pa kapitalizëm – pra, një emër tjetër ky për feudalët. Një pjesë e madhe e prodhimit edhe ashtu të vogël në Kosovë, nuk u bë për tregun, siç e thotë kapitalizmi, por për vetveten, siç ndodh te feudalizmi. U propagandua për nevojën e ndërmarrjeve të vogla e të mesme, që nuk mund të zhvillojnë sindikata të fuqishme, që nuk kanë kurrfarë shanse në garë me korporatat dhe që s’do të merren me mineralet dhe energjinë, pra me

pasuritë e mëdha të Kosovës, të cilat gjithashtu mendohet të shiten në vitet në vijim. Kosova u fut në garë me shtetet e rajonit e shtetet e tjera për të mbetur tërësisht e shfrytëzuar, si më e dobët që është. Shteti i dobët dhe i hapur i Kosovës nuk i bëri ballë asnjëherë asnjë korporate të huaj. Dhe, sërish, duke e pasur shtetin e dobët dhe të hapur, prej korporatave që erdhën në Kosovë përfitimi ishte vetëm i njëanshëm. Përfituan korporatat e llojit që nuk brengosen për reputacionin e tyre dhe nuk përfitoi Kosova, nëse kur themi Kosova, i përjashtojmë një dyzinë politikanësh të qeverive të pasluftës.

Meqenëse popullit të Kosovës nuk iu pranua e drejta për vetëvendosje, madje as pas shpalljes së pavarësisë, për pasojë nuk ndodhi dekolonizimi para privatizimit. Ndërmarrjet shoqërore deri në vitin 1989, kur u suprimua autonomia e Kosovës, ishin prona të qytetarëve të Kosovës, të shoqërisë kosovare. Mirëpo, përgjatë viteve '90, regjimi i Milosheviqit i shndërroi këto ndërmarrje të Kosovës në degë të ndërmarrjeve të ndryshme të Serbisë dhe ua nënshtroi ato një privatizimi të pjesshëm, nga i cili përfituan ndërmarrësit privatë nga Serbia, që i kontrollonte vetë regjimi, si dhe kompani të huaja, kryesisht greke e italiane. Në mungesë të vetëvendosjes, në thelb të së cilës ndodhet dekolonizimi, që përfshin edhe korrigjimin e tjetërsimit të pronës dhe resurseve natyrore të vendasve, sot e kësaj dite Fondi i Privatizimit me mbi gjysmë miliardi euro mbahet i bllokuar jashtë Kosovës, me ç'rast edhe Serbia e kreditorët e jashtëm kërkojnë hise aty. Sikur të ishte bërë dekolonizimi, nuk do të bëhej fjalë që borxhet e ndërmarrjeve të Kosovës gjatë viteve '90 t'i paguajë Kosova, por Serbia dhe vetëm ajo, si okupatore dhe shfrytëzuese që ishte. Tash, në bazë të këtij Projektligji për AKP-në, me përcaktimin e Autoritetit të Likuidimit po kërkohet nga Kuvendi i Kosovës që ta inaugurojë një princ për ekonominë e Kosovës, që do të ketë së tepërmi pushtet e tepër pak llogaridhënie. Mund të apelosh në Dhomën e Veçantë, të cilën gjuha e formulimit e vendos nën Autoritetin e Likuidimit, ndërkaq te apelimi ndaj Dhomës së Veçantë, si instancë përfundimtare, janë ndërkombëtarët, nga pesë anëtarë, tre janë ndërkombëtarë. Rolin e PSSP-së, pra të shefit të UNMIK-ut, tash e luan Bordi i AKP-së dhe në vend të AKM-së, kemi AKP-në. Kanë ndryshuar akronimet, por jo edhe politikat. Ashtu qysh PSSP-ja dirigjonte me AKM-në, tani Bordi, jo Kuvendi i Kosovës, do të dirigjojë me Autoritetin e Likuidimit. Pra, Bordi dhe jo Kuvendi i Kosovës do ta kontrollojnë këtë Autoritet Likuidues. Prej neve sot, Qeveria po kërkon që ta legjitimojmë mënyrën e këtillë, pra mënyrën që realisht e shfuqizon Kuvendin. Qeveria nuk dëshiron që Autoriteti i Likuidimit të zgjedhet nga Kuvendi.

Privatizimi në Kosovë nuk e ka bërë kalimin në kapitalizëm, por në një lloj të veçantë të kapitalizmit: në neoliberalizëm. Në vitin 1999, në emër të abstrahimit të mundësive tjera jashtë kapitalizmit, është bërë abstrahimi i mundësive tjera brenda kapitalizmit, përveç kapitalizmit neoliberal. Prandaj, Kosova nuk u shndërrua në një shtet-komb, që do të ishte tipik për kapitalizmin e epokës moderne, pra industrializmin, por u kthye në feudalizëm, me dallimin që as bujqësi me tamam s'kemi. Teknologjia informative dhe komunikuese në formën e laptop-ëve dhe celularëve pati efekt maskues: kosovarëve u dukej se janë në hap me botën, porse marrëdhëniet ekonomike, shoqërore dhe politike vazhdojnë t'i ngjajnë shumë më tepër feudalizmit. Aq shumë gjëra e dëshmojnë feudalizmin te ne: nuk kemi industri, lulëzon nepotizmi, është zvogëluar shkrim-leximi dhe është rritur analfabetizmi, ka gjithnjë e më pak para kesh dhe është shtuar këmbimi mall me mall, buxheti grumbullohet në kufi të vendit që nuk kontrollohet i tëri, etnia, si eufemizëm për fisin nga periudha e kolonializmit, është bërë cilësia kategorizuese dhe jo kombi, kryeqyteti Prishtina është rritur jo si pasojë e industrializmit, por e burokratizimit me zyra qeveritare, administrative dhe aso të perandorive, kemi më pak ujë dhe drita në sistemin furnizues publik dhe më shumë puse dhe gjeneratorë privatë, kultura nuk përdoret për ta përkufizuar njësinë politike, por për ta mirëmbajtur

ndarjen hierarkike qytetar-fshatar, zbatohet decentralizimi etnik që e shkatërron unitetin shtetëror, gjallëron lokalizmi krahinor i partive politike me liderë prej bajraktarësh, rrotull tyre sillen biznesmenë feudalë që janë bërë pronarë tokash afër magjistraleve, aeroportit apo aty ku do të jenë minierat e ardhshme dhe, mbi të gjithë këta, kemi mbretin formal dhe mbretin joformal të Kosovës, pra Pieter Feithin dhe Christopher Dellin. Sepse, neoliberalizimi nuk e do as kapitalizmin e llojit menaxheria, ku do të vinte në shprehje kolektivja, mirëqenia, punësimi dhe barazia që i referohet meritave a nevojave. Pra, asnjëherë neoliberalizmi dhe politikat e tij, të cilave ju ka shërbyer kjo Qeveri dhe AKP-ja tash, nuk e duan një kapitalizëm që, pikësëpari, i shërben ekonomisë kombëtare, siç e kemi pasur p.sh. rastin me Slloveninë. Në vend të kësaj, qysh prej fillimit, kishim instalimin e kapitalizmit neoliberal, ku theksohej individualizmi si parim e si qëllim, zgjedhja e individit (që u bë zgjedhje jopolitike: njerëzit zgjedhin veçse pastën e dhëmbëve, destinacionet turistike, nëse kanë para ose kanalet televizive, nëse kanë energji elektrike), liria e individëve, që u bë sërish liri e tregut dhe jo e njerëzve, dhe barazia vetëm si barazi e mundësive që realisht është e pamundur kur nuk është starti njëjtë, e të gjitha këto në kuadër të ekspozimit flagrant të ekonomisë kombëtare ndaj konkurrencës prej jashtë, gjë që në rastin e Kosovës as nuk e la të lindte ekonominë e vendit.

Përfundimisht, Kuvendi i Kosovës do të faktorizohet dhe do të përfaqësojë përnjëmend qytetarët në masën në të cilën flasim e diskutojmë për konceptet politike, para se të flasin për hollësitë teknike.

Unë ju bëj thirrje që të mos e votoni këtë projektligj për AKP-në për shkak se ky ligj e vazhdon punën e UNMIK-ut, pa kurrfarë vështrimi kritik mbi të kaluarën. UNMIK-u krijoi ndërmarrje të reja nga asetet e ndërmarrjeve, i shiti ato dhe mbetën vetëm guaskat e ndërmarrjeve që tash, me këtë ligj për ristrukturimin e AKP-së, i thyen Autoriteti i Likuidimit, kurse çmimin e paguan Fondi i Privatizimit. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit! Grupi Parlamentar i AAK-së, fjalën e ka deputeti Ardian Gjini.

ARDIAN GJINI: Ju faleminderit zoti nënkryetar i Kuvendit!

Të nderuar deputetë të Kuvendit të Kosovës,

Nuk e di qysh është shndërruar Kuvendi i Kosovës në një vend, ku në vend se të flitet për esencën, shumica flasin për efektet anësore të projektligjeve dhe të asaj që ndodhë këtu se si po heqim një element ndërkombëtar, si po bëjmë diçka tjetër, do të thotë askush, në fakt, më falni, nuk guxoj të them ashtu askush, ka deputetë, por shumica e deputetëve po flasin për efektet anësore të projektligjeve dhe po përtojnë në njëfarë mënyre të na kallëzojnë se çka po donë të bëjnë me këtë ligj, bile, bile dhe Qevria e Kosovës asnjëherë nuk po vjen këtu dhe të na thotë për çka e kemi sjellë Projektligjin, për çka i kemi sjellë tri projektligje me procedurë të përshpejtuar, çka po duam të bëjmë, se zakonisht kur Qeveria sjell projektligjin në Kuvend, e ka një qëllim. Mos vet hallin, nëse nuk e ka asnjë qëllim!

Vetëm pak po ndalem te vet dokumenti të cilin e ka sjellë Qeveria e Kosovës dhe çka shkruan në të. Ministri tha se ky projektligj ka kosto të përballueshme buxhetore. Unë do t'ua lexoj përfundimin e Ministrisë së Financave, do të thotë të Administratës të Ministrisë së Financave, të të njëjtës Qeveri, jo të ndonjë qeverie të ndonjë shteti tjetër. Thotë kështu, po lexoj, e keni në dokumentet tuaja: "Përfundim. Departamenti i buxhetit, bazuar në argumentet e vlerësuara dhe që u ceken më lartë, por dhe duke u bazuar në dispozitat që përmban ky draftligj, nuk mund ta mbështesë në aspektin e ndikimit dhe efekteve buxhetore", Do të thotë, nuk ndërtohet shteti kur ministri thotë diçka, e administrata profesionale thotë diçka tjetër. Kjo nuk është mënyra për të

ndërtuar shtet, ose të paktën duhet të argumentohen para se të vijnë në Kuvend, në mes veti, të argumentohen gjatë derisa t'i zgjidhin keqkuptimet ose të mos e sjellin projektligjin, se me të vërtetë, kjo mënyrë e ndërtimit të shtetit të ri, një shtet tri e pak vjet, është mënyra e cila realisht vetëm sa na çon krejtësisht kontra.

E për çka e ka fjalën Departamenti i Buxhetit, që po ju tregoj. Me këtë projektligj parashihet që Agjencioni Kosovar i Privatizimit t'i ndalë 5% të të gjitha mjeteve që janë akumuluar gjatë privatizimit edhe ato paraprakisht, edhe këto që ndodhin tash, por edhe që do të ndodhin në të ardhmen. Tani, ky është agjencion të cilin po e themelojmë ne, se e kemi themeluar, Kuvendi i Kosovës. Edhe nëse i shihni agjencitë e patundësive, edhe ato e kanë tarifën 3 deri në 5%, Domethënë, a ka Agjencioni Kosovar i Privatizimit tarifa të njëjta me agjencitë private, apo çka është ka ndodhë këtu? Domethënë, të paktën duhet të na shpjegohet kjo çështje.

Çështje tjetër, prapë po lexoj, e kemi prej Agjencionit për Integritet Evropian, i cili thotë kështu: "Shqyrtimi dhe analiza (i, e, e kanë shkruar, e duhet të jetë) e këtij Projektligji është kërkuar të bëhet në mënyrë urgjente dhe të përshpejtuar. Duke marrë për bazë kohën shumë të shkurtër për shqyrtim dhe analizë, opinionin e mëposhtëm nuk pasqyron opinionin ligjor të plotë dhe përmbledhës". Domethënë, këto kanë ardhur prej Qeverisë, këto janë agjencione qeveritare. Edhe në dokumentet të cilat i kemi marrë na, këto janë materialet dhe ministri na prezanton diçka tjetër.

Kjo më sjellë deri te elementi tjetër, që është edhe diçka tjetër, para se të hyjë esencialisht në atë që duhet thënë për këtë ligj, është: sa kohë merr Qeveria e Kosovës për ta paraqitur ligjin para Kuvendit dhe para popullit? 2 minuta! Po ju garantoj se, nëse ishim duke folur për ligjin se sa të trasha duhet të jenë vijat e asfaltit, kishin për t'i marrë një 10, duke na dhënë detaje të vogla teknike, kush e di se çfarë për tokëzimet e krejt çka ka tjetër. E për Ligjin i cili ka të bëjë realisht me menaxhimin e krejt pasurisë të Kosovës, e cila është akumuluar që 10 vjet, janë dy minuta shpejt e shpejt, hajt kaloni nëpër të, aprovoni se nuk është fort me rëndësi kjo punë, hajde se po ecim më tej. Domethënë, ku kemi mbërri, është pyetja kryesore që duhet t'ia shtrojmë vetes vazhdimisht, ku ka mbërri Kosova, ku ka mbërri Kuvendi, ku ka mbërri Qeveria, ku kemi mbërri ne, kur për dy minuta tentohet të kalohet një ligj, i cili, edhe një herë po ju them, se do të kalojmë te esenca, se nuk di qysh është mësuar të flasë vetëm me rrotulla, 2 minuta, shpejt, kaloni nëpër ligj edhe ecim më tutje!

Po kaloj tani te esenca politike e Ligjit. Para një muaji e kemi votuar Kornizën afatmesme të shpenzimeve, në fakt e keni votuar, këtu në këtë Kuvend. Një muaj më vonë, vjen një dokument i cili është në kundërshtim me Kornizën afatmesme të shpenzimeve, që e keni votuar vet. Kjo na bën të dijmë që në Qeverinë e Kosovës, në zyrat e Qeverisë së Kosovës, situata është kështu: nuk ka strategji, nuk ka ide çka të bëhet edhe çka t'i bjen në mend dikujt në mëngjes, sikur fëmijët e vegjël që njëherë e marrin një lodër edhe e hedhin, atëherë e marrin tjetrën edhe e hedhin, derisa diçka në fund ju pëlqen ose i kryen punë. Do të thotë, nuk ka qeverisje në vend. Ka Qeveri, por nuk ka qeverisje, nuk ka sistem të menduarit, nuk ka sistem qeverisës edhe kjo është fondamenti i arsyeve pse Kosova është në gjendje çfarë është, për shkak se nuk ka qeverisje.

Çështja tjetër është kjo: Ne në Aleancë mendojmë se pasuria e Kosovës duhet të shfrytëzohet, por jo të shpenzohet, përderisa Qeveria e Kosovës, që është fundamentalisht e majtë, edhe pse thotë diçka tjetër, është Qeveri e cila do të shpenzojë, do të thotë edhe dallimi në mes të majtës dhe të

djathtës është e se e djathta krijon, e majta shpërndanë atë që është krijuar, kjo është esencialisht kjo që është në krejt botën edhe askush nuk e vë në dyshim. Edhe na tash po kërkojmë edhe një herë mos të shpenzohet pasuria e Kosovës, të shfrytëzohet, se kur shfrytëzohet, krijon edhe më tepër se sa që ka. Nëse, shembull ta marrim, 500 milionë euro të cilat janë akumuluar në Fondin e Mirëbesimit, do të ishin shfrytëzuar, do të mund të kreditohej bujku, me kamata jashtëzakonisht të ulëta, për të mos thënë zero, ekonomia e vogël, ekonomia e mesme, në këtë mënyrë do të gjeneroheshin vende të punës dhe në këtë mënyrë shteti edhe më shumë do të merrte, por do të merrnin të gjithë për shkak se do të shfrytëzoheshin dhe do të shfrytëzoheshin në mënyrë që të mos shpenzohen kurrë.

Përderisa Qeveria e Kosovës, e cila i ka trashëguar në rezervë 500 milionë euro, e i ka sjellë në zero, tash po duhet t'i marrë edhe disa 500 milionë euro, t'i sjellë prapë në zero, se është duke i shpenzuar. Edhe ne, sot i kemi...

(Ndërhyrje)

...çohu mandej fol, mos më fol kur jam duke fol unë! Qeveria e vendit sot i merr, nesër nuk i ka, i shpenzon...

(Ndërhyrje)

...Po, po, ashtu duhet, nuk është kulturë të flasësh prej aty, çohu merre fjalën mandej, repliko! Ne po insistojmë që kjo mos të ndodhë. E tash, pse ka ndodhur që kjo pako e ligjeve ka ardhur shpejt e shpejt? Kjo pako e ligjeve ka ardhur shpejt e shpejt për shkak se duhet marrë paratë që janë akumuluar që 9 vjet, duhet të kthehen edhe të futen në buxhet të Kosovës dhe të shpenzohen për shkak se po duket se ju ka dështuar privatizimi i postës.

Tani, po shpresoj që na e kemi keq, por po presim edhe po shohim edhe po dua t'i mbaj peng fjalët e mia dhe të të gjithë atyre që flasin sot.

Çfarë fshihet pas shpejtësisë me të cilën ka ardhur ky ligj këtu? Pse kaq shpejt, pse duhet me procedurë të përshpejtuar? Pse nuk iu ka rënë ndërmend, shembull ta marrim, para 6 muajve, ta sjellin këtë ligj këtu, pse para gjashtë muajve nuk ka qenë me urgjencë kjo? Kanë mundur para 6 muajve të mendojnë që duhet të kryehet kjo punë, se është punë e mirë dhe ta bien këtë ligji në Kuvend edhe Kuvendi ta procedojë normalisht. Po, ju ka rënë ndërmend vonë. Tash ju ka rënë ndërmend se kanë thënë – kuku, mbetem pa mjete!

E fundit, çka po ju them, është kjo: Fondi i Mirëbesimit ka pasur garantor, garantorët kanë qenë ndërkombëtarët, nuk kanë qenë vetëm Kosova ajo që ka garantuar për fondin e vet, por ka pasur garantorë ndërkombëtarë, për shkak se menjëherë pas lufte Serbia është ankuar, siç u tha më përpara, me të drejtë, dhe ka pretenduar se këto prona janë të saj. Padrejtësisht ka pretenduar. Këta garantorë ndërkombëtarë deri me tash nuk kanë lejuar që ne t'i shfrytëzojmë këto mjete përderisa nuk zgjidhen përfundimisht dilemat cilat ekzistojnë. Tash po lejojnë, mirëpo këta garantorë, realisht, e kanë pasur hallin e Serisë dhe po na intereson - a iu ka hequr halli i Serbisë? Këto janë pyetjet tona.

Sidoqoftë, për shkak se ne kemi insistuar edhe prapë insistojmë që mjetet e Kosovës të sillen në Kosovë, ne do ta mbështesim në parim këtë projektligj, por nuk do ta keni votën e Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës kur ky ligj do të votohet në leximin e dytë, nëse nuk do të merren parasysh edhe nuk do të jepen përgjigje në pyetjet tona. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti Gjini!

Grupi Parlamentar Kosova e Re, deputeti Muhamet Mustafa e ka fjalën!

MUHAMET MUSTAFA: I nderuari zoti kryesues,

Të nderuar kolegë deputet,

Të nderuar Kabinet qeveritar,

Më lejoni që në fillim të paraqitjes së qëndrimeve të Grupit Parlamentar të Kosovës së Re, edhe unë të shpreh pakënaqësinë se ne, këtë pako ligjesh të cilat kanë një rëndësi shumë të madhe për Kosovën, po e shqyrtojmë me nguti. Nuk di sa ka pasur kohë për shqyrtim Kabineti qeveritar, por në bazë të disa indikacioneve që unë i kam, edhe atje është kaluar shpejt ky ligj. Nën dy, u pa që komisioni funksional që duhet t'i trajtojë me kujdes këto ligje, i ka marrë dy ditë përpara, e një pako ligjesh me një vëllim kaq të madh, me një materie kaq të ndërlikuar, duhen së paku një muaj që të kenë kohë deputetët që t'i lexojnë dhe të konsultohen dhe të realizojnë përgjegjësinë e tyre që kanë marrë para deputetëve. Prandaj, mendoj se praktikat e tilla duhet të ndërpriten dhe duhet të krijohet kohë mjaftë për deputetët që t'i analizojnë me përgjegjësi ligjet e tilla organike dhe shumë të rëndësishme për zhvillimin e Kosovës, sepse ne përgjigjemi para votuesve për votat që japim sot. Prandaj, mos të vijmë në një situatë kur ne duhet të votojmë, e nëse nuk votojmë, të akuzohemi, siç ndodhi sot, se jemi për ruajtjen e strukturave të tejkaluara, të cilat i kemi kritikuar, siç ka qenë struktura e AKM-së, për shembull, ose e Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit. Pra, ne jemi ku jemi, ndonëse procesi i privatizimit ka shkuar larg këto vite, prapë se prapë këto ligje janë të një rëndësie të veçantë sepse mund të korrigjojnë disa defekte që e kanë përcjellë këtë proces, edhe përkundër rëndësisë të madhe që e ka pasur procesi i privatizimit, sepse përkundër problemeve që ka pasur privatizimit, vetë lansimi i privatizimit ka qenë një lloj fitoreje dhe një shprehje e një sovranitetit të Kosovës. Në atë drejtim, pra, ka pasur një rëndësi, por problemet e mëdha e kanë përcjellë dhe ka qenë mundësia që me këto ligje ne t'i korrigjojmë disa probleme.

Ajo që mund të merret si diçka, që unë kam mundur t'i nxjerr nga leximi i këtyre ligjeve, si pozitive është fakti se është precizuar likuidimi më mirë si një mundësi e zgjidhjes të disa problemeve të një pasurie shoqërore, e cila është inaktive dhe duhet të vihet në funksion ekonomik, është një mundësi modeste, tejet modeste për deblokimin e mejteve nga fondet e shitura dhe tre, ka edhe një mundësi për korporatizimin, mundësinë e korporatizimit të ndërmarrjeve shoqërore, që nuk janë privatizuar deri tani dhe kjo krijon, hap disa mundësi.

Megjithatë, më lejoni të them se koncepti dhe instrumentet e ligjit mbeten shumë nën ndikimin e koncepteve që e përbëjnë në inercion dhe vazhdimësi të atyre pikëpamjeve të cilat kanë qenë në bazamentin e funksionimit të Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit, e bazament i funksionimit të Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit ka qenë kontestimi, po ua përsëris, kontestimi i të drejtës së kosovarëve që ta qeverisin pronën e tyre shoqërore. Pra, ne jemi sot tri vite pas shpalljes së pavarësisë dhe ende nuk ka ardhur në shprehje ky fakt, se Kosova tash është e pavarur dhe duhet në mënyrë të plotë ta realizojë sovranitetin e vet në qeverisjen dhe menaxhimin e aseteve të saja.

Një dobësi esenciale e këtij ligji është se shitja e aseteve gjithmonë vëhet, nën një, në funksion të kreditorëve, e diku, nëse mbetet diçka, në funksion të zhvillimit të Kosovës. Ky është ai problemi fundamental në bazamentin e konceptit mbi AKM-në, i cili duhet të ndryshojë patjetër dhe pasojë e këtij koncepti, më lejoni të them edhe këtë, se pasojë e këtij koncepti janë rezultatet tejet modeste, të them, nga privatizimi në Kosovë. Nuk mund të themi se nuk ka fare rezultate, unë nuk jam me ata që thonë se nuk ka kurrfarë rezultati. Ka edhe shembuj ku ka rezultate, por rezultatet janë tejet modeste. Dhe tash, çka ka ndodhur? Tash ne më duket se kemi lëshuar një shans shumë të mirë, që këto defekte që i kemi pasur deri tani, me këtë pako ligjesh t'i korrigjojmë shumë më tepër. Nuk po them se nuk janë korrigjuar hiq, ka disa korrigjime, por me këtë pako ligjesh ne kemi mundur t'i korrigjojmë shumë më tepër, por kjo bëhet e pamundur me një ngutje të tillë, me një ngarkim të tillë të deputetëve dhe me një eskluзивitet në dokumente.

Ne duhet t'i tejkalojmë këto qasje ekskluzive në trajtimin e problemeve kaq të rëndësishme për zhvillimin e Kosovës. Duhet të krijohet një bazament për të arritur një konsensus minimal social, ekonomik dhe politik kur është në pyetje qeverisja dhe privatizimi i pronës shoqërore në Kosovë.

Prandaj, mos të habitemi, nëse ne ngutemi me gjëra të tilla dhe nëse kemi probleme sociale, kemi tensione politike të cilat, prapë po them, do ta rrezikojnë stabilitetin politik dhe social në Kosovë dhe do të çojnë, dërgojnë porosi jo të mira për mjedisin investues në Kosovë dhe mjedisin politik në Kosovë.

Çka duhet bërë dhe çka mund të shpëtohet, të them ashtu, në këtë shpejtësi. Së pari, më lejoni t'i ceku disa propozime tona, të cilat shpresoj se do të merren seriozisht. Koncepti ynë është që në vend të fondit rizidual, siç thuhet në ligj, i cili na siguron që ka pretendime për kërkesa të kreditorëve dhe ato pretendime, në qoftë se diçka jetë mbi ato pretendime, atëherë ajo pjesë e mjeteve mund të debblokohet. Ne e dimë se pretendimet e kreditorëve, të shumtën janë pretendime të egzagjeruara, pretendime fallco te Serbisë, e cila e konteston pronësinë e Kosovës në pronën e vet shoqërore dhe më tutje.

Prandaj, në vend të kësaj, Koalicioni për Kosovë të Re, për fondet ekzistuese propozon që të krijohet, të shpëtohet së pari pagesa e 20%, maksimalisht.

Nën dy, të krijohet një fond i restitimit, jo rizidual çka të mbetet, nëse jetë diçka, hajrli koftë. Ne kërkojmë që të krijohet Fondi i ristitimit, i cili do të ketë 15 deri 20% të fondeve nga privatizimi dhe do të ruhet për kërkesat e kreditorëve. Në qoftë se ka ndonjë kërkesë të arsyeshme të kreditorëve, ne mund t'i paguajmë kreditorët, jo spekulativ, jo fiktiv, por kreditorë të arsyeshëm prej asaj pjese dhe kjo do të jetë më se e nevojshme. Përvojat tregojnë në Evropë e gjithkund, fFondi i restitimit ka qenë 7 deri 5%, 5 deri 7%, në Kosovë është një situatë sui-generis, do të them edhe unë, mund të shkojmë ndoshta deri në 20%.

E dyta, modeli i dytë, ne kërkojmë një model të ri të futet në Ligj për privatizimin. Ky është modeli i një partneriteti publiko – privat, i cili për objektet e rëndësishme, për pasuritë e rëndësishme, siç janë minierat, siç janë ndërmarrjet e pa privatizuara të Gjakovës, siç janë tokat ndryshme, do të krijojnë një partneritet publiko – privat, ku pjesa publike do të ketë pronësinë rreth 30%, investitori privat pjesën tjetër dhe pas regjenerimit të rristurimit dhe rritjes së vlerës së kësaj, pas 3 viteve, kjo mund të shitet. Përvojat tregojnë se me këtë ne do t'ua rrisim vlerën këtyre dhe nuk do të bllokojmë mjetet e investitorëve brenda dhe do të ketë përfitime.

Sipas disa informatave, Ferronikeli sot ka shitur 1/3, tri herë më shumë se që e ka shitur Kosova. 1/3 e Feroniklit tash këto ditë është shitur me çmim më të lartë tri herë se sa që e ka shitur Kosova në mënyrë origjinale. Prandaj, ky model i yni është atraktiv për investitorët privatë dhe krijon mundësi që të rritet vlera e aseteve të Kosovës dhe këto mjete të jenë në funksion të zhvillimit të Kosovës.

Çështja e tretë esenciale që na kërkojmë, është që mjetet edhe nga Fondi i privatizimit, të cilat do të vijnë në buxhetin e Kosovës, mos të kenë trajtimin e mjeteve të zakonshme të buxhetit të Kosovës e të përdoren për mallra, shërbime dhe për paga, sepse këto janë mjete të njëhershme, krijojnë obligime afatgjata dhe krijojnë probleme të mëdha në buxhetin e Kosovës. Këto mjete duhet të shkojnë në Fondin për zhvillimi në qëndrueshëm të Kosovës dhe ai fond duhet të përdoret për investime në infrastrukturë, për investime në arsim, për investime në shëndetësi, në mënyrë që gjeneratat e ardhshme të cilat janë hisenike të kësaj pasurie, të kenë përfitime, jo vetëm gjeneratat e stome.

Bordi dhe funksionimi i tij, nuk është mirë që bordi të ketë 8 anëtarë, por duhet të shihet përmbajtja e bordit, që të jetë më funksionale, të ketë më shumë ekspertë të pavarur, mos të jenë në bord të infiltuara interesat grupore dhe politike. Prandaj, në këtë pjesë duhet të kemi kujdes. Dy, nuk është mirë kryetari t'i ketë dy vota.

Çështja tjetër është kostoja shumë e madhe e 5%-shit, edhe kjo duhet të ndryshojë. Pra, siç po e shihni, ka probleme shumë, mirë është që kanë ardhur, por duhet të diskutohen me durim, duhet t'i ndërtojmë këto, një konsensus me durim rreth këtyre...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Ju faleminderit! Shtojani edhe 2 minuta!

MUHAMET MUSTAFA: ... prandaj varësisht nga ndjesia e Qeverisë dhe akterëve tjerë që të dëgjojnë këto argumente të cilat i folëm, Koalicioni për Kosovë të Re do të shikojë lidhur me përkrahjen e këtij ligji në fazat e ardhshme, prandaj ne e rezervojmë të drejtën që të tërheqim përkrahjen në qoftë se nuk ka një debat tolerant dhe krijues lidhur me këto argumente. Ju faleminderit!

KRYESUESI: SLS-ja, nuk ka të paraqitur.

Në emër të Grupit Parlamentar "6", deputeti Fikrim Danka.

FIKRIM DAMKA: Teşekkür ederim Meclis Başkan yardımcısı

Sayın Başbakan

Sayın Bakanlar

Değerli milletvekilleri

Kosova Ozelestirme Ajansi kanun taslagi, Kosva BM-Misionun cikartmis oldugu yonetmenlik geregi kurulan Kosova guven ajansinin

(AKM) nin devaminin Hukuksal eksikliklerini tamamlayan bir kanun oldugunu gormekteyiz.

Bu gune kadar bu yonetmenlikle geceklestirilen ozelestimenin Kosova ekonomisine yeteri kadar hiz kazandirmadigini, issizlige care bulamadigini gorduk.

Yine bu gune kadar ozelestirilen sirketler uzerinde yabanci yatirimciyi ve dis kapitalin ilgisini cekemedigimizi ve bunun nedenini yeteri kadar hukuksal zemin ve guven olmadigindan kaynaklanmaktadir.

Kosovada gerceklestirilen ozelestirmelirinin hukuksal bosluk nedeniyle dogru yapilmadigini, 1998 yilina kadar calisir halde olan fabrikalarin bu gun bu ozelestirme sebebiyle kapali oldugunun ve ya bu fabrikalarin yerine binalarin insa edildigini, tarim topraklarinin uzerine de cesitli binalarin yapildigini gormek bizleri uzmektedir bu tur davranislar Kosova ekonomisine zarar vermektedir.

Bu kanun taslaginin bundan sonra yapilacak ozelestirmelerinin daha dogu olacagini kanunun 6 madesinde bilirtilen ozelestirme sartlarinin uygulanacagini inanarak Kosova ekonomisine hiz kazandirarak yabanci yatirimciyida Kosova ya cekebilecektir.

Kosova ozelestirme ajansinda calisan personelin icerisinde topluluklarinda temsil edilmesi konusuna dikat edilmesi gerekmektedir.

Genel anlam ihtibariyle 6+ Grub adina kanu taslagini desteklemekteyiz.

KRYESUESI: Tash është radha e deputetëve. Deputeti Bekim Haxhiu e ka fjalën!

BEKIM HAXHIU: Ju falemidnerit, i nderuari nënkryetar Haliti!

Ë respektuar Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Do të paraqes disa prej vërejtjeve të mia sa i përket Ligjit për Agjencionin Kosovar të Privatizimit.

Pika e parë, do të fokusohem në nenin 12, te përbërja e Bordit, ...bordi i përbërë nga 8 drejtorë, duke përfshirë drejtorin menaxhues. Versioni i propozuar, bordi përbëhet nga 8 drejtorë. Në nenin 12, pika 2 përshkruhet e njëjta pa ndryshime. Unë mendoj se ky nen duhet të ndryshohet tek përfaqësimi i sindikatave. Në këtë nen thuhet se Kuvendi i Kosovës do të emërojë 5 drejtorë, duke e përfshirë një përfaqësues nga komuniteti joshqiptar, si dhe kryetarin e Bashkimit të Sindikatave të Kosovës.

Meqenëse në Kosovë ka më shumë sindikata, jo vetë BSPK-ja, ky nen duhet të thotë, do me thënë si një përfaqësues i punëtorëve të sindikatave, apo që kjo të zgjidhet mes përfaqësuesve të sindikatave me rotacion apo në formë që domethënë të kemi një përfaqësues që e zgjedhin të gjitha sindikatat bashkërisht.

Vërejtja tjetër është në nenin 13, pika 1, propozohet që kryesuesi i Bordit dhe zëvendësi i tij, të jenë pa mandat të qartë, kurse anëtarëve tjerë t'ju përsëritet mandati çdo dy vite. Mendoj se duhet të thuhet se mandati për anëtarë të Bordit pa përjashtim të jetë 3 vjet. Dhe në nenin 15, pika 3, propozohet përfaqësimi duhet të bëhet me pëlqimin e komunave. Ky nen e pamundëson

privatizimin në komunat ku udhëhiqen nga organet paralele dhe mendoj se duhet që këtu AKP-ja, duhet të bashkëpunojë ngushtë me përfaqësuesit e komunave gjatë periudhës së privatizimit.

Në nenin 16, pika 4, propozohet të jetë: anëtarët e Bordit nuk kanë të drejtë të zgjidhen si drejtor menaxhues. Unë mendoj se kjo nuk është në rregull dhe duhet të fshihet në tërësi për arsye se në shumicën shteteve të Bashkimit Evropian, 90% e këtyre shteteve nuk ka një praktikë të tillë, por mendoj që, domethënë, edhe drejtori menaxhues duhet të jetë anëtar i Bordit, ashtu siç është edhe në Trustin Pensional, edhe në ndërmarrjet tjera publike, siç është KEK-u, PTK-ja dhe të tjera.

Ky propozim duhet të jetë i fokusuar në gjërat praktike që janë në dobi të privatizimit dhe një çështje tjetër që dua ngreh, domethënë, për shkak që edhe para dy vitesh Asociacioni i komunave të Kosovës i është drejtuar Agjencionit Kosovar të Privatizimit me një kërkesë për zgjidhjen e pronësisë së stadioneve të futbollit dhe është një çështje që padrejtësisht është futur në menaxhimin e Agjencionit Kosovar të Privatizimit, në veçanti të disa stadioneve të cilat konsiderohen si asetë të ndërmarrjeve shoqërore, bazuar në Kushtetutën e Kosovës, neni 65, pika 1 dhe neni 159 pika 2 dhe nenin 160 dhe Ligjin për AKP-në. Vërejtjet e mia do t'i paraqes për stadiumet e futbollit, duke pasur parasysh se pasiguria e vazhdueshme juridike lidhur me pronësinë e këtyre ndërmarrjeve dhe pasiguria është duke penguar në masë të madhe edhe investimet edhe ... e tyre zhvillimin e futbollit, duke ditur që të gjitha stadiumet e futbollit në Kosovë janë ndërtuar nga fondet për zhvillim, të sportit dhe rinisë, fondet e grumbulluara në Kosovë në afate kohore të kaluara nga tatimpaguesit kosovarë. Prandaj, do të ishte jo korrekt që këto të menaxhohen nga Agjencioni Kosovar i Privatizimit. Ato do të duhej të ishin në pronësi të klubeve apo të komunave gjegjëse.

Duke e ditur se të gjitha stadiumet në Kosovë, prej ndërtimit kanë qenë në menaxhim dhënë pronësi të klubeve, për shembull stadiumi i Prishtinës, prej themelimit, të ndërtimit ka qenë i menaxhuar dhe i udhëhequr nga Klubi "Prishtina", ai i "Lirisë" në Prizren nga "Liria", ai i Pejës në Pejë nga KF "Besa", në Mitrovicë nga "Trepça", në Ferizaj nga "Ferizaj" dhe kështu me radhë, të gjitha stadiumet kanë qenë në pronësi prej ndërtimit të tyre dhe të menaxhuara nga vetë klubet, prandaj është e pajustificueshme dhe kjo ka penguar edhe zhvillimin e futbollit për arsye se ne nuk kemi pasur mundësi që të bëjmë diçka rreth zhvillimit të futbollit, po as nuk kemi pasur hapësirë që të joshim investitorët që të jenë pjesë e kësaj. Mendoj që duhet shqyrtuar kjo çështje edhe në komision pas këtij leximi.

Në parim e mbështes këtë ligj, do të thotë, për shkak që jep një mundësi që edhe mjetet të cilat janë grumbulluar nga privatizimi, domethënë të shfrytëzohen nga buxheti i Kosovës, nga Qeveria. Në parim, e mbështes këtë dhe e përkrah. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit! Jeni paraqitur dy diskutues që keni diskutuar njëri në emër të Grupit, tjetri në emër të Komisionit, prapë.

Zenun, ti dhe Sala, jeni të paraqitur prapë. A e keni kërkuar fjalën si deputetë apo si? A do të diskutosh si deputetë, prapë? Jo, thashë mos e ke harruar të shtypur atë. Okej. Atëherë, fjalën e ka deputetja Sala Berisha Shala.

SALA ABRISHA SHALA: Ju faleminderit, kryesues!
Tani fjalën e kërkoja në emrin tim personal.

Është për t'u përshëndetur ky interesim dhe ky debat në lidhje me këtë pako të projektligjeve, edhe pse pati deputetë që dolën jashtë rendit të ditës, folën për procesin e privatizimit e jo për ligjin si ligj.

Ne megjithatë e dimë se procesi i privatizimit të ndërmarrjeve shoqërore në Kosovë përfaqëson njërin ndër proceset më të ndërlikuara të privatizimit në vendet postkomuniste. Kjo edhe për vetë faktin se Kosova ka specifika të dallueshme prej këtyre vendeve. Më lejoni t'i përmend disa specifika, t'ua përkujtoj kolegëve të mi deputetë, por edhe opinionit i cili na përcjellë me vëmendje. Privatizimi në Kosovë i ka disa specifika nga të cilat lindin edhe vështirësitë e këtij procesi dhe që mund të përmbliidhen së paku këto arsye:

Nën një, privatizimi është udhëhequr nga një dualizëm institucional, organizatës ndërkombëtare të quajtur UNMIK, përmes Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit dhe pjesëmarrjes së institucioneve të Kosovës.

Nën dy, baza ligjore konfuze dhe jo e qartë.

Nën tre, konfliktet pronësore në pronën që privatizohet.

Unë e kam një pyetje për kolegët e mi deputetë të cilët nuk i mbështesin këto pako të ligjeve: a janë të interesuar që të vazhdojë ky dualizëm institucional me mos miratimin e këtyre ligjeve? A janë të interesuar që ende në Kosovë të mbretërojë një konfuzitet ligjor? A janë të interesuar që të mos sqarohen konfliktet pronësore në pronën që privatizohet?

Dhe, një tjetër gjë që dëshiroj ta them, se u përmend këtu se këto ligje kanë ardhur me nguti në komisionin funksional, de jure kanë ardhur me nguti, mirëpo ne si komision funksional në vazhdimësi kemi qenë të njohur rreth sfidave që janë paraqitur për ndryshimin me urgjencë të këtyre ligjeve dhe për prurjen me urgjencë të ligjeve të cilat nuk kanë qenë më parë në Kosovë.

Unë dua t'ua përkujtoj edhe kolegëve të mi në komision, por edhe të tjerëve se në prill të këtij viti, Instituti GAP e ka organizuar një debat shumë të rëndësishëm, një tryezë të rëndësishme me temën: Konflikti ligjor lidhur me privatizimin e ndërmarrjeve shoqërore, në të cilën temë janë debatuar, është shteruar kjo temë dhe kanë nxjerrë konkluzione që duhet të ndryshohen ligjet që janë për momentin, që kanë dualizëm ligjor dhe duhet të bëjnë ligje të cilat ende nuk e mbulojnë sferën e çështjeve të ndryshme që lidhen me këtë çështje që po debatojmë në Kosovë. Prandaj, nuk është nguti për Komisionin dhe ata që janë të interesuar sinqerisht të japin ndihmën e vet në këtë drejtim, nuk duhet t'i shohin gjërat shkëputur, ndaras por në kontinuitet dhe ata deputetë që kanë qenë pjesë e komisionit edhe në mandate tjera, e dinë se sa është punuar në këtë drejtim.

Tjetër, ne i kemi edhe raportet vjetore të AKP-së, të cilat sillen në Kuvend dhe vazhdimisht sfidë për ta kanë qenë edhe këto probleme të cilat ne po i shqyrtojmë sot dhe po tentojmë që t'i sqarojmë dhe të vendosim një rregull ligjor që më mos të përballohet institucionet tona, siç është AKP-ja, me sfidat e tilla.

Krejt në fund, dëshiroj që t'i ftoj kolegët e mi deputetë dhe ju ftoj, urdhëroni bëhuni pjesë e ndryshimeve pozitive, sepse nesër do të bëhet tepër vonë dhe do t'ju mbetet merak, sikurse po i

shfrytëzoni foltoret për patriotizmin tuaj të vonuar. Do t'ju mbetet merak, se do të vonoheni edhe në procesin e zhvillimit ekonomik të Kosovës. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit! deputetja Teuta Sahatqija e ka fjalën!

TEUTA SAHATQIJA: Ju faleminderit, kryesues !

Këtu folëm për Projektligjin për Agjencinë Kosovare të Privatizimit dhe si Grup Parlamentar e kemi paraqitur mendimin tonë. Unë desha të ngrejë një çështje tjetër, një çështje e cila ka të bëjë me AKM-në, me AKP-në, sidomos tash me ligjin e ri. Është çështja e ndërmarrjeve aksionare të Gjakovës.

Nuk dëshiroj t'i hyjë historisë dhe të tregoj se sa të rëndësishme kanë qenë këto ndërmarrje aksionare, këto shoqëri aksionare në të kaluarën, sepse të gjithë ne e dimë atë. Por, fatkeqësisht, të gjithë ne e dimë edhe atë se nuk ju ka kushtuar kurrfarë rëndësie këtyre ndërmarrjeve aksionare apo shoqërive aksionare dhe nuk ju ka kushtuar aspak rënësi që të revitalizohet industria dhe ekonomia e Gjakovës. Mendoj që është pikërisht rasti tash që të përmendet kjo, që të vazhdohet puna edhe në Komisionin për Zhvillim, në mënyrë që këto të mos mbesin peng dhe të mos bllokojnë zhvillimin ekonomik, në rend të parë të Gjakovës, por edhe të Kosovës në përgjithësi.

Dëshiroj të përkujtoj që statusi i ndërmarrjeve, të cilat kanë bërë transformimin e pronës shoqërore në atë private të punëtorëve aksionarë, në bazë të ligjeve në fuqi të ish Federatës Jugosllave, përkatësisht sipas fletoreve zyrtare përkatëse, duhet të aprovohet në tërësi.

Të gjitha ndërmarrjet e Gjakovës, pas aplikimit për regjistrim si shoqëri aksionare më 30.06. 2003, i kanë fituar të gjitha paditë. Disa të vërtetuara edhe nga Gjykata Supreme e Kosovës, me të cilat vendimet e Gjykatës Ekonomike të Prishtinës e obligojnë Zyrën për regjistrimin e bizneseve që këto ndërmarrje t'i regjistrojnë si shoqëri aksionare. Ndërmarrjet të cilat e kanë bërë transformimin e kapitalit, sipas ligjeve në fuqi, të njohura edhe me rregulloret mbi formimin e AKM-së, domosdoshmërisht duhet të pranohet transformimi i kapitalit shoqëror në atë aksionar privat, nëse ligjet janë aplikuar në mënyrë të drejtë dhe nuk kanë qenë diskriminuese.

Nuk mund të abrogohet apo të shuhet një e drejtë e fituar në pronën pas 20 viteve, me ligjet e kohëpaskohshme, siç është ky Ligji i AKP-së, ngase në këtë mënyrë cenohet Konventa Evropiane mbi të drejtat e njeriut, përkatësisht neni 1 dhe Protokolli i kësaj Konvente.

Dëshiroj, pra, të shfrytëzoj rastin që të ngrejë përsëri vetëdijen për këtë problem, i cili vazhdon edhe 12 vjet pas luftës ta rëndojë ekonominë e Kosovës dhe në veçanti e ekonominë shumë të brishtë të qytetit, të Komunës të Gjakovës. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit! deputeti Visar Ymeri e ka fjalën!

VISAR YMERI: Ju faleminderit, kryesues!

Të nderuar deputetë,

Unë e përmenda se këto ligje janë ngutur në komision dhe kjo qëndron, janë ngutur edhe nëse dikujt ia merr mendja se nuk janë ngutur këto ligje, nëse dikush kujton që për dy ditë është e mjaftueshme për t'i proceduar këto ligje, atëherë kjo është çështje tjetër. Mirëpo, ligjet janë ngutur

në komision dhe nuk është dhënë kurrfarë arsytimi për këtë nguti. Këtë e përmendën edhe deputetët tjerë.

Për sa i përket ligjit një fjalë, konsideroj që më e rëndësishme se sa ta kemi një ligj, është ta shohim nëse ai ligj vërtet i përmbush nevojat ekonomike të Kosovës dhe vërtet i përmbush nevojat dhe të drejtat sociale që i gëzon populli i Kosovës. Pra, ne e dimë që procesi i privatizimit është proceduar në kundërshtim të plotë edhe me nevojat dhe interesat ekonomike të vendit, po ashtu edhe me të drejtat shoqërore që i kemi pasur ne si popull, e që vazhdojmë t'i kemi dhe këtë na e ka bërë UNMIK-u, në bashkëpunim, natyrisht, me krerët politikë të Kosovës. Mirëpo, tash t'ia bëjmë këtë gjë vetes, është dy herë krim. Dhe, fatkeqësisht, ky ligj e vazhdon këtë logjikë. Pra, këtu po thuhet që duam që përmes ligjit t'i ndryshojmë këto, ta ndryshojmë Rregulloren e UNMIK-ut dhe ta heqim UNMIKU-n nga procesi i privatizimit, në mënyrë që ta marrim vetë në duar atë, mirëpo asgjë nuk e ndryshon procesin privatizimit si të tillë.

Pra, ne tash po bëhemi, Qeveria e Kosovës, në këtë rast, së bashku me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, po shndërrohet në një UNMIK të dytë. Unë nuk mendoj që kjo është zgjidhje, kjo është vetëm vazhdim i problemit me emër tjetër, siç e përmendi edhe Albini. Po ashtu, po flitet këtu që UNMIK-u edhe rregulloret e UNMIK-ut do të shfuqizohen tërësisht me këtë ligj. Mirëpo, në nenin i cili i cakton fuqitë apo fushëveprimin e Agjencisë, në pikën 1.19, në faqen 20 të Ligjit që e keni përpara, thotë që Agjencia ka të drejtë ta iniciojë, sipas Rregullore së UNMIK-ut 2005/40, procedurën e mbikëqyrur nga gjykatat e organizimit ose likuidimit të ndërmarrjes dhe marrin pjesë në ato procedura në cilësinë, në mënyrën e paraparë me atë Rregullore. Pra, ky është vazhdim i Rregullore së UNMIK-ut, nuk është shfuqizim i saj.

Tjetër, ky nen po ashtu e paraqet edhe një lloj, si të them ashtu, dykuptimësie të re për shkak se edhe në Ligjin për Dhomën e Veçantë thuhet se Dhoma e Veçantë ka të drejtë ta iniciojë procesin e likuidimit, ndërkohë që këtu kjo e drejtë i jepet Agjencisë, pra këtu ekziston një mospërputhje në atë se kush do ta ketë të drejtën e inicimit të procedurës së likuidimit të ndërmarrjes.

Çështja tjetër për të cilën desha të flas, është edhe çështja e kreditorëve apo kërkesave, qoftë të rëndësishë apo të kreditorëve që mund të paraqiten për ndërmarrjet për të cilat jemi duke folur, pra ndërmarrjet e privatizuara. Aty në ligj, të paktën nuk përmendet askund se cilat do të jenë ato kërkesa, përveç që quhen kërkesa legjitime dhe jolegjitime, po bëhet një ndarje e tillë dhe këto kërkesa, siç u tha këtu edhe nga parafolësit, disa herë ne e dimë që shumica e tyre do të vinë, nëse nuk kanë ardhur deri tash, nga ndërmarrjet Serbisë, qoftë si kërkesa pronësie apo kërkesa kreditimi dhe në ligj nuk specifikohet se si do të veprohet me këto kërkesa kur kihet parasysh që shumica prej tyre janë kërkesa të cilat nuk kanë kurrfarë baze ose nuk do të duhej të kishin kurrfarë baze, për shkak se Kosova ka qenë e pushtuar nga Serbia. Mirëpo, nëse shikohen vetëm në aspektin ligjor, ato mund të jenë të bazuara plotësisht në ligjet e aplikueshme, atëherë edhe në ligjet të cilat po aplikohen sot në Kosovë.

Ne folëm edhe kemi folur edhe disa herë më parë për një nevojë të rishqyrtimit të procesit të privatizimit të deritashëm, për ta parë nëse ai ka dëmtuar qoftë të drejtat individuale apo kolektive të popullit të Kosovës, qoftë edhe ekonominë e Kosovës dhe me këtë ligj shihet që është bërë një hapë në atë drejtim. Pra, kjo kërkesë ose ky parim i lëvizjes “Vetëvendosje” ka filluar të dëgjohet nga Qeveria e Kosovës, por natyrisht është shtrembëruar, siç di kjo Qeveri ta shtrembërojë. Për shembull, aty thuhet që te transformimet e reja nuk do ta ndikojnë autoritetin e Agjencisë, i cili i

është mëveshur kësaj Agjencie me nenin 5.1 të këtij ligji, e që është autoritet për menaxhimin e pronës publike, qoftë ajo e transformuar apo jo dhe përmenden në tri raste, të cilat nuk do ta prekin këtë autoritet dhe kjo është, domethënë, nëse transformimi i pronës është bërë sipas Ligjit të aplikuar në kohën kur është transformuar dhe, nëse nuk ka qenë shkelje e të drejtave të njeriut dhe, këtu është një “dhe”, e cila mendoj që ndoshta është menduar të jetë “ose”, mirëpo ndoshta edhe është menduar të jetë “dhe”, dhe nëse nuk ka qenë në shkelje me Konventën Evropiane për të drejtat e njeriut. Pra, nëse e mbajmë ashtu si “dhe”, atëherë nënkupton që për ta vlerësuar një proces të transformimit të pronës, do të duhej të përmbusheshin të tria këto kushte, në mënyrë që ajo të vlerësohet se nuk duhet proceduar me të. Nëse e bëjmë “ose”, atëherë secili prej këtyre kushteve bëhet domethënë i plotfuqishëm për sa i përket trajtimit të likuidimit të pronës.

Pra, me këtë ligj paramendohet edhe synohet që të përshpejtohet procesi i likuidimit të ndërmarrjeve, të cilat aktualisht ekzistojnë si shuma parash, të them ashtu, të ruajtura në Fondin e Privatizimit. Në ligj po ashtu parashihet që të gjitha ndërmarrjet shoqërore të Kosovës do të kalojnë në pronësi të shtetit të Kosovës në formë aksionesh dhe kjo është, mendoj, personalisht mendoj që është çështje e mirë. Mirëpo, me kalimin e këtyre aksioneve në pronësi të shtetit të Kosovës, atëherë kjo pyetje është më shumë se sa koment, për shkak se nuk jam i sigurt se si do të procedohet, a nënkupton kjo që shteti i Kosovës do t’i marrë edhe përgjegjësitë për këto ndërmarrje, përveç se privilegjet.

Pra, ta zëmë një rast hipotetik, kur për një ndërmarrje, shuma me të cilën është shitur ajo ndërmarrje në kohën kur është privatizuar, është një shumë e caktuar dhe, nëse kemi kërkesa legjitime të kreditorëve dhe të pronarëve të cilat do të paguhen fillimisht nga kjo shumë, pasi që të hiqet 20% i punëtorëve, atëherë nëse rezultojmë më me pak para, do me thënë minus para për këtë ndërmarrje, atëherë a do t’i paguaj Qeveria e Kosovës këto para apo ato do të mbesin borxhe të cilat nuk do të merren përsipër nga askush.

Dhe, çështja tjetër është për sa i përket Fondit të Privatizimit, u përmend këtu edhe Lëvizja “Vetëvendosje” mendon se ky Fond i Privatizimit ose ajo që mbetet prej tij, nuk duhet në asnjë mënyrë të futet përbrenda buxhetit të Kosovës dhe të trajtohet si pjesë e buxhetit të Kosovës, por me të duhet të krijohet një fond zhvillimor, i cili pastaj gradualisht do të transformohej në Bankë zhvillimore, e cila do ta ndihmonte veçanërisht bujqësinë dhe industrinë e Kosovës. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit! I fundit, deputeti Zenun Pajaziti!

ZENUN PAJAZITI: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Po e shoh të arsyeshme të jap edhe disa sqarime për sa i përket këtij projektligji dhe kësaj pakoje të projektligjeve në përgjithësi se si janë trajtuar. Unë dëgjova disa opinione se janë sjellë me ngut. Unë personalisht mendoj që jemi vonuar me këto projektligje. Ka qenë një debat i madh gjatë tërë kohës, edhe politik, edhe tjetër, edhe profesional, por për sa i përket krejt procesit të privatizimit në tërësi, por edhe Ligjit ekzistues në veçanti, unë mendoj që është koha e mirë që ne tani të merremi me ligjin e ri ose ta trajtojmë ligjin, projektligjin që e kemi në dorë.

Është shumë herët të paragjykojmë se si është ky ligj, duhet t’ia lëmë zbatimit. Ajo që ne duhet të bëjmë shpejtë, është t’i trajtojmë mangësitë që i ka pasur ligji ekzistues. Unë mendoj që tri kryesoret ky dokument, ky projektligj i trajton, atë që ka të bëjë me heqjen e një lloji burokracie për sa iu

përket komisioneve shqyrtuese, janë konsideruar që janë të tepërta, që nuk kanë qenë efikase. Pastaj, një çështje tjetër që ka të bëjë me likuidimet, po ashtu ligji i ri është se ky projektligj i jep mundësitë më të mira Agjencionit të Privatizimit që të angazhojë kompani profesionale që do të merren me monitorimin edhe me trajtimin e procesit të likuidimit në përgjithësi dhe po ashtu një çështje që ka të bëjë me buxhetin, mundëson që një pjesë, në përputhje me procedurat që i parasheh ky ligj, që një pjesë e fondeve të derdhen, parashihet 50 deri 100 milionë për 12 muajt e parë, nëse fillon së zbatuari ky projektligj.

Dhe, sa i përket çështjes, edhe një herë po kthehem, të kohës së shpejtë që ka ardhur, unë mendoj që ne duhet të mësohemi t'i trajtojmë këto projektligje, por kjo nuk do të ndodhë gjatë trajtimit. Unë po ju them që procesi i trajtimit të këtij projektligji do të jetë ende më i shpejtë. Unë kam thirr mbledhjen e Grupit punues, nesër në ora 9:00 dhe i ftoj të gjithë deputetët edhe në komision, por edhe ata të tjerët që kanë interesim. Nuk kemi asnjë lloj arsyeje të mos e marrim cilindo propozim që vjen nga cilindo deputetë. Ju siguroj që asnjë interes tjetër, përpos që ligji të jetë sa më i mirë, nuk do të jetë në komision. Unë personalisht e udhëheq edhe Grupin punues. Ju ftoj të gjithëve që t'i sillni qoftë me shkrim apo në mënyrë tjetër propozimet e mundshme, në mënyrë që ne që nga nesër t'i trajtojmë ato në komision. Ju faleminderit, shumë!

KRYESUESI: Ju faleminderit! Ministri Beqaj e ka kërkuar fjalën!

MINISTRI BESIM BEQAJ: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar ministra,

Deputetë,

Më lejoni t'i falënderoj të gjithë për kontributin tuaj në drejtim të përmirësimit të këtij draftligji.

Dëshiroj të ritheksoj, të kësaj pakete, ndoshta më mirë të them, të draftligjeve, dëshiroj të theksoj se kemi një kthesë jashtëzakonisht të rëndësishme në procesin e privatizimit dhe ajo kthesë është që përmes Gjykatës Supreme, Dhomës së Posaçme identifikohen qartë autoritetet vendore, ato të cilat marrin përgjegjësitë, përmes Ligjit për AKP-në qartësohet dhe shkurtohet procesi i likuidimit të ndërmarrjeve dhe mundësia e marrjes së vendimit nga ana e AKP-së, në rast se nuk ka kërkesa nga ana e kreditorëve, të menjëhershme. Njëkohësisht, Paneli i gjyqtarëve dhe Dhoma e Posaçme është ajo e cila definon se çka është kërkesë legjitime dhe çka është kërkesë jolegjitime në drejtim të këtyre kreditorëve potencialë.

Ligji që do ta pasojmë në prezantim, gjithashtu e definon që çdo transaksion i cili ka ndodhur pas ndryshimeve kushtuese, pas marrjes së autonomisë, dhe çfarëdo transformimi nuk pranohet, prandaj kemi një qasje jashtëzakonisht të avancuar të këtyre projektligjeve, të cilat unë pres që të përmirësohen edhe më shumë gjatë debatit dhe kontributeve profesionale të cilat do t'i japin deputetët e këtij Kuvendi.

Lidhur me shpejtësinë, më lejoni t'ju them që Qeveria këto ligje i ka proceduar në Kuvend me datën 24 qershor, është afër një muaj dhe ne presim që këto ligje të na mundësojnë që sa më shpejt t'i marrin kompetencat tona, në mënyrë që të parandalojmë masat të cilat janë paralajmëruar në fushën, qoftë të likuidimeve apo të ristrukturimeve të ndërmarrjeve të cilat janë me rëndësi vitale për shtetin.

Çka nënkupton kjo në tërësi? Nënkupton që për të gjitha ato moratoriume, nënkupton për të gjithë ata administratorë të cilët janë menduar, për rolin e bashkësisë ndërkombëtare, për gjyqtarët, të gjitha këto kompetenca do t'i marrin vendorët, të gjitha këto kompetenca do të merren për të mirën e qytetarëve të vendit dhe kjo është arsyeja pse këto ligje janë pjesë e rëndësishme dhe janë paketë.

Unë nuk pretendoj të di secilën normë juridike të secilit ligj, por pretendoj të di qëllimin dhe e di, jam shumë i bindur në qëllimin e këtyre ligjeve, të cilat kanë të kthejnë dinjitetin e qytetarëve të vendit, të kthejnë dinjitetin e ndërmarrjeve tona për një proces mjaftë kompleks në udhëheqje të personave dhe institucioneve të cilat janë themeluar dhe janë themeluar nga ky Kuvend dhe janë përgjegjës para këtij Kuvendi.

Prandaj, ju ftoj edhe njëherë që gjatë debateve të cilat do të bëhen në grupe parlamentare dhe ofroj veten dhe tërë ekipin që të jemi në disponimin tuaj për të dhënë shpjegimet e detajizuara. Sot është leximi i parë. Unë mund të dal këtu dhe të bëjë ekspozë, ta lexojmë ligjin në tërësi dhe ta shkoqisim nën për nën, por ky është leximi i parë, i cili hap një debat publik në Kuvend për ligjet të cilat ne i procedojmë.

Lidhur me futjen në ligj të ndërmarrjeve të shoqërive aksionare nga Gjakova, mendoj që këtu duhet të shkojmë pak më tutje, sepse me kërkesë nga këto ndërmarrje, më herët është pranuar statusi i ndërmarrjeve të shoqërisë aksionare dhe ato konsiderohen të mbyllura, të privatizuara, prandaj ne flasim për Agjencion Kosovari të Privatizimit dhe është njohur më parë statusi i shoqërive aksionare. Agjencia e Privatizimit, Ligji për Dhomën e Posaçme dhe Ligji për rinstrukturimin e ndërmarrjeve të veçanta nuk merren me shoqëri aksionare të cilat janë në pronësi dhe iu ka njohur statusi. Prandaj, kjo është çështje të cilën ne duhet ta diskutojmë në tjetër platformë, sepse është marrë një vendim një herë dhe do të ishte tash e rëndë t'i hyjmë kësaj pune.

Prandaj, çështja e likuidimeve, sipas procedurave në fjalë, likuidimet kanë marrë 42 muaj të plotë, nëse çdo gjë ka shkuar sipas planit dhe kjo, nëse zërthehet në afate kohore dhe nëse e marrin numrin e ndërmarrjeve të cilat presin të likuidohen dhe sa janë likuiduar deri më tash, janë vetëm dy, kjo merr diku rreth 25 deri 30 vite apo 35 vite proces të likuidimit dhe bllokim të këtyre mjeteve dhe kjo është arsyeja pse ne sot po ngutemi, kjo është arsyeja pse ne po procedojmë një ligj të tillë, sepse me aneksin për likuidimin e ndërmarrjeve specifikohet qartë, është shkurtuar procedura dhe kjo reflekton kosto shumë më të ulët se sa procesi i likuidimit konform rregullave të cilat kanë qenë të përcaktuara.

Po ju them që kostoja e likuidimit të ndërmarrjeve konform procedurave paraprahe dhe as nuk është ky Kuvend, as nuk jemi ne kjo Qeveri e cila i ka caktua këto rregulla, sepse të gjithë i kemi trashëguar këto rregulla paraprahe. Ky proces i likuidimit do të kushtonte mbi 120 milionë euro shpenzime, të cilat kërkojnë do të thotë dhe bëhen pjesë e procesit të përgjithshëm. Dhe, me veprimet të cilat po merren, kjo do të jetë minore kostoja e realizimit të procesit të likuidimeve.

Edhe një herë po e them, me këto, me këtë paketë legjislative, ne po flasim për eliminim të plotë të çfarëdo autoriteti, i cili ka mund t'i kontrollojë ndërmarrjet tona dhe unë po ju them që ndihem i privilegjuar edhe me komentet e të gjithë deputetëve këtu, profesionale, normalisht ka edhe ngjyra politike dhe kjo është e kuptueshme, por ne shpresojmë që gjatë debateve nëpër komisionet parlamentare, ligji do të pasurohet për të mirën e qytetarëve të vendit dhe për të mirën e ekonomisë së vendit. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Debati është mbyllur.

Të nderuar deputetë,

Tani kërkoj deklarinimin, nuk ka më fjalë. Nuk ka replikë, në vazhdim kërkohet deklarimi me votim për miratimin në parim të Projektligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit.

Në mbledhje janë prezentë 76 deputetë.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tani:

(Reagim)

Lexo rregulloren, lexo mirë, nuk ke të drejtë!

Ju faleminderit!

Konstatoj se me 54 vota “për”, 3 abstenime, 18 “kundër”, Kuvendi miratoi në parim Projektligjin për Agjencinë Kosovare të Privatizimit.

Kërkohet nga komisioni funksional dhe komisionet e përhershme që në aftin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit, ta shqyrtojnë Projektligjin dhe Kuvendit t’ia paraqesin raportet me rekomandime. Ju faleminderit!

Vazhdojmë në orën 15:00. Deri atëherë kemi pauzë!

Vazhdimi i seancës pas pauze

KRYETARI I KUVENDIT: Të nderuar deputetë, vazhdojmë seancën me pikën e 11-të të rendit të ditës:

11. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për riorganizimin e ndërmarrjeve të caktuara dhe të pasurisë së tyre

Në bazë të nenit 56 të Rregullores së Kuvendit, komisioni funksional e ka shqyrtuar Projektligjin dhe Kuvendit i ka paraqitur raportin me rekomandime.

Fjala e parë do të ishte e kryetarit të Komisionit, nëse e do fjalën. Fjala pra për kryetarin e Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, deputeti Zenun Pajaziti! A e do fjalën Zenun?

ZENUN PAJAZITI: Faleminderit, zoti kryetar!

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri e ka shqyrtuar me datën 7.7.2011 këtë projektligj në përputhje me Rregulloren e Kuvendit dhe pas shqyrtimit vlerëson se projektligji i plotëson kushtet e parapara me nenin 54 të Rregullores së Kuvendit dhe i rekomandon Kuvendit për miratim, në parim.

KRYETARI: Ministër, e keni fjalën! Se e ndërrova pak rendin e paraqitjes!

MINISTRI BESIM BEQAJ: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar deputetë,

Ministër,

Më lejoni që të paraqes Ligjin e tretë dhe të fundit për sot para Kuvendit të Kosovës, pra Projektligjin për riorganizimin e ndërmarrjeve të caktuara dhe të pasurisë së tyre.

Ky ligj ka për qëllim krijimin e kornizës legjislative që përcakton rregullat dhe procedurat për riorganizimin dhe likuidimin e ndërmarrjeve të caktuara dhe të pasurisë dhe obligimet e tyre nën autoritetin administrativ të Agjencisë Kosovare të Privatizimit apo paraardhës të saj, siç ka qenë Agjencia Kosovare e Mirëbesimit, për ta mundësuar rehabilitimin e këtyre ndërmarrjeve dhe rishikimin e qëndrueshmërisë së tyre si ndërmarrje afariste për t'i sjellë përfitime ekonomisë së Republikës së Kosovës.

Me këtë projektligj përcaktohen rregullat dhe procedurat për riorganizim dhe likuidim të të gjitha ndërmarrjeve, për të cilat Agjencia Kosovare e Privatizimit apo paraardhësja së saj Agjencia Kosovare e Mirëbesimit ka paraqitur kërkesën pranë Odës së Posaçme.

Njëkohësisht, ky ligj heq mundësinë e emërimit të administratorëve ndërkombëtarë, që ka qenë një ndër çështjet që është diskutuar shumë gjatë në Kosovë.

Procedura e riorganizimit apo likuidimit të këtyre ndërmarrjeve do të udhëhiqet nga Oda e Posaçme dhe vetëm në pajtim me këtë ligj. Këto procedura do të mbulojnë tërë pasurinë e ndërmarrjeve në fjalë. Asnjë procedurë tjetër e riorganizimit apo likuidimit nuk do të ketë kurrfarë ndikimi mbi ndërmarrjet e tilla apo pasuritë e tyre, pa marrë parasysh kohën e zhvillimit të tyre, gjë që mundëson që realisht edhe transaksionet të cilat janë bërë pas heqjes së autonomisë, të eliminohen si të tilla dhe ky ligj është ligj i cili i tejkalon të gjitha ato rregullore dhe ligje të cilat kanë qenë paraprakisht.

Pra, ky ligj është ligj i cili mundëson që realisht në paketë edhe AKP-ja, edhe Dhoma e Posaçme, por edhe nevoja për ristrukturim të ndërmarrjeve me interes të fuqishëm shoqëror, siç është Trepça dhe ndërmarrjet e tjera të trajtohen në mënyrë më të mirë të mundshme dhe t'u kthehen në kompetenca të plota dhe të hiqet rreziku i administratorëve ndërkombëtarë dhe moratoriumeve të cilat më herët janë diskutuar brenda shoqërisë kosovare. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, ministër! Në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, Zenun Pajaziti!

MINISTRI ZENUN PAJAZITI: Faleminderit, zoti kryetar!

Qëllimi i këtij ligji është zëvendësimi i një rregulloreje të UNMIK-ut Numër 2005/48, që i përcakton procedurat të cilat duhet t'i zbatojë Dhoma e Posaçme gjatë mbikëqyrjes së organizimit të këtyre ndërmarrjeve në pronësi shoqërore dhe që është e vendosur në autoritetin e saj nga AKM ose AKP.

Kjo rregullore tanimë është koha të zëvendësohet për së paku dy arsye. E para, se kjo rregullore e UNMIK-ut është e shkruar shumë keq dhe ndër problemet e shumta që ka kjo rregullore është edhe fakti se është shumë e pa qartë ose nuk i rregullon fare disa çështje shumë të rëndësishme. Dhe, së dyti, Rregullorja e UNMIK-ut 2005/48 kërkon emërimin e një administratori të jashtëm për çdo ndërmarrje që është vendosur nën autorizimin për riorganizimin e Dhomës së Posaçme.

Kjo kërkesë e vendosur nga UNMIK-u thjeshtë nuk është tanimë edhe politikisht e pranueshme dhe as që është më e nevojshme.

Ligji i ri e zgjidh këtë problem duke përcaktuar AKP-në si administratorin kryesor, por kërkon po ashtu nga AKP që të angazhojë profesionistë me përvojë në çështjet e riorganizimit që të ushtrojnë kompetenca teknike profesionale të administratorit.

Pra, ligji i ri mundëson që menaxhmenti ekzistues i ndërmarrjeve të vazhdojë të qëndrojë deri në përmbylljen e procesit të riorganizimit nën mbikëqyrjen e Dhomës së Posaçme.

Ligji i ri gjithashtu përcakton hollësisht dhe qartësisht procedurat për riorganizimin e ndërmarrjeve që janë vendosur nën autoritetin për riorganizimin e Dhomës së Posaçme.

Po ashtu, ky ligj i mundëson Dhomës së Posaçme që të mbikëqyrë riorganizimin e një ndërmarrjeje që është e vendosur nën autoritetin e saj, në mënyrë të shpejtë dhe të rregullt, përderisa menaxhmenti qëndron gjatë procesit të riorganizimit. AKP sipas këtij ligji ose Ligjit të ri është e obliguar që profesionalisht të angazhuarit ligjor dhe financiar të jenë të përgjegjshëm gjatë zhvillimit të riorganizimit. Pra, e definon qartë rolin e tyre.

Në fund, ky ligj do t'i mundësojë Dhomës së Posaçme që të miratojë një plan të riorganizimit për një ndërmarrje të riorganizuar që mundëson shkarkimin nga të gjitha borxhet dhe i hap rrugën privatizimit të saj ose të pjesëve të saj.

Partia Demokratike e Kosovës e mbështet këtë projektligj. Grupi Parlamentar do të votojë “për” dhe ftojme po ashtu deputetët që ta mbështesin dhe do të japim kontributin tonë në vazhdim. Faleminderit!

KRYETARI: Në emër të LDK-së, deputetja Teuta Sahatqija!

TEUTA SAHATQIJA: Faleminderit, kryetar!

Ndërmarrjet shoqërore të rëndësishme të veçantë të cilat nuk janë privatizuar, janë përballur me një numër të problemeve lidhur me qëndrueshmërinë e këtyre ndërmarrjeve, funksionimin jo adekuat të tyre, grumbullimin e borxheve dhe problemet tjera. Në këto çështje nuk ka pasur kornizë ligjore adekuate, e cila do të ishte bazë e zgjidhjes së problemeve të cilat me vite të tëra vetëm sa grumbulloheshin.

Ky projektligj është në pakon e ligjeve që bashkë me Ligjin e AKP-së dhe Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës lidhur përbëjnë një tërësi apo kornizë ligjore që e rregullon këtë çështje dhe nuk paraqet kolizion me asnjë dispozitë ligjore të legjislacionit në fuqi të Republikës së Kosovës.

Ardhja e këtij projektligji ka mbuluar mungesën e kornizës ligjore dhe ka krijuar ambientin rregullativ për procedura për riorganizimin e borxheve të ndërmarrjeve të caktuara në pronësi shoqërore, si dhe kthimin e qëndrueshmërisë së atyre ndërmarrjeve që janë duke u likuiduar, si dhe pasuritë e tyre.

Ky projektligj ka të bëjë me procedura dhe caktimin e rregullave për riorganizimin e borxheve të ndërmarrjeve në pronësi shoqërore, për të cilat është dorëzuar kërkesa për riorganizim nga AKP ose në të kaluarën nga AKM në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës.

Është mirë dhe është për t'u përshëndetur që me këtë ligj hiqet emërtimi – emërimi i një administratori të jashtëm përmes Rregullores së UNMIK-ut 2005/48 dhe mendoj që kjo gjë ka qenë më se e nevojshme.

Ligji i ri e zgjidh këtë problem duke e përcaktuar AKP-në si administrator, por kërkon nga ajo që të angazhojë profesionistë me përvojë që në mënyrë kompetente të administrojë ndërmarrjen shoqërore.

Ligji i ri i mundëson Dhomës së Posaçme që të Mbikëqyrë riorganizimin që është nën autoritetin e saj dhe të menaxhojë gjatë procesit të riorganizimit.

Në ndërkohë, AKP-ja është e obliguar me ligj që ata profesionistë të jenë të zotë dhe të përgjegjshëm gjatë zhvillimit të riorganizimit.

Ligji i ri do t'i mundësojë Dhomës së Posaçme që të miratojë një plan të riorganizimit dhe të mundësojë shkarkimin nga të gjitha borxhet e saj.

Ky projektligj, në të vërtetë, përveç të gjitha këtyre të mirave që i cekëm, shkakton një barrë në buxhetin e Kosovës dhe atë në vitin e parë 5 milionë dhe në vitet tjera nga 4 milionë me radhë.

Ka vlerësime se ky ligj, përveç këtij buxheti, do të krijojë shpenzime shtesë për buxhetin e Kosovës dhe këto shpenzime nuk janë të parapara në buxhetin e aprovuar nga Kuvendi, as në Kornizën afatmesme të shpenzimeve, ndonëse ky ligj ishte në listën e ligjeve të cilat duhet të procedohen në Kuvendin e Kosovës.

Prandaj, Grupi Parlamentar i LDK-së mendon se ky ligj është i nevojshëm për Kosovën, por qysh në start është i pazbatueshëm ekonomikisht, prandaj në ndërkohë, përderisa kalon në Komisionin për Zhvillim Ekonomik, presim që Qeveria të sigurojë që ky ligj të jetë i zbatueshëm, qoftë ajo pa kosto buxhetore ose të sigurojë se nga do të vijnë mjetet të cilat do ta shndërrojnë këtë ligj në një ligj të zbatueshëm. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të “Vetëvendosjes” deputeti Visar Ymeri e ka fjalën!

VISAR YMERI: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar deputetë,

Projektligji për riorganizimin e ndërmarrjeve të caktuara dhe të pasurisë së tyre është shumë i ngjashëm, madje në disa aspekte edhe identik me Rregulloren e UNMIK-ut 2005/48 mbi organizimin dhe likuidimin e ndërmarrjeve dhe të pasurisë së tyre.

Teksti i ligjit në shumë pjesë është i pa qartë dhe konfuz dhe kjo lë shumë hapësirë ose për t'u keqkuptuar ose për t'u keqinterpretuar, gjë që duhet evituar në ligj. Po ashtu, është pak a shumë e paqartë se kush është administratori. Pra, me këtë ligj rregullohet se AKP-ja, Agjencia Kosovare e Privatizimit do të jetë ose do të shërbejë si administrator i ndërmarrjeve, mirëpo pastaj ajo i mundësohet me ligj që të zgjedhë një ofrues të shërbimeve profesionale, në nenin 7 të ligjit, kurse në tekstin e mëtejshëm të Ligjit administratori obligohet, thuhet që administratori obligohet ta informojë Agjencinë, për shembull në nenin 10 pika 7, por kjo shihet që administratori edhe shihet si Agjencia, por edhe si i jashtëm nga Agjencia.

Roli i menaxhmentit ekzistues të ndërmarrjeve është plotësisht i pa definuar. Në nenin 11 pika 2 pikë 13 administratorit i mundësohet angazhimi i një agjenti për të kryer afarizmin e nevojshëm të ndërmarrjes, po këtuijorohet plotësisht menaxhmenti aktual i ndërmarrjeve.

Administratori me këtë ligj e ka autorizimin e plotë për afarizmin, riorganizimin, shitjen e pjeseshme të pronës dhe likuidimin e ndërmarrjes, kurse ai dhe ofruesit e shërbimeve profesionale të angazhuar prej tij kanë imunitet të plotë për dëmet që mund t'i shkaktohen ndërmarrjes me veprimet ose mos veprimet të tyre. Dhe kjo natyrisht se e shkakton një mundësi apo potencial të madh të shkuarjes së administratorit ndaj pronës. Kjo thuhet në nenin 10 pika 3.1.

Qëllimi primar i administratorit nuk është, siç ishte dashur të jetë sanimi, konsolidimi dhe aftësimi i ndërmarrjes për afarizëm, por siguri i mjeteve për pagesën e kreditorëve – pretendentëve. Pra, këtuijshihet edhe me këtë ligj se po i vihet shumë më shumë rëndësi, ose po punohet shumë më shumë për t'i kënaqur apetitet prej kërkuesve apo kreditorëve dhe atyre që kanë kërkesa pronësore ndaj pronës së Kosovës, se sa vetë ndërmarrjeve dhe ekonomisë së Kosovës. Po ashtu, kreditorët kanë rol vendimtar në aprovimin e planit për riorganizim, propozimin e planit alternativ dhe implikimin drejtpërdrejtë në realizimin e planit dhe afarizmit të ndërmarrjes. Për shembull, në rastin e Trepçës, Këshilli i kreditorëve do të mbivotohet prej kompanive nga Serbia, Greqia, Bullgaria dhe Franca, të cilat kanë kërkesa ndaj Trepçës, qofshin ato pronësore apo kërkesa kreditore.

Me këtë riorganizim, pjesa më e madhe e punëtorëve definitivisht i humbin vendet e punës e në rast të likuidimit, të gjithë. Çështja e punëtorëve aktualë dhe ish punëtorëve, ta zëmë të Trepçës, mbetet barrë e Qeverisë dhe me ta nuk merret as plani e as riorganizimi i ndërmarrjes. Punëtorëve madje në këto raste nuk iu takon as 20%, sikur është rasti me fondet e privatizimit.

Me ligj është paraparë pagesa deri në 3 rroga të pa paguara për punëtorët, por me renditjen e pagesave sipas prioritetit kjo rrezikon që edhe këto paga të pamundësohen për punëtorët.

Dhe çështja e katërt, çështjet e ambientit dhe sanimi i pasojave nga ndotja në të kaluarën i mbeten obligim Qeverisë, pra nuk barten si obligim së bashku me pronën.

Lëvizja “Vetëvendosje” insiston me çdo kusht që në ligj të rregullohen edhe këto çështje.

Ndërmarrjet e xehetarisë dhe metalurgjisë së plumbit e zinkut si dhe asetet e tyre nuk mund të tjetërsohen në asnjë formë. Plani për riorganizim duhet ta ketë për qëllim lirimin e tyre prej veprimtarive jo esenciale dhe aftësimin e tyre për afarizëm themelor.

Dhe, nën 2, mjetet e investuara në Trepçë nga buxheti i konsoliduar i Kosovës, pra si investimet kapitale, subvencione, stipendione dhe pensione të para kobshme, kanë tretman të kredivë. Mbështetur në këtë, Qeveria e Kosovës ka të drejtë të caktojë përfaqësuesin e vet në Këshillin e kreditorëve dhe kështu të ketë një mundësi më të madhe të kontrollimit dhe planifikimit, veçanërisht të Trepçës, por edhe të minierave tjera nga institucionet e Kosovës.

Pra, për fund, Lëvizja “Vetëvendosje” nuk do ta mbështes në parim këtë ligj dhe këtë mos mbështetje e kushtëzohet me këto vërejtje që i dhashë, të cilat po që se përfshihen, atëherë e votojmë ligjin. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të Aleancës, Ardian Gjini e ka fjalën!

ARDIAN GJINI: Faleminderit, zoti kryetar!

Gjatë diskutimit për Ligjin paraparak, i dhamë disa aspekte politike të votimit të këtyre ligjeve. Mendojmë se parimin të cilin e kemi mbajtur në votimin e dy ligjeve paraprahe që kanë ardhur në pako, vlejné edhe për këtë ligj, kështu që ne do ta votojmë në parim, mirëpo kemi kërkesa shumë specifike gjatë shqyrtimit nëpër komisione dhe nuk do ta votojmë Ligjin nëse kërkesat tona në lexim të dytë nuk do të merren parasysh. Do të thotë, vlen i njëjti parim sikurse ka vlejtur edhe për dy ligjet paraprahe. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të Koalicionit Kosova e Re, deputetja Muzejene Selmani e ka kërkuar fjalën!

MUZEJEN SELMANI: Faleminderit, kryetar!

Koalicioni për Kosovën e Re e ka shqyrtuar Projektligjin për riorganizimin e ndërmarrjeve të caktuara dhe pasuritë e tyre. Shumëçka çka diskutuam në aspektin parimor lidhur edhe me dy projektligjet e mëparshme, që vijnë nga kjo pako, vlen edhe për këtë projektligj.

Brenga jonë kryesore është se ndërmarrjet që riorganizohen, kreditorët dhe dhomat speciale të gjykatës marrin kompetenca të mëdha, kështu që kjo mund të paralizojë funksionimin dhe operacionet e këtyre ndërmarrjeve.

Brengë po aq e madhe është edhe se pasuritë e patundshme të këtyre ndërmarrjeve mund të jepen me qira dhe koncesion për 92 vite, është neni 26, ku ceket mjaft mirë si këto asete mund të jepen dhe është shumë e pa pranueshme në rast se kjo ndodhë edhe te minierat, që është në kundërshtim edhe me Ligjin për miniera dhe minerale, ku e kemi caktuar mjaft mirë çështjen e funksionimit të minierave.

Koalicioni për Kosovë të Re, të gjitha sugjerimet në lidhje me amendamentimin e këtij projektligji do t'i japë në komisionin parlamentar që ky projektligj në lexim të dytë të marrë formën e duhur dhe të jetë i zbatueshëm. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të SLS-së, nuk është paraqitur kurrkush! Në emër të Grupit “6+”, deputeti Rasim Demiri e ka fjalën!

RASIM DEMIRI: Hvala, predsedniče!

Izvršili smo analizu ovog nacrta, zajedno sa propratnim dokumentima. Vidljivo je da će biti budžetskih implikacija koje su veoma jasno i nedvosmisleno objašnjene. No, bez obzira na upozorenje o budžetskim implikacijama, jasno je da ovakav zakon nedostaje, ova materija je do sad ne regulisana. Dakle, ovaj zakon je novost u novom kosovskom zakonodavstvu.

Parlamentarna grupa „6+“ ovaj nacrt podržava, uz preporuku da se do drugog čitanja još jednom pročita i isprave eventualne greške.

KRYETARI: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Sadri Ferati.

SADRI FERATI: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Unë më tepër desha të shpreh kënaqësinë time dhe të përshëndes, do të thotë, këto ligje për të cilat po diskutojmë sot dhe procedimin, posaçërisht të këtij ligji, ngase më në fund shohim një tentativë pozitive që ne të jemi kreativë dhe të sfidohemi me disa situata dhe me disa pasuri të rëndësishme që i takojnë shtetit dhe në interes të qytetarëve.

Posaçërisht e kam fjalën tek ndërmarrjet të cilat kanë një kapital të kombinuar, siç është ai, domethënë kapitali shtetëror, që lidhet me pasurinë, siç tha kolegja më herët, me pasuritë e shtetit, resurseve që i posedon vetë ndërmarrja, por edhe domosdoja e tërheqjes së investitorëve në cilësi të blerësit apo të ndërtimit të partneritetit privato-publik dhe për herë të parë në këtë rast shihet se vetë institucionet nuk janë më indiferente në pasojat që po krijohen nganjëherë nga një e kaluar dhe nga një menaxhim i keq i ndërmarrjeve që është bërë në të kaluarën dhe këtu e kam fjalën sidomos te kombinati “Trepça”.

Prandaj, pres nga Grupi punues që do të inkorporojë të gjithë ekspertët dhe njohësit e mirë të këtyre fushave, sidomos tek situata në kombinatin “Trepça” në tërësi, në mënyrë që ky ligj të vjen i kompletuar dhe të krijohen parakushte të mira që pastaj të hiqen të gjitha barrierat që atje të shfrytëzohen mirë ato resurse dhe të krijohet mundësia që njerëzit të punojnë, të përfitojnë, por njëkohësisht edhe të sjellin kontributin e tyre për qytetarët dhe për shtetin. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Fjalën e ka deputetja Justina Pula-Shiroka!

JUSTINA PULA - SHIROKA: I nderuari kryetar i Kuvendit,

Ministra,

Të nderuar deputetë,

Ka kohë që jemi duke pritur të analizojmë dhe të miratojmë Ligjin i cili do të mundësojë transformimin dhe ristrukturimin e ndërmarrjeve për tërheqjen e sektorit privat, si dhe për rimëkëmbjen e sektorit minerar.

Mirëpo, me keqardhje konstatohet se Projektligji për riorganizimin e ndërmarrjeve të caktuara dhe pasurisë së tyre nuk është ai të cilin e pret Kosova dhe të gjithë akterët relevantë vendorë kur bëhet fjalë për Trepçën.

Ky projektligj nuk është në përputhje me strategjinë legislative të Qeverisë së Republikës së Kosovës, për vitin 2011.

Ministria për Zhvillimin Ekonomik ka paraparë miratimin e Projektligjit për transformimin e pjesshëm të Trepçës, ndërmarrje në administrim të AKP-së, draftligj ky që është planifikuar të dërgohet në Kuvend më së voni deri më 30.9.2011.

Mosparaqitja e projektligjit për Trepçën, që u përgatit me shumë mund nga institucionet vendore dhe paraqitja tani e Projektligjit për riorganizimin e ndërmarrjeve të caktuara dhe të pasurisë së tyre, vetëm se do të shtyjë zgjidhjen e problemit dhe riaktivizimin e Trepçës sipas modelit që është përzgjedhur tashmë.

Ky Projektligj është kopje e Rregullores 2005/48 e UNMIK-ut, të cilën ekspertët e lëmisë përkatëse dhe ata të Trepçës e kanë kundërshtuar nga fillimi me shumë argumente konkrete juridike.

Ligji pretendon se problemi i Trepçës zgjidhet duke likuiduar atë, bile duke bërë pjesë të likuidimit edhe burimet minerare, e cila shumë qartë parashikohet se si do të shfrytëzohen burimet minerare me Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

Ky projektligj është i papranueshëm për të gjithë ata që u angazhuan të trajtojnë problemin e Trepçës, sepse cenon interesat ekonomike të Kosovës dhe është në funksion të mbrojtjes ekskluzive të interesave të kreditorëve të cilët janë të supozuar.

Ky projektligj në rolin formal të administratorit e vë AKP-në, ndërsa si autoritet ekzekutiv përzgjedh kompaninë e huaj të përkrahur nga Dhoma e Posaçme për të gjitha politikat operacionale, duke e vë kështu këtë mekanizëm mbi Kushtetutën dhe ligjet e Kosovës, nëse nuk harmonizohet me Ligjin e Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me AKP-në.

Në këtë Projektligj Trepça trajtohet si një ndërmarrje unike nga obligimet e supozuara nga e kaluara. Duhet përmendur se Trepça, e cila po trajtohet si unike, në kuadër të organizimit të brendshëm ka 27 subjekte ekonomike, organizata punuese të cilat kanë pasur subjektivitet të plotë ekonomik, juridik dhe afarist dhe si të tillë kanë qenë të regjistruara në Gjykatën Ekonomike të Qarkut në Prishtinë.

Me Projektligj transformimi, likuidimi, vendimmarrja për shitje dhe format tjera të transformimit të pronës dhe të rezervave minerare parashihet të bëhet nga ana e një komisioni të kreditorëve, i cili shpallet si trup vendimmarrës në politikat operacionale, fakt ky që është i papranueshëm dhe i dëmshëm si për kompanitë, ashtu edhe për Kosovën. Duket se kreditorët mund të bëjnë çka të duan me burimet minerale të Kosovës.

Prandaj, kurrësi nuk duhet marginalizuar dhe minimizuar rolin e pa kontestueshëm të menaxhmentit dhe të punëtorëve të Trepçës që janë duke u angazhuar dhe punuar me shumë përkushtim.

Mendoj se Ligji duhet të miratohet në parim, për t'i dhënë hapësirë komisionit parlamentar jo vetëm për të plotësuar, por edhe për të ndryshuar gjatë fazës së amendamentimit. Kosova ka shumë nevojë të shqyrtojë dhe miratojë Projektligj për transformimin e pjesshëm të Trepçës, ndërmarrje nën administrim të AKP-së.

Projektligji për transformimin e Trepçës, si dhe strategjia për Trepçën është punuar në vitin 2010, me pjesëmarrjen dhe me pëlqimin e të gjitha strukturave dhe institucioneve relevante në Kosovë, duke filluar prej Ministrisë së Energjisë, Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave, Ministrisë së Drejtësisë, Komisionit të Pavarur të Minierave dhe Mineraleve, AKP-së dhe menaxhmentit të Trepçës.

Sido që të quhet ligji, kompanitë e Trepçës duhet të regjistrohen si subjekte aksionare dhe t'i marrin të gjitha përgjegjësitë për t'i shqyrtuar me procedura të rregullta dhe me ekspertiza normale gjyqësore, duke hapur kështu rrugë dhe perspektivë zhvillimore me partnerë të ndryshëm në bazë të ligjeve për organizimin e kompanive tregtare në Kosovë dhe Ligjit për partneritet publiko- privat në Kosovë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Dhe, diskutuesi i fundit, deputeti Salih Morina!

SALIH MORINA: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Unë nuk do ta komentoj ligjin, mirëpo thanë edhe parafolësit tjerë se në mungesë... paraprakisht aprovuam edhe një Projektligj për Dhomat e Posaçme, i cili nuk e pat buxhetin, do të thotë të paraparë, po ashtu edhe ky ligj tash që po e diskutojmë, njëkohësisht nuk e ka një buxhet të paraparë dhe jemi në kundërshtim me Kushtetutën, jemi në kundërshtim me Rregulloren e Parlamentit të Kosovës, sepse neni 54 thotë që deklaratën për ndikim buxhetor duhet ta ketë çdo ligj në vitin e parë dhe në vitet e mëpastajshme.

Prandaj, këto dy ligje, do të thotë, nuk janë të paraparë as në Kornizën afatmesme 2011 – 2014 dhe njëkohësisht implementimi i tyre pritet të bëhet, do të thotë, në vitin 2015.

Mendoj se duhet të kihet parasysh që komisionet, të cilat i hartojnë këto ligje dhe të cilat merren me çështjen e këtyre ligjeve, duhet të kenë kujdes që të shikohet deklarata financiare, të shikohet mundësia se Qeveria mund t'i implementojë këto ligje dhe më pastaj të shikohet mundësia e implementimit të tyre.

Përderisa në Rregulloren e Parlamentit shkruan do të thotë qartë që neni 54 parasheh që të kemi buxhet fiks të caktuar, domethënë për vitet të cilat fillon të implementohet ky ligj, unë mendoj se është në kundërshtim me Rregulloren. Nuk po i kundërshtoj ligjet të cilat janë hartuar, por realisht jemi në kundërshtim me nenin 54, zoti kryetar. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Jo, unë veç po them, ishalla është vetëm ky problemi! Ministri e ka fjalën!

MINISTRI BESIM BEQAJ: Faleminderit, kryetar!

Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Edhe një herë më lejoni të ju falënderoj sot për të gjitha diskutimet. Ligji për riorganizimin e ndërmarrjeve me karakter të veçantë, është ligj i cili nuk e ka për qëllim mbulimin e vetëm një ndërmarrje, por edhe të ndërmarrjeve të tjera. Normalisht, këto ligje janë hartuar në grupe punuese të cilat në vete kanë pasur përbërjen e të gjithë akterëve relevantë, të cilët janë të ftuar dhe kanë qenë të mirëseardhur për të dhënë mendimet e tyre.

Unë e di që Ministria e Energjisë dhe e Minierave përpara ka pasur mundësi për ta bërë, nuk e ka proceduar, situata është e tillë, që ne jemi duke e përgatitur një paket legjislative, e cila mundëson jo vetëm një ligj për një ndërmarrje, por për ndërmarrje në tërësi, sepse përveç tjerash s'ka ndërmarrje tjera të cilat kanë karakter të rëndësisë së veçantë dhe ligjet nuk bëhen vetëm e vetëm për një

ndërmarrje, por ligjet bëhen për ndërmarrje me interes shtetëror. Njëkohësisht, sa i përket aspekteve të implementimit të ligjit, harmonizimi në mes të ministrive do të jetë komplet, kompatibil dhe ligjet do të implementohen konform miratimit dhe afatit i cili përcaktohet me ligj kur ato duhet të hyjnë në fuqi. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Të lajmëruar për debat s'kemi, kështu që shkojmë në procedurën e votimit. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim dhe votojmë tash:

Prezentë janë 75 deputetë.

Konstatohet që me 53 vota “për”, 11 “kundër” dhe 3 abstenime, Kuvendi miratoi në parim Projektligjin për riorganizimin e ndërmarrjeve të caktuara dhe të pasurisë së tyre.

Kërkohej nga komisioni funksional dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit ta shqyrtojnë Projektligjin dhe Kuvendit t'i paraqesin raportin me rekomandime.

Në radhë kemi pikën e dymbëdhjetë të rendit të ditës:

12. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për statistikat zyrtare të Republikës së Kosovës

Në bazë të nenit 56 të Rregullores së Kuvendit, komisioni funksional ka shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit i ka paraqitur raportin me rekomandime për shqyrtim, në parim.

Ftoj ministrin, kësaj radhe në emër të ministrit të Administratës, ftoj zotin Ramë Buja, që në emër të Qeverisë para deputetëve të Kuvendit të prezantojë dhe arsyetojë projektligjin.

MINISTRI RAMË BUJA: I nderuar zoti kryetar,
Të nderuar zotërinj zëvendëskryeministra,
Të nderuar dhe të respektuar deputetë,
Meqë ministri Yagcillar mungon sot, jam i ngarkuar prej tij dhe prej Qeverisë ta bëj këtë prezantim sot.

Projektligji për statistikat zyrtare ka për qëllim të përcaktojë parimet themelore dhe të krijojë kornizën ligjore për organizimin, prodhimin dhe publikimin e statistikave zyrtare të Kosovës.

Krahas të arriturave bashkëkohore në këtë fushë dhe unifikimit të terminologjisë, si dhe përmbushjes së zbrastësirave ligjore në fushën e statistikave zyrtare, ky projektligj përcakton kornizat kryesore të statistikave zyrtare si përbërës kryesor për grumbullimin, përpunimin dhe publikimet e të dhënave statistikore zyrtare në Kosovë, andaj e shohim të nevojshme që sot para jush ta paraqesim për aprovim Projektligjin për statistikat zyrtare të Republikës së Kosovës.

Ky projektligj përcakton dhe përkufizon çështjet që kanë të bëjnë me statistikat zyrtare, si parime themelore të udhëheqjes së statistikave zyrtare, organizimin, pozitën, punët dhe koordinimin e sistemit të statistikave dhe të institucionit qeveritar, Agjencisë së Statistikave të Kosovës, në shkurtesë: ASK, si bartës institucional i statistikave zyrtare.

Njëherësh, Projektligji rregullon statusin dhe financimin e ASK-së, përgjegjësitë dhe detyrat e ASK-së, pozitën dhe përgjegjësitë e kryeshefit ekzekutiv të ASK-së, pozitën, përbërjen, organizimin dhe përgjegjësitë e Këshillit Statistikor, pastaj përfshin masat planifikuese, programuese dhe zbatuese të statistikave zyrtare, grumbullimin e të dhënave statistikore, përpunimin dhe ruajtjen e të dhënave statistikore e të tjera.

Projektligji përbëhet prej 12 pjesëve ose kapitujve, me gjithsej 51 nene. Ky projektligj është aprovuar nga Qeveria në mbledhjen e mbajtur më 22.6.2011 me Numër 0420 dhe sipas procedurës së përcaktuar po i parashtrohet Kuvendit të Kosovës për miratim.

Projektligji është hartuar në përputhje me Rregulloren e punës së Qeverisë së Kosovës Numër 01/2007 dhe në hartimin e tij kanë marrë pjesë zyrtarë nga institucionet vendore dhe ndërkombëtare, të përcaktuara me nenin 32 të kësaj rregulloreje.

E gjithë puna e hartimit të projektligjit është bërë nga një frymë që karakterizon transparencë të madhe.

Projektligji ka formën dhe strukturën standarde në pajtim me Udhëzimin administrativ 14/2008 për hartimin e projektligjeve dhe të akteve nënligjore.

Projektligji është në pajtim me Kushtetutën dhe me standardet, marrëveshjet, konventat dhe detyrimet ndërkombëtare, si dhe është i përafëruar me dispozitat e detyrueshme të *acquis* komunitare.

Prandaj, të nderuar deputetë, ju propozoj që ta aprovoni këtë projektligj për ta bërë ligj të mirëfilltë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Kryetari i komisionit funksional, e do fjalën? Fjalën e ka deputeti Idriz Vehapi!

IDRIIZ VEHAPI: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar ministra,

Të nderuar deputetë,

Komisioni për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media, në bazë të nenit 56 paragrafi 2 të Rregullores së Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur me datën 11.07.2011, shqyrtoi në parim Projektligjin për statistikat zyrtare të Republikës së Kosovës dhe vendosi që Kuvendit t'ia paraqesë këtë rekomandim:

Që të miratohet në parim Projektligji për statistikat zyrtare të Republikës së Kosovës. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të Grupit parlamentar të Partisë Demokratike, fjalën e ka deputetja Xhevahire Izmaaku!

XHEVAHIRE IZMAKU: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike e ka shqyrtuar Projektligjin për statistikën zyrtare të Republikës së Kosovës dhe mendojmë se ky ligj që do ta diskutojmë sot, synon të rregullojë një çështje mjaft të rëndësishme që lidhet me shumë dimensione shoqërore e politike të një shteti funksional.

Projektligji që e kemi para vetes, ka për qëllim të përcaktojë parimet themelore, duke krijuar një bazë ligjore për organizimin, prodhimin dhe publikimin e statistikave zyrtare të Republikës së Kosovës.

Grumbullimi, prodhimi, përpunimi dhe publikimi i statistikave zyrtare për shtetin dhe ofrimi i tyre për publikim zyrtar dhe publikun e gjerë, janë çështje që i adreson shumë mirë ky projektligj.

Përbërja dhe emërimi i Këshillit Statistikor, bartësit e statistikave zyrtare, ruajtja e dokumentacionit sipas kriterëve ndërkombëtarë janë elemente që janë adresuar në këtë projektligj, përfshirë edhe dënimet për ofrimin apo refuzimin jo zyrtar të këtyre të dhënave.

Hartuesit e këtij ligji kanë punuar mbi standardet e BE-së në hartimin e tij, ndërtuar mbi parimet themelore, siç janë pavarësia profesionale, paanshmëria, objektiviteti, besueshmëria, fshehtësia statistikore dhe kosto aktiviteti. Cilësia e rezultateve garantohej përmes kriterëve të përcaktuara, po ashtu, sipas legjislacionit të BE-së.

Ky projektligj definon bartësit e statistikave zyrtare, siç janë: Agjencioni i Statistikave të Kosovës, Banka Qendrore dhe Ministria e Financave.

Projektligji tregon rolin dhe përgjegjësinë e Këshillit Statistikor dhe të organeve tjera ekzekutive dhe mandatin e tyre.

Ekistenca e këtij ligji do të ketë rëndësi shumë të madhe për vendin tonë dhe shpresoj se do të jetë i pranueshëm për mbarë shoqërinë tonë dhe i ekzekutueshëm, pasi që shumë projekte të reja dhe iniciativa ndërkombëtare që marrin jetë për herë të parë në shtetin tonë, do të reflektojnë edhe mbi bazën e asaj se sa ne jemi në gjendje të krijojmë edhe vlera të qëndrueshme të sferës së statistikës zyrtare në vend.

Grupi i Partisë Demokratike e mbështet këtë projektligj dhe ju fton të votoni “për”. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të LDK-së, deputeti Sadri Ferati e ka fjalën!

SADRI FERATI: Faleminderit, kryetar!

Edhe Grupi Parlamentar i LDK-së, pas analizës konstaton se Ligji ka një gjuhë të qartë dhe krijon një bazë të mirë për organizimin, prodhimin dhe publikimin e statistikave zyrtare të Kosovës.

Megjithatë, ne do shfrytëzojmë mundësinë tonë që në punën që do të bëhet në kuadër të grupeve punuese, të ngrehim edhe disa dilema, në rend të parë ne konsiderojmë se ky projektligj Entin e Statistikave e avancoi në Agjencion dhe propozon formimin e Këshillit dhe parashikon edhe një fuqizim, por megjithatë për mendimin tonë, ekziston një gjendje mezo, në mes të asaj që do të jetë institucion në kuadër të Ministrisë së Administratës Publike apo një agjencion i pavarur, i cili do të ketë mundësinë që të funksionojë si vetanak, çfarë edhe parashikohet me buxhetin. Prandaj, të gjitha

këto dilema dhe angazhime ne do t'i shprehim në kuadër të grupeve punuese, ndërsa sot jemi që ky projektligj të mbështetet parimisht dhe do ta votojmë.

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të “Vetëvendosje”, deputeti Glauk Konjufca e ka fjalën!

GLAUK KONJUFCA: Faleminderit!

Deputetë të Kuvendit të Kosovës, siç mund të parashihet me këtë projektligj duhet të sqarohet në mënyrë administrative, hierarkike dhe llogaridhënese puna dhe përgjegjësia e Entit të Statistikave të Kosovës, që nga ky projektligj do të quhet Agjencia e Statistikave të Kosovës.

Fatkeqësisht, ky projektligj nuk e rregullon siç duhet fushën në fjalë dhe janë disa pika që duhet të përmenden me këtë rast.

Enti i Statistikave përgjatë këtyre viteve ka kaluar nëpër një lëmsh në punën e vet. Asnjë dështim në prodhimet e tyre statistikore, që shpesh nuk ishin të ngritura as mbi faktet demografike, sociale dhe ekonomike të Kosovës, nuk është marrë përsipër nga ky institucion.

Njëra prej arsyeve për një situatë të tillë ka qenë po ashtu mungesa e Ligjit përkatës për statistikat. Secili institucion qeveritar, pra ministritë, por edhe kuvendet komunale mbledhin, përpunojnë dhe publikojnë statistika për punën dhe interesin e tyre, por që janë edhe në interes mbarë shtetëror.

Shpesh, siç e dimë, këto statistika të prodhuara në këtë mënyrë kanë qenë kontradiktore ose përjashtuese ndaj njëra – tjetrës, kjo përsëri në mungesë të ligjit përkatës për rregullimin e prodhimit statistikor në Kosovë.

Tash kur e kemi projektligjin në duar, përsëri nuk do të mund të ndërtojmë me ligj një sistem të qartë statistikor edhe në prodhimin e statistikave, por edhe në marrjen e përgjegjësisë për prodhimin e tyre, sepse me këtë projektligj nuk po ndërtohet sistemi statistikor i Kosovës, pra i mbledhjes, përpunimit dhe i prodhimit të tyre sipas fushës përkatëse.

Për më tepër, me këtë projektligj i cili është mjaft i paqartë, lëmshi statistikor që ekziston në Kosovë po zyrtarizohet. Sepse, për shembull, cila është përgjegjësia e Agjencisë karshi llogaridhënies, si dhe kujt i jep përgjegjësi dhe llogari Agjencia ose edhe kryeshefi i Agjenciës, sepse në punën e Agjencisë, sipas këtij projektligji, ndërhyjnë edhe Ministria e Administratës Publike dhe krejt Qeveria, por sipas projektligjit edhe vetë Këshilli për statistika.

Për shembull, Këshilli Statistikor, i cili pritet të themelohet pas miratimit të këtij projektligji, do të qëndrojë mbi Agjencinë si institucion dhe pa i dhënë llogari asaj. Në këtë mënyrë, ky këshill statistikor, i cili në fakt është zyrtarizim i Komisionit Qendror për Regjistrim, që udhëheqet nga Rifat Blaku, do ta shndërrojë Agjencinë në sekretariat të vetin administrativ. Ose Këshilli dhe Agjencia do të jenë dy institucione paralele që do të udhëheqin prodhimin statistikor në Kosovë, pa i dhënë llogari njëra - tjetrës dhe duke e vendosur në situatë shantazhimi ose favori njëra – tjetrën, varësisht prej interesit personal ose momentit.

Propozojmë që këshilli të themelohet drejt nga Agjencia në bashkëpunim me Ministrinë e Administratës Publike dhe me shoqërinë civile, por jo siç parashihet me këtë projektligj, sepse është deformim administrativ në prodhimin statistikor, ngarkesë shtesë për buxhetin e Kosovës si dhe

krijon rrethana nga të cilat lëmshi i organizimit dhe i prodhimit statistikor do të bëhet edhe më i madh seç ka qenë deri më tash.

Edhe një herë, në vend që projektligji për statistikat zyrtare të zgjidh dhe rregullojë lëmshin, me këtë projektligj ky do të bëhet edhe më lëmsh duke zyrtarizuar atë ekzistues, ku askush nuk i jep llogari askujt për asgjë. Për shembull, Enti i Statistikave e ka strategjinë e tij të miratuar nga Qeveria për zhvillim 2009/2013, por kjo strategji nuk po zbatohet sepse është strategji jo profesionale. Me këtë askush nuk po e merr përgjegjësinë e nuk po jep llogari, sidomos kur kihet parasysh që janë harxhuar qindra mijëra euro për përpilimin e një strategjie të tillë.

Në këtë kuadër duhet përmendur edhe situatën politike që ndikohet nga prodhimet statistikore, sidomos ato të cilat lidhen me aspektin ekonomik të Kosovës. Dihet nga përvoja që ekonomia e Greqisë kolapsoi pikërisht për shkak të prodhimit të rrejshëm të të dhënave dhe shifrave statistikore ekonomike në këtë shtet.

Nuk duhet lejuar që Qeveria e Kosovës të manipulojë me prodhimet dhe shifrat statistikore, duke na thënë që për shembull GDP-ia po rritet në vend, vit pas viti, deri sa në të njëjtën kohë ne po e shohim që varfëria është ajo e cila po rritet, pra duke krijuar një pasqyrë të rrejshme statistikore për gjendjen ekonomike, por edhe demografike dhe sociale në Kosovë.

Në këtë kuadër, propozojmë që Agjencia të jetë nën përgjegjësinë dhe llogaridhënien e drejtpërdrejtë të Kuvendit të Republikës së Kosovës, duke ditur rëndësinë e prodhimeve statistikore, duke e ditur që prodhimet statistikore janë mjet i rëndësishëm për vendimmarrjen edhe në Kuvend, edhe në Qeveri. Nuk guxojmë të lejojmë që Qeveria dhe ne të marrim vendime në cilëndo fushë në bazë të statistikave të rrejshme, në bazë të statistikave që s'kanë lidhje me realitetin në Kosovë.

Gjithashtu, duhet sqaruar edhe bashkëpunimi i Agjencisë me Eurostatin, Zyrën e Bashkimit Evropian për Statistika. Është mirë që ka dhe do të ketë bashkëpunime të tilla, por Enti i Statistikave, siç ka vepruar deri më tash, shpesh ka dalë që i ka dhënë përgjegjësi dhe llogari të drejtpërdrejtë Eurostatit, në vend të institucioneve të Republikës së Kosovës.

Po ashtu, duhet të rregullohet me ligj edhe mënyra e mbledhjes dhe shpenzimet e donacioneve ndërkombëtare për Agjencionin, sepse bashkësia ndërkombëtare nëpërmjet organizatave të veta statistikore po investon në mbledhjen dhe publikimin e të disa të dhënave në Kosovë, por asnjëherë nuk është bërë transparent ky investim se si janë menaxhuar dhe harxhuar këto fonde, që shpesh në baza vjetore kanë kapërcyer shumë e miliona eurove, pra duhet të sigurohet transparenca dhe llogaridhënia edhe në këtë pikë të rëndësishme të bashkëpunimit.

Në fund, edhe një vërejtje teknike. Në nenin 9 pika 2 në këtë ligj, thuhet se anëtar i Këshillit Statistikor duhet të jetë po ashtu një ekspert, po citoj “nga Universiteti”. Këtu duhet të specifikohet se për cilin universitet është fjala. Kurse në nenin 9.3 duhet të sqarohet se qysh zgjedhet eksperti në fjalë nga filan universiteti dhe nga cilat organe të universitetit në fjalë zgjedhet ai.

Edhe një diçka, domethënë për fund, Lëvizja “Vetëvendosje” do të votojë kundër këtij projektligji për arsye se ka defekte esenciale, siç i përmenda unë, por ne do t'i mbrojmë këto qëndrime politike në komision dhe nëse nuk përfillen vërejtjet tona dhe sugjerimet, atëherë do ta vulosim votën tonë kundërshtuese në leximin e dytë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të AAK-së, deputetja Teuta Haxhiu!

TEUTA HAXHIU: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Edhe ne, si Grup Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës e kemi shqyrtuar Projektligjin në fjalë dhe kemi disa sugjerime, por ne preferojmë që kontributin tonë ta japim në komisionin përkatës, me të vetmin qëllim që të nxjerrim, të kontribuojmë në nxjerrjen e një ligji i cili do të krijojë një hapësirë dhe të krijojë një sistem stabil të udhëheqjes së statistikave zyrtare në vendin tonë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të Grupit Koalicioni Kosova e Re, deputeti Amir Ahmeti e ka fjalën!

AMIR AHMETI: I nderuar kryetar,

Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Qytetarë të Kosovës,

Projektligjin për statistikave zyrtare të Republikës së Kosovës në leximin e parë, që e keni para vetes, Koalicioni për Kosovë të Re në parim do ta mbështesim, ndërsa do të japim kontributin tonë në komisionet përkatëse që në leximin e dytë të inkorporohen edhe këto vërejtjet tona për leximin përfundimtar. Kurse sot kishim vetëm disa vërejtje praktike, disa prej tyre veç i përmendën kolegët që folën para meje, ndërsa unë do të ndalem atëherë vetëm edhe te dy çështje tjera të cilat i konsiderojmë të rëndësishme, tek neni 9, ku flitet për Këshillin Statistikor, i cili është Këshill shumë i rëndësishëm, paragrafi 2 përcakton se nga cilat ministri apo subjekte caktohen anëtarët e Këshillit Statistikor, unë po numëroj shumë shpejt kështu, përmendet Ministria e Financave, Tregtisë, Industrisë, Banka Qendrore, Administrata Tatimore, Ministria e Punëve dhe Mirëqenies Sociale, Ministria e Bujqësisë, Universiteti, Shoqëria Civile, Komiteti i Biznesit. Duke pasur parasysh se Ministria e Administratës Publike administron me ASK-në, Agjencionin e Statistikave të Kosovës, duhet pasur edhe një anëtar nga kjo ministri. Qysh është e mundshme të jetë ky agjencion pa asnjë anëtar nga Ministria e cila administron me këtë agjencion dhe, e dyta që nuk është më pak e rëndësishme, konsiderojmë se është me rëndësi esenciale që institucionet qeveritare të marrin përgjegjësi për të tejkaluar problemet lidhur me publikimin e statistikave mbi llogaritë kombëtare, si parakusht të ngritjes së cilësisë së vendimmarrjeve të qeverisjes ekonomike. Sot ky institucion nuk prodhon as 1/3 e asaj që duhet për një qeverisje të mirë ekonomike.

Vërejtje tjera do t'i paraqesim në komisionin paraprak dhe shpresojmë që propozimet e vërejtjet tona do të merren parasysh dhe që në leximin e dytë të japim edhe ne votimin tonë. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të SLS-së, fjalën e ka deputeti Sasha Millosavljeviq.

SAŠA MILOSAVLJEVIĆ: Hvala, gospodine predsjedniče!

Samostalna liberalna stranka je razmatrala Nacrt zakona o zvaničnim statistikama Kosova i mi čemo u načelu podržati ovaj zakon.

KRYETARI: Faleminderit, deputet! Në emër të Grupit Parlamentar “6+”, deputeti Albert Kinolli e ka fjalën!

ALBERT KINOLLI: Faleminderit, i nderuar zoti kryetar!

I nderuar ministër,

Të nderuar kolegë deputetë,

Grupi Parlamentar “6+” e ka shqyrtuar me vëmendje këtë Projektligj për statistikën zyrtare të Republikës së Kosovës dhe duke pasur parasysh se i njëjti i plotëson kushtet e parapara sipas nenit 54 dhe për shkak të esencës së materies që rregullon ky ligj, ne si të tillë e përkrahim dhe në parim do ta votojmë, kurse kontributin tonë do ta japim përmes komisionit funksional. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Deputeti Arsim Bajrami e ka fjalën!

ARSIM BAJRAMI: Faleminderit, i nderuari zoti kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Padyshim se Ligji për statistikën zyrtare është një ligj shumë i rëndësishëm, i cili është edhe pjesë e obligimeve që i kemi si Kuvend në raport me Raportin e Progresit dhe me këtë ligj plotësohet një vakum ligjor sa i përket vendosjes së rregullit dhe rendit në grumbullimin, organizimin, prodhimin dhe publikimin e statistikave zyrtare dhe ky ligj pak a shumë i plotëson këto standarde ndërkombëtare sepse gjatë gjithë kohës ligji është punuar në koordinim të ngushtë me Eurostatin dhe me Komisionin Evropian dhe ka qenë një periudhë e gjatë në përgatitjen e këtij projektligji.

Siç shihet, projektligji është marrë kryesisht me tri çështje kryesore, me atë se si organizohen statistikën zyrtare, me publikimin e tyre dhe me grumbullimin e tyre dhe në përgjithësi ka vendosur një sistem të qëndrueshëm, një sistem shtetëror të qëndrueshëm sa i përket statistikave zyrtare.

Mirëpo, unë po shtroj dy çështje që i rekomandoj komisionit funksional t’i marrë parasysh me rastin e debatit. Çështja e parë, është çështja e statusit të Agjencionit Kosovar të Statistikave. Është një progres sepse kemi një ngritje të Entit të Statistikave nga Enti, që ka qenë një element i sistemeve të kaluara, në një Agjencion. Dilema ime është ku ta vendosim këtë Agjencion, për cilat nevoja prodhohen statistikën zyrtare.

Unë mendoj se statistikën zyrtare kanë tre klientë kryesorë. E para, institucionet shtetërore dhe atë të gjitha, ku edhe Qeveria është një klient i përhershëm që ka nevojë për të dhëna statistikore. Subjekti i dytë, është ekonomia, bizneset, ndërmarrjet publike dhe private dhe subjekti i tretë janë institucionet akademike dhe institucionet hulumtuese. Kështu që prodhimi i statistikave, përdorimi i të dhënave statistikore ka një kontekst shumë më të gjerë se sa që jepet në ligj dhe unë besoj se duhet të vazhdojnë debatet rreth strukturimit të Agjencionit të statistikave sepse Qeveria e Republikës së Kosovës ka bërë një studim në kuadër të Projektit të rishikimit funksional me mbështetjen ndërkombëtare, ku ka pasur kryesisht dy opsione rreth strukturimit të Agjencionit statistikor. Opsioni i parë ka qenë që të ndërtohet si agjencion i pavarur dhe ai të lidhet kryesisht me Kuvendin, në atë mënyrë që Kuvendi do të marrë raportet vjetore dhe asgjë më tepër. Dhe opsioni i dytë, të strukturoret brenda Qeverisë, brenda resorit përkatës. Pas transformimit të Ministrisë së Shërbimeve Publike, kalimit në një ministri të specializuar të Administratës Publike, statistikën nuk shkojnë fort me këtë ministri sepse kjo ministri tani ka preokupim kryesisht ngritjen e administratës publike dhe në rekomandimet ndërkombëtare, të cilat janë miratuar nga Qeveria, ka qenë opsioni që kjo të lidhet më tepër me ekonomi, për shkak se statistikën janë pjesë e ekonomisë dhe unë mendoj se gjatë

debateve në leximin e dytë duhet të sqarohet kjo, në mënyrë që funksionaliteti i Agjencionit të Statistikave të jetë shumë më i plotë.

Një çështje e dytë, edhe pse ligji i ka standarde të larta të shkrimit ligjor, është hartuar me standarde të larta të shkrimit ligjor, një çështje e dytë që ka mbetur nga trashëgimia ligjore e UNMIK-ut apo shkrimit ligjor të UNMIK-ut është që ligji operon me nocionin Ministria kompetente e Ekonomisë, Ministria kompetente e Administratës. Nuk i kemi nga dy ministri, por e kemi nga një dhe duhet të adresohet plotësisht qartë Ministria e Ekonomisë, Ministria e Bujqësisë, Ministria e Financave për shkak se kjo ka ndodhur në kohën kur nga ish Ministria e Sërbimeve Publike kanë dalë disa ministri dhe gjithmonë bartja e kompetencave është bërë në mënyrën progresive.

Përgjithësisht, ligji është i mirë dhe mendoj se është një bazë e mirë që ne të krijojmë një kornizë evropiane sa i përket statistikave zyrtare. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Deputetja Alma Lama e ka fjalën!

ALMA LAMA: Faleminderit, zoti kryetar!

Statistikat zyrtare normalisht shërbejnë si orientuese për zhvillimin e politikave pothuaj se në të gjitha fushat e jetës dhe ky projektligj ka një rëndësi të madhe.

Përveç vërejtjeve që i thanë parafolësit, e kam fjalën për Lëvizjen “Vetëvendosje”, unë dua të kundërshtoj pak profesor Bajramin, i cili tha që Ligji është shkruar me standarde të lartat shkrimit ligjor, mbase ligjor, por me standarde të larta të gjuhës shqipe ky ligj nuk është shkruar. Ka një konfuzitet të tërë nëpër fjali, nëpër nene, sa që në shumë prej tyre është krejtësisht i pakuptueshëm.

Unë e di që Kuvendi i Kosovës ka nisur një bashkëpunim me Republikën e Shqipërisë për të marrë ato ligje të cilat janë të miratuara në Shqipëri dhe nuk e di se pse nuk po vihet në jetë në fakt kjo.

Unë bëra një krahasim me Ligjin e miratuar nga Republika e Shqipërisë, ku kishte vende - vende ngjashmëri, por për koncepte krejtësisht të njëjta këtu ka një shpjegim, do me thënë, me një gjuhë aq të pakuptueshme, sa edhe ne që merremi përditë me këtë punë, nuk e kuptojmë.

Tendenca e çdo ligji është që të jetë sa më i kuptueshëm, sa më e thjeshtë gjuha dhe të prekë thelbin ose esencën e gjërave. Mirëpo, në këtë ligj, sikurse edhe në shumë ligje të tjera faktikisht, po veçanërisht në këtë ligj është komplikuar gjuha në mënyrë të panevojshme, nuk e di, mbase është bërë me përkthim Google apo nuk e di se pse ka ndodhur kjo.

Mendoj se duhet një shqyrtim edhe në aspektin gjuhësor. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Për replikë, Arsim Bajrami është lajmëruar!

ARSIM BAJRAMI: Faleminderit! Natyrisht se nuk fola për gramatikën dhe sintaksën e ligjit, sepse mendoj që janë lektorët edhe të Kuvendit, edhe të Qeverisë që duhet ta shikojnë, por në aspektin e shkrimit ligjor, mbarështrimit të ligjit është në rregull dhe është çdo gjë me standarde të shkrimit ligjor.

Sa i përket mundësisë së importimit të ligjeve, mendoj se nuk duhet të marrim ne atë praktikë që ne t'i importojmë ligjet, por ligjet duhet të përshtaten, sepse tek Republika e Shqipërisë autoritet kompetent për statistika është Instafi, i cili është i lidhur me shumë ministri dhe i cili i referon të dhëna statistikore edhe shumë subjekteve, kështu që ne gjithmonë do të marrim ndoshta modele të ligjeve, por jo siç tha, t'i marrim nga Google apo t'i marrim nga ligjet tjera, po ato ligje duhet t'ua përshtatim rrethanave tona. Nuk janë përvojat tona statistikore të ngjashme me të shteteve tjera dhe mendoj se me prurjen e këtij ligji ne veç po i vendosim do kontura për funksionimin e mirë të statistikave zyrtare dhe në një mënyrë po bëjmë një hap që Agjencioni i Statistikave duke u avancuar edhe të pavarësohet dhe të servisojë të dhëna statistikore për të gjitha subjektet e interesuara.

KRYETARI: Alma Lama, për replikë, kundër-replikë, a si ta quajmë!

ALMA LAMA: Si të doni! Jo, profesor Bajrami, mendoj që nuk më kuptoi! Nuk bëhet fjalë për lekturim të thjeshtë, bëhet fjalë për kuptimin e gjuhës shqipe. Një ligj duhet të kuptohet në shqip. Sintaksa nuk është element i pa rëndësishëm, është shumë i rëndësishëm, sepse nga një presje varet kuptimi i fjalisë, nëse mund ta thjeshtësojmë kështu. Dhe, konceptet, mënyra se si shpjegohen konceptet në këtë ligj, janë të pakuptimta në gjuhën shqipe.

Unë mund të citoj disa nene, nëse ka nevojë. Ndërsa, për sa i përket bashkëpunimit me Shqipërinë, nuk po them që të merren tërësisht, sepse atje ka edhe institucione të tjera, mirëpo në vend që të merren nga vendet e tjera, ta zëmë si Sllovenia, Kroacia, Mali i Zi, Maqedonia, fare mirë dhe më lehtë mund të merren nga Shqipëria, sepse edhe Shqipëria është në procesin e integritimit dhe madje është një shkallë më tej se sa Kosova për sa i përket përputhjes me legjislacionin e BE-së, ndërsa të tjerat le t'i përshtatet realitetit në Kosovë. Kjo ishte ideja ime. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Vazhdojmë. Nuk kemi të lajmëruar më as për replikë as për diskutim. Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim dhe votojmë tash:

Prezentë janë 67 deputetë. “Për” kanë votuar 48, “kundër” 10, 3 kanë abstenuar, kështu që Kuvendi miratoi në parim Projektligjin për statistikat zyrtare të Republikës së Kosovës.

Kërkohet nga komisioni funksional dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit ta shqyrtojnë Projektligjin dhe Kuvendit t'i paraqesin raportin me rekomandime.

Vazhdojmë me pikën e trembëdhjetë të rendit të ditës:

13. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për arsimin e lartë në Republikën e Kosovës

Në bazë të nenit 56 të Rregullores së Kuvendit, komisioni funksional ka shqyrtuar Projektligjin dhe Kuvendit ia ka paraqitur raportin me rekomandime, për shqyrtim në parim.

Ftoj ministrin e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, zotin Ramë Buja, që në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës para deputetëve të Kuvendit të prezantojë dhe arsyetojë Projektligjin.

MINISTRI RAMË BUJA: I nderuar zoti kryetar,

Të nderuar deputetë,

Ministrat janë në mungesë!

Miratimi i Ligjit të arsimit të lartë nga Kuvendi i Kosovës ka rëndësi të madhe për arsimin e lartë në Kosovë pasi që ky ligj do të mundësojë zhvillimin e reformave në arsimin e lartë, si dhe krijimin e sistemit të arsimit të lartë i cili do të jetë kompatibil me sistemin evropian të arsimit të lartë.

Qëllimi i Ligjit të arsimit të lartë në Republikën e Kosovës është krijimi i bazës ligjore për rregullimin, funksionimin dhe zhvillimin e arsimit të lartë në Kosovë, ndërsa parimet e Ligjit të arsimit të lartë janë këto.

Ofrimi i arsimit të lartë në Republikën e Kosovës bazohet në këto parime që do t'i numërojmë pastaj, në vijim:

- lirinë akademike të përcaktuar në Kushtetutën e Republikës së Kosovës;
- barazimin para ligjit për të gjithë bartësit e arsimit të lartë;
- mundësitë e barabarta për të gjithë studentët dhe personelin në institucionin e arsimit të lartë, pavarësisht dallimeve gjinore, racës, prirjes seksuale, aftësive të kufizuara mendore, fizike apo tjera, gjendjes martesore, ngjyrës, fesë, opinionëve politike apo fetare, prejardhjes kombëtare, etnike apo sociale, përkatësisë ndaj një komuniteti etnik, pronësisë apo dallimeve tjera;
- shumëllojshmëri dhe cilësi në programe të studimit dhe në mbështetje të mësimnxënies,
- kreativiteti, inovacioni dhe ndërvlerësia si objektiva kyçe për bartësit e arsimit të lartë dhe të programeve të studimit;
- fokusimi evropian dhe ndërkombëtar në të gjitha fushat e arsimit të lartë që i sigurojnë studentit dhe personelit lëvizshmëri dhe krahasueshmëri të standardeve në dhënien e diplomave dhe të kualifikimit,
- përkushtim në punë kërkimore dhe akademike, për të mbështetur mësimdhënien dhe mësimnxënien, si dhe për të zgjeruar kufijtë e njohurive brenda Kosovës dhe jashtë saj;
- angazhim aktiv të studentëve si në aspektin individual, ashtu edhe në atë kolektiv në jetën e institucionit dhe në mësimnxënien e tyre.

Qasja në arsimin e lartë është kjo: Në arsimin e lartë që ofrohet nga bartësit e licencuar të arsimit të lartë në Kosovë, do të kenë qasje të gjithë personat brenda apo jashtë territorit të Kosovës, pa asnjë lloj diskriminimi të drejtpërdrejtë ose të tërthortë për ndonjë arsye reale apo të supozuar që ka lidhje me gjininë, racën, prirjen seksuale, aftësinë e kufizuar fizike, vendosje të një lloji tjetër, gjendja martesore, ngjyrën, gjuhën, fenë, opinionet politike apo fetare, prejardhjen kombëtare, etnike apo sociale, përkatësinë ndaj një komuniteti etnik; pronësinë, lindjen apo ndonjë status tjetër. Mund të ketë kufizim moshe për t'u regjistruar apo për të fituar kualifikim në arsimin e lartë në Kosovë.

Kompetencat dhe përgjegjësitë e institucionit: Ligji përcakton qartë kompetencat dhe përgjegjësitë e MASH-tit, Agjencisë së Akreditimit të Kosovës, bartësve publikë dhe bartësve të tjerë të arsimit të lartë duke krijuar një koordinim funksional të të gjithë akterëve në arsimin e lartë në Kosovë.

Ligji përcakton themelimin, akreditimin, licencimin, strukturën qeverisëse, funksionimin, financimin, kontrollimin financiar dhe autonominë e bartësve publikë dhe bartësve të tjerë të arsimit të lartë. Po ashtu, Ligji përcakton qartë marrjen e titujve, të gradave shkencore, diplomave dhe thirrjeve akademike.

Ligji parasheh edhe nxjerrjen e statuteve të bartësve të arsimit të lartë. Me ligj, po ashtu, përcaktohen edhe të drejtat dhe përgjegjësitë e studentëve, prandaj të nderuar deputetë, ju propozoj që ta aprovoni

këtë projektligj në lexim të parë për ta bartur në leximin e dytë dhe për të krijuar mundësinë e përbashkët që të bëjmë ndryshimet e domosdoshme për ta bërë këtë ligj më funksional dhe më të implementuar. Faleminderit!

Drejtimin e seancës e merr z. Xhavit Haliti, nënkryetar i Kuvendit

KRYESUESI: Faleminderit! Kryetari i komisionit funksional, zoti Vehapi!

IDRIZ VEHAPI: Faleminderit, zoti kryesues!

I nderuar ministër,

Të nderuar deputetë,

Komisioni funksional përkatës, me datën 11.07.2011 e ka shqyrtuar Projektligjin, me ç'rast ka vlerësuar se Projektligji për arsimin e lartë në Republikën e Kosovës i plotëson kushtet e parapara me nenin 54 të Rregullores së Kuvendit dhe bazuar në këtë fakt, ia rekomandon Kuvendit për miratim në parim. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Edhe një herë kisha apeluar te deputetët që s'kanë vërejtje për Ligjin, besoj që s'ka nevojë ta zgjasin shumë, se i kemi edhe gjashtë pika pët t'i kryer. Mirë është t'i shkurtojmë diskutimet që nuk interferojnë drejtpërsëdrejti në ligj dhe duke pasur parasysh se janë në lexim të parë, këto do të shkojnë në amendamentim në komisione.

Sipas renditjes, kryetarët ose përfaqësuesit e grupeve parlamentare. Në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, deputeti Ramë Vataj.

RAMË VATAJ: Faleminderit, nënkryetar!

I nderuar zoti ministër,

Të nderuar kolegë deputetë,

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike e ka shqyrtuar me vëmendje këtë projektligj për arsimin e lartë në Republikën e Kosovës dhe jep mendimin se ky ligj është shumë më i avancuar se Ligji i mëparshëm 2002/03 për arsimin e lartë.

Ne konsiderojmë se ky projektligj duhet të rregullohet në mënyrë gjuhësore sepse lë përshtypjen se është një përkthim i dobët prej gjuhës angleze në gjuhën shqipe.

Unë nuk do të përmend ato që më parë i tha ministri i Arsimit, mirëpo do t'i përmendi gjërat që ne mendojmë se duhet të rregullohen më mirë me këtë ligj. Për shembull, duhet definuar qartë niveli, apo nivelet e organizimit të arsimit të lartë në Kosovë. Në të gjitha vendet e zhvilluara arsimi i lartë bëhet apo organizohet në tri cikle, cikli i parë, cikli i dytë dhe cikli i tretë, apo në gjuhën e zakonshme që jemi mësuar të themi bachellar, master doktoraturë, e në këtë projektligj ne mendojmë se janë ngatërruar objektivat e arsimit të lartë me nivele të organizimit të arsimit të lartë.

Pastaj, duhet të definohet me ligj themelimi i Agjencionit të Akreditimit të Kosovës, si agjencion i pavarur. Pra, ky duhet të rregullohet me ligj sikur të gjitha agjencionet tjera.

Në këtë ligj Agjencioni i Akreditimit të Kosovës del më tepër si organ këshillues dhe sipas përshkrimit të punës që është në këtë ligj, do të duhej të quhej Këshilli i Akreditimit të Kosovës, e jo si organ rekomandues që është detyra e këtij agjencioni.

Nuk janë të definuara mirë cilët janë bartësit e arsimit të lartë. Ne mendojmë se duhet të definohet mirë, të saktësohet çka është universiteti, çka janë akademitë, çka janë kolegjet universitare apo profesionale. Duhet po ashtu të definohen mirë edhe njësitë përbërëse të tyre, çka është fakulteti, çka është departamenti, instituti, njësia kërkimore, programi e kështu me radhë.

Në këtë projektligj përmendet edhe Këshilli Shtetëror i Arsimit të Lartë. Ne e dimë që edhe ky këshill është edhe i themeluar. Mirëpo, nuk është i definuar me ligj themelimi, përbërja dhe detyrat e këtij këshilli, prandaj ne mendojmë që duhet të definohet në këtë ligj funksionimi i Këshillit Shtetëror të Arsimit të Lartë.

Po citoj nenin 18 paragrafi 3 për përbërjen e Këshillit Drejtues të Universitetit që është shkruar, citoj: “Një numër i anëtarëve të zgjedhur nga Universiteti duhet të jenë nga komuniteti akademik ndërkombëtar”, që ne e vlerësojmë se është gabim se nuk dimë shembull të tillë që ndonjë universitet publik të ketë shtetas të huaj në këshillin drejtues.

Po ashtu, duket nënçmuese për Këshillin Drejtues dhe panelin përzgjedhës që përzgjedhja e Rektorit të Universitetit të bëhet, citoj: “...pas vlerësimit profesional nga një kompani konsulente me angazhim të ekspertëve të jashtëm”, neni 19, paragrafi 1. Dihet, rektori zgjidhet në bazë të CV-së, në bazë të gjitha punimeve, aftësive menaxhuese që i tregon para panelit përzgjedhës dhe dokumenteve që i ofron ai për ato aftësi që ka.

Po ashtu, neni 26, për tituj dhe gradat akademike, thirrja e profesorëve ordinarë është përkthyer gabim, duhet të jetë profesor i rregullt. Po ashtu thirrja “asistent i universitetit” duhet të jetë vetëm “asistent”, ndërsa paragrafi 5 i këtij neni duhet të precizohet se kush janë bartësit tjerë, nëse mendohet për bartësit privatë, atëherë nuk është në rregull, duhet të definohet përsëri çka janë profesorë asistentë, profesorë, e kështu me radhë.

Kemi edhe gjëra tjera, por Grupi ynë parlamentar do t’i diskutojë këto nëpër grupet punuese dhe në komisionet përkatëse, prandaj ne do ta votojmë në parim këtë projektligj, e po ashtu kërkojmë që edhe kolegët tjerë të grupeve tjera parlamentare të japin kontributin e tyre që me vërejtjet dhe sugjerimet e tyre ta bëjnë që ky ligj të jetë sa më i kompletuar. Ju faleminderit për vëmendjen!

KRYESUESI: Faleminderit! Deputeti Demolli, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së.

HAKI DEMOLLI: Faleminderit, i nderuari kryesues!

I nderuari ministër,

Të nderuar kolegë deputetë,

Para se t’i paraqes disa vërejtje, disa komente dhe sugjerime në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së lidhur me nenet konkrete, unë do t’i kisha thënë disa vlerësime të përgjithshme lidhur me këtë draft-ligj.

Nën 1. Në përgjithësi, vërehet se fryma e këtij ligji shkon në drejtim të centralizimit të pushtetit dhe të kompetencave në MASHT, si në raport me institucionet e arsimit të lartë publik, ashtu edhe në raport me vetë këtë Kuvend.

Nën 2. Po ashtu, me këtë ligj shkohet në drejtim të rrënimit të autonomisë së bartësve publikë të arsimit të lartë si në rrafshin e menaxhimit, ashtu edhe në rrafshin akademik, që mund të jetë tejet i dëmshëm për jetën akademike dhe arsimin e lartë në përgjithësi në Kosovë, pasojat e të cilit do të jenë tejet të rënda jo vetëm par arsimin e lartë, por edhe për shoqërinë kosovare në përgjithësi.

Kurse, sa i përket vërejtjeve konkrete, unë do të filloja nga neni 9. Në nenin 9, paragrafi i cili rregullon themelimin dhe shuarjen e universiteteve publike apo të bartësve të arsimit të lartë publik, theksohet: “bartësit publikë të arsimit të lartë mund të krijohen vetëm me vendimin e Ministrisë, i cili duhet të ratifikohet nga Kuvendi”. Mendoj se për themelimin dhe shuarjen e universiteteve publike duhet të vendosë ky Kuvend e jo Kuvendi të bëjë vetëm ratifikimin e vendimeve, sepse nëse ne aprovojmë një dispozitë të tillë, mund të ndodhë që në Kosovë për çdo ndryshim të partisë që udhëheq me këtë ministri, të kemi themelime respektivisht shuarje të universiteteve publike, respektivisht universitetet publike do të shndërroheshin në premtime elektorale, gjë që ka ndodhur edhe më parë nga disa parti politike.

Më tutje, në nenin 17 përcaktohet që statuti i bartësit publik të arsimit të lartë të propozohet nga Ministria, për t’u miratuar nga Kuvendi. Në tërësi, me këtë dispozitë po anashkalohen organet e bartësit publik të arsimit të lartë, sikurse të ishte fjala për ndonjë institucion jo akademik, e jo për një institucion që mund të ketë në kuadrin e vet me dhjetëra apo edhe me qindra doktorë shkencash.

Jam i mendimit që statutet e bartësve të arsimit të lartë publik të përgatiten, të aprovohen nga ana e organeve të tyre, kurse ratifikimi i këtyre statuteve të bëhet nga ana këtij Kuvendi e assesi Ministria të bëjë një propozim të tillë.

Më tutje, neni 18, paragrafi 2 flet për Këshillin Drejtues të bartësit publik të arsimit të lartë, në të cilin nen nuk përcaktohet saktësisht numri i anëtarëve të Këshillit Drejtues, por thuhet të jetë prej 5 deri në 9 anëtarë. Mendoj se është mirë të përcaktohet numri i saktë. Tani për tani i ka 9 anëtarë, dhe pse jo mos të mbetet ky numër edhe në të ardhmen.

Po ashtu, në këtë nen, si kusht për të caktuar një person si anëtar i Këshillit Drejtues, nga MASHT-i kërkohet që kandidati të ketë aftësi profesionale dhe afariste dhe kërkohet që asnjë anëtar i emëruar nuk duhet të ketë lidhje të drejtpërdrejta me institucionin në të cilin emërohet si anëtar i Këshillit Drejtues. Ne mendojmë se si kriter duhet të jetë që anëtari i Këshillit Drejtues të jetë pikërisht mësimdhënës i bartësit publik të arsimit të lartë, në mënyrë që mos të na shndërrohen universitetet në institucione komerciale, ku afaristët e ndryshëm realizojnë interesat e tyre.

Po ashtu, në nenin 18 pikë 3, kërkohet që një numër i anëtarëve të zgjedhur nga Universiteti duhet të jenë nga komuniteti akademik ndërkombëtar, që e përmendi më herët edhe kolegu nga PDK.

Shtrohet pyetja, si do të sigurohet që një staf akademik ndërkombëtar të vijë në Universitetin e Prishtinës apo në Universitetin e Prizrenit? Ne kemi parë se Universiteti i Prizrenit tash për tash ka mjaft probleme me stafin akademik ndërkombëtar, andaj pse t’i shtojmë vetës therë në këmbë.

Në nenin 18, paragrafi 5, theksohet: “Këshilli Drejtues zgjedh për çdo vit kryesuesin, që nuk mund të jetë punonjës apo student i këtij institucioni”, kurse ne si Grup Parlamentar mendojmë se studentët fare nuk mund të jenë anëtarë të Këshillit Drejtues. Po ashtu, mendojmë se kryesuesi gjithsesi duhet të jetë i punësuar i Universitetit, kryesuesi duhet të ketë një mandat të caktuar, që në këtë rast

propozoj të jetë 4 vjet, por edhe anëtarët tjerë të Këshillit Drejtues duhet të kenë mandatin e caktuar, e sipas mundësive të jetë 3 ose 4 vjet.

Më tutje, në nenin 18, në paragrafin 7 e 8 theksohet se Ministria e shkarkon anëtarin e Këshillit Drejtues, kurse sipas këtij paragrafi, ankesa kundër vendimit të shkarkimit i drejtohet Ministrisë. Sipas mendimit tim, nuk është kjo e logjikshme. Paramendoni, cilat janë gjasat e të shkarkuarit për miratimin e ankesës së tij nga Ministria, e cila atë e ka shkarkuar.

Po ashtu, në nenin 19 pika 1, shtroj pyetjen: Pse kërkohet që në procesin e konkursit publik për zgjedhjen e rektorit të angazhohet vlerësimi profesional nga një kompani konsulente me angazhimin e ekspertëve të jashtëm. Athua, nuk kemi mjaft ne si Kosovë kuadro vendorë që të bëjmë një përzgjedhje të tillë?

Ndërsa, neni 23, alineja 4, i cili nen rregullon përgjegjësitë e Këshillit Drejtues dhe të rektorit, mendoj se për mua është mjaft problematik, sepse i njeh të drejtën që Ministria ta largojë dhe ta zëvendësojë përkohësisht një apo më shumë anëtarë të Këshillit Drejtues ose edhe vetë rektorin. Një dispozitë e këtillë është kundër autonomisë akademike dhe menaxheriale të bartësit publikë, sepse në vazhdimësi politika do të mund të ushtrojë ndikimin e vet në rrjedhat akademike dhe funksionale të bartësit publik të arsimit të lartë, respektivisht të universiteteve publike.

Po ashtu, neni 23, paragrafi 4 është në kundërshtim me nenin 18 paragrafi 8, sepse deri sa në nenin 18, paragrafi 8 parashihej që ankesa kundër shkarkimit të anëtarëve t'i drejtohet Ministrisë, ndërsa në nenin 23, paragrafi 4 parashihet që kjo ankesë t'i drejtohet gjykatës kompetente.

Për mua, po ashtu është mjaft problematik edhe neni 26, respektivisht paragrafi 3 i këtij neni, ku rregullohen titujt dhe gradat akademike si të universiteteve, kolegjeve universitare dhe të bartësve të tjerë. Dhe, paramendoni, sipas këtij neni, parashihen këta tituj akademikë: profesor ordinar, profesor i asociuar, profesor asistent dhe asistent universitar. Në këtë nen thuhet: kriter për secilin titull është që të ketë të paktën një diplomë masteri.

Paramendoni, profesorin ordinar apo të rregullt me diplomë masteri, në kohën kur për t'u regjistruar në studimet tona të masterit nuk kërkohet kurrfarë kriteri. E besoni se e dimë të gjithë, gjithkund në botë titulli i profesorit fitohet të paktën me diplomë të doktoraturës.

Andaj, mirë është që ky nen, respektivisht neni 26 të analizohet, të përpunohet mirë dhe të harmonizohet me kriteret për tituj akademikë në vende të ndryshme të botës.

Po ashtu, edhe në nenin 29, paragrafi 3 shihet intervenimi apo ndërhyrja e drejtpërdrejtë e Ministrisë, madje edhe në pranimin e studentëve. Kështu, për shembull, atje theksohet se me rastin e organizimit të provimeve pranuese, provimet shtesë duhet të aprovohen nga ana e Ministrisë. Dhe, po del se Ministria është e gjithëdijshme, ndërsa universitetet nuk kanë aftësi as të organizojnë provimet pranuese, respektivisht provime shtesë për studentë.

Po ashtu, do të isha ndalur pak edhe rreth Agjencionit Kosovar të Akreditimit, i cili parashihet apo rregullohet me nenin 7, paragrafi 4, në të cilin flitet për Bordin i cili do të qeverisë me këtë Agjencion.

Ky nen nuk e rregullon në mënyrë të qartë kualifikimin apo aftësitë dhe kushtet që duhet plotësuar anëtarët e këtij bordi, madje përdorë shprehjen: “dhe ose në profesione brenda dhe jashtë Kosove”. Po ashtu, nuk është përcaktuar edhe numri i saktë i anëtarëve, por thuhet “prej 5 deri 9”, e shtrohet pyetja: pse të mos përcaktohet numri 8, 7 ose 9 për të cilët definohet. Po ashtu, theksohet se anëtarët e tij ratifikohen nga Kuvendi. Pse ratifikohen, e jo mos të zgjidhen apo të emërohen nga ana e vetë Kuvendit. Andaj, mirë është që ky nen të riformulohet dhe të përcaktohen më për së afërmi kriteret për Bordin e Agjencionit Kosovar të Akreditimit.

Dhe, krejtësisht në fund, vetëm edhe dy çështje, që nuk janë të këtij karakteri dhe të kësaj rëndësie, por që edhe...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Faleminderit! Po më duket, boll gjatë e pate, veç hajt le ta japin edhe një minutë!

HAKI DEMOLLI: Në nenin 2, paragrafi 1.3, flet për “mundësi të barabarta për të gjithë studentët dhe personelin, pavarësisht dallimeve gjinore, racës përfshirë edhe aftësitë e kufizuara mendore”. Athua, sa është serioze që në universitetet tona të punojë personeli me aftësi të kufizuara mendore, respektivisht të regjistruar studentë me aftësi të tilla?

Andaj, duke pasur parasysh të gjitha këto vërejtje, Grupi Parlamentar i LDK-së, në parim përkrah procedimin e më tutjeshëm të këtij projektligji dhe njëherësh kërkon që komisionet përkatëse t’i inkorporojnë vërejtjet, sugjerimet e theksuara dhe të riformulohen dispozitat e kontestuara konform kërkesës së Grupit Parlamentar të LDK-së. Ju faleminderit, për këtë minutën shtesë!

KRYESUESI: Faleminderit! Nga Grupi Parlamentar i “Vetëvendosjes”, kush e merr fjalën? Zoti Kasolli!

AFRIM KASOLLI: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar deputetë,

Lëvizja “Vetëvendosje” e ka shqyrtuar me vëmendje Projektligjin për arsimin e lartë në Republikën e Kosovës dhe si e tillë në parim e përkrah këtë projektligj. Megjithatë, kjo Lëvizje ka disa vërejtje serioze ndaj këtij projektligji, me ç’rast shpreson se këto vërejtje do të merren në konsideratë në fazat e më tutjeshme të procedimit të këtij projektligji deri sa ai të marrë formën përfundimtar dhe finale.

Sidoqoftë, këto gabime kanë të bëjnë që nga çështjet më të thjeshta, si nga sferat terminologjike e deri te ato më të komplikuarat. Kështu, për shembull, bie fjala në nenin 3 paragrafi 1.7 thuhet “çka pritet që nxënësi të dijë, të kuptojë dhe të jetë në gjendje të bëjë pas përfundimit të shkallës së studimeve apo modulit”. Konsideroj që në vend të “nxënësit” duhet të jetë “studenti” sepse, me sa di unë, nxënësi është një kategori e nivelit që i përket nivelit fillor dhe të mesëm të arsimit, e jo nivelit të arsimit të lartë.

Këto gabime të rastësishme apo të qëllimshme në këtë nen vërehen edhe në pikën 1.14, ku thuhet se “bartës publik nënkupton bartës të themeluar nga Qeveria e Republikës së Kosovës.” Në këtë rrafsh, duhet të jetë e propozuar nga Qeveria, për t’u themeluar nga Kuvendi. Madje, logjikisht, nisur nga

premisë, atëherë del se edhe çfarë anomalish juridike kanë karakterizuar themelimin e Universitetit të Prizrenit për shkak të mungesës së transparencës që e ka karakterizuar këtë proces.

Paradoksalisht, kjo paqartësi vazhdon edhe me nenin 7, që ka të bëjë me AKA – Agjencinë e Kosovës për Akreditim, duke përshkruar rolin, funksionin dhe detyrat e këtij mekanizmi, ky nen herë thotë se e këshillon Ministrinë dhe herë thotë se merr vendime. Për shembull në paragrafin 2.1 të këtij nenik thotë se “këshillimin me Ministrinë lidhur me kërkesat e institucioneve për licencimin e kurseve dhe programeve”, kurse në paragrafin 2.3 thotë “marrjen e vendimit për akreditim apo riakreditim”. Pra, shtrohet pyetja, ky institucion a këshillon apo merr vendime?

Ndërkaq, në nenin 8, paragrafi 1, thotë se “bartësit publikë të arsimit të lartë janë universitetet dhe institucionet e tjera të arsimit të lartë”. Shtrohet pyetja: Kush janë këto institucione të tjera të arsimit të lartë? A janë institutet apo çka janë ato? Konsideroj se edhe kjo pikë duhet të përkufizohet qartë.

Ndërkaq, ajo që si çështje hap shumë dilema, mund të merret edhe neni 16, paragrafi 5, ku thuhet se “vetëm bartësit publikë të arsimit të lartë mund të ofrojnë programe studimi, që çojnë në kualifikimin e një mësimmshënësi për t’u punësuar në një shkollë”. E para, këtu shtrohet pyetje, se a është fjala vetëm për shkolla publike apo private, pra se edhe ata që diplomojnë në shkolla private, nuk kanë të drejtë po ashtu të punojnë në procesin mësimmor as në shkolla private apo as në shkolla publike dhe se vetëm ata që diplomojnë në shkolla publike kanë të drejtë të japin mësimm edhe në shkolla private dhe në shkolla publike.

Me anë të këtij projektligji, po ashtu, synohet që të ruhet kontrolli politik nga ana e Ministrisë mbi bartësit e arsimit të lartë dhe është interesant që ky kontroll të mbulohet duke shfrytëzuar si paravan argumentin ligjor dhe juridik. Kështu, bie fjala, neni 17 paragrafi 1, thotë se “funksioni dhe menaxhimi i bartësit publik të arsimit të lartë përcaktohet me statut të propozuar nga ana e Ministrisë dhe të miratuar nga Kuvendi”. Me këtë rast, shihet qartë që eliminohet Senati si faktor kyç në hartimin e statutit të këtyre institucioneve. Kjo tendencë spikat veçanërisht edhe në kompetencat që merr Këshilli Drejtues i Universitetit dhe deri tek fuqia e tij për të zgjedhur rektorin e Universitetit, gjëja në konsultim me një kompani konsulente ndërkombëtare, me angazhim të ekspertëve të jashtëm. Pra, edhe me këtë rast këtu përjashtohet Senati si njësi e Universitetit në këtë proces. Kështu, në vend që strukturat drejtuese të Universitetit të jenë produkt i nivelit horizontal të tij, përkundrazi këtij niveli i imponohet niveli vertikal. Dhe në fund të fundit, paramendojeni vetëm sot përbërjen e Këshillit Drejtues të Universitetit, ku lirisht mund të thuhet se ai nuk është këshill drejtues i Universitetit, por është një këshill politik i partisë në pushtet, e cila i ka shpërblyer këta individë për shkak të servilitetit të pa parë politik ndaj saj.

Shqetësues mbetet edhe paragrafi 4 i nenit 20, ku thuhet se Ministria mund të sigurojë fonde publike për bartësit privat të arsimit të lartë, të licencuar dhe të akredituar në mbështetje të objektivave të Ministrisë. Në këtë kontekst, shtrohet pyetja se a ka të drejtë Ministria ta bëjë këtë gjë, por edhe nëse ka të drejtë, këtu duhet të jenë të precizuara qartë kriteret se mbi çfarë baze merret një vendim i tillë, a është performanca akademike, kërkimet shkencore dhe teorike të atij instituti apo lidhjet biznesore dhe politike, çfarë edhe i aplikon kjo qeveri.

Kurse, në nenin 22, pika 6, te kushtet e financimit, thuhet se Ministria mund të anulohet fonde, nëse ajo mendon se janë keqpërdorur. Është imediate të thuhet se Ministria mund ta bëjë një gjë të tillë

vetëm nëse verifikohet dhe argumentohet se janë keqpërdorur fonde, e që jo veprimet e tilla të merren mbi bazën e hamendjeve.

Po ashtu, është konfuze edhe çështja që ka të bëjë në lidhje me titujt akademikë, ku thuhet në paragrafin 6 të neni 26, se kriteret për të gjithë titujt, përveç atyre asistentëve ligjërues, përfshin të paktën një diplomë master ose ekuivalente, e kjo i bie që ligjërues mund të jetë edhe pa këtë gradë akademike, atëherë shtrohet pyetja se kush mund ta bëjë këtë thirrje për ndonjë person si ligjërues pa këtë gradë akademike, nuk është e precizuar.

Kurse paragrafi 9 i po këtij neni, thotë se “profesori ordinar i pensionuar nga një post me orar të plotë, mund të caktohet si profesor emeritus dhe mund të thirret për ta mbështetur institucionin në të cilin ai mban këtë titull, në cilëndo mënyrë që konsiderohet e përshtatshme nga rektori”. Ky paragraf shumë panevojshëmrisht e anulon rolin e Këshillit të fakulteteve dhe të organeve tjera, sepse në këtë rast duhet të jetë që profesori emeritus, me kërkesën e Këshillit të fakultetit e me miratimin e rektorit mund të angazhohet në mbajtjen e mësimit në nivelin master dhe të doktoraturës.

Këto formulime jo korrekte përfshin edhe neni 28 paragrafi 1, ku thuhet se “statuti i një institucioni publik të arsimit të lartë përmban dispozita lidhur me pushimin nga puna apo shkuarjen në pension”. Paradoksalisht, ky formulim duket sikur është hartuar enkas nga rektori aktual i Universitetit të Prishtinës, zoti Mujë Rugova, i cili e mban pozitën e tij si rektor në mënyrë jo ligjore, sepse shkuarja në pension rregullohet me Ligjin e punës e jo me akte të veçanta dhe statute të caktuara të këtyre institucioneve.

Sidoqoftë, është interesant të vihet në pah se në këtë projektligj as që është menduar fare edhe për një çështje tjetër, për arsimin e lartë të asaj kategorie të shoqërisë që ka për qëllim dhe synim të përgatisë dhe kualifikojë specialistë të lartë në mbrojtjen e vendit dhe të sigurisë së tij. Është e vërtetë se shumë ligje të arsimit të lartë, në vende të tjera këto çështje janë kompetencë e ministrive tjera, sikur asaj të Mbrojtjes dhe të Punëve të Brendshme, por po ashtu arsimimi i kësaj kategorie përfshihet pikërisht në Ligjin e lartë për arsimin, prandaj mos përfshirja e këtij elementi në Projektligjin për arsimin e lartë lë mundësi që të kuptohet se kjo qeveri as që e paramendon mundësinë e ndërtimit të strukturave të kualifikuara dhe kompetente që i shërbejnë vendit edhe në këtë aspekt.

Për fund, po ashtu, shumë nga dispozitat e këtij projektligji mbetet e pa qartë se a do të mund të zbatohen ndonjëherë, sepse neni 36 lidhur me dispozitat kalimtare thotë se ato mund të hyjnë në fuqi që nga viti shkollor 2015 – 2016 po që se krijohen kushtet financiare. Kjo i bie që në rast se nuk krijohen kushtet financiare dhe vendi do të përballet me deficite buxhetore e financiare për vitet në vijim, ato dispozita nuk do të mund të implementohen dhe se ky projektligj në vend se të ofronte zgjidhje për problemet që aktualisht sot dominojnë në sferën e arsimit të lartë, në të vërtetë kjo situatë me shumë të panjohura do ta thellojë edhe më tej konfuzionin dhe kaosin në këtë segment të arsimit. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, deputetja Teuta Haxhiu!

TEUTA HAXHIU: Faleminderit, i nderuar kryesues!

I nderuar ministër,

Të nderuar kolegë deputetë,

Po mundohem të kursej kohën pak, edhe për ju deputetë të nderuar. Unë do të ndalem pak në disa dispozita për të cilat mendoj se do t'i kontribuojnë projektligjit në fjalë, duke menduar që pjesën tjetër të sugjerimeve tona ta japim në komisionin funksional.

Së pari, mendoj se duke filluar nga neni 2, te parimet, ndoshta duhet kërkuar një kujdes gjuhësor dhe riformulim më i saktë dhe të mënjanohej disa lëshime, si përdorimi mësimxënie për nxënie, nxënës për studentë dhe disa herë është përdorur emërtimi banor, disa herë persona, edhe ndoshta duhet respektuar emërtimet të cilat përdoren në Kushtetutën e Kosovës.

Së dyti, të diskutueshme për ne janë edhe disa dispozita që detajohen në nenin 13, në autonominë e bartësve të arsimit të lartë, te kompetencat e ministrisë përkatëse, që duhet konkretizuar në ofrimin e kushteve të bartësve të arsimit në aspektin financiar.

Kur jemi te autonomia, duhet mënjanoj praktikën e deritashme ose me dispozita më të qarta, që Ministria t'u ofroj kushte bartësve të arsimit të lartë. Në këtë rast, njërive akademike, që të jenë autonome në përcaktimin e kuotës së regjistrimit të studentëve në vitin e parë. Meqë në këto vitet e fundit kuota e përcaktuar herë nga Qeveria, e herë me ndërmjetësimin e Ministrisë, ka krijuar rrëmujë, ka ulur mundësinë e cilësisë së studimeve, të punës kërkimore shkencore, duke i detyruar fakultetet të pranojnë edhe numër enorm të studentëve.

Për shembull, fakultetet e edukimit në Evropë dhe gjetiu kanë një standard që pranojnë 25 deri 35 studentë për një program, kurse te ne vitin e kaluar, ka ndodhur që të jenë të pranuar edhe 250 studentë për një program.

Kjo autonomi e fakulteteve duhet respektuar me dispozita të veçanta dhe të mbetet çështje e fakulteteve, e jo ndërhyrje e Ministrisë.

Së treti, në dispozitat me Agjencinë e Akreditimit duhet të konkretizohen qartë që këto dispozita ta rregullojnë çështjen e ankimimit të bartësve të arsimit të lartë për procesin e vlerësimit dhe promovimit. Kështu, siç është, i gjithë procesi mbyllet në kuadër të Agjencisë së Akreditimit. Praktika ka treguar parregullsi të skajshme. Kjo e bën edhe më të domosdoshme, sepse në Kosovë e kemi vetëm një agjenci të licencuar, kështu adresa e ankimimit mund të jetë edhe Ministria e Arsimit.

Unë nuk do të hyjë tek nenet që janë të shumta, që mendoj se edhe ne si Aleancë, por edhe ekspertët që i kemi në Grupin tonë, do të kontribuojnë shumë që ky ligj të jetë ligj i cili do të rregullojë shumë çështje. Në fund, unë e përgëzoj hartuesin e Projektligjit në përpjekje, edhe pse modeste. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Koalicionit Kosova e Re, deputeti Muhamet Mustafa!

MUHAMET MUSTAFA: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

I nderuar dhe të nderuar zëvendëskryeministër dhe ministër, ju po qëndroni hala barabarë me deputetë!

Më lejoni që edhe unë në fillim të përshëndes në emër të Koalicionit për Kosovë të Re këtë projekt – draft, i cili mund të konstatoj me kënaqësi se është më cilësor se sa ligji ekzistues, e ky draft është

shumë më cilësor se sa disa drafte që kanë qarkulluar gjatë vitit të kaluar. Edhe kjo tregon se kur ka kohë të punohet në draftet e ligjeve dhe iu jepet një kohë më e madhe, mund të nxirren ligje edhe më të mira.

Veçanërisht janë me rëndësi instrumentet që janë siguruar për sigurimin e cilësisë në arsimin e lartë, e ky është faktori kryesor për integrimin e arsimit të lartë në hapësirën arsimore evropiane dhe më gjerë.

Në këtë drejtim ne e përshëndesim avancimin në këtë draft lidhur me zgjedhjen e Bordit menaxhues të Agjencisë Kosovare për Akreditim nga Kuvendi, megjithëse ne sugjerojmë që jo vetëm ratifikimi të bëhet nga Kuvendi, por të bëhet zgjedhja nga Kuvendi dhe të precizohen kualifikimet që duhet të kenë anëtarët e Bordit, mundësisht të shpallet një konkurs publik që ata të konkurrojnë dhe të kemi një panel që do t'i zgjedh, edhe Ministria të ketë po ashtu të drejtën që të propozojë, por në këtë mënyrë ne do të sigurojmë pavarësinë e këtij institucioni, e pavarësia e tij është esenciale sepse, përkundër disa rezultateve që janë mbërri në procesin e akreditimit që e kemi pas në të kaluarën, problemi se Agjencia Kosovare e Akreditimit nuk ka qenë e pavarur, por ka qenë nën ndikimin shumë të madh të Ministrisë, e mos të them edhe individëve të caktuar, i ka devalvuar rezultatet e këtij institucioni, sepse shpeshherë vendimet e kësaj agjencie kanë qenë arbitrare dhe nuk i kanë respektuar vendimet e ekspertëve ndërkombëtarë. Kështu që, për t'i ikur kësaj, ne duhet të sigurojmë, domethënë, kredibilitet dhe të sigurojmë pavarësi të këtyre ekspertëve, sepse rezultatet e akreditimit nuk duhet të varen prej partisë në pushtet, nuk duhet të varen prej ndikimeve politike, por duhet të sigurojnë, domethënë, në mënyrë kontinuele sigurinë.

Gjithashtu, unë kisha sugjeruar, domethënë, në emër të Grupit Parlamentar, që të shikohen nenet lidhur me kriteret për universitet dhe kolegji u universitar. Nuk është me rëndësi çka ka prodhuar ose sa ka prodhuar universiteti, por çfarë potencialesh ka. Në rend të parë, këtu duhet të jetë kriter prodhimi i kërkimor, a ka fuqi kërkimore një institucion për t'u quajtur universitet dhe çfarë prodhimi i kërkimor ka? Në këtë drejtim duhet të shihen domethënë edhe përvojat e definimit të universiteteve gjetiu, sepse janë disa të pazakonshme, tri fusha doktorate, pesë fusha doktorate... Me rëndësi është sa profesorë dhe çfarë kërkimesh ka ai, kështu që mendoj se mund të gjendet një formulim edhe më i mirë, edhe pse ka një avancim këtu.

Çështja tjetër është se kanë mbetur të pa përkufizuara cilat kriterë duhet t'i plotësojë një institucion i arsimit të lartë për të qenë kolegji, për të qenë akademi, për të qenë institut apo fakultet?

Tash për tash, e kemi atë situatë që jemi, në qoftë se quhesh kolegji, ti nuk është me rëndësi a ke cilësi a nuk ke cilësi. Kjo është absurde për arsye se diploma e kolegjit është e barasvlershme me diplomën e universitetit, prandaj edhe dikush kush quhet kolegji, duhet t'i ketë disa potenciale, duhet të ketë disa resurse që e garanton cilësinë, ose institut ose akademi. Për të mos i lënë, domethënë në mënyrë arbitrare cakimin e institucioneve dhe me çfarë titulli janë, është mirë që të përkufizohen disa kriterë minimale që duhet t'i plotësojnë edhe këto institucione.

Licencimi i bartësve të arsimit publik. Me të drejtë, ky është neni 15, në paragrafin paraprak thuhet që duhet të paraqitet elaborati dhe licencimi një vit përpara, para se të fillojë, por një paragraf më vonë thotë: “mundet edhe gjatë atij viti”. Kjo sigurisht ka të bëjë, reflekton praktikën e Universitetit të Prizrenit.

Mendoj se ky paragraf duhet të hiqet, sepse pikërisht kur nuk kemi një elaborat, kur nuk e kemi analizuar një vit para se të fillojë nuk janë krijuar resurset, kur universitetet krijohen shpejt e shpejt, e mos të them edhe në çfarë situatash elektorale, atëherë ato nuk mund, nuk kanë një perspektivë, ose kanë perspektivë shumë të vështirë. Prandaj, këtë paragraf ndoshta është mirë për ta këqyrë edhe një herë.

Gjithashtu, meritojnë pak kujdes gjykatat kompetente të definohen mirë, se për mos definim se cila gjykatë është kompetente, në qoftë se një bartës i arsimit ankohet, ka krijuar probleme në komunikime shpeshherë të institucioneve me Ministrinë dhe me Qeverinë. Prandaj, për të gjitha këto procedura administrative të shikohen edhe një herë udhëzimet lidhur me ankesat.

Dhe, në fund, edhe unë mendoj se neni 36 lidhur me hyrjen në fuqi, duhet të shikohet sepse, për shembull, nuk ka arsye që neni 2.3, i cili flet për lirinë akademike ose për mosdiskriminimin, të prolongohet hyrja e tij në fuqi vonë, por sigurisht është një gabim teknik, kështu që edhe një herë të shikohet dhe në përgjithësi ne e mbështesim këtë projekt dhe dëshirojmë që të zhvillohet një bashkëpunim edhe me grupet parlamentare dhe me Ministrinë që ky projekt të bëhet edhe më i mirë. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të SLS, Sasha Millosavljeviq e ka fjalën!

SASA MILOSAVLJEVIĆ: Hvala, gospodine predsjedavajući!

Mi smo kao Poslanička grupa analizirali Nacrt zakona o visokom obrazovanju i utvrdili smo da postoje određene manjkavosti, koje ćemo nastojati da uklonimo kroz funkcionalne i stalne komisije, i podržaćemo ovaj nacrt zakona u načelu.

KRYESUESI: Faleminderit! „6+“, deputetja Muera Shinik!

MUFERA ŞINIK:

Sayın Başkan, sayın bakanlar ve milletvekilleri,
Kosova Cumhuriyetinde Yüksek Öğretim Yasa Tasarısını okuduktan sonar değerlendirme yaptığımızda amaç ve prensiplerin tespit edildiği görülmektedir. Sadece yasanın yazılış şeklinde ayan olmayan bazı durumlar görülmektedir.

Yasa tasarısının 3. maddesi 1. noktasına göre Kamu-Özel ortaklık konusunda ve 5. madde her anlamda ayrımcılığa (diskriminasyona) karşı hazırlandığı ve her alanda aynı olanakların yarattığı görülmektedir.

Aynı Yasa tasarısının 7. maddesinin 4. noktasına göre Üniversite Bordu'nun en az 5 en çok 9 üyeden oluşarak cinsiyet eşitliği vurgulanırken topluluk hakları hiçe sayılmış. Üçü Uluslar arası uzman olmalı deniliyorken çoğunlukta olmayan toplulukların temsilcisi yani Bord'da yer alması da vurgulanmalıdır.

Öyle ki Üniversite Bordu'nda en az bir üyenin çoğunlukta olmayan topluluk temsilcisinin olması ve dönüşümlü bir şekilde toplulukları temsil etmesi gerekir.

18. madde 2. noktaya göre İdari Kurula Bakanlığın atadığı üyelerde de topluluk temsilcileri görülmemektedir, bu da Yasada ivedilikle işlenmelidir.

Tüm bunları vurgularken 6. maddenin 1.6 noktasına göre Avrupa ve Uluslar arası Yüksek öğretim alanında İngilizce dilinin kullanımı konusunda desteğin sunulması, Bolonya çerçevesine ve Lizbon Konvansiyonuna göre KEBTB (MASHT) ya da Kosova Akreditasyon Ajansı Kuralları belirlemektedir. Bu kurallar belirlenirken, topluluk dillerinde öğrenim gören öğrencilere öncelik tanınmalıdır.

Bu maddenin devamında öğrenciler, uzaktan eğitime tabi tutulmalıdır. Öyle ki uzaktan eğitim yapılırken öğrencilerin anadillerinde tercüme sağlamak ve aynı zamanda çoğunlukta olmayan topluluk öğrencilerine kendi anadillerinde uzaktan eğitim sağlama olanağı bu Yasayla garanti altına alınmalıdır.

Bunlarla birlikte Komisyona sunacağımız amandamentler (değişiklik önerileri) ile ek katkımız sayesinde de 6+ Parlamenter Grubu olarak Kosova Cumhuriyetinde Yüksek Öğretim Yasa Tasarısının Birinci okunuşunu kabul etmekteyiz. Teşekkür ederim!

KRYESUESI: Faleminderit! Deputetja Emilia Rexhepi!

EMILIA REDŽEPI: Zahvaljujem, predsedavajući!

Poštovana zamenica premijera,

Poštovani ministri,

Kolege poslanici,

Mi svakako podržavamo Nacrt zakona o visokom obrazovanju, ali gospodine ministre Buja, molimo vas da obratite pažnju oko nostrifikacije diploma pripadnika manjinskih zajednica, koje svakodnevno imaju probleme sa administracijom u Ministarstvu za obrazovanje. Posebno bih istakla problem multietničkog univerziteta u Prizrenu, gde i dalje nemamo adekvatnih stručnih smerova na bosanskom i turskom jeziku, to je pravo manjinskih zajednica i pravo na poštovanje i upotrebu službenog jezika.

Takođe, zbog kvaliteta nastave i položaja studenata na edukativnom fakultetu u Prizrenu, u nastavi na bosanskom jeziku, poštovani ministre, zahtevamo od vas da Ministarstvo za obrazovanje izvrši jednu unutrašnju reviziju stručnog kadra, koji mimo zakona drže određene stručne predmete već osam godina, a protiv nekih profesora već su podnete i krivične prijave. Zahvaljujem!

KRYESUESI: Faleminderit! Deputeti Arsim Bajrami e ka fjalën!

ARSIM BAJRAMI: I nderuari, zoti nënkryetar!

E nderuara zëvendëskryeministre,

I nderuari ministër,

Të nderuar kolegë,

Fillimisht, më lejoni të komplimentoj ministrin për propozimin e një drafti shumë më të avancuar, e tha edhe profesor Mustava, shumë më të avancuar se sa draftin që e kemi pasur në debate publike para dy viteve, ku të gjitha institucionet e arsimit të lartë kanë qenë të përfshira në debatin për këtë draft dhe kanë pasur mjaft vërejtje.

Koncepti i arsimit të lartë i zhvilluar në këtë projektligj është jashtëzakonisht i qartë, do të thotë përmbahen të gjitha ato standardet më të reja të procesit të Bolonjës, që është një proces evropian, proces i krijimit të zonës evropiane të arsimit të lartë dhe pothuaj se ky projektligj është ndërtuar dhe hartuar plotësisht në këtë frymë, që është frymë e re e shkrimit të ligjeve për arsimin e lartë.

Ligji përmban pak a shumë të gjitha standardet e arsimeve me tri nivele, arsimeve me sistem të kredive, të qarkullimit të kredive dhe sistem të integritetit të Kosovës brenda hapësirës evropiane, edhe pse pranimi i Kosovës në proceset e Bolonjës, fatkeqësisht, për shkak të mosnjohjes së Kosovës nga pesë shtetet e Bashkimit Evropian po vonohet padrejtësisht për shkaqe politike. Kështu që nuk do të jap shumë komplimente për ligjin, por do të jap disa sugjerime. Kam disa ide që do t'i zhvillojmë edhe në leximin e dytë dhe mendoj se këtë ligj do ta bëjnë shumë më të mirë dhe do ta bëjnë shumë më jetëgjatë, sepse ne kemi nevojë për një sistem afatgjatë të zhvillimit dhe projektimit të arsimit të lartë.

Çështja e parë, do të thotë ideja e këtij ligji është qarkullimi dhe mobiliteti i dy elementeve. Qarkullimi dhe mobiliteti i studentëve dhe qarkullimi dhe mobiliteti i diplomave ekonomike, i njohurive akademike brenda hapësirës evropiane. Kjo është jashtëzakonisht pozitive, po para se ne të integrohemi në hapësirën evropiane, duhet të krijojmë qarkullim dhe mobilitet në hapësirën kombëtare të arsimit të lartë, duke pasur parasysh pluralitetin e bartësve të subjekteve të larta.

Ligji është mjaft liberal sepse krijon një konkurrencë të lirë të shumë bartësve të arsimit të lartë dhe heq monopolet që kanë ekzistuar në arsimin publik dhe është një ligj i hartuar edhe në frymën e ekonomisë së tregut, kështu që ne duhet të punojmë edhe pak në ligj që të sigurojmë këtë mobilitet dhe qarkullim brenda hapësirës kombëtare, në mënyrë që të mos kemi situata ku ne garojmë për pranimin e diplomave në Vjenë e Paris, e kemi problem për t'i pranuar në mes veti. Do të thotë, që të gjitha subjektet e arsimit të lartë që licencohen dhe akreditohen nga Ministria, duhet të jenë të barabartë dhe të sigurojmë këtë sistem që do të funksionojë.

Një element shumë i rëndësishëm në këtë ligj, që duhet pasur kujdes, është sigurimi i mekanizmave të përhershëm të vlerësimit të brendshëm dhe të jashtëm. Ligji i ka këto institucione, por ne duhet të insistojmë që këto institucione të forcohen, sidomos vlerësimi i brendshëm të kualitetit, sepse tani kemi shumë bartës të arsimit të lartë, kemi një hiperbolizim të studentëve, numër të madh të studentëve dhe jo pse s'ka nevojë Kosova, por s'ka kapacitete, dhe ka ardhur koha që të instalojmë mekanizma dhe të sigurojmë një mësim cilësor, një mësim kombëtar me mësimin që ofrohet në universitete evropiane, krahas mekanizmave të jashtëm që është Agjencioni i Akreditimit, të krijojmë edhe mekanizma të brendshëm për matjen e performancës së kualitetit të mësimin dhe performancës së mësimdhënësve. Ekzistojnë tani mekanizma evropianë si bëhet kjo dhe ne do t'i fusim në ligj, jo ta lëmë çështje të voluntarizmit, do universiteti publik apo privat të ketë mekanizma të matjes së cilësisë, por ta fusim një mekanizëm të detyrueshëm që ky sistem të funksionojë. Po e zëmë, në krejt universitetet evropiane në përfundim të një kursi, në përfundim të një kurikuli, gjithmonë studentët janë ata që e matin performancën e kursit dhe të profesorit dhe ai është kusht që ai kurs të ofrohet edhe në vitin e ardhshëm dhe ne ta bëjmë detyrim, sepse ne kemi e provuar një gjë të tillë, por po shkon vështirë në universitetin publik.

Çështja e dytë, që është jashtëzakonisht e rëndësishme, është çështja e barazisë së plotë të bartësve privatë dhe publikë. E fola, është kohë e konkurrencës edhe në sferën e arsimit dhe të sigurojmë

kushte të lira që këto të futen në garë, në mënyrë që duke u futur në garë të sigurojnë edhe kualitet dhe cilësi.

Një çështje shumë e rëndësishme të bartësit e arsimit publik, është vendosja e mirë e ekuilibrit, e asaj që është interes publik dhe liri akademike. Balancimi i qartë, cili është interesi publik i Republikës së Kosovës në arsimin e lartë dhe deri ku ky interes publik mund të ndrydhë apo mund të ngulfatë lirinë akademike.

Mendoj se ne duhet të jemi të qartë që universitetet publike, është e vërtetë se duhet t'i kontrollojmë sa i përket cilësisë, kualitetit të programeve, por kur të licencohen, akreditojnë, të kalojnë, duhet t'u afrojmë autonomi të plotë akademike dhe akademi financiare.

Interesi i Republikës së Kosovës tek universitetet publike është i qartë. Shteti ka nevojë për kuadro të përgatitura, ka nevojë për kuadro që i kontribuojnë edhe shtetit, edhe zhvillimit ekonomik dhe janë bartëse dhe ky interes mbrohet në mënyrë legjitime, sepse e kontrollon mënyrën e themelimit, e ratifikon mendimin, por në pjesën tjetër duhet dhënë plotësisht liria akademike që nga zgjedhja e rektorit, që nuk është plotësisht liri akademike, e deri te segmentet tjera të qeverisjes së brendshme.

Ne e kemi pa këtë pozicion se si qeveriset universiteti, qeveriset në një anë përmes lirisë akademike të Këshillit Drejtues dhe rektorit dhe në anën tjetër përmes ndërhyrjes së Qeverisë dhe institucioneve tjera në Këshill Drejtues.

Unë kam një ide, që do ta propozoj në formë amendamenti, do t'ia jap edhe Komisionit, që rektori të zgjidhet drejtpërdrejt nga universiteti, nga mësimdhënësit dhe studentët. Në minimum 20 universitete i kam vëzhguar zgjedhjet për zgjedhjen e drejtpërdrejtë të rektorit dhe ka qenë një sistem jashtëzakonisht funksional, ku të gjithë studentët aktivë, të gjithë profesorët dhe punëtorët e zgjedhin rektorin e universitetit dhe ai pastaj merr legjitimitet të plotë, sepse zgjedhja e rektorit përmes Këshillit Drejtues, duhet pranuar, gjithmonë është problematike. Është problematike dhe ne e kemi parë që nga pas lufta ka pasur probleme në zgjedhjen e rektorit dhe mendoj se duhet ta bëjmë edhe për faktin që ne po e legjitimojmë zgjedhjen e drejtpërdrejtë të zyrtarëve të lartë publikë, siç është zgjedhja e presidentit, pse të mos ta bëjmë këtë edhe në postet e larta akademike. Unë e kam një ide, do ta zhvilloj dhe do ta bëj një amendament, të cilin do ta diskutojmë në leximin e dytë.

Dhe, një çështje e fundit, që u diskutua edhe në diskutimet tjera, kryesisht kjo çështje ka të bëjë me involvimin e Kuvendit të Kosovës në sferën e arsimit të lartë. Kemi tri, katër pozicione, nene ku kërkon involvimin dhe pëlqimin e Kuvendit. E para, kemi pozicionin ku ne ratifikojmë çfarëdo themelimi apo shuarje të institucionit të arsimit të lartë dhe, e dyta, kemi një involvim ku statutet e universiteteve publike ratifikohen në Kuvend.

Deri sa për të parën herë, edhe unë mendoj se duhet të funksionojë, për të dytën kam rezerva, sepse nuk e di se çfarë kishte për të thënë Kuvendi për statutin e universitetit. Në qoftë se mendojmë që statuti është akti më i lartë, me të cilin shprehet autonomia e universitetit, atëherë përse ne ta kontrollojmë universitetin se çfarë statuti po bën, kështu që t'ia lëmë statutin plotësisht Universitetit të Prishtinës.

Dhe, e fundit, pavarësia menaxheriale. Pra, ne duhet t'i thejmë klishtë e funksionimit të universiteteve. Universiteti nuk është vetëm konsum i buxhetit, nuk është diçka që merr nga shteti,

po ne duhet ta promovojmë një frymë menaxheriale edhe në qeverisjen e universitetit, duke i stimuluar universitetet që të prodhojnë të hyra, që me programe atraktive ato të konkurrojnë në treg dhe t'i menaxhojnë ato të hyra. Unë mendoj se vetëm 40% ne duhet ta investojmë universitetin publik, jo më tepër se 40%. Në qoftë se ne insistojmë që universiteti të ketë buxhet vetëm nga Qeveria, ai kurrë nuk do të zhvillohet me programe hulumtuese, me programe studiuëse.

Vet kam ligjëruar një vit në universitetet amerikane dhe ata faktikisht po ulin tani në 25% financimin e universiteteve publike dhe po i detyrojnë universitetet që të hartojnë programe që janë kompatible me ekonominë, që janë të kërkuara nga tregu i punës dhe si të tilla të futen në konkurrencë, mendoj se diçka të tillë edhe duhet të bëjmë, do t'i japim mundësi që universiteti të prodhojë të hyra, jo vetëm nga taksat e studentëve, jo vetëm nga taksat që paguajnë ata që duhet më së paku të ngarkohen, por nga programet hulumtuese, nga lidhja me biznesin, nga lidhja me ekonominë, sepse tani e kemi ekonominë private, kemi ndërmarrje specifike të cilat, po e zëmë, në fushën e IT-së, në fushën e teknologjisë informative mund të porosisim nga universiteti që ta përgatit një kutikulë apo një program të kuadrove për IT, për sisteme të komunikimit modern dhe ata do ta financojnë dhe në këtë mënyrë ne do të futemi edhe në atë komponenten hulumtuese të universiteteve.

Marrë tërësisht, ligji është shumë më i mirë se sa ka qenë në diskutime publike. Unë e uroj ministrin dhe mendoj se me leximin e dytë, me disa korrektime, ne po bëjmë një ligj të mirë, i cili do të mundësojë zhvillimin afatgjatë të këtij sektori shumë të rëndësishëm të Kosovës.

KRYESUESI: Faleminderit! Deputeti Armend Zemaj e ka fjalën!

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit, kryesues!

Zëvendëskryeministër,

I nderuar ministër,

Faktikisht, shumëçka u tha nga kolegët e mi deputetë, edhe pse po thuhet se është një ligj i mirë i përgatitur, me të gjitha këto vërejtje dhe të gjitha këto mangësi, nuk mendoj se do të dalë mirë në fund.

Prandaj, po i theksoj edhe nja dy çështje të cilat mbetën, për të mos përsëritur shumëçka që u tha.

Brengë e imja e përgjithshme është se mendoj që këtij ligji apo me këtë ligj nuk është bërë një analizë të bartësve të arsimit të lartë në Kosovë, sa kemi nevojë, e kemi nevojë për to, a kemi kuadër përkatës dhe cili është kualiteti i tyre për të ofruar konkurrencë me universitetet evropiane apo studentët tanë të jenë të barabartë.

Personalisht edhe unë jam për barazinë në mes universitetit privat dhe universitetit publik, por më lejoni t'i theksoj dy dispozita të cilat bien ndesh dhe mund në të ardhmen të ketë edhe keqpërdorime edhe afera korruptive dhe devalvim të këtyre vlerave.

E para, është neni 11 pika 2, ku thuhet apo theksohet: “kompanitë private, fondacionet dhe trustet mund të themelojnë institucione të arsimit të lartë”. Sipas kësaj dispozite, të zotëri ministrit, unë shpreh dyshime, sidomos para fushatave zgjedhore, apo në të ardhmen, aq sa kemi qebaptore, kioska, mund të kemi edhe institucione të arsimit të lartë, nëse iu lejojmë edhe kompanive private, fondacioneve të ndryshme dhe trustet themelojnë institucione të arsimit të lartë.

Dhe, e dyta, një çështje brengosëse që është dhe që mund të ketë abuzim me fondet publike, është neni 20, pika 4, ku thuhet: “Ministria mund të sigurojë fondet publike për bartësit privat të arsimit të lartë”. Kjo është shumë e kuptueshme dhe shumë njerëz qeveritar punojnë edhe në arsimin privat dhe sipas interesave personale, kjo dispozitë hap mundësinë për keqpërdorime të mëdha që të bartin mjetet publike, nënkuptohet fondet publike të universitetit e miqve, të afërmeve, jaranëve, familjarëve e të tjerëve. Prandaj, këto dy nene mendoj që duhet të eliminohen apo të rishikohen nga komisioni përkatës funksional, në mënyrë të amendamenteve që t’i shmangemi keqpërdorimeve dhe devalvimit të vlerave institucionale në të ardhmen. Faleminderit shumë!

KRYESUESI: Faleminderit! Deputetja Xhevahire Izmaqi e ka fjalën!

XHEVAHIRE IZMAQI: Faleminderit, kryesues!

Do të jem shumë e shkurtër!

I nderuar ministër,

E nderuar zëvendëskryeministër,

Konsideroj se ky projektligj që e kemi para veti me pak ndërhyrje është një zgjidhje optimale që do t’i ofrojmë institucionit të lartë arsimor në vend. Ndërsa, konsideroj që vërejtjet dhe komplimentet që i dhanë kolegët e mi, ia vlejnë që të jemi me të vërtetë optimistë për hartimin e këtij projektligji.

Konsideroj që ligji po ashtu hap mundësinë për studime dhe dije gjatë gjithë jetës dhe kjo është një gjë pozitive, duke i hequr pra kufizimet në moshë për t’u regjistruar apo kualifikuar.

Ligji mundëson krijimin, zhvillimin, mbrojtjen dhe transmetimin e njohurive përmes mësimdhënies dhe punës kërkimore shkencore, garanton cilësinë e studimeve, diplomat e dijes, të barasvlershme me universitetet ndërkombëtare. Gjithashtu, me këtë ligj rritet përgjegjësia e institucioneve të arsimit të lartë në Republikën e Kosovës, në ngritjen cilësisë së studimeve dhe hulumtimeve shkencore, ku Kosova do të bëhet konkurrense e dijes në vendet e familjes evropiane.

Si anëtare e këtij komisioni, konsideroj se përpara një projektligji të tillë komisioni ynë do të gjejë të gjitha kapacitetet e nevojshme që të diskutohet me të gjithë akterët dhe palët e interesuara deri në detaje në fazat e më tutjeshme të punimit të tij.

Ky ligj do t’iu shërbejë universiteteve publike dhe private në vendin tonë, andaj është e nevojshme që të marrë edhe mendimin e stafit akademik të studentëve dhe të stafit administrativ për të gjetur me të vërtetë optimalen në shërbim të institucionit tonë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Deputetja Bakalli e ka fjalën!

AURORA BAKALLI: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar deputetë,

Unë do të jem gjithashtu shumë e shkurtër dhe do të ndalem vetëm në dy çështje në këtë ligj.

Në ligj në disa vende vërehet se bëhet promovimi i studimeve jashtë vendit. Kështu, për shembull, neni 6 pika 1.6, thotë se “bëhet promovimi i lëvizjes së studentëve dhe të personelit brenda zonës evropiane dhe asaj ndërkombëtare të arsimit të lartë, si dhe inkurajimi për përdorimin e gjuhës angleze për mësim krahas gjuhës zyrtare”. Mirëpo, në ligj nuk parashihet në mënyrë specifike

askund barasvlerësimi i diplomave të fituara jashtë vendit. Këtu patjetër duhet të përcaktohet me ligj edhe afati kohor për të kthyer përgjigjen kandidatit dhe ky afat nuk duhet të jetë mbi 3 muaj. Sepse, nga përvoja në të kaluarën, dihet se ka pasur raste kur kandidatët të cilët kanë marrë diploma të arsimit të lartë jashtë vendit, kanë qenë të detyruar të presin me vite të tëra për t'u bërë nostrifikimi në vendin tonë, brengë kjo të cilën e ngriti edhe deputetja Emilija Rexhepi.

Në ligj vetëm shkarazi përmendet çështja e barasvlerësimit dhe atë në nenin 3, te emërtimet në këtë ligj, pika 1.9, ku përmendet Nariku, ku definohet si nocion, ndër të tjera thuhet, domethënë krejt shkarazi, se vendimet mbi njohjen dhe barasvlerën merret nga Këshilli shtetëror për njohje, por më tutje në ligj nuk trajtohet askund kjo çështje dhe mendoj që duhet t'i jepet një rëndësi, në mënyrë që vërtetë të inkurajohen studentët që të studiojnë jashtë vendit e jo të dekurajohen pasi që do të kenë pengesa të mëdha administrative për njohjen e diplomave të tyre.

Dhe çështja tjetër të cilën do të dëshiroja ta përmend këtu, është në nenin 26, lidhur me titujt dhe gradat e personelit. Mendoj se këto nuk janë të precizuara mirë.

Një gjë tjetër më konkrete, në të cilën do të ndalesha, është se në disa vende ceket se kandidati duhet të dëshmojë me një sfond të suksesshëm të publikimeve në revista me recension ndërkombëtar, kështu që është shumë pozitive, mirëpo vlerësoj se këtu duhet të parashihet me ligj kuantifikimi i publikimeve ndërkombëtare të cilat paraqiten si pikë kyçe për avancimin në grada akademike. Do të thotë, nëse themi një sfond, është një term shumë i përgjithshëm dhe mbetet në mëshirën e komisionit recensues që të vendosë për kandidatin. Të themi, nëse janë dy kandidatë dhe njëri prezanton me një publikim ndërkombëtar, ndërsa tjetri me dhjetë, mbetet në mëshirën e komisionit recensues që të vendosë për cilin kandidat të përcaktohet.

Në mënyrë që të evitohen keqpërdorimet, subjektiviteti dhe në shërbim të objektivitetit dhe të transparencës, propozoj që të parashihet me ligj se duhet të bëhet kuantifikimi me poentim i punës së kandidatit dhe avancimi të bëhet në këtë bazë.

Shpresoj se këto dy vërejtje do të merren parasysh në punën të cilën do ta bëjë gjatë amendamentimit komisioni gjegjë. Ju faleminderit!

Diskutim i dorëzuar me shkrim

BLERTA DELIU-KODRA: I nderuar, kryesues,

Të nderuar ministra,

Kolegë të respektuar deputetë,

Me Projektligjin për arsimin e lartë në Kosovë, bartësve publikë të arsimit të lartë – universiteteve dhe institucioneve tjera të arsimit të lartë iu krijohet bazë e shëndosh ekuivalente me vendet me arsim të avancuar.

Dispozitat e këtij projektligji përcaktojnë shkallën e autonomisë së bartësve të arsimit të lartë, rregullojnë çështjen e licencimit, akreditimit dhe vlerësimit të cilësisë, çështjen e titujve dhe diplomave, strukturën qeverisëse dhe parimet themelore të financimit. Madje, me këtë projektligj është rregulluar mirë dhe qartë çështja e krijimit, licencimit dhe akreditimit të bartësve privatë të arsimit të lartë, përfshirë këtu edhe çështjet e gradave të personelit, pranimit të studentëve, pagesës së shkollimit, tarifave etj.

Projektligji me 38 nenet e tij, sa ka gjithsej, konsideroj se do t'i kontribuojë ndërtimit të një sistemi bashkëkohor të arsimit të lartë në Kosovë, si promotor i zhvillimit të vendit dhe i përpjekjeve integruese. Dokumenti që kemi përpara i cakton kreditë sipas sistemit evropian të transferit dhe akumulimit të kredive SETAK (ECTS) – një vit akademik - 60 kredi, sipas Kornizës Evropiane të Kualifikimeve.

Po ashtu, për hartimin këtij projektligji shihet se janë konsultuar strategjitë e zhvillimit të arsimit të lartë të disa vendeve të botës dhe dokumentet e Procesit të Bolonjës.

Sipas këtij projektligji, tashmë është definuar qartë rruga e ligjshme për marrjen e diplomës universitare (Bachelor) pas një studimi ekuivalent prej së paku tre vjetësh studimesh të rregullta (normalisht diku ndërmjet 180 dhe 240 kredi SETAK) është qartësuar fitimi i titullit Master apo Doktor, duke precizuar edhe rolin e akreditimit të Kosovës (AAK), e ngarkuar me vlerësimin dhe promovimin e cilësisë së arsimit të lartë në Kosovë, duke siguruar që standardet dhe cilësia e arsimit të lartë në Kosovë të plotësojnë kërkesat dhe pritjet e Asociacionit Evropian për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë (ENQA).

Gjithashtu, me këtë projektligj rregullohet enkas përgjegjësia për universitetin publik në gjuhën serbe, në pajtim me Ligjin në fuqi të Republikës së Kosovës.

Krejt në fund, të nderuar deputetë, mendoj se miratimi i Projektligjit për arsimin e lartë në Kosovë, në parim hap rrugë për amendamentimin eventual dhe procedimin për miratim final, që do të jetë edhe një kontribut yni për plotësimin e hapësirës së ligjeve që rregullojnë arsimin e të gjitha niveleve. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Buja, a dëshironi fjalën? Zoti Buja e ka fjalën, ministri!

MINISTRI RAMË BUJA: Shumë shkurt, siç thotë një fjalë popullore: kam përshtypjen apo po më pëlqen mua të them që pas atit të mirë, çohet pluhur shumë! Është fjala e Ligjit, nuk po bëjmë fjalë për personin. Edhe juve ju falënderoj shumë, sinqerisht, sepse e di që jeni lodhur dhe do ta respektoj lodhjen tuaj, unë s'dua të zgjas fare, por dua t'ju falënderoj sinqerisht për kontributin që e keni dhënë, sepse nuk domethënë që unë që e kam dhënë sot ekspozenë këtu për ligjin, jam i kënaqur me atë që është bërë në projektligj dhe unë jam shumë i bindur që barabar kemi dëshirë që ky ligj të bëhet i mirë, sepse ministri Buja është sot dhe nesër nuk është, e nuk do të jetë, andaj Ligji për arsimin e lartë dhe ligjet tjera...

(Ndërhyrje)

Jo për nesër, për pasnesër e kam! Besoj se të gjithë duam që të kemi një ligj të mirë dhe funksional. Ju them atyre kolegëve që sugjeruan që ka nene dhe mbase edhe pjesë tjera që krijojnë rubinete shpërdorimi, m'i mbyllni ato rubinete, ju lutem, se ju jeni kompetent për atë punë, mua dhe të tjerët që mund të vijnë pas. Unë jam shumë mirënjohës, nëse ju do të veproni ashtu. Mos leni rubinete, ku dikush mund të pijë ujë në kroin e tjetrit, sepse jam shumë mirënjohës për këtë.

Unë sinqerisht jam i gëzuar për faktin që ky projektligj, që do ta bëni ju ligj të mirëfilltë, ka dhënë konditat elementare dhe bazike që të krijohet mundësia e ngritjes së cilësisë mësimore dhe studimore.

Gjëja tjetër, jam shumë i interesuar, siç jeni edhe ju, të mos bëjmë lojë e plojë me njerëzit tanë! Kemi bërë universitete, kemi bërë kolegje, që s'ka hiq kurrkund emërtim kolegji dhe në asnjë ligj, e ne i quajmë në emër të atit, të birit e të shpirtit e s'e di të dikujt dhe nuk duhet kjo të ndodhë absolutisht!

Ka kolegë të mitë këtu dhe unë vet që kemi ligjëruar në publikun dhe në privatin dhe nuk mund të jemi dysh andej e këndeje, o duhet të jemi të njëjtë, sepse ne themi me Kushtetutë, kemi thënë me ligje, themi me të gjitha aktet tona që s'do të kemi qytetarë të diskriminuar, e bëjmë akademik të diskriminuar, nuk guxon të ndodhë! Jam shumë i përkushtuar si ministër, bashkë me ju, që të bëjmë qytetarë të ndërgjegjshëm, të ditur, të ndershëm, veprues, aktivë dhe efektivë, kështu që po ju them sinqerisht, kjo është tendenca e ligjit.

Unë jam i sigurt që është më i mirë se sa draftet tjera, assesi as afër së përkryerës. Urdhëroni dhe ofrone këtë përkryeshmëri ju, ju lutem, dhe unë do të jem zbatuesi më fanatik i këtij ligji, që do ta bëni ju bashkë me mua. Faleminderit shumë!

KRYESUESI: Të faleminderit! Të nderuar kolegë, në vazhdim kërkohet deklarimi me votim për miratim në parim të Projektligjit për arsimin e lartë të Republikës së Kosovës.

Në seancë marrin pjesë 69 deputetë. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim, votojmë tani:

Konstatohet se me 60 vota “për”, 2 abstenime, 2 “kundër”, Kuvendi miratoi në parim Projektligjin për arsimin e lartë në Republikën e Kosovës.

Kërkohet nga komisioni funksional dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit, ta shqyrtojnë Projektligjin dhe Kuvendit t'i paraqesin raportet me rekomandime.

A do të vazhdojmë, apo ta bëjmë një pauzë, për një 10 minuta, sa për nga një kafe. Zoti Beqiri, në emër të Grupit Parlamentar, për procedurë, a si e keni hallin?

ISMET BEQIRI: Zoti kryesues,

Unë propozoj që, meqenëse janë raporte, i kemi edhe një 3, 4 pika që janë të rëndësishme, unë propozoj që edhe një pikë ta shqyrtojmë sot dhe katra tjera t'i vazhdojmë nesër. Arsyeja është e thjeshtë. Unë po e jap propozimin, sepse ne këtë e kemi punë, po punë që duhet të ketë edhe produktivitet në kuptimin e asaj se vërehet që është një lodhje te shumica ose te disa deputetë, s'po paragjykoj. Unë propozoj në emër të Grupit që ta shqyrtojmë edhe një pikë dhe i kemi edhe katër pika tjera të rendit të ditës dhe to mund t'i vazhdojmë nesër në orën 10:00.

KRYESUESI: Mirë! Zoti Beqiri, në emër të Grupit Parlamentar, fole. Gjysma e Grupit Parlamentar janë kundër teje, me sa po e shoh unë, për këtë propozim, jo kështu kundër.

(Ndërhyrje)

Në rregull! Është një kërkesë, ta quajmë mocion i Grupit Parlamentar të LDK-së, tani duhet të deklarohen edhe të tjerët. Grupi Parlamentar i PDK-ës, në qoftë se jeni për ta ndërprerë menjëherë, nuk e vazhdojmë më tutje.

Zoti Muja, në emër të Grupit Parlamentar, ty të autorizuan apo si? Zoti Shaip Muja e ka fjalën, në emër të Grupit Parlamentar!

(Ndërhyrje)

Shiko, po ngjanë kjo që nuk po të pranon as mikrofonin, Shaip. Prandaj, jepja fjalën...

SHAIP MUJA: Zoti kryesues,

Kam një vërejtje. Për vendime të tilla pyetet partia, e cila është në mazhorancë, jo partia e cila është në opozitë. Prandaj, ne mund të merremi vesh me grupet parlamentare a do të vazhdojmë a jo. Ne po mendojmë të vazhdojmë deri në orën 18, e mandej çka të mbetet, mund të diskutojmë edhe nesër.

KRYESUESI: Mirë, është mendim i Grupit Parlamentar. Grupi Parlamentar “Vetëvendosje”? Zotit Ymeri, fjalën!

VISAR YMERI: Kryesues, ne mendojmë që po që se e ndërpresim seancën, e po duket se duhet ta ndërpresim, për shkak se nuk është e mundur që t’i përfundojmë të gjitha këto pika, atëherë do ta ndërpresim tash. Pra, mos të procedojmë me asnjë pikë dhe të vazhdojmë nesër me pikat që na kanë mbetur.

KRYESUESI: Grupi Parlamentar i AAK-së?

ARDIAN GJINI: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Unë e diskutova me të gjithë deputetët e Grupit Parlamentar. Deputetët tanë nuk janë lodhur dhe janë të gatshëm të vazhdojnë të punojnë. Kush është lodhur, mund ta ndërpresë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Koalicioni Kosova e Re, Muzejene Selmani!

MUZEJENE SELMANI: Zoti kryesues, faleminderit për fjalën! Kërkoj që, meqë është një lodhje të të gjithë deputetët, nesër të vazhdojmë seancën.

KRYESUESI: Faleminderit! SLS?

SAŠA MILOSAVLJEVIĆ: Hvala, gospodine predsjedavajući!

I mi smatramo da nema potrebe da održimo još jednu tačku danas, a da ostale da ostavimo sutra. Ako prekidamo sednicu danas, najbolje je da prekidamo odmah. Sada odmah, znači, da nema još jedna tačka, nego da prekidamo sada sve i da sutra nastavimo!

KRYESUESI: Faleminderit! “6+”?

RASIM DEMIRI: I mi smo mišljenja da sutra nastavimo!

KRYESUESI: Faleminderit!

Kush është për ta ndërprerë tani seancën dhe të vazhdojë nesër?

Kush është “kundër”?

Atëherë, shumica janë për ta ndërprerë. Faleminderit!

Nesër vazhdojmë në orën 10:00.

E premte, më 22. korrik 2011, vazhdimi i seancës
Drejton seancën: zoti Xhavit Haliti, nënkryetar i Kuvendit

KRYESUESI: Të nderuar deputetë,

Të nderuar zëvendëskryeministra,

Vazhdojmë punimet e seancës plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës, të filluar më 21 korrik, për pikat e mbetura.

Në sallë janë 60 deputetë dhe mund të fillojmë me shqyrtimin e ligjeve, shqyrtimin e pikës së katërmbëdhjetë të rendit të ditës, që është:

**14. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin
e Ligjit për përfitimin e ish zyrtarëve të lartë**

Në bazë të nenit 56 të Rregullores së Kuvendit, komisioni funksional ka shqyrtuar Projektligjin dhe Kuvendit i ka paraqitur Raportin me rekomandimet për shqyrtim, në parim.

Ftoj zëvendëskryeministrin, zotin Hajredin Kuçi, që në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës para deputetëve të Kuvendit të prezantojë dhe arsyetojë Projektligjin.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI HAJREDIN KUÇI: Faleminderit, zoti nënkryetar i Kuvendit,

Të nderuar deputetë,

Të nderuar anëtarë të Qeverisë,

Zonja dhe zotërinj,

Më lejoni që në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës të paraqes para jush Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Numër 03/L-001 për përfitimin e ish zyrtarëve të lartë.

Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e këtij ligji për përfitimin e ish zyrtarëve të lartë është miratuar nga Qeveria e Kosovës më 29.6.2011. Nevoja për nxjerrjen e këtij projektligji qëndron në përmbushjen e obligimeve kushtetuese, ku ka për qëllim edhe plotësimin dhe ndryshimin e këtij projektligji për përfitimin e ish zyrtarëve të lartë.

Derisa me Ligjin e theksuar më lart për përfitimin e ish zyrtarëve të lartë, ish zyrtarë të lartë janë konsideruar ish kryetari i Kuvendit, ish kryeministri dhe ish kryetari i Gjykatës Supreme. Me hyrje në fuqi të Ligjit 03/L-021 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës dhe të Ligjit Numër 03/L-225 për Prokurorinë e shtetit dhe duke marrë parasysh rëndësinë dhe pavarësinë e këtyre dy institucioneve të rëndësishme, në kategorinë e ish zyrtarëve të lartë përfshihen edhe ish kryetari i Gjykatës Kushtetuese dhe ish kryeprokurori i shtetit.

Në këtë drejtim, me projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit 03/L-001 për përfitimin e ish zyrtarëve të lartë tanimë mund të konsiderohen ish kryetari i Kuvendit, ish kryeministri, ish kryetari i Gjykatës Kushtetuese, ish Kryeprokurori i shtetit dhe ish kryetari i Gjykatës Supreme.

Hartimi dhe miratimi i këtij projektligji do të rezultojë në përmbushjen e objektivave për ish kryetarin e Gjykatës Kushtetuese, për ish Kryeprokurorin e shtetit dhe ish funksionarëve të tjerë, duke përfshirë të drejtat që iu takojnë atyre për të ushtruar funksionin e tyre të pavarur, të plotë dhe në realizimin e obligimeve që ata i kanë.

Po ashtu, me këtë projektligj synohet që të kompletohet infrastruktura ligjore në përmbushjen e detyrimeve kushtetuese në rregullimin e kësaj materie juridike.

Ne duhet ta theksojmë këtu që ky projektligj ka për synim që të funksionojnë edhe më mirë institucionet kryesore të shtetit, por dua të them publikisht, prej 6 ish zyrtarëve të lartë, 3 vijnë nga sistemi i drejtësisë, që nënkupton se në këtë vend i jepet përparësi forcimit të rendit dhe ligjit, po ashtu edhe me këtë projektligj.

Ju ftoj që me vërejtjet dhe me sugjerimet tuaja ta miratoni në parim dhe pastaj Qeveria do të japë kontributin e vet në grupe punuese. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Tani sipas Rregullores, fjalën e ka kryetari i Komisionit funksional për Legjislacion, deputeti Arben Gashi.

ARBEN GASHI: Faleminderit, nënkryetar!

Komisioni funksional e ka trajtuar këtë ndryshim në këtë projektligj dhe e ka dhënë dritën e gjelbër që të vazhdohet në procedim, pastaj shohim në diskutimet tjera që bëhen në komision në leximin e dytë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Përfaqësuesit e grupeve parlamentare. Në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës, deputeti Idriz Vehapi! Nëse doni ta ndërroni, ndërrone. Ma kanë dhënë emrin tënd! Regjia, zotit Vehapi fjalën!

IDRIZ VEHAPI: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar ministra,

Zëvendëskryeministra,

Të nderuar deputetë,

Edhe Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike e ka shqyrtuar Projektligjin dhe po ashtu është pajtuar që ky projektligj të procedohet më tej dhe të miratohet në parim dhe po ashtu në komisionin e përhershëm të jepen edhe vërejtjet edhe sugjerimet, edhe amendamentet e nevojshme që ky projektligj të marrë formën e plotë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, deputeti Armend Zemaj!

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit, kryesues!

Përhëndetje për zëvendëskryeministrat!

Të nderuar kolegë deputetë,

Edhe ne e kemi shqyrtuar këtë plotësim-ndryshim të këtij projektligji për përfitimin e ish zyrtarëve të lartë dhe si kategori kushtetuese apo ajo mangësi që ka qenë në Ligjin për Gjykatën Kushtetuese, mendojmë që të japim përkrahje në parim, edhe pse janë bërë disa ndryshime shumë të vogla në aspektin e amendamentimit.

Për neve shqetësuese është dhe do të kishim dashur edhe një përgjigje nga Qeveria e Republikës së Kosovës, sepse nga vlerësimi i ndikimit buxhetor paraqiten rreziqet financiare të cilat nuk i ka paraparë Qeveria as në Kornizën afatmesme të shpenzimeve dhe konkretisht në faqen e fundit të Projektligjit rekomandohet nga Ministria e Financave, vetëm nëse përcaktohen mjetet paraprakisht për këtë kosto buxhetore, atëherë rekomandojmë për miratim, përndryshe rekomandojmë për mosmiratim.

Kjo tregon qartë një konfuzitet në mes dikastereve qeveritare dhe ne do të dëshironim ta kemi këtë sqarim. Përndryshe, ndoshta e ka paraparë edhe Qeveria e Kosovës se nuk do të ketë ndërrim të kryetarit të Gjykatës Kushtetuese që të përfitojë nga kjo dhe sigurisht edhe në bazë të këtyre viteve, edhe të mandatit, por edhe në bazë të Kornizës afatmesme të shpenzimeve. Faleminderit shumë!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar „Vetëvendosje“, fjalën e ka nënkryetari i Kuvendit, Glauk Konjufca.

GLAUK KONJUFCA: Deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës,
Kur e kam lexuar Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për përfitimin e ish zyrtarëve të lartë, e kam kuptuar se kryeministri Hashim Thaçi po përgatitet për pensionim politik.

Tash kur kryeministrit po i afrohet fundi politik, ai ka filluar t'i ndryshojë ligjet për t'ia bërë vetes vendin sa më luksoz, atëherë kur nuk do të jetë më aty ku është.

Arsyet janë të qarta, nëse e lexojmë Ligjin. Ky është një ligj që e tregon makutërinë e zyrtarëve tanë shtetërorë.

Në nenin 3 pika 1, Ligji specifikon se zyrtari i lartë pas përfundimit të mandatit e merr 70% të rrogës së tij, të cilën e merrte për derisa e ushtronte funksionin e tij përkatës. Kjo do të thotë se ish zyrtarët e lartë do të marrin paga mbi 1.000 euro edhe pasi të mos e ushtrjnë funksionin që e kishin ushtruar më parë. Dhe nëse ky përfitim merret si pension, ashtu siç duhet të merret, ma merr mendja mua, atëherë kemi të bëjmë me pensione të ish zyrtarëve të lartë që janë 30 herë më të larta se sa ato të qytetarëve të varfër të Kosovës. Por vetëm kjo nuk iu mjafton zyrtarëve tanë të lartë.

Në nenin 3 pika 4, ata kujdesen që edhe pas përfundimit të mandatit të tyre ta kenë asistentin e tyre të lartë, truprojnë dhe vozitësin e tyre që paguhet nga buxheti i Republikës së Kosovës.

Me të drejtë qytetarët e Kosovës do të thonin që kjo është për t'ia tepruar. Por kjo nuk është e gjitha, sepse zyrtarët tanë të lartë janë përkujdesur edhe për më shumë se kaq.

Në nenin 3 pika 7 thuhet se ata do t'ia kenë 1.200 euro në vit për harxhime të telefonit dhe të internetit. Përfitimet e tilla na tregojnë për një mendësi absolutiste të zyrtarëve tanë të lartë. Ata nuk duan dhe nuk mund të shkëputen nga luksi që e shfrytëzojnë gjatë mandatit, prandaj e vazhdojnë këtë jetë edhe pas përfundimit të mandatit. Pra, ata janë të përrpirë nga një jetesë e tillë, ata janë të

robëruar nga luksi. Në këtë mënyrë, ata nuk po bëhen ish zyrtarë të lartë, por po vazhdojnë të jenë zyrtarë të lartë.

Kryeministri po përgatitet për pension, por ai nuk po dëshiron që pas mandatit të përfundojë para drejtësisë. Dhe kjo mund të kuptohet nëse e lexojmë projektligjin në fjalë. Sepse këtyre tri figurave ekzistuese që janë ish zyrtarë të lartë, pra kryeministri, ish kryeministri, ish kryetari i Kuvendit dhe ish kryetari i Gjykatës Supreme, ky Projektligj po ia shton edhe dy tjerë. Pra, kryeprokurorin e shtetit dhe kryetarin e Gjykatës Kushtetuese. Pra, kryeprokurorin, ai i cili do të duhet ta hetonte kryeministrin për korrupsion dhe kryetarin e Gjykatës Kushtetuese, ai i cili po ia interpreton kryeministrit imunitetin. Flitet pra për Enver Hasanin dhe Ismet Kabashin.

Lëvizja „Vetëvendosje“ është kundër këtij projektligji dhe kundër këtij ligji. Pra, kundër këtij projektligji që ligjin ashtu të keq e bën edhe më skandaloz.

Ky ligj dhe projektligj është shembulli më i mirë dhe ilustrativ se si zyrtarët tanë politikë institucionet e Kosovës i kanë kthyer në salltanete personale, në vend që t'i trajtojnë si instrumente shërbyese për qytetarin.

Prej krejt gjërave që i kanë bërë zyrtarët tanë politikë, më së miri duket se e kanë bërë këtë punën e përfitimeve personale.

Po të ishin kujdesur ata për pensionet e qytetarëve, ashtu qysh përkujdesen për të vetat, mirëqenia e qytetarit do ishte përmirësuar dukshëm.

Halli kryesor nuk është këtu se 5 veta, plus stafi i secilit prej tre vetash, që bëjnë gjithsej 20 veta, do të marrin këto përfitime. Halli është se kjo është vetëm maja e Icebergut. Kjo është vetëm simptomë e asaj se në çka janë kthyer institucionet tona politike dhe publike. Ato janë kolonizuar nga mijëra njerëz që e keqpërdorin paranë tonë publike, duke filluar prej lapsave kimikë, e deri te Postë-Telekomi i Kosovës, Ferronikeli apo Trepça.

Për të gjitha këto arsye që i theksova, ne do të votojmë kundër këtij projektligji, të tillë që e shpërfaq mendësinë e korruptuar të zyrtarëve tanë të pangopur me paranë tonë publike.

KRYESUESI: Faleminderit! Unë ju kisha lutur, kush i ka futur kartelat e kolegëve, le t'i heqin. Nuk është fer që njerëzit që s'janë këtu, të jenë prezent, të prezantuar në tabularin e Kuvendit se janë prezent në seancë.

(Ndërhyrje)

Atëherë, Sekretaria, atyre që i kanë lënë prej dje, ua hiqni kartelat! Në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, deputeti Ardian Gjini!

ARDIAN GJINI: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Mendoj se ajo që bën ky ligj, është se i shton, siç u tha edhe më përpara, edhe dy zyrtarë që vijnë nga pjesa e gjyqësorit të Kosovës në listën e zyrtarëve të lartë të shtetit. Mendoj se fillimisht duhet t'i shohim edhe praktikat tjera, të vendeve tjera.

Ne do ta votojmë ligjin, në parim, për shkak se mendojmë se duhet të harmonizohet me ligjet tjera dhe me Kushtetutën, siç u tha më herët, mirëpo mendojmë po ashtu se duhet të shihen praktikat tjera në shtuarjen, në rritjen e kësaj liste.

Nuk mund të ecim vetëm ashtu dhe të shpikim vet. Ligji i cili është i miratuar, i cili është në fuqi në fakt deri më tani, i parasheh ato që thuhet dhe mendoj se një ditë me siguri se duhet të ndërrohen, është e vërtetë, por tani ne duhet ta harmonizojmë këtë ligj.

Mendoj se po ashtu në komision duhet të shikohet edhe titulli i Projektligjit dhe te çështja e rreziqeve financiare, mendoj se nuk janë edhe aq të mëdha meqenëse nuk i kanë futur edhe zëvendëskryeministrat në listën e zyrtarëve të lartë të shtetit, për shkak se janë shumë, sikur t'i kishin shti, atëherë me siguri se na kishte dalë pak telashe.

Sidoqoftë, edhe një herë, në parim do ta votojmë ligjin, mirëpo mendojmë se para se të vjen në lexim të dytë, duhet të shihen praktikat tjera dhe ndoshta Komisioni për Legjislacion duhet të shohë se cilat janë praktikat e vendeve tjera dhe ta amendamentojë ligjin ndoshta në të ardhmen në tërësi. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar Koalicioni Kosova e Re, deputetja Muzejane Selmani!

MUZEJANE SELMANI: Faleminderit zotëri kryesues!

Përsëritet për dy zëvendëskryeministrat dhe gjithë deputetët në këtë seancë!

Koalicioni për Kosovën e Re e ka shqyrtuar Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për përfitimin e ish zyrtarëve të lartë. Duke marrë parasysh edhe fjalët e kolegut nga Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, shihet se është bërë një përmirësim apo një plotësim-ndryshim në këtë projektligj, mirëpo në esencë duhet të përballemi me ligje të cilat janë në rajon dhe duke marrë parasysh se janë vetëm disa plotësim-ndryshime, atëherë Koalicioni për Kosovë të re do t'i japë përkrahje këtij projektligji dhe gjatë amendamentimit në Komision mund t'i japë vërejtjet e veta. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Grupi Parlamentar SLS, Jasmina Zhivković.

JASMINA ŽIVKOVIĆ: Zahvaljujem!

Poslanička grupa SLS nema konkretnih primedbi na ovaj nacrt zakona, te će s toga podržati isti. Hvala!

KRYESUESI: Grupi Parlamentar „6+“, Albert Kinolli!

ALBERT KINOLLI: Faleminderit, i nderuari nënkryetar!

Të nderuar zëvendëskryeministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Grupi Parlamentar „6+“ e ka shqyrtuar këtë projektligj për fitimin e ish zyrtarëve dhe pas vlerësimit të komisionit përkatës se Projektligji ka bazë kushtetuese, si dhe i plotëson kushtet e caktuara me rregullat e hartimit të legjislacionit, ne si Grup parlamentar „6+“ e japim miratimin në parim, kurse kontributin tonë dhe vërejtjet tona do t'i japim në punën tonë në komisionin përkatës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Tani radhën e kanë deputetët, sipas paraqitjes. Fjalën e ka deputeti Hydajet Hyseni!

HYDAJET HYSENI: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Zonja e zotërinj deputetë,

Të nderuar zëvendëskryeministra,

Duke ju përshëndetur ju, më lejoni që të përshëndes edhe sjelljen në Kuvend të këtij ligji, ç'është e vërteta me një ndryshim të vogël, por për mendimin tim të arsyeshëm. Ligji nuk rregullon gjithë këtë çështje, por vetëm e plotëson atë, siç është thënë edhe në titull, dhe unë do të dëshiroja ta nënvizoja si një praktikë të mirë që ligjet që plotësojnë një ligj të mëparshëm edhe të titullohen saktë – ligj për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit, e tjera. Dhe jo si ndonjë ligj që na ka ardhur, që është ligj i ri, në të vërtetë është plotësim i ligjit të mëparshëm dhe në këtë mënyrë krijohet konfuzion i tërë.

Ky plotësim ligji, vërtet rregullon një mangësi dhe nuk mund të pritet tash prej këtij ligji që ta shqyrtonte gjithë materien. Si të tillë, mendoj se duhet mbështetur.

Megjithatë, unë do të dëshiroja të shtroj si vërejtje amendamentin 3 të këtij ligji, i cili kërkon zëvendësimin e shprehjes, si thuhet, „funksionar“ me shprehjen „zyrtar“. S' do të kishte ndonjë arsye për ta marrë fjalën, po të mos ishte diçka më shumë se sa terminologji.

Së pari, shprehja “zyrtar” nuk e mbulon gjithë materien që synon ligji. Sepse, fjala është vetëm për funksionarët e lartë, do të thotë, dhe jo për çdo zyrtar. Më saktë do të ishte që shprehja “funksionar” të zëvendësohej me “zyrtarë të lartë”. Por druaj se as kjo nuk do ta mbulonte, do të thotë nuk do ta kishte kuptimin e saktë që mëtohet të ketë me këtë.... Është fjala për funksionarët e lartë shtetërorë.

Angazhohem që gjithë kjo çështje të shqyrtohet në komision, dhe e theksoj këtu në diskutim, në parim, që nuk jam në komisionin përkatës, që të gjendet shprehja adekuate dhe për mendimin tim, shprehja adekuate do të ishte “bartësit e funksioneve të larta shtetërore”, që të mos lejohet konfuzioni me zyrtarë, ku hyjnë të gjithë zyrtarët dhe janë shumë, as me zyrtarë të lartë, ku hyjnë zyrtarë që janë zyrtarë të lartë, por nuk përfshihen në këtë çështje.

Besoj se komisioni do ta bëjë këtë dhe si të tillë e përshëndes! Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Konjufca, jeni paraqitur prapë për fjalë apo ka mbetur i shtypur... Shtype edhe një herë! Në rregull! Deputeti Shaip Muja e ka fjalën!

SHAIP MUJA: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar zëvendëskryeministra,

Unë e kisha një vërejtje për bontonin e sjelljes në mënyrë të rrugaçërisë, që përdoret bina e Parlamentit për kryeministrin, Qeverinë, autoritetet. Ne bisedojmë...

KRYESUESI: Të lutem, Shaip, vetëm për ligjin. Mos na futni në debate tjera!

SHAIP MUJA: Parafolësi këtu nuk fliste për ligjin, por fliste për personat që nuk janë prezentë dhe atakohet edhe Partia Demokratike që e ka dërguar si kryeministër dhe këta nuk mund të sillen si pararojë e vegjëlisë, sepse koha i ka demontuar këto dhe po ju propozoj që të bëjmë një leksion se si

respektohet dhe funksionon shteti, po jo të përdoret bina këtu dhe të keqpërdoret për marketing politik ose për identifikim të kualitetit të vet të cilët s'kanë kurrfarë kualiteti, as intelektual, as njerëzor.

KRYESUESI: Faleminderit! Deputeti Halit Krasniqi e ka fjalën!

HALIT KRASNIQI: Faleminderit kryesues!

I nderuar zëvendëskryeministër,

E nderuara zëvendëskryeministre dhe ministre,

Të nderuar kolegë deputetë,

Me këtë rend të ditës kemi mbuluar një zbrazëti dhe kemi plotësuar një obligim kushtetues. Nga komisioni raporti është bërë jashtëzakonisht mirë, i mbështetur dhe i ndërtuar edhe në aspektin gjuhësor jashtëzakonisht mirë.

Bëhet fjalë për privilegje të pesë ish zyrtarëve, që kanë bazë kushtetuese, dhe bëhet fjalë edhe për një staf, që nuk do të mund të thoshim se bëhet fjalë për privilegjet e stafit, por për marrëdhëniet ... punës së tyre. Dhe deri këtu nuk ka asgjë të keqe, përkundrazi, veç e plotësojmë një obligim kushtetues. E keqja është këtu. Sot as dje, dhe as këtë javë, as javën tjetër, nuk është dashur të futej në rend dite kjo problematikë, kjo fushë, kjo çështje për arsye se është sikur t'i hedhësh benzinë zjarrit.

Neve përjashta kemi kërkesa të veteranëve të luftës dhe kemi për kaq kohë të gjatë, që jemi duke bërë përpjekje maksimale të gjitha institucionet, madje edhe ato ndërkombëtare që t'i plotësojmë kërkesat e tyre, por që tani ta shtrojmë në rend dite një çështje që është obligim kushtetues, por që ka konotacion politik për momentin, është sikur t'i hedhësh benzinë zjarrit.

Unë nuk e shoh shumë, e shoh non-sens, nuk e shoh shumë me sens këtë rend të ditës dhe prandaj këtu tani i jepet shansi gjithkujt që do të krijojë amulli, nebulizitet, që do të acarojë situatën, i jepet shansi.

Unë për veten time, e përkrah, e mbështes edhe formulimin që e ka bërë komisioni dhe ndërtimin e rekomandimit, por e bëj një vërejtje për administratën e Kuvendit, dhe atë shumë miqësore, dashamirëse dhe rekomandoj që në të ardhmen të jetë më e ndjeshme ndaj situatave jashtë këtij Kuvendi. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Administrata nuk ka asnjë përgjegjësi në këtë rast. Ka ardhur nga rruga normale e prezantimit të ligjit, andaj administrata nuk ka asnjë faj. Detyrë e ka ta sjell për ta shqyrtuar në Kryesi dhe në Parlament. Nuk ka tjerë të paraqitur. Më falni, zoti zëvendëskryeministër Kuçi e ka fjalën!

ZËVENDËSKRYEMINISTRI HAREDIN KUÇI: Faleminderit, zoti nënkryetar i Kuvendit!

Faleminderit, të nderuar deputetë, për kontributin tuaj, natyrisht edhe për vërejtjet dhe sugjerimet.

Ne pajtohemi plotësisht me disa prej vërejtjeve që u dhanë këtu. Më lejoni që t'i theksoj vetëm dy-tri gjëra që u theksuan, ndoshta kanë nevojë për përgjigje nga Qeveria.

E para, esenca e këtij projektligji është forcimi dhe pavarësimi i funksionimit të institucioneve. Nëse dikujt ia siguron, një prokurori të shtetit dhe sot ky propozim është për dy veta nga sistemi i drejtësisë. Ish kryeministri, ish kryetari i Kuvendit, ish kryetari i Gjykatës Supreme dhe ish presidentët e kanë pasur të rregulluar me ligj këtë çështje dhe i kanë gëzuar privilegjet dhe janë duke i gëzuar. Por, këtu është fjala për dy njerëz nga sistemi i drejtësisë.

Unë e kam takuar mendimin e “Vetëvendosjes” gjatë fushatës elektorale për forcimin e prokurorit të shtetit. Dhe zoti Konjufca, po e jap informatën sot. Me insistimin tim ka hy edhe ish prokurori i shtetit të jetë në këtë vi dhe një prokuror i shtetit në një vend ku sundon rendi dhe ligji, është njeriu më i rrezikuar dhe ai ka nevojë për një siguri, edhe gjatë punës, po edhe më pastaj.

E dyta, e keni dhënë një slogan që duhet për t’ia dhënë xhipin e mirë. Dhe unë ia kam dhënë xhipin e Ministrisë sime. Xhipin që e kam pasur në dispozicion unë si ministër dhe ia kam dhënë pasaportën diplomatike. Jo ta bëj të varur, në kuptimin e punës së tij për Qeverinë, por për ta pavarësuar në tërësi nga Qeveria. Dhe cili do njeri që në këtë vend i ka këto privilegje, duhet të jetë i pavarur për punën e tij, për familjen e tij, për sigurinë e tij. Dhe sot dy njerëzve të sistemit të drejtësisë jemi duke ua dhënë këto privilegje, të tjerët i kanë pasur. Dhe kjo ka ndodhur, besoj se është sinjal i mirë.

Çështje tjetër, që u përmend, pak sa në shkaka po e them: Këtu flitet për privilegje të atyre njerëzve, zoti Konjufca, nëse ke vëmendjen, se me ju po diskutoj, të atyre njerëzve të cilët nëse marrin paga nga buxheti i konsoliduar i Kosovës, nuk do të kenë paga dhe unë po ju them që kryeministri aktual mund të vazhdojë të jetë kryeministër ose do të marrë pagë pa merak në cilindo pozicion që do ta ketë. Kështu që, mos u shqetësoni si do të jetë pozicioni i tij. Por, prizmi duhet të shihet në këtë rast, jo me figurat aktuale që e udhëheqin vendin, por me figurat, pa i hequr fotografitë, me figurat që e udhëheqin shtetin.

Pajtohem plotësisht me propozimin që e dha zoti Hyseni, i cili tha se duhet të quhen “zyrtarë të lartë shtetërorë” dhe këtu kemi të bëjmë me 5 veta, përfshirë edhe Presidentin 6. Tre janë nga sistemi gjyqësor, 3 të tjerë janë – një nga Kuvendi, një nga Qeveria dhe një - Presidenti apo Presidentja e Republikës. Zoti Gjini e tha pak në shaka, nëse lypin zëvendëskryeministrat, lypin edhe ministrat, zoti Gjini, kështu që e kemi lënë pa asnjërin. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në mbledhje janë prezentë ... Debat i është kryer. Kur e merr fjalën, i fundit është ministri, nuk ka replikë, se tani po bëhet... Edhe dje s’ua kam dhënë fjalën, nuk ua jap! Është me Rregullore, i fundit flet ministri, ruajuni mos u përllani më herët. Kurrkush as juve s’ju ka replikuar. Ke pasur kohë, Alma, më herët! E ke pasur kohën për t’u paraqitur, nuk je paraqitur.

(Reagim)

Jo, jo. Është kryer. Kur ta kryen ministri, kryhet ajo punë. Kryhet debati për ligjin dhe jemi në votim. Në mbledhje janë prezent 78 deputetë. Bëhemi gati për votim dhe votojmë tani.

Më falni, 83 deputetë janë të pranishëm!

Faleminderit! 60 vota “për”, 12 “kundër”, 4 “abstenime”, konstatoj se Kuvendi miratoi, në parim, Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për përfitimin e ish zyrtarëve të lartë.

Kërkojmë nga komisioni funksional dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit ta shqyrtojnë projektligjin dhe Kuvendit t'i paraqesin raportet me rekomandime.

Pika e pesëmbëdhjetë e rendit të ditës:

15. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për kërkesat teknike për produkte dhe vlerësim të konformitetit

Në bazë të nenit 56 të Rregullores së Kuvendit, komisioni funksional ka shqyrtuar Projektligjin dhe Kuvendit i ka paraqitur raportin me rekomandime për shqyrtim, në parim.

Ftoj ministren e Tregtisë dhe Industrisë, zonjën Mimoza Kusari-Lila që në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës, para deputetëve të Kuvendit ta prezantojë dhe arsyetojë projektligjin.

MINISTRJA MIMOZA KUSARI-LILA: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar deputetë,

I nderuari zëvendëskryeministër,

Më lejoni që në emër të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, si bartëse e këtij projekti legjislativ, të përmend shkurtimisht arsyet për hartimin e Projektligjit të ri për kërkesat teknike, për produktet dhe vlerësim të konformitetit, qëllimin dhe fushëveprimin e këtij projektligji, rolin dhe rëndësinë që ka për sistemin e gjithmbarshëm ekonomik të Kosovës.

Në cilëndo shoqëri moderne ekzistojnë shumë produkte të cilat mund të rrezikojnë jetën apo shëndetin e përdoruesve, mjedisin dhe pronën nëse ato janë të projektuara dhe të prodhuara në mënyrë jo të drejtë, prandaj ato duhet të projektohen dhe prodhohen në mënyrë të tillë që të mos shkaktojnë rreziqe apo lëndime për përdoruesit e tyre. Për këtë arsye, Qeveria zhvillon legjislacionin në mënyrë që të mbrojë qytetarët e vet prej rrezikut që vjen nga produktet jo të sigurta.

Ky legjislacion që mbulon fushën teknike, përfshirë edhe rregulloret teknike, mund të jetë i ndryshëm ndërmjet shteteve shpesh për shkak të historisë së zhvillimit të veçantë të rregullativës së tyre dhe të praktikës industriale.

Këto ndryshime teknike shpeshherë shkaktojnë barriera shumë të mëdha tregtare, të njohura si barriera teknike në tregti. Tregu i unifikuar i Bashkimit Evropian është një hapësirë e gjerë ekonomike, ku mallrat, shërbimet, kapitali dhe puna mund të qarkullojnë lirshëm, kurse sigurimi i një prosperiteti të vendit është integrimi në këtë treg.

Në funksion të përmbushjes së obligimeve për të asociuar në mekanizmat e BE-së, duke pretenduar për një qasje të mundshme të tregut unik të BE-së, industrisë kosovare i nevojitet infrastrukturë e nevojshme për të filluar procesin e përafrimit me kërkesat themelore që shtrojnë direktivat e BE-së.

Projektligji në fjalë ka bazë në direktivat e qasjes së re dhe asaj globale, si njëri ndër ligjet horizontale që rregullon produktet e fushës teknike industriale dhe nga i cili dalin shumë akte nënligjore të ashtuquajtura rregullore teknike, të cilat paraqesin njërin ndër elementet e

domosdoshme për integrimet në strukturat evropiane, përfshirë edhe marrëveshjet e ndryshme për pranimin e produkteve industriale në tregun e jashtëm.

Industria e BE-së përfshin 27 fusha të produkteve industriale, të cilat janë të rregulluara me ligj në dy mënyra të ndryshme. Në këto fusha industriale përfshihen: industria kimike, farmaceutike dhe ajo e tekstilit, të cilat përfshihen në qasjen globale, përderisa produktet e industrisë elektrike, makinerisë janë të rregulluara me direktivat e qasjes së re.

Direktivat e qasjes së re, të cilat përbëhen nga dy degë të industrisë, ku nënkuptohet vendosja e o obligueshme e shenjës CE në produkte, pas vlerësimit të konformitetit me të cilin vërtetohet se produkti i plotëson të gjitha kërkesat e një apo më shumë direktivave.

E përbashkëta ndërmjet qasjes së re dhe asaj globale është se ato kufizojnë ndërhyrjen publike ndaj asaj që është kërkesë themelore dhe i krijojnë biznesit dhe industrisë mundësi më të shumta për të përmbushur detyrimet publike.

Rëndësia e Projektligjit për kërkesat teknike dhe produktet në vlerësim të konformitetit është se vendos objektivat kyçe të cilat kanë të bëjnë me shëndetin dhe sigurinë, mbrojtjen e pasurisë dhe mjedisit.

Kërkesat themelore të cilat dalin nga ky projektligj, përcaktojnë qartë dhe saktë rezultatin e dëshiruar që duhet të arrihet me ngritjen e infrastrukturës dhe cilësisë.

Projektligji përmban 39 nene, ku përfshihen rregullimi, qëllimi, fusha e zbatimit, përkufizimet, përcaktimi i kërkesave teknike, detyrimet e prodhuesve, përfaqësuesit e autorizuar, detyrimet e importuesve, detyrimet e distributorëve, rastet në të cilat detyrimet e prodhuesve zbatohen nga importuesit dhe distributorët, identifikimi i subjekteve ekonomike, vlerësimi i konformitetit, trupat për vlerësimin e konformitetit dhe kërkesat të cilat duhet t'i plotësojnë ato; vlefshmëria e dokumenteve të konformitetit të lëshuara jashtë vendit, mbikëqyrja inspektuese, autorizimet e inspektorëve, shpenzimet e procedurës inspektuese, bashkëpunimi ndërkombëtar, verifikimi i produkteve para importit me qëllim të vendosjes në treg; dispozitat ndëshkuese, dispozitat kalimtare, dispozitat shfuqizuese dhe hyrja në fuqi janë pjesa përmbyllëse e këtij projektligji.

Zbatimi i këtij projektligji ndikon drejtpërdrejt në zvogëlimin e dështimeve të produkteve, mbrojtjen e shëndetit dhe sigurisë së njeriut; mbrojtjen e interesave të ligjshme të konsumatorit përmes plotësimit të kriterëve të caktuara; kërkesave themelore të produkteve, si dhe shërbimeve që në ligj e quajmë konfirmimet, respektivisht përputhje e kërkesave të produkteve, shërbimeve dhe sistemeve me standarde dhe kërkesa tjera të specifikimeve teknike. Praktikisht mund të vlerësohen produktet, shërbimet pajisjet dhe sistemet e menaxhimit.

Duke pasur parasysh që një ndër kërkesat themelore për nënshkrimin e Marrëveshjes së stabilizim - asocimit me Bashkimin Evropian është zhvillimi paralel i infrastrukturës kryesore të cilësisë, si bartës që bazë e kësaj infrastrukture është Departamenti i Industrisë, përkatësisht Divizioni për hartimin e rregullave teknike, së bashku me Agjencinë e Standardizimit, Departamentin e Metrologjisë dhe Drejtorinë e Akreditimit, si dhe duke pasur rëndësinë që paraqet ky projektligj për Republikën e Kosovës dhe legjislacionin e saj për ngritjen e infrastrukturës së cilësisë, rekomandoj

që Projektligji për kërkesat teknike, për produkte dhe vlerësim të konformitetit, pas shqyrtimit dhe diskutimit, të miratohet dhe të dërgohet në procedim të mëtutjeshëm. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Sipas radhës, kryetari i komisionit funksional për zhvillim ekonomik, infrastrukturë, tregti dhe industri, zoti Zenun Pajaziti e ka fjalën.

ZENUN PAJAZITI: Faleminderit, zoti kryesues!

Komisioni për Zhvillim, Ekonomi, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri me datën 19.7.2011 në përputhje me Rregulloren e ka shqyrtuar këtë projektligj dhe vlerëson se ky projektligj i plotëson kushtet e parapara me nenin 54 të Rregullores së Kuvendit dhe i rekomandon Kuvendit për miratim, në parim.

Zoti kryesues, edhe në kërkesë të vogël. Komisioni nuk e ka paraparë që do të jetë e shtyrë seanca, për sot, në orën 11:00 e kemi një takim me një delegacion të Shqipërisë, kështu që nëse për mirëkuptim, nëse nuk arrijmë ta shterojmë këtë pikë, anëtarët e Komisionit kanë angazhim në ndërkohë, veç të ju informoj. Faleminderit!

KRYESUESI: S'është e thënë të jenë të gjithë. Shkoni dy-tre përfaqësues dhe e kryeni. Nëse na duheni, ju thërrasim për votim. Në emër të Grupit Parlamentar PDK, deputeti Berat Buzhala.

BERAT BUZHALA: Faleminderit, zoti kryesues!

Grupi Parlamentar i PDK-së e ka shqyrtuar këtë projektligj, i cili është jashtëzakonisht i rëndësishëm dhe është në harmonizim me direktivat e Bashkimit Evropian. Me këtë ligj rregullohet mënyra e përcaktimit të kërkesave teknike për produkte, procedura të vlerësimit të konformitetit me kërkesat e përcaktuara, si dhe nxjerrjen e rregulloreve nga ana e ministrive kompetente.

Ne si grup parlamentar do ta japim kontributin tonë në komisionin funksional dhe në komisionet tjera, duke marrë parasysh se edhe ky është një prej projektligjeve i paraparë në Raportin e progresit dhe shpresojmë se Kuvendi do ta ketë si prioritet në seancat tjera.

Në parim, e mbështesim Projektligjin për kërkesat teknike për produkte dhe vlerësim të konformitetit dhe kërkojmë edhe nga grupet tjera ta bëjnë një gjë të tillë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Grupi Parlamentar i LDK-së, deputeti Hashim Deshishku!

HASHIM DESHISHKU: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Të nderuar, zëvendëskryeministër, jo s'qenka këtu dhe

zëvendëskryeministrja,

Të nderuar deputetë,

Edhe Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës me vëmendje e ka shqyrtuar Projektligjin 04/39 për kërkesat teknike dhe vlerësim të konformitetit.

Sot kemi në shqyrtim njërin prej dokumenteve themelore që ka të bëjë me: sigurinë, mbrojtjen e jetës dhe shëndetin e njerëzve, kafshëve shtëpiake dhe bimëve, mbrojtjen e mjedisit dhe natyrës, mbrojtjen e konsumatorëve dhe përdoruesve të tyre.

Madje, duke pasur parasysh rëndësinë dhe raportet që Ligji për kërkesat teknike, për produkte dhe vlerësim të konformitetit i rregullon në treg, është dashur të kemi më shumë kohë për përpunimin e tij, përkatësisht që miratimi i tij të mos bëhet nën presionin e Raportit të progresit.

Fillimisht dua të them se është ligj i mirë, i cili kompletion kornizën që ka të bëjë me funksionimin e tregut në Kosovë, posaçërisht me sigurinë e mallrave që janë në qarkullim.

Pa marrë parasysh këtë qëllim fisnik që ka, Grupi Parlamentar i LDK-së ka disa vërejtje për këtë ligj.

Ligji i ka disa defekte apo paqartësi, që si të tilla i sjellin hamendje operatorit ekonomik apo konsumatorit.

Për hir të kohës që kemi me grupin e komisionit, unë do ta shkurtoj fjalimin dhe në parim Grupi Parlamentar e përkrah, por vërejtjet që i ka do t'i japë në komisionin tonë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Grupi Parlamentar “Vetëvendosje”, deputeti Kasolli!

AFRIM KASOLLI: Faleminderit, kryesues!

Edhe Grupi Parlamentar i Lëvizjes “Vetëvendosje” e mbështet në parim Projektligjin për kërkesat teknike, për produkte dhe vlerësim të konformitetit. Vërejtjet që i ka lidhur me këtë projektligj, do t'i japë në fazat e më tutjeshme të procedimit të tij në kuadër të komisionit adekuat për të. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Grupi Parlamentar AAK, deputeti Gjini!

ARDIAN GJINI: Faleminderit, zoti kryesues!

Edhe ne mendojmë se është e nevojshme që ta kemi një ligj të këtillë. Është e qartë se provohet që të arrihen dy çështje, që të arrihet edhe të rritet siguria, qoftë nga produktet të cilat mund të hyjnë në Kosovë ose ato vendore dhe në të njëjtën kohë provohet që të eliminohen disa nga barrierat jo tarifore, që u përmendën edhe nga zëvendëskryeministrja.

Përpos që duhet të votohet ligji dhe përpos që edhe ne i kemi disa vërejtje, të cilat me siguri se do t'i paraqesim në komision, mendojmë se përpos këtij ligji i cili është i domosdoshëm, Ministria duhet me më shumë ngulm të merret me standardizim, për shkak se nuk e plotëson të gjithë aspektin e standardizimit vetëm ky ligj.

Ne e kemi parasysh gjendjen të cilën e kemi, kur shumica e kablove, ashtu të themi, instaluese vijnë nga Turqia ose gjysma e elektronikës dhe e plastikës vjen nga Kina dhe tani për një kohë duhet ta standardizojmë me një standard të Bashkimit Evropian shpejt e shpejt, që është një sfidë në Kosovë, po ashtu duke pasur parasysh kualitetin e prodhimeve vendore, mirëpo mendojmë se një synim i tashëm, i menjëhershëm për standardizim do të ndihmojë edhe në implementimin e këtij ligji, se kjo edhe do të jetë një pjesë e diskutimit tonë në komision si ta bëjmë ligjin më shpejt të implementueshëm, për shkak se mendojmë se ka provizione të cilat do të mund të shkaktojnë konfuzitet në implementim të ligjit. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Koalicioni Kosova e Re, deputetja Selmani!

MUZEJENE SELMANI: Faleminderit, zoti kryesues!

Koalicioni për Kosovën e Re e ka shqyrtuar Projektligjin për kërkesat teknike dhe produkte dhe vlerësimin e konformitetit.

Duke marrë parasysh se ky projektligj favorizon edhe vetë qytetarët e Kosovës dhe njëkohësisht bizneset të cilat janë në Kosovë, Koalicioni për Kosovë të Re përkrah në parim projektligjin dhe nëse ka vërejtje në këtë projektligj, do të paraqiten në komisionin parlamentar. U faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Grupi Parlamentar, SLS, Sasha Millosavljeviq.

SAŠA MILOSAVLJEVIĆ: Hvala, gospodine predsjedavajući!

Parlamentarna Grupa Samostalne liberalne stranke je razmatrala Nacrt zakona o tehničkim zahtevima za proizvode i ocenjivanje pogodnosti i mi podržavamo ovaj zakon u načelu, a manjkosti koje ima ovaj zakon, nastojaćemo da eliminišemo kroz komisije.

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Në emër Grupit parlamentar “6+”, deputeti Kinolli!

ALLBERT KINOLLI: Ju faleminderit, i nderuari nënkryetar i Kuvendit!

Të nderuar kolegë,

Grupi Parlamentar “6+” e ka shqyrtuar këtë Projektligj për kërkesat teknike për produktet dhe vlerësim të konformitetit dhe mendojmë se pasi që i plotëson të gjitha kushtet dhe kriteret e nevojshme dhe duke pasur parasysh peshën dhe rëndësinë e këtij Projektligji, ne në parim e mbështesim si të tillë dhe vërejtjet tona do t’i japim përmes komisionit përkatës. Faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Nuk ka tjerë të paraqitur. Lus deputetët që të kthehen në sallë! Nuk kemi kuorum për votim, ose përdore zilen! Po presim një minutë apo dy, ndoshta hyjnë brenda.

Ju faleminderit! Tani besoj që ka kuorum për votim, janë 64 deputetë. Lus regjinë dhe juve, të nderuar deputetë, që të përgatiteni për votim.

Votojmë, tani. Ju faleminderit!

Konstatoj se 56 vota janë “për”, 1 abstenim dhe asnjë “kundër” Me këtë konstatoj se Kuvendi miratoi, në parim, Projektligjin për kërkesa teknike për produkte dhe vlerësim të konformitetit.

Kërkohet nga Komisioni funksional dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit, ta shqyrtojnë Projektligjin dhe Kuvendit t’ia paraqesin raportet me rekomandime. Ju faleminderit!

Pika e 16-të e rendit të ditës:

16. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Rregullimin e tokës

Në bazë të nenit 56 të Rregullores së Kuvendit, komisioni funksional ka shqyrtuar Projektligjin dhe Kuvendit ia ka paraqitur raportin me rekomandime për shqyrtim, në parim.

Ftoj përfaqësuesin e Qeverisë, zëvendëskryeministren Mimoza Kusari Lila që paraqes projektligjin.

ZËVENDESKRYEMINISTRJA MIMOZA KUSARI LILA: Ju faleminderit kryesues!

Të nderuar deputetë,

Në emër të ministrit të Bujqësisë, zotit Blerand Stavilevci, më lejoni të prezantoj edhe në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës, natyrisht, ekspozenë për Projektligjin për rregullimin e tokës.

Rregullim i tokës, siç dihet, është një prej faktorëve kyç në zhvillimin rural dhe si veprim specifik adreson çështjet e fermave të vogla dhe fragmentimin e ngastrave të tokës, me qëllim që të ndihmohet zhvillimi i aktiviteteve bujqësore komerciale. Fragmentimi i tokës bujqësore është proces që ndikon drejtpërdrejtë në degradimin e tokës dhe në uljen e prodhimitarisë bujqësore. Prandaj, përmirësimi i projektimit dhe grupimi i tokave bujqësore rritë mundësinë për shfrytëzimin më racional të tokës ngase shton sipërfaqet punuese të fermave, si dhe ndikon në një menaxhim më të mirë të tyre.

Në këtë drejtim, kontribut të veçantë jep edhe miratimi i këtij projektligji, i cili synon të rregullojë këtë fushë nëpërmjet krijimit të një kornize ligjore të bazuar në parimet e përgjithshme që kanë të bëjnë me ndërmarrjen e masave dhe veprimeve në baza vullnetare për krijimin e parcelave më të mëdha të tokave të punueshme dhe për rregullimin e tokës pyjore.

Vendit tonë deri më tani i ka munguar legjislacioni i përshtatshëm që i referohet procedurave dhe metodologjisë së rregullimit të tokës, përgjegjësisë së institucioneve, kushteve dhe kriterëve për rregullimin e tokës dhe ky Projektligj ka për qëllim që t'i adresojë këto dhe të gjitha çështjet tjera që kanë të bëjnë me krijimin e një strukture të kompletuar ligjore gjithëpërfshirëse dhe përmbajtjesore, të bazuar në praktikën dhe parimet e legjislacionit bazë të Bashkimit Evropian, veçanërisht në principet themelore të përcaktuara me Konventën Evropiane për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut dhe të drejtën pronësore.

Ekonomikë shtëpiake bujqësore dhe pyjore janë të shpërndara dhe kryesisht bazohen në prodhimitarinë ekzistenciale, prandaj për të krijuar ekonomi familjare, komerciale dhe të qëndrueshme, rregullimi i tokave është mjet efektiv dhe është në funksion të shfrytëzimit sa më racional të resurseve tona. Projektligji është plotësisht i arsyeshëm dhe ka rol organizativ dhe funksional për rregullimin e tokës në baza vullnetare. Në përputhshmëri me këtë, Ministria e Bujqësisë ka hartuar strategjinë për konsolidimin e tokës 2010-2020, si dhe planin e veprimit për këtë periudhë kohore 10-vjeçare.

Pas shqyrtimit të këtij projektligji, ju ftoj që ta miratoni dhe ta dërgoni në procedim të mëtutjeshëm. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Tani, sipas radhës, fjalën e ka kryetari i Komisionit funksional për Bujqësi, Pylltari, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, deputeti Nait Hasani.

NAIT HASANI: Ju faleminderit, kryesues!

Përsëndetje kolegë!

Komisionit për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim, Planifikim Hapësinor, ka mbajtur mbledhjen me 11.07.2011 dhe ka shqyrtuar në parim Projektligjin për rregullimin e tokës dhe ia ka dërguar Kuvendit për miratim. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Tani përfaqësuesit e grupeve parlamentare.

Në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, deputeti Niazi Idrizi.

NIAZI IDRIZI: I nderuari kryesues,

E nderuara zëvendëskryeministre,

Të nderuar deputetë,

Ky Projektligj synon rregullimin e tokave për shfrytëzimin racional të tyre me qëllim të rritjes së konkurrencës së fermave, diversifikimit të ekonomisë rurale, shtrimit të të ardhurave dhe rritjen e mirëqenies së njerëzve në zonat rurale.

Në Kosovë kemi një tokë jashtëzakonisht të segmentuar e cila shkon, arrin në 2 milionë ngastra. Po ashtu, në vendin tonë janë rreth 180 mijë ekonomi bujqësore familjare, rreth 80% e tyre kanë nga 0.5 deri në 2 hektarë tokë bujqësore, ndërsa vetëm 0.6% i kanë mbi 10 hektarë tokë. Çdo fermë mesatarisht posedon 2.3 hektarë tokë të punueshme, e cila është e fragmentuar në 6 deri 8 ngastra.

Në shtetet e Bashkimit Evropian kjo mesatare arrin rreth 20 hektarë. Toka e Kosovës ka nevojë që të konsolidohet, në radhë të parë për shkak të këtij segmentimi, i cili ka ndodhur si pasojë e shtimit të popullsisë dhe mungesës së përkushtimit institucional. Nga ky segmentim, mijëra hektarë të tokës bujqësore janë bërë kufi, të cilët shumë shpesh kanë nxitur konflikte familjare me pasoja.

Komostacioni i tokës në Kosovës ka filluar në vitin '83, në territorin e 8 komunave dhe ky projekt është përkrahur nga Banka Botërore. Ajo është zbatuar në rreth 26.000 hektarë dhe ka mbetur i papërfunduar. Asnjë pronë sipas komasacionit nuk ka qenë e regjistruar në dokumentacionin kadastral. Tokat punohen sipas komasacionit, ndërsa pronësia mbetet me të vjetrën. Ka raste kur është prishur komasacioni, prona juridikisht nuk është zgjidhur dhe ka shkaktuar konflikte. Ka ndërtime të paplanifikuara në tokat e përfshira në komasacione të tjera.

Ministria e Bujqësisë nga viti 2008, është në proces të zbatimit të projekteve për përfundimin e këtij komasacioni, i cili në fakt ka shkaktuar shumë probleme. Në anën tjetër, dihet se pa konsolidimin e kësaj toke kaq shumë të segmentuar, nuk mund të kemi ferma të konsoliduara të cilat aktivitetet primar të tyre do ta kenë bujqësinë.

Rritja e nevojës për prodhimin e ushqimit dhe ngritja e çmimeve të prodhimit të bujqësore në tregjet ndërkombëtare edhe në tregjet vendore, janë faktor inkurajues për orientimin e aktivitetëve të njerëzve në këtë sektor. Edhe rritja e interesimit të fermerëve të ri, të cilët po orientohen drejtë prodhimit të bujqësore, e bëjnë këtë sektor të mirë për të ardhmen. Këta fermerë kanë shtuar interesimin dhe janë shumë të informuar për përparësitë që sjell konsolidimi i tokës. Ta marrim, në Pozharan të Vitisë qysh tash kemi kërkesë për konsolidimin e një pjese të tokës nga një grup fermerësh atje. Po ashtu, edhe gatishmëria politike e institucioneve tona për ngritjen e prodhimit të bujqësisë dhe zhvillimin e pronave rurale me premtimin se brenda 2 vitesh do të trefishohet buxheti, janë motive të fuqishme të cilat do ta bëjnë këtë ligj të zbatueshëm.

Grupi i Partisë Demokratike në parim e mirëpret miratimin e këtij ligji dhe si të tillë do ta votojë. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, deputeti Sali Morina.

SALI MORINA: Ju faleminderit, kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Kabinet qeveritar,

Edhe Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike e ka shqyrtuar Ligjin për tokat dhe njëkohësisht ka paraqitur edhe disa vërejtje në kuadër të këtij ligji, të cilin ne në parim do ta mbështesim dhe do të vazhdojmë që të japim kontributin edhe në kudër të komisionit.

Përderisa në këtë ligj, do të thotë, thuhet se qëllimi i këtij projektligji është ndërmarrja e masave dhe e veprimeve në baza vullnetare për krijimin e parcelave më të mëdha dhe rregullimit të tokës bujqësore, pyjeve, tokës pyjore në funksion të shfrytëzimit racional dhe ekonomik, toka bujqësore deri më tani është shfrytëzuar në mënyrë joracionale. Fatkeqësisht, në mungesë të mbrojtjes institucionale, ka vazhduar kjo praktikë duke e zënë tokën bujqësore me ndërtime pa leje.

Arsyeja kryesore e humbjes së tokës është mungesa e planeve zhvillimore, urbane dhe komunale dhe gjithashtu për shkak të moskultivimit, shumë sipërfaqe të tokës së punueshme janë shndërruar në djerrina, të cilat nevojitet kohë për t'u kthyer në gjendjen e mëparshme. Shkaktarët dhe humbjet e përkohshme apo degradimi i sipërfaqeve të tokës dhe ajo që është duke ndodhur aktualisht, janë mihjet sipërfaqësore, eksploatimi i rërës, zhavorrit përmes gurëthyesve dhe seperacioneve të cilët i kemi në një numër shumë të madh, hedhurinat e automjeteve, deponitë, mbeturinat industriale, mbeturinat komunale, procesi i revizionit dhe degradimit, gërryerjet e lumenjve, si dhe shkatërrimi dhe prerja e pyjeve.

Tek neni 5, do të thotë pika 2, thotë se rregullimi i tokës nga paragrafi 1 i këtij neni, nuk mund të zbatohet nëse nuk është nxjerrë plani zhvillimor komunal. Deri më tani, do të thotë në shumë komuna të Kosovës, disa komuna kanë nxjerrë vetëm vendimin për planin zhvillimor, disa komuna kanë filluar do të thotë të merren me hartimin e këtij plani dhe një numër shumë i vogël është që e kanë miratuar planin e zhvillimit komunal, prandaj kërkohet që komunat të miratojnë ose të hartojnë planet zhvillimore dhe përmes këtij ligji do të jepet mundësia që të rregullohet edhe toka bujqësore dhe akterët tjerë të cilët kanë të bëjnë me këtë ligj. Prandaj, edhe një herë, Lidhja Demokratike, Grupi Parlamentar i LDK-së në parim e mbështet dhe do të insistojmë që gjatë Komisionit të merremi me riparimin e neneve të cilat kanë mangësi. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar “Vetëvendosje”, a e do dikush fjalën? Deputeti Liburn Aliu me kartelën e deputetit Kurti.

LIBURN ALIU: Ju faleminderit!

Projektligjin për rregullimin e tokës, Grupi Parlamentar i Lëvizjes “Vetëvendosje” e ka shqyrtuar dhe e përkrah në parim, me qenë se parimisht ky ligj, përmbajtja e këtij ligjit përputhet plotësisht edhe me programin e Lëvizjes “Vetëvendosje”. Pra, konsiderojmë që ky ligj është tejet i nevojshëm me qenë se komasacioni apo rregullimi i tokës është si parakusht për një bujqësi intensive dhe parakusht për zhvillim të Kosovës.

Konsiderojmë që implementimi i këtij ligji, për implementimin e këtij ligji është i nevojshëm një vullnet i jashtëzakonshëm me qenë se gjendja aktuale reale në terren, u fol edhe nga parafolësit këtu, u tregua, është tejet e rëndë. Toka bujqësore është në zvogëlim e sipër, me qenë se ajo uzurpohet dhe shndërrohet, i ndërrohet destinimi në tokë ndërtimore. E njëjta gjë pra ka ndodhur posaçërisht edhe me tokën që veç tanimë ka qenë nën komasacion dhe ka qenë nën sistemin e ujitjes. Pra, përpos që duhet mbrojtur toka dhe përpos që duhet të vazhdohet pra me Ligjin për komasacionin, pra të rriten sipërfaqet të cilat do të jenë, do të rregullohen përmes komasacionit, është e nevojshme që të kemi një vullnet për mbrojtjen e kësaj sipërfaqe të tokës dhe shpresojmë që edhe ky ligj ndikon sadopak në krijimin e një vullneti ndryshe prej këtij që e kemi deri tash në institucione për mbrojtjen e tokës dhe rritjen e sipërfaqes bujqësore në Kosovë. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, deputetja Kadrijaj.

TIME KADRIJAJ: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar deputetë,

Qëllimi i këtij ligji është ndërmarrja e masave dhe veprimeve në baza vullnetare për krijimin e parcelave më të mëdha dhe rregullimin e tokës bujqësore, pyjeve dhe tokës pyjore në funksion të shfrytëzimit racional dhe ekonomik.

Projektligji për rregullimin e tokës është i rëndësisë së veçantë, sepse Kosovës i mungon legjislacioni i përshtatshëm, i cili i referohet procedurave dhe metodologjisë për rregullimin e tokës, përgjegjësitë e institucioneve, kushtet dhe kriteret për rregullimin e tokës, planifikimi, financimi dhe zbatimi i këtij procesi.

Me këtë projektligj, përcaktohen procedurat dhe metodologjia për rregullim të tokës, përgjegjësitë e institucioneve, kushtet dhe kriteret për rregullimin e tokës, planifikimi, financimi dhe zbatimi i këtij procesi. Ky projektligj do të ketë rol organizativ dhe funksional për rregullimin e tokës në baza vullnetare.

Grupi Parlamentar i Aleancës e ka shqyrtuar këtë projektligj dhe në parim do ta përkrahë. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar Koalicioni Kosova e Re, deputetja Suzan Novobrdaliu.

SUZAN NOVOBRDALIU: Ju faleminderit, kryesues!

Grupi Parlamentar Koalicioni për Kosovë të Re e ka shqyrtuar Projektligjin për rregullimin e tokës. Konsiderojmë se është një projektligj i rëndësisë së veçantë. Të njëjtin në parim e përkrahim dhe vërejtjet tona eventuale do t'i japim në komisionet përkatëse të Kuvendit. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar SLS, Sasha Millosavljeviq

SAŠA MILOSAVLJEVIĆ: Hvala, gospodine predsedavajući!

Parlamentarna grupa Samostalne liberalne stranke je takođe razmotrila Nacrt zakona o regulisanju zemljišta. Nemamo nikakvih primedbi i podržaćemo ovaj zakon u načelu. Hvala!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar “6+”, Duda Balje.

DUDA BALJE: Zahvaljujem!

Nakon analize ovog nacrtā zakona, uzimajući u obzir da se njime regulišu procedure i metodologija za uređenje zemljišta, odgovornosti institucija, zatim uslovi, kriterijumi i planiranje, finansiranje i sprovođenje čitavog procesa koji za cilj ima poboljšanje, projektiranje ruralne oblasti, kao i razvoj ekonomskog i racionalnog korišćenja zemljišta, njegovo grupisanje i poboljšanje infrastrukture, zakon podržavamo u načelu i smatramo ga vrlo korisnim. Zahvaljujem!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Deputeti Haki Demolli e ka kërkuar fjalën.

HAKI DEMOLLI: Ju faleminderit, i nderuari kryesues!

E nderuara zonja zëvendëskryeministre,

Të nderuar deputetë të Kuvendit të Kosovës,

Unë vërtetë do të jem i shkurtër dhe do të ndalem vetëm në dy nene të këtij projektligji.

Me nenin 7, përcaktohet dhe rregullohet ekzistimi i Komisionit për rregullimin e tokës. Mund të them se në parim jam kundër ekzistimit të këtij komisioni, sepse në një vend ku ekziston Agjencioni kadastral, në një vend ku ekzistojnë zyrtat kadastrale të komunave, në një vend ku ekzistojnë vetë komunat, besoj se nuk ka nevojë të ekzistojë një komision i tillë, i cili në radhë të parë do të paraqet një dyfishim apo duplikim të organeve që merren me çështjet e tokave dhe njëherësh ekzistimi i komisionit të tillë paraqet edhe shpenzimet shtesë për buxhetin e Kosovës.

Mirëpo, e dimë se ekzistimet e komisioneve të këtilla dhe agjencionet e caktuara janë edhe një mundësi e punësimit të miqve, angazhimit të miqve, të dashamirëve të ministrive të caktuara dhe të afërmeve të tyre. Kurse, çështjen e dytë e kam lidhur me nenin 36, respektivisht me dispozitat ndëshkimore.

Në nenin 36, atje theksohet se me gjobë prej 1000 deri në 2000 euro mund të dënohet personi fizik i cili ndërton objekte apo mbjellë kultura shumëvjeçare pas hyrjes në fuqi të vendimeve për projektin e rregullimit të tokës. Në kohën kur me mijëra hektarë të Kosovës, të tokës më të mirë bujqësore janë privatizuar e pastaj ato toka bujqësore janë shndërruar ose janë shitur për toka ndërtimore, për ndërtimin e lagjeve të reja, për mini fabrika dhe për depot e ndryshme, përfshirë këtu edhe depozitë e hekurit, siç janë varrezat e ndryshme të veturave, mendoj se një sanksion i tillë është tejet u ulët apo tejet i butë, prandaj kërkoj që të kemi një ashpërsim të sanksioneve në këtë drejtim, në mënyrë që përmes sanksioneve ta ruajmë tokën bujqësore e mos ta shndërrojmë atë në tokë ndërtimore.

KRYESUESI: Ju faleminderit! Deputeti Ardian Gjini e ka fjalën!

ARDIAN AGJINI: Ju faleminderit, zoti nënkryetar!

Mendoj se, edhe pse grupi ynë do ta përkrah në parim, siç tha edhe deputetja Kadrijaj, duhet thënë disa çështje që kanë të bëjnë me këtë ligj.

Fillimisht qëllimi të cilin ia ka vënë vetit ky projektligj, më lehtë arrihet me politika se sa me ligj, për shkak se ligji do të duplikojë provizionet dhe me siguri, kështu si është, se e kemi parë të gjithë, do të ketë edhe provizione të cilat janë në kolizion me ligjet tjera në Kosovë. Kështu që, në vend që të zgjidhim problem me këtë projektligj, ne do të shkaktojmë problem.

Politikat të cilat nuk po ndiqen në Kosovë janë shumë problematike dhe kanë një jetëgjatësi, do të thotë, kanë ndodhur shumë më herët dhe po vazhdojnë. Në kohën sa janë provuar të zgjidhen këto çështje, kemi hasur në shumë probleme dhe do t'i përmend disa. Ne nuk mundemi ta ndryshojmë traditën, do të thotë, përkundër faktit se në disa vende të cilat nuk po i përmendi, toka nuk fragmentohet, do të thotë prona që është tokë bujqësore, sidomos, nuk ndahet në mes pasardhësve, por ndahet pasuria e luajtshme, paratë ose ari ose pasuria tjetër e paluajtshme. Në Kosovë ndahet toka dhe ne nuk mund t'u themi njerëzve mos ua leni trashëgimi tokën pasardhësve veç e veç dhe kur të kalojnë dy gjenerata, pasardhësit të cilët e kanë trashëguar tokën, do të jenë kushërinj të lartë, ajo tokë është fragmentuar dhe ky proces i fragmentimit të tokës, nuk do të mund të ndalet kurrë në Kosovës.

Tani, çka mund të bëhet në mënyrë që kjo tokë të mos fragmentohet në mënyrë të tillë ose të paktën që interesi i pronarëve të tokave të jetë i njëjtë, që të mos kenë interesa të ndryshme, se nëse njëri ka interes për të ndërtuar, tjetri të mbjellë, një gjysmë hektari tokë nuk është bujqësi intensive, do me thënë nuk mund të millet. Ajo është më tepër kopsht se sa arë.

Çka ka ndodhur, është që ka ndryshuar vlera e tokës dhe tani kjo vlerë e tokës, në shumicën e rasteve matet si tokë ndërtimore, nuk matet më si tokë bujqësore, për shkak se u tha këtu, është shndërruar në tokë ndërtimore dhe mund t'ju them edhe një gjë tjetër se shndërrimi i tokës bujqësore në tokë ndërtimore në Kosovë, do të vazhdojë edhe për shumë, shumë, shumë vite që vinë për shkak se, edhe pse regjistrimi i popullsisë ka qenë me shumë defekte, një gjë do ta dëshmojë që hapësira e banimit për kokë banori në Kosovë është më e ulëta në Evropë, ndoshta, dhe Kosova do të ketë nevojë për hapësirë të banimit për shkak se familjet janë të mëdha, nuk mund të jetojnë një mburr dhe një grua me fëmijët e vet, por jetojnë familje shumë më të mëdha, se ata me siguri do të kenë nevojë për hapësirë banimi në të ardhmen edhe pasi të rriten fëmijët e tyre. Do të thotë, duhet të shohin diku 20-30 ose 40 vjet prej sot.

Cilat janë politikat të cilat nuk janë ndjekur në Kosovë, pa fajësuar veç e veç do të thotë as Qeverinë, as ndonjë qeveri lokale? Politikë e gabueshme ka qenë rritja e fshatit dhe mos rritja e qyteteve, do të thotë ngulfatja e qyteteve, mos hapja e qyteteve, mos krijimi i lagjeve të reja, ku njerëzit do të kishin mund të krijojnë hapësira banimi të urbanizuara, në mënyrë që fshati mos të rritet. Rritja e fshatit e ka sjell Kosovën në një situatë në të cilën unë mendoj se do t'i duhen edhe shumë e shumë vite për të dalë. Rritja e fshatit ka ndikuar për fragmentimin e tokës dhe shkatërrimin e tokës bujqësore, definitivisht, por ka ndikuar edhe në probleme jashtëzakonisht të mëdha me trajtim të ujërave të zeza, në mbledhjen e mbeturinave dhe në infrastrukturë, në rrugë edhe të tjera e tjera. Do të thotë, Kosova nuk ka pasur politikë të rritjes të qytetit. Bile, bile kemi dëgjuar njerëzit shpesh po thonë se po na zbrazet fshati, do të thotë thuaj ti se më me rëndësi është e të rritet fshati se qyteti. Kjo është krejt kontra, fakti që është premisë definitive që Kosova i ka vetëm 11 mijë kilometra katrorë dhe po shndërrohet në shtetin më të populluar për kilometër katror, do të thotë është problem mbipopullimi i fshatit dhe mos rritja e qyteteve, që duhet të jetë politikë.

Çështje tjetër është mos mbështetja adekuate e sektorit të bujqësisë, në mënyrë që njerëzit të kenë interes që të kenë parcela më të mëdha të tokave.

Edhe e fundit, që lidhet me ato dy të parat, është mosurbanizimi i fshatit. Në Kosovë nuk ka urbanizim të fshatit, fshatrat as që ka filluar t'i urbanizojë dikush dhe ndoshta është mëkat që prapë se prapë një shtet me 11 mijë kilometra katror të mos mbërrij për 10 vjet ta urbanizojë vetveten. Kemi ngecje serioze, sidomos në 4 vitet e fundit në këtë drejtim dhe po e ... Qeverinë dhe qeveritë lokale prej këtui, që përpos këtij ligji t'i kenë këto politika para vetit, se pa këto politika ligji do të jetë plotësisht i kotë.

Mendoj se Kosovës do t'i duhet në një të ardhme shumë të afërt që të ketë ndoshta një unifikim shumë të madh gjithë politik dhe nacional për mbrojtje të tokës për shkak se, po them edhe një herë, kjo rrugë në të cilën jemi tani nuk garanton absolutisht asgjë për shkak se ju thashë se cilat janë premisat, popullsia që rritet më së shpejti në Evropë, fshati i pa urbanizuar e tjera e tjera dhe 11 mijë kilometra katrorë hapësirë. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit! Deputeti Ismet Beqiri e ka fjalën.

ISMET BEQIRI: Zoti kryesues, unë vetëm e kam një lutje. Unë nuk di se si mund të votohen projektligjet kur nuk janë as 30 vet të pozitës këtu. Është një papërgjegjësi. Unë ju lus që si kryesues edhe vetë Qeverisë, nuk diskutohet këtu se po shishet pjesëmarrja që është, ju e shihni nëpër korridore, prandaj vërtetë është e pakuptueshme se si mendojnë. Po të ishim në njëfarë forme të ketë destruktivitet nga ana jonë, ky ligj nuk kalon, nuk të kalonte në asnjë mënyrë asnjëri ligj nëse vazhdohet kështu kësi soji, në sallë nuk i ke 30 vetë të pozitës prej 67 që lavdërohen që i kanë. Prandaj, i lutni që të jenë në sallë ose po dalim edhe ne.

KRYESUESI: Ju faleminderit! nuk ka tjerë të paraqitur. Në mbledhje janë prezent 64 deputetë. Bëhemi gati që të votojmë.

Votojmë, tani.

Ju faleminderit!

Me 60 vota "për", 1 abstenim dhe 1 "kundër", konstatoj që Kuvendi miratoi në parim Projektligjin për rregullimin e tokës.

Kërkohet nga komisiointi funksional dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit, ta shqyrtojnë projektligjin dhe Kuvendit t'i paraqesin raportet me rekomandime. Ju faleminderit!

Vazhdojmë me pikën e 17-të të rendit të ditës, që është:

17. Shqyrtimi i Raportit të punës të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për vitin 2010

Komisioni funksional për Legjislacion e ka shqyrtuar Raportin e punës të Komisionit Qendror të zgjedhjeve për vitin 2010, dhe Kuvendit ia ka rekomanduar miratimin e tij.

Komisioni për Buxhet dhe Financa e ka shqyrtuar Raportin vjetor financiar të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për vitin 2010, dhe Kuvendit ia ka rekomanduar për miratim.

Sipas radhës, fjalën e ka kryetari i komisionit funksional, deputeti Armend Zemaj.

ARMEND ZEMAJ: Ju faleminderit, kryesues!

Komisioni për Legjislacion, duke u bazuar në nenin 72 të Rregullores së Kuvendit, e ka shqyrtuar Raportin e Komisionit, Raportin e punës të Komisionit për vitin 2010, në prani edhe të kryetares së Komisionit Qendror Zgjedhor dhe zyrtarëve udhëheqës të atij komisioni.

Komisioni për Legjislacion vlerësoi se Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka vepruar në pajtim me Ligjin për zgjedhjet e përgjithshme në Kosovë, me rastin e dërgimit për shqyrtim në Kuvendin e Kosovës të Raportit të punës për vitin paraprak.

Komisioni vlerësoi se në Raportin e KQZ-së janë përfshirë problemet dhe vështirësitë që e kanë përcjellë punën e KQZ-së, por raportit i mungojnë konstatimet dhe analizat se çka duhet bërë që zgjedhjet të jenë më të avancuara.

Po ashtu, komisioni konstatoi se duhet të rishikohet çështja e votimit me kusht, çështja e votimit jashtë Kosovës, në diasporë, të bëhet spastrimi i listave të votuesve dhe të ngrihen kapacitetet e KQZ-së, si riorganizimi, profesionalizmi, modernizimi, menaxhimi dhe kontrolli më i mirë në vendet e votimit dhe numrit të votave dhe aftësinë e KQZ-së për zgjedhje të rregullta dhe ato të jashtëzakonshme, nëse paraqiten.

Problemi kryesor që është paraqitur gjatë shqyrtimit të këtij raporti, dhe Komisioni ka kërkuar sqarime shtesë rreth përmbledhjes në lidhje me listën e votuesve që ka të bëjnë me numrin e përgjithshëm të votuesve, votuesve të rinj dhe votuesve që kanë mbushur 18 vjet. Raporti pra është i përbërë pra nga dy pjesë, pjesës hyrëse – aktivitetet përmbledhëse të KQZ-së gjatë periudhës raportuese dhe pjesës së dytë, pasqyrës përmbledhëse të aktiviteteve zgjedhore 2010, si dhe pasqyra përmbledhëse si pjesë integrale e raportit.

KQZ-ja e ka dërguar Raportin vjetor të punës në pajtim me obligimin e përcaktuar, me nenin 63.10 të Ligjit nr. 03-L-073 për zgjedhjet e përgjithshme në Republikën e Kosovës. Komisioni vlerëson se raporti përmban informata të mjaftueshme, përpos atyre shqetësimeve që i parashtrova më parë dhe që do t'i parashtrojnë edhe anëtarët e tjerë të komisionit dhe ne e sugjerojmë miratimin e këtij raporti. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Kryetarja e Komisionit për Buxhet dhe Financa, deputetja Safete Hadergjonaj.

SAFETE HADERGJONAJ: Ju faleminderit, zoti nënkryetar!

E nderuara zëvendëskryeministre,

Të nderuar kolegë deputetë,

Komisioni Qendror Zgjedhor, Raportit vjetor të punës duhet t'ia bashkëngjis edhe raportin financiar vjetor. Komisioni Qendror Zgjedhor ka dorëzuar raportin financiar së bashku me raportin e punës. Komisioni për Buxhet dhe Financa, në mbledhjen që ka mbajtur me datën 22 qershor, ka vlerësuar që raporti i cili i është bashkëngjitur, raporti financiar i cili i është bashkëngjitur raportit vjetor, nuk i përmbush kushtet për raportim financiar dhe ka konstatuar se është një raport i mangët.

Për këtë arsye, ka kërkuar nga Komisioni Qendror Zgjedhor që t'i dorëzojë një raport më të detajizuar.

Komisioni Qendror Zgjedhor i ka dorëzuar Komisionit për Buxhet dhe Financa raportin e detajizuar financiar, i cili raport i është bashkëngjitur rekomandimit tonë, të cilin ia kemi ofruar Kuvendit. Komisionit Qendror Zgjedhor, në fillim të vitit 2010, iu ka ndarë mjete prej 1.837.000 euro, kurse buxheti i Komisionit Qendror Zgjedhor është shtuar në 8.723.000 euro në arsyeshmërinë, sepse gjatë vitit të kaluar kemi pasur zgjedhje të jashtëzakonshme.

Nga këto mjete, janë shpenzuar diku 5.433.000 euro, apo vetëm 62.2% të mjeteve të cilat janë planifikuar. Nëse shikohen mjetet të cilat janë të ndara sipas kategorive ekonomike, shohim se në kategorinë ekonomike - paga dhe mëditje, mjetet janë shpenzuar 100%, kurse tek kategoria e mallrave dhe shpenzimeve janë shpenzuar diku 59.6%, për shpenzime komunale 53.2% dhe për shpenzime kapitale 79.5%.

Komisioni për Buxhet dhe Financa, në mbledhjen e mbajtur me datën 6 korrik, ka shqyrtuar raportin vjetor financiar dhe pas marrjes të disa përgjigjeve dhe sqarimeve në pyetjet të cilat janë bërë nga anëtarët e Komisionit për Buxhet dhe Financa, e ka miratuar këtë raport dhe ka rekomanduar që raporti të votohet edhe në Kuvend dhe ka vlerësuar se i njëjti përmbush obligimet ligjore të cilat dalin nga Ligji për menaxhimin e financave publike. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Sipas radhës, përfaqësuesit e grupeve parlamentare.

Në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, deputetja Hasime Krasniqi.

HASIME KRASNIQI: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Edhe Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike e ka shqyrtuar në tërësi këtë Raport me të gjitha ato mangësi që i ka pasur dhe e mbështesim.

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar i LDK-së, deputeti Arben Gashi.

ARBEN GASHI: Të nderuar kolegë deputetë,

Ne sot pritet të miratojmë një raport të një institucioni të pavarur, ndër më të rëndësishmit, më kryesori në Republikën e Kosovës.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, i themeluar në pajtim me nenin 139 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, është përgjegjës për organizimin dhe implementimin e zgjedhjeve në Kosovës. Duke qenë se zgjedhjet janë procesi më i rëndësishëm politik në një demokraci parlamentare, me ç'rast qytetari përmes votës zgjedh përfaqësuesin e vet, atëherë kuptohet pse ky institucion ka rëndësi. Zgjedhjet prodhojnë një parlament, ky parlament zgjedh Qeverinë e deri dje e zgjidhte edhe Presidentin. Presidenti i emëronte gjyqtarët, pra nga KQZ burojnë tri pushtete në Kosovë: ai legjislativ, ai ekzekutiv dhe ai gjyqësor, plus edhe Presidenti.

Sipas vetë përkufizimit të KQZ-së, në faqen e saj, roli i KQZ-së është të rregullojë dhe të mbikëqyrë procesin zgjedhor të gjitha aspektet për të siguruar që zgjedhjet të arrijnë standarde ndërkombëtare.

Duke nënkuptuar këtu që standardet ndërkombëtare flasin për zgjedhjet fer dhe të drejta demokratike dhe të lira, sepse këtu sigurohet përfaqësimi i vërtetë i zërit të qytetarit në parlamentin e tyre.

Ky parlament është parlament i qytetarëve të Kosovës, ne jemi vetëm përfaqësues të zgjedhur të tyre. Mes nesh dhe qytetarëve qëndron KQZ-ja. Ajo siguron që ne nuk kemi ardhur si rezultat i një procesi të padrejtë zgjedhor dhe se vërtet jemi të zgjedhurit e popullit. Por, a ka bërë vërtetë KQZ-ja këtë punë dhe sidomos a e ka bërë në vitin 2010? Raporti të cilin ne po e shqyrtojmë dhe diskutojmë sot nuk, na thotë që e ka bërë.

Unë nuk do të ndalem shumë në vlerësimet e Raportit financiar, sepse siç mund të lexojmë, ky raport ka marrë miratimin e Komisionit për Buxhet dhe Financa, sa i përket përmbushjes së obligimeve ligjore për raportimin, si dhe ka marrë miratimin e Komisionit për Legjislacion, që e drejtojnë, me rekomandime të caktuara. Unë do të flas këtu më shumë mbi atë se çfarë ka bërë KQZ apo më mirë çfarë nuk ka bërë ky organ, respektivisht ka dështuar të bëjë.

Zgjedhjet e vitit 2010, të organizuara nga KQZ, kanë qenë zgjedhjet më të dobëta të organizuara ndonjëherë në Kosovë, të vlerësuara kështu për herë të parë edhe nga institucionet e rëndësishme ndërkombëtare, monitoruesit e zgjedhjeve dhe të tjerët. Deri në vitin 2010, vëzhguesit ndërkombëtarë kanë vlerësuar zgjedhjet kryesisht korrekte, megjithëse me mangësi evidente. Një nga këto mangësi të përsërita vazhdimisht ka qenë lista e votuesve. Janë të njohura problemet me numrin relativisht të madh të personave të vdekur që figurojnë ende në listat e votuesve, si dhe numri jashtëzakonisht i madh i votuesve pasivë, ndoshta edhe fiktiv në këtë listë. Por, një problem që nuk është potencuar mjaftueshëm, është numri i votuesve të rinj që i shtohen listës sa herë që organizohen zgjedhjet.

Komisioni për Legjislacion ka kërkuar nga KQZ një sqarim lidhur me numrin e votuesve të rinj në vitin 2010, që ishin shtuar për 73.288 votues nga zgjedhjet e fundit në vitin 2009. Nga sqarimi i KQZ-së kuptojmë që nga këta 72 mijë e diçka votues të rinj, vetëm 35.735 ishin votues që kishin mbushur moshën 18 vjeçare. Për pjesën tjetër, KQZ-ja supozon, tek sa na përgjigjet, thotë se potencialisht janë, se mund të jenë qytetarë të Kosovës që jetojnë jashtë Kosovës dhe minoritete etnike që janë pajisur me vonesë me dokumente të Kosovës, apo qytetarë të tjerë, që po ashtu janë pajisur me vonesë për arsye të ndryshme, rreth 37.000 votues të rinj, që nuk dihet se kah kanë ardhur.

Ka shumë pikëpyetje në përgjigjen e KQZ-së për një çështje kaq të rëndësishme, siç është lista e votuesve, bazament i zgjedhjeve.

Në faqen e internetit të KQZ-së, është vështirë për një qytetar të Kosovës të sigurojë informacione të mjaftueshme për rezultate zgjedhore, statistika tjera zgjedhore, siç janë: Numri i votuesve në vite, trendi i shtimit të votuesve të rinj dhe shifra tjera këto. Statistikat janë parciaisht, shumë të dhëna mungojnë dhe kur jepen, nuk janë të renditura në mënyrë kronologjike, gjë që pamundëson kuptimin e trendit, të rritjes së pritshme dhe krahasimeve të tjera në vite. Nga ato që kam arritur të marrë në faqe, vërehet se rritja e numrit të votuesve ka qenë e vazhdueshme, por me dallime të mëdha në vite.

Në zgjedhjet e vitit 2000, në Kosovë janë regjistruar 913.000 votues.

Në zgjedhjet e vitit 2002, në Kosovë kanë qenë të regjistruar 1.320.000 votues. Kjo rritje prej 400.000 votuesish i atribuohet regjistrimit të popullsisë dhe minoriteteve në vitet e para të pasluftës, një proces që nuk kishte filluar që në vitin 2000.

Dy vite më vonë, në zgjedhjet e vitit 2004, listës i janë shtuar, ka mbërri në 1.412.000 votues, pra listës së votuesve i shtohen 92.000 votues. Shënojeni këtë shifër, për dy vjet, nga 2002 në 2004, janë shtuar 92.000, për 1 vit mesatarisht i bie rreth 46.000 votues. Jemi pra në periudhën e regjistrimit të emigrantëve tanë, që vazhdonin të vinin për të marrë dokumente në Kosovë.

Nga viti 2009, në vitin 2010, pra vetëm për një vit janë shtuar 73.000 votues të rinj.

Në zgjedhjet e vitit 2007, shifrat e KQZ-së ngatërrohen. Sipas një dokumenti të KQZ-së, në vitin 2007 ka pasur 1.454.000 votues, që i bie se në tri vite, nga viti 2004 janë shtuar vetëm 43.000 votues. Krahasojini me 73.000 votues në një vit.

Një dokument tjetër i KQZ-së për zgjedhjet e vitit 2007, në UEB faqen e OSBE-së tregon se në këto zgjedhje, pra në vitin 2007 ka pasur 1.567.000 votues. Nëse e marrim të mirëqenë këtë shifër, unë besoj se kjo duhet të jetë e saktë, atëherë nga viti 2004 deri në vitin 2007 janë shtuar 155.000 votues, rreth 52.000 votues, krahasojeni prapë me shifrën 73.000 votues.

Në vitin 2009, të dhënat përsëri ngatërrohen. Sipas UEB faqes së KQZ-së, trupi votues shënon rritjen në raport me shifrën, që unë e konsideroj të gabuar, të vitit 2004, ku ishin vetëm 1.454.000 votues në vit, sipas KQZ-së votojnë 1.563.000 votues. Votojnë më shumë se sa që ishin.

Në raport të vitit 2007, shënon rritje prej 109.000 votuesish, pra 55.000 votues në vit, i krahasoni me 73.000 votues, po ua përsëris. Në qoftë se merret i mirëqenë dokumenti i dytë, që flet për trupin votues të vitit 2007, dokument me logo të KQZ-së, që mund të gjendet në UEB e OSBE-së, pra shifrat e votuesve për zgjedhjet e vitit 2007 prej 1.567.000 votues, i bie që në vitin 2009 kemi pasur ulje të numrit prej 4000 votuesish më pak.

Dhe, në vitin 2010, sipas KQZ-së, trupi votues rritet në 1.630.000 votues. Rritja nga 2009, sipas KQZ-së, është 73.000 votues. Ndonëse nga matematika e thjeshtë, zbritja e numrit të 2010-tës me numrin e 2009-tës del një rritje prej 67 mijë votuesish. Duke konsideruar se KQZ-ja ka shifra të sakta, rritja prej 73.000 është një rritje alarmante që duhet të zgjonte vëmendjen tonë, sepse shkalla e manipulimit të zgjedhjeve, që u quajt “industriale” nga diplomatët ndërkombëtarë, të cituar në media vendore dhe të huaja, ka pasur shtrirje të jashtëzakonshme si në gjerësi, ashtu edhe në thellësi të saj. Hajnia klasike e konstatuar në disa komuna të Kosovës, ku kishin votuar deri 150% të trupit votues, u tentua të riparohet me një proces zgjedhor të përsëritur, por që përsëriti vetëm hajninë, e nuk siguroi asnjë element tjetër zgjedhjeve të lira.

Kërcënimet fizike, dhuna, blerjet e votave, blerjet e komisionarëve, mashtrimet teknike, mbushja e kutive që prodhuan këtë magjorancë, që mungon këtu mbrapa sot, ose që është këtu para pjesërisht, ka qenë evidente dhe janë evidentuar në të gjitha, por një mashtrim i tjetër i pa vërejtur duket të ketë ndodhur në listën e votuesve, siç mund ta kuptojmë nga raporti i KQZ-së, ndër statistikën ndër vite të trupit elektoral. Ky mashtrim i pavërejtur, por efektiv, ka mundësuar që listës t’i shtohen në mënyrë fiktive edhe një numër prej së paku 25 mijë votuesish in-ekzistentë. Siç e dimë, lista e votuesve paraqet një ekstrakt të regjistrimit civil të Kosovës, përgjegjës për të cilën është Ministria e Punëve të

Brendshme, e kontrolluar nga PDK-ja, partia e cila, siç u dëshmuar, përfitoi ose së paku u përpoq të përfitojë më së shumti nga manipulimet zgjedhore. Kjo dëshmohet me vendim gjykatash dhe përsëritje zgjedhjesh në komunat ku kjo parti fitonte me numra matematikor iracional.

Ne mendojmë se kjo ministri ka shtuar këta votues fiktivë, në mënyrë që zgjedhjet dhe këto 20.000 vota t'ia shtojë rezultatit të vet zgjedhor. Ndonëse përgjegjësia për përpilimin e listës së votuesve, si ekstrakt i regjistrimit civil, bile në Ministrinë e Punëve të Brendshme, KQZ nuk mund t'i ikë përgjegjësisë së vet, që listat përfundimtare të votuesve të jenë të sakta dhe të azhurnuara, sepse Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në bazë të Ligjit për zgjedhjet e përgjithshme, neni 7, Lista e votuesve, mbanë listën e votuesve dhe siguron që lista e votuesve është e saktë dhe është e azhurnuar.

Ne kërkojmë...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Edhe dy minuta ia shtoni zotit Gashi!

ARBEN GASHI: Prandaj, si përfundim, ne kërkojmë një raport të detajuar nga Ministria e Punëve të Brendshme lidhur me regjistrime të reja të qytetarëve në regjistra civilë, përfshirë edhe ata që për herë të parë mbushin moshën, si dhe në raport të detajuar jo vetëm statistikor, por analitik nga KQZ-ja, mbi arsyet dhe trendet e rritjes së numrit të votuesve.

Kjo përgjigje e KQZ-së, e dhënë të cilën e keni edhe ju, është e paarsyeshme, e palogjikshme dhe e papranueshme. KQZ dhe kryetarja e saj na ka thënë në mbledhje të Komisionit se nuk e di nga kanë ardhur 37.000 votues të rinj në Kosovë. Faleminderit!

Prandaj, unë rekomandoj që të mos votohet ky raport.

KRYESUESI: Faleminderit!

Grupi Parlamentar “Vetëvendosje”, deputetja Haxhiu!

ALBULENA HAXHIU: Faleminderit, kryesues!

Fillimisht, në emër të Grupit parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje” po shpreh pakënaqësinë për mënyrën se si funksionon Komisioni Qendror i Zgjedhjeve dhe për dështimin e plotë që pati gjatë procesit të rivotimit për zgjedhjet komunale dhe për zgjedhjet e përgjithshme 2010.

Është për t'u befasuar me këtë raport,, sepse po të bazohemi në të, del se zgjedhjet ishin në nivel, gjersa kemi dhjetëra raporte e qëndrime të organizatave vendore e ndërkombëtare që thonë se zgjedhjet ishin të keq organizuara, të manipuluara e të përcjella me dhunë e kërcënime ndaj komisionarëve, vëzhguesve dhe votuesve.

Mendoj se ky institucion ka herë e ka humbur betejën për të qenë i paanshëm dhe rrjedhimisht i pavarur. Në vazhdim, po i cek disa nga vërejtjet që kemi në lidhje me këtë raport:

Misionet vëzhguese, vizitat tjera dhe trajnimet. Sipas disa informatave që kemi, vizitat-trajnimet planifikohen dhe bëhen pa analizuar nevojat e KQZ-së, se stafi profesional injorohet apo nuk

dërgohet në këto vizita apo trajnime, se këto shfrytëzohen nga anëtarët e KQZ-së të cilët nuk kanë të bëjnë fare me programin e këtyre vizitave apo trajnimeve dhe se nuk ka kurrfarë procesi i cili siguron bartjen e përvojave nga këto vizita tek stafi tjetër në KQZ dhe, më e rëndësishmja, që KQZ-ja shpenzon mjete pa nevojë për akomodim, udhëtim e mëditje duke marrë pjesë në këto vizita.

Bile është për t'u çuditur se me gjithë këto vizita e trajnime, të cilat mbizotërojnë në këtë raport, ne nuk e pamë që KQZ të kryej detyrën e vet gjatë zgjedhjeve.

Votimi jashtë Kosovës. Vërehen se shumë qytetarëve që jetojnë jashtë vendit iu është mohuar e drejta për të votuar, pra nga 5015 aplikacione, janë aprovuar 1640 (pra 3228 janë refuzuar).

KQZ-ja këtë e ka paraqitur si sfidë, por ajo që është brengosëse, është se kryetarja e KQZ-së ka qenë pjesë e grupit punues në vitin e kaluar dhe si ka lejuar që kjo mënyrë diskriminuese e votimit të mos ndërrohet apo së paku të lehtësohet për bashkatdhetarët tanë, duke qenë se ata edhe ashtu doli që në këto zgjedhje kanë votuar.

Certifikimi i Listës përfundimtare të votuesve. Kemi qenë dëshmitarë të ekzistimit të personave të vdekur në listën e votuesve, gjersa në raport ceket se personat e vdekur janë hequr nga lista, pra një shpërputhje në mes realitetit dhe asaj që përmban ky raport. Pra, raporti jo vetëm në këtë pjesë, por në tërësinë e tij duket të jetë më shumë si shndërrim i detyrave dhe përgjegjësi në punë të kryera.

Pra, duhet të shtohet në raport se përse ka dështuar heqja e personave të vdekur nga lista dhe arsyetimi në faktorin kohë të pamjaftueshme nuk është as i sinqertë e as i vërtetë. Ka persona që kanë vdekur mbi 15 vite, por ende janë në listë të votuesve.

Plani operacional i sigurisë për ditën e zgjedhjeve. Edhe pse këtu përmendet Policia e Kosovës, aty nuk paraqiten vështirësitë në këtë bashkëpunim pasi që ka pasur raste ku manipulimet, kërcënimet janë bërë në prezencë të policisë, por ata nuk kanë ndërmarrë kurrfarë masash.

Pra, një shpjegim i këtij bashkëpunimi të dobët mendoj se do t'i kontribuonte paraqitjes reale të raportit.

Informimi i votuesve. Në raport shohim se KQZ-ja ju ka dhënë informata përveç se votuesve, edhe partive politike, së paku për Lëvizjen "Vetëvendosje" mund të them se informatat që kemi pranuar nga KQZ kanë qenë minimale, bile kanë qenë pothuajse të mbyllur ndaj nesh, e mos të flasim për votuesit, andaj nuk dihet se cila ka qenë baza mbi të cilën është paraqitur se është bërë informimi dhe të mos harrojmë se po flasim edhe për fushatën e sensibilizimit, që ka kushtuar rreth 700 mijë euro, që nuk besoj se do gjejmë dikë që ta besojë se ka pasur informim ashtu siç paraqitet në raport. Andaj, edhe për këtë pjesë është e mirëseardhur paraqitja e sfidave dhe mangësive që ka pasur informimi, përfshirë edhe arsyetimin mbi shpenzimin e një shume kaq të madhe për aq pak aktivitete dhe një arsyetim shtesë mbi kritikën dhe akuzat që KQZ-ja ka pasur mbi dhënien e tenderit për fushatën vetëdijësuese.

Shpallja dhe certifikimi i rezultateve. Tek kjo pjesë, ajo që mungon, është se kemi qenë dëshmitarë që shumë informata apo rezultate kanë dal nga KQZ në mënyrë të paligjshme dhe të njëjtat bile janë publikuar edhe në media para se ato të publikohen nga KQZ, gjersa ne si subjekt nuk e kemi pasur as

edhe një mundësi të informohemi mbi rezultatin e as procesin, përveç atyre të dhënave që na janë servuar përmes mediave apo paraqitjeve të rralla publike të KQZ-së.

Pjesa financiare, pra buxheti është paraqitur në vija shumë të trasha, çka na pamundëson të flasim më gjerësisht, por megjithatë, në bazë të informatave shitesë që i kemi, ekzistojnë disa probleme me buxhetin dhe mënyrën se si është shpenzuar dhe që duhet të reflektohen në këtë raport, e që janë:

Blerjet një burimore, pra pa shpallje të rregullt të tenderëve, çka ka sjell favorizim të kompanive, siç është ajo e fushatës për sensibilizim të votuesve.

Mandej kontrata për furnizimin me llamba dhe bateri si dhe ajo për furnizim me prej, së bashku janë rreth 60 mijë euro. Pra, për informim janë shpenzuar 700 mijë euro, gjersa për furnizim me këto materiale kaq sensitive janë harxhuar 60 mijë euro, që po t'i shohim çmimet e ofruara dhe krahasojmë me kualitetin e llambave, baterive dhe spreit, del se kemi paguar çmim goxha të shtrenjtë për materiale shumë të dobëta, kualiteti i të cilave u pa edhe gjatë zgjedhjeve.

Po ashtu edhe shpenzimet e karburanteve janë jashtëzakonisht shumë të mëdha sa që shtrohet pyetja se makinat e KQZ-së ecin me kerozin apo si ndodhë?

Si përfundim do të ishte mirë që KQZ-ja ta rishikojë edhe një herë këtë raport, t'i krahasojë ato që ka shkruar me gjendjen reale dhe kur të vijë në Kuvend së paku të jetë më për tokë, sepse si i tillë çfarë është tani, është në shpërputhje të plotë me proceset që kemi parë të kenë ndodhur, e për të cilat ky institucion ka qenë përgjegjësi kryesor.

Pra, përderisa ky raport është kështu si është ne nuk do të votojmë në favor të tij, pra do të votojmë kundër. Faleminderit!

KRYETARI: Në emër të Grupit Parlamentar të Aleancës, Blerim Shala e ka fjalën.

BLERIM SHALA: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar kolegë,

Viti për të cilin po flasim ne në kuadër të Raportit vjetor të Komisionit Qendror Zgjedhor, ka qenë me siguri viti më i vështirë politik për Kosovën që prej që është bërë shtet dhe viti më i vështirë për Komisionin Qendror Zgjedhor t'i menaxhojë zgjedhjet, për shkaqe të njohura për të gjithë ne. Para se të gjithash e dimë që gati në gjithë vitin 2010 ka pasur zgjedhje, prej përsëritjes së zgjedhjeve lokale, zgjedhjeve lokale të jashtëzakonshme dhe më në fund edhe zgjedhjeve të përgjithshme të jashtëzakonshme.

Në raportin për të cilin po flasim ne nuk ka pasqyrim të kësaj gjendje po thuaj dramatike e cila ka mbretëruar në procesin e organizimit të zgjedhjeve lokale dhe të përgjithshme në Kosovë. Është një raport fund e krye teknik thuaj se asgjë e veçantë nuk ka ndodhur, thuaj se gjithçka ka qenë në rregull, thuaj se Kosova ka pasur zgjedhje të tjera të mira apo të organizuara si duhet e ne të gjithë e dimë që, veçmas prej vitit 2007 e këndej kemi një degradim të procesit të organizimit të zgjedhjeve që ka kulminuar me zgjedhjet e 12 dhjetorit të vitit të kaluar, që janë cilësuar si zgjedhjet më të këqija që i kemi pasur në Kosovë.

Pos detaleve të shumta sot konfirmojnë këtë vlerësim, mendoj që gabimi më i madh që Komisioni Qendror Zgjedhor ka bërë është kur nën presionin politik, i cili ka ekzistuar, këtë duhet ta pranojmë të gjithë, ka konstatuar që është i gatshëm, ka mundësi t'i organizojë zgjedhjet e jashtëzakonshme brenda 45 ditëve, pas shpërbërjes së Kuvendit.

E dimë fare mirë që kjo ka qenë e pamundur. E kanë ditur të gjithë në Komisioni Qendror Zgjedhor, që diçka e tillë është e pamundur. Pra, ideja për organizimin e zgjedhjeve të jashtëzakonshme, prej fillimit deri në fund, është mbizotëruar me motive e interesat politike e jo me aftësitë reale menaxheriale të Komisionit Qendror Zgjedhor, ndërsa pikërisht KQZ-ja është instanca më e lartë e cila ka përgjegjësinë e organizimit të zgjedhjeve dhe nga KQZ-së është dashur të dëgjohet qysh atëherë që është e pamundur që zgjedhjet e mira, të lira, fer, demokratike, të cilat do të pranoheshin prej të gjithëve, mund të bëhen brenda periudhe të shkurt kohore.

Nga ky raport që kemi sot para vetes nuk del që janë nxjerr mësimet e duhura për KQZ-në dhe për të gjithë ne. E mësimet e duhura shkojnë së bashku në një kolabim të përbashkët që zgjedhjet e tilla më kurrë nuk duhet t'i kemi në Kosovë, që ato zgjedhje kanë degraduar demokracinë në Kosovë, kanë krijuar institucionet e brishta, faktikisht kanë thelluar krizën politike në Kosovë dhe konfirmim për të gjitha këto konkludime janë krijimi i dy komisioneve parlamentare, të cilat merren me ndryshimin e Kushtetutës, merren me ndryshimin e Ligjit për zgjedhjet e përgjithshme, sepse është parë së bashku që kështu nuk mund të bëhen zgjedhjet, nuk mund të organizohen zgjedhjet. Pra, kemi të bëjmë me defekte të mëdha organizative, menaxheriale, legjislative dhe politike të cilat nuk reflektohen në këtë raport.

Prandaj, Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, grupi parlamentar i saj, nuk do ta përkrahë këtë raport apo do të votojë kundër. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Zgjedhjet e jashtëzakonshme ju e dini që janë të parapara me Kushtetutë. Vazhdojmë. Në emër të Grupit Koalicioni për Kosovë të Re, Muhamet Mustafa e ka fjalën.

MUHAMET MUSTAFA: Ju faleminderit, zoti kryetar i Kuvendit,

Grupi ynë parlamentar, Koalicioni për Kosovë të Re, mendon se raporti i prezantuar është një pasqyrë teknike e aktiviteteve të cilat i ka zhvilluar Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në mënyrë kronologjike, mirëpo nuk e pasqyron edhe anën tjetër esenciale të procesit zgjedhor për të cilin u bë fjalë këtu.

Lëshimet të cilat kanë ndodhur gjatë këtij procesi zgjedhor janë shprehur negativisht në eficiencën e krijimit të institucioneve të Kosovës. Ju e dini se zgjedhjet kanë qenë më 12 dhjetor, kurse ne kemi filluar dhe kemi konstituuar Kuvendin, pas 3 – 4 muajve, konkretisht më 22 shkurt. Në situatën për të cilën ka qenë Kosova atëherë kur janë nevojitur institucionet të cilat duhet ta udhëheqin Kosovën në zgjidhjen e problemeve sociale, ekonomike, sidomos në forcimin e pozicionit ndërkombëtar, të Kosovës, kjo vonesë ka qenë tejet e dëmshme. E vonesa ka ardhur për shkak të lëshimeve që janë bërë në zbatimin e ligjit e problemi në këtë raport është se nuk konstaton këtu cilat janë këto lëshime. Pra, ne kishim kërkuar që vërtet Komisioni Zgjedhor do të duhej t'i kishte të evidentuara këto lëshime. Edhe në këtë drejtim mendojmë se, nga ky evidentim do të nxirreshin mësimet, unë besoj se ato mësimet po nxirren edhe po merren parasysh në ligjin e ri dhe në këtë drejtim ne shpresojmë që Komisioni Zgjedhor duhet të hartojë një raport. Ne këtë raport mund ta aprovojmë

vetëm si një kronologji e proceseve teknike se si është zhvilluar procesi, por nuk mund ta hartojmë një raport lidhur me procesin zgjedhor të cilin e ka menaxhuar ky komision.

Prandaj, ne sugjerojmë që Komisioni Zgjedhor vërtet t'i ketë të evidentuar edhe të diskutuara këto çështje të cilat duhet t'i dërgojë, ndoshta në mënyrë të veçantë në Parlament, por sidomos duhet t'ia japë në disponim Komisionit i cili po punon në reformën e zgjedhjeve.

Gjithashtu, një çështje shumë e rëndësishme, për çka unë sot këtu propozoj një konkluzë të Kuvendit, sepse dihet se ka pasur shkelës të identifikuar të ligjit, ka pasur njerëz të cilët janë para gjyqeve. Prokurorët kanë bërë disa padi, mos të gabofsha 114 apo 140, nuk jam i sigurt, mirëpo kam parë me të vërtetë një vonesë dhe një neglizhencë në trajtimin e këtyre lëndëve dhe kam parë disa vendime të cilat ne nuk mund të hymë tash në kompetencat e atyre që marrin vendime lidhur me këto shkelje, por në qoftë se kemi vetëm dënime me kusht nuk jam i sigurt se do të nxjerrim mësim nga shkeljet e rënda që janë bërë gjatë procesit zgjedhor të cilin e lamë pas.

Prandaj, propozimi im është që të jetë një rekomandim dhe një konkluzë e Kuvendit që shkeljet e evidentuara ligjore lidhur me procesin zgjedhor të cilën e lamë pas, duhet të trajtohen me prioritet dhe me përgjegjësi në mënyrë që në zgjedhjet tjera të evitohen praktikat e ngjashme. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të SLS-së, deputetja Jelena Bontiq e ka fjalën.

JELENA BONTIĆ: Hvala, gospodine predsjedniče!

Radi delovanja Centralne izborne komisije, pogotovo za vreme parlamentarnih izbora, bili su dogo tema raznih političkih prepucavanja i medijskih špekulacija. Smatram da razmatranje godišnjeg finansijskog izveštaja ove nezavisne institucije ne treba da bude opterećen tim političkim napetostima. Ovo se prevashodno odnosi na trošenje novca za organizaciju izbornog procesa. Zato je posebno važno da izveštaj bude transparentan, jasan i pre svega odgovori na jedno pitanje: Koliko Kosovo koštaju izbori? U želi da povećamo transparentnost ovog izveštaja, Poslanička grupa Samostalne liberalne stranke glasaće za njegovo usvajanje, ali izneću nekoliko primedbi.

Moja najveća zamerka ovom izveštaju zasniva se na nepostojanju jasno podeljenih troškova po izbornim procesima. Naime, godišnji izveštaj Centralne izborne komisije za 2010. godinu obuhvata ukupno 9 izbornih procesa i to 8 lokalnih izbornih radnji i jedne parlamentarne izbore. Na žalost, pregled troškova dat je kumulativno i zahteva pretpostavljanje koliko su koštali pojedinačno.

Neophodna transparentnost ovog izveštaja dovedena je u pitanje i u delu izveštaja o troškovima u kategoriji robe i usluge, napomena 6, strana 7. Naime, i ako ovi troškovi čine oko 88% budžeta, njihova analitika data nedovoljno precizno. Posebno budžetska linija - ostale ugovorne usluge sa oko 3.600.000 evra predstavlja 76% troškova kategorije robe i usluge. Ovo je u suprotnosti sa međunarodnim računovodstvenim standardima da se ubedljivo najveća stavka u realizovanom budžetu vodi pod kategorijom - ostalo. Smatram da je neophodno da se u buduće ove greške isprave.

Izveštaj takođe ne sadrži podatke o kadrovskoj, etničkoj i polnoj strukturi. Takođe smatram da Komisija veću pažnju treba posvetiti kadrovskoj obuci, koja sada iznosi 0,09% budžeta. Smatram da je ovo posebno bitno jer, na žalost, Kosovo zbog nepostojanja više stranačke tradicije, svake izbore organizuje po novim izbornim zakonima, tražeći naj efikasniji model. To će se po svemu studeći i

opet desiti. Upravo je za to kadrovska obuka uslov da se u buduće izbori sprovede u skladu sa najvišim evropskim i svetskim standardima. Hvala vam!

KRYETARI: Faleminderit, deputete!

Në emër të Grupit Parlamentar “6+” deputeti Albert Kinolli e ka fjalën.

ALBERT KINOLLI: Faleminderit, i nderuar kryetar i Kuvendit!

Grupi Parlamentar “6+” e ka bërë analizën e detalizuar të Raportit vjetor financiar të KQZ-së si dhe raportin e punës së KQZ-së për vitin 2010, vit në të cilën janë mbajtur zgjedhjet e parakohshme, më 12 dhjetor.

Ne konsiderojmë se Raporti financiar është real dhe jep gjendjen reale të shpenzimeve të KQZ-së për vitin 2010. Këto shpenzime janë bërë në kuadër të buxhetit i cili është lejuar për këtë institucion të pavarur.

Në faqen 6 të mallrat dhe shërbimet është bërë përshkrimi detal me vërejtjet se ekzistojnë disa gabime teknike në numra.

Ne gjithashtu e kemi studiuar dhe rekomandimin e Komisionit për Legjislacion, i cili propozon që ky raport të miratohet. Konsiderojmë se arsyetimi i këtij rekomandimi është real, sepse përmban mirëkuptimin dhe udhëzimet për vështirësitë në të cilat gjendet Komisioni Qendror i Zgjedhjeve.

Komisioni për Legjislacion jep rekomandime për përparimin e zgjedhjeve si: votimin me kusht, votimi jashtë Kosovës, rritja e kapaciteteve të KQZ-së, riorganizimi, modernizimi, profesionalizimi, udhëheqja dhe kontrolli më i mirë i vendvotimeve, rinumërimit e të tjerë. Krejt kjo tregon ndërlikueshmërinë e punës me të cilën merret Komisioni Qendror Zgjedhor.

Këto rekomandime në qoftë se zbatohen në mënyrë të drejtë e ne besojmë se kjo do të ndodhë në të ardhmen në masë të madhe do të përmirësojmë procesin zgjedhor dhe do t'i shmangemi pasojave të padëshirueshme të cilat i kemi vërejtur më herët siç ishte anulimi dhe përsëritja e zgjedhjeve.

Ne si Grup Parlamentar “6+” e vlerësojmë lartë Raportin e punës së KQZ-së duke pasur parasysh afatet kohore për përgatitjen e zgjedhjeve dhe mangësitë apo zbrastirën e ligjit aktual për zgjedhjet me çrastë ne e përgëzojmë për punën që e kanë bërë.

Grupi Parlamentar “6+” është për miratimin e këtij raporti të punës të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Për diskutim është lajmëruar deputeti Lutfi Haziri.

LUTFI HAZIRI: Faleminderit, zoti kryetar!

Dua të diskutoj që është një segment i këtij raporti që ka të bëjë kryesisht me mësimet e nxjerra nga procesi i jashtëzakonshëm zgjedhor. Për herë të parë KQZ-ja në Kosovë është ballafaquar me një proces të jashtëzakonshëm zgjedhor, sepse prej vitit 2001 u paraqit edhe nga kryetari i Komisionit edhe nga përfaqësues të tjerë, ka qenë proces i menaxhuar i rregullt zgjedhor të cilën organet

kushtetuese, në këtë rast KQZ-ja ka pasur mundësi të përgatitet teknikisht për zgjedhje dhe deri në vitin 2007 zakonisht është thënë që Kosova i ka zgjedhjet më të mirat të organizuara në regjion.

Defektet që kanë lindur në zgjedhjet e fundit janë edhe pasoj e zgjedhjeve të vitit 2007, po ashtu dhe problemi kryesor është regjistri zgjedhor. Mosazhurimi i listave të regjistri zgjedhor dhe problemet shtesë që u përmendën janë brengë serioze e secilit prej neve, sepse tash me regjistrimin e popullatës ka shpërputhje të madhe të regjistrit zgjedhor dhe regjistrit votues. Ka komuna që ka më shumë votues se qytetarë të regjistruar dhe shumë probleme tjera, natyrisht që janë serioze dhe duhet të merren parasysh.

Problemi më i madh se me regjistrimin e popullatës nuk është paraparë edhe regjistri i ri i votuesve. Është lëshim i madh, do të ketë kosto Kosova, sepse ky regjistër zgjedhor për zgjedhjet e ardhshme tashmë nuk mund të jetë në funksion dhe nuk mund të jetë dokument dhe regjistër i besueshëm. Përpilimi i regjistrit të ri është problem serioz, sepse Kosova ka humbur mundësinë që krahas regjistrimit të popullatës ta bëjë edhe regjistrin e ri zgjedhor, se cili model do të zgjidhet se si do të arrihet të bëhet regjistri i ri zgjedhor do të jetë problemi që do të shqyrtohet në të ardhmen.

Shpresoj shumë që reformat në sistem zgjedhor do të arrijnë me reformua edhe KQZ-në në tërësi si organ kushtetues, në mënyrë që zgjedhjet e ardhshme të parapara me kalendarin e ri zgjedhor vërtet janë të besueshme dhe të pranueshme për gjithë ne. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Deputeti Shqip Muja e ka kërkuar fjalën.

SHAIPI MUJA: Faleminderit, zoti kryetar!

Unë mendoj që duhet të kalohet ky raport përkundër gabimeve të cilat u evidentuan nga parafolësit dhe vlerësimet politike që i dhanë edhe raportit janë vetë anëtarët e Komisionit të partive politike të deleguar në Komisionin Qendror Zgjedhor të cilët janë edhe në një farë mënyre edhe aprovues të këtij raporti dhe ne dalin në kundërshtim me atë kur themi si deputetë se nuk do ta pranojmë kur përfaqësuesit e partive tona janë prezentë në atë komision. Prandaj, duke u bazuar se Ligji zgjedhor i ri i cili do të aprovohet dhe do të jetë në kushte më të mira për organizimin e zgjedhjeve në të ardhmen dhe strukturës teknike të saj, unë ftoj që të votohet ky raport me vërejtjet të cilat do të jetë sugjerime për legjislacionin e ri që përgatitet për Komisionin qendror Zgjedhor. Ndërsa sa i përket konkludimet se viti i kaluar ka qenë viti më i vështirë për Kosovën gjatë zgjedhjeve, unë mund të them po, sepse sa herë është kundërshtuar çdo zgjedhje është fituar nga Partia Demokratike dhe kostoja është rritur çdo herë. Prandaj edhe elektorati në një mënyrë është përgjigjur nga kundërshtuesit dhe në këtë mënyrë kanë gjeneruar vetë kundërshtuesit mjete financiare nga buxheti i Kosovës dhe tani kundërshtohet. Prandaj, edhe kundërshtimet kur bëhen duhen të jenë të bazuara që mos të shfrytëzohet buxheti i Kosovës për qëllime ose qejfe të kundërshtimeve boshe. Faleminderit!

KRYETARI: Albulena Haxhiu, a ke replikë ?

Urdhëro!

ALBULENA HAXHIU: Po, vetëm desha t'ju bëj me dije që unë edhe në Komision kur e kemi pasur Raportin e KQZ-së kam votuar "kundër", kështu që edhe tash jemi "kundër". Këta duhet ta kenë të

qartë se Komision shumica kanë qenë “për” unë “kundër” ashtu nuk shkruhet, sepse sipas Rregullores nuk është e cekur.

KRETARI: Mirë, faleminderit, deputete!

Unë i kisha thënë nja dy -tri fjalë dhe po i them nga vendi për shkak se nuk e kam zëvendësuesin këtu, po si shkurt.

Ne kemi raportet e dy komisioneve që kanë vlerësuar që këto raporte duhet të miratohen. Kemi Raportin e Komisionit Qendror Zgjedhor ku janë përfaqësuesit e të gjitha partive dhe ato në një mënyrë a tjetër i kanë dhënë vizën këtij raporti. Realisht, Komisionin Qendror Zgjedhor ne nuk mund ta ngarkojmë me parregullsitë që nuk janë të tij. Ne të gjithë e dimë që parregullsitë nuk janë të Komisionit Qendror Zgjedhor, janë të subjekteve politike që kanë dalë në zgjedhje dhe ato parregullsi janë të gjitha subjekteve politike, natyrisht ndahet proporcionalisht dhe sipas fuqisë politike. Po, nuk mund ta adresojmë problemin e zgjedhjeve në Komision Qendror Zgjedhor. Kështu unë ju kisha lutur edhe juve që e thanë nuk e votojmë këtë raport që vërtet ky raport të votohet dhe defekte tjera mendoj që duhet t'i zgjedhë edhe përpjekja për reformën zgjedhore edhe vetë përgjegjësia dhe ndërgjegjja e subjekteve politike që do të dalin në zgjedhjet e ardhshme. Kështu që unë po dua të jem korrekt me Komisionin Qendror Zgjedhor. Po e them edhe një herë publikisht se e kam thënë edhe një herë me kohë, parregullsia nuk buron te Komisioni Qendror Zgjedhor, parregullsia ka buruar te partitë politike ose te forcat politike, të subjektet politike që kanë marrë pjesë në zgjedhje dhe të mësohemi, fajin mos ta kërkojmë atje ku s'është.

Prandaj, tash kishim hy në procedurën e votimit dhe ju lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim dhe votojmë tash.

Prezentë ishin 71 deputetë.

Konstatohet se me 32 vota “për”, 40 “kundër” dhe asnjë abstenim, Raporti nuk miratohet.

Vazhdojmë me pikën e radhës të rendit të ditës:

17. Shqyrtimi i Raportit të Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për duhanin

Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale ka monitoruar zbatimin e Ligjit për duhanin dhe Kuvendit ia ka paraqitur raportin me rekomandime.

Fjalën po ja japim nënkryetares së Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, deputetes Time Kadrijaj.

TIME KADRIJAJ: Faleminderit, zoti kryetar i Kuvendit!

Të nderuar deputetë,

Me qëllim të përmbushjes së obligimeve të Komisionit të parapara me rregullën 73 të Rregullores së Punës, Komisioni i Shëndetësisë në mbledhjen e mbajtur më 13 prill 2011 miratoi iniciativën për monitorimin e Ligjit 02/L-36 për duhanin. Shëndeti i popullatës është prioritet i çdo shteti, prandaj zbatimi i Ligjit të duhanit ndikon drejtpërdrejtë në përmirësimin e shëndetit të popullatës. Dhe kemi menduar se përmes mbikëqyrjes së zbatimit të këtij ligji të merren masa efektive për mbrojtjen e shëndetit të popullatës.

Qëllimi kryesor i mbikëqyrjes së këtij ligji është të vlerësohet niveli i zbatueshmërisë në praktikë të këtij ligji, duke u bazuar në të dhënat nga takimet me institucionet përkatëse, vizitat në terren dhe vlerësimi, nëse qeveria, Ministria e Shëndetësisë dhe institucionet e nivelit lokal janë duke i përmbushur obligimet sipas ligjit.

Me qëllim të realizimit të këtyre synimeve dhe objektivave Komisioni ka ndërmarrë hapat si në vijim: formimi i grupit punues nga anëtarët e Komisionit, identifikimi i institucioneve, autoriteteve dhe subjekteve relevante për zbatimin e Ligjit të duhanit, vizitat në institucionet e nivelit qendror, Ministria e Shëndetësisë dhe Inspektoratin sanitar dhe vizitat në nivelin lokal.

Grupi punues bazuar në autorizimet që kishte ka arritur me sukses të përmbyllë aktivitetet e planifikuara. Gjatë periudhës prill – korrik grupi ka realizuar 7 vizita në terren. Gjithashtu janë mbajtur takime, qëllimi i të cilave ishte koordinimi dhe planifikimi i aktiviteteve.

Vizitat e grupit punues në terren u përqendruan në tri nivele institucionesh, institucionet qendrore, lokale dhe lokalet afariste.

Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale gjatë vizitave në terren, takimeve dhe shqyrtimit të dhënave ka arritur të identifikojë shumë probleme në zbatimin e Ligjit të duhanit.

Komisioni pas përfundimit të punës disa mujore ka përgatitur këtë raport i cili shpreh vlerësimin e tij për zbatimin e Ligjit të duhanit duke përfshijë dhe rekomandimet për masat që duhet të ndërmarrë. Ligji për duhanin nuk po zbatohet si pasojë e disa mangësive të ligjit dhe mos efikasitetit të institucioneve përgjegjëse për zbatim.

Me qëllim të ndryshimit dhe përmirësimit të gjendjes aktuale dhe me qëllim të rritjes së nivelit të zbatimit të këtij ligji, Komisioni propozon disa rekomandime. Qeveria e Kosovës, Ministria e Shëndetësisë dhe organe tjera përgjegjëse duhet të rrisin përpjekjet për zbatimin e ligjit. Qeveria e Kosovës, Ministria e Shëndetësisë dhe kuvendet komunale duhet të rrisin kapacitetet dhe të mobilizojnë inspektoratet përgjegjëse për zbatimin e ligjit.

Ministria e Shëndetësisë duhet të harmonizojë udhëzimet administrative me plotësim dhe ndryshimet e Ligjit për duhanin. Qeveria e Kosovës duhet të funksionalizojë Këshillin profesional për kontrollin e duhanit. Qeveria e Kosovës në koordinim me Ministrinë e Shëndetësisë duhet të ngre Laboratorin për testimin e produkteve të duhanit.

Rekomandojmë që të plotësohet dhe të ndryshohet Ligji për duhanin, neni 10 i ligjit është i paqartë sa i përket hapësirës së pirjes së duhanit, sepse nuk ceket me ligj se duhet të bëhet ndarja fizike. Neni 8 i ligjit nuk e rregullon reklamimet dhe ekspozimin e duhanit në mënyrë të duhur dhe procedura e shqiptimit të gjobave nuk është e definuar. Inspektoratet të fillojnë me shqiptimin e gjobave, të ndalohet shitja e duhanit jashtë pikave të shitjes dhe nga personat më të rinj se 18 vjeç. Organet përgjegjëse duhet të luftojnë kontrabandën e duhanit. Niveli qendror dhe lokal duhet të ndërmarrë aktivitete që promovojnë vetëdisimin e popullatës së re mbi dëmet që shkakton pirja e duhanit. Dhe, Ministria e Shëndetësisë duhet t'i raportojë Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, për nivelin e zbatimit të ligjeve së paku një herë në vit. Kjo përgjegjësi e Ministrisë buron nga Rregulla 73, paragrafi 2 i Rregullores së Punës së Kuvendit të Kosovës.

Ne si Komision për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, ftojmë deputetët ta përkrahin këtë raport. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Nga grupet parlamentare, deputetja Flora Brovina, në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike.

FLORA BROVINA: Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike ka marrë pjesë në nxjerrjen e Ligjit për duhanin dhe ka participuar gjithashtu përmes deputeteve të veta në Komisionin për Shëndetësi dhe Çështje Sociale edhe në monitorimin e Ligjit për duhanin.

Grupi Parlamentar ka analizuar rekomandimet e Komisionit dhe pajtohet plotësisht me këto rekomandime në rend të parë që Qeveria, Ministria dhe institucionet gjegjëse të nxisin përpjekje për zbatimin e këtij ligji që Qeveria dhe Ministria gjithashtu edhe komunat, të rrisin kapacitetet dhe të mobilizojnë në inspeksionet e tyre përgjegjëse për kontrollimin e zbatueshmërisë së këtij ligji që Ministria të harmonizojë udhëzimet administrative me plotësimin- ndryshimin e Ligjit për duhanin që të funksionalizohet Këshilli profesional në kontrollin e duhanit në kuadër të Qeverisë dhe që Qeveria dhe Ministria të ngritin Laboratorin për testimin e produkteve të duhanit. Të shtohet kontrolli i shitjes dhe reklamimit të këtij produkti.

Grupi Parlamentar i jep pëlqimin për këto rekomandime, duke shtuar se është e nevojshme sidomos gjithëpërfshirja e popullatës në zbatimin e këtij ligji, në rend të parë të përfshihet rinia, punëtorët e arsimit, shëndetësisë, organizatat joqeveritare, të sensibilizohen më shumë dhe të marrin pjesë në zbatimin e këtij ligji, e secili qytetar veç e veç, sidomos në ruajtjen e shëndetit të popullatës më sensitive si janë të sëmurit kronikë, shtatzënat, foshnjat, fëmijët dhe të miturit.

Ligji nuk na mbron neve, ne përmes ligjit mbrojmë vetveten dhe pikërisht ky është Ligji për duhanin i cili kërkon nga ne secili që ta zbatojmë atë për ta ruajtur shëndetin tonë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Unë një njoftim dua ta jap edhe për ju deputetët edhe për opinionin.

Prezentë në sallë kur është votuar paraprakisht kanë qenë 71 deputetë, në fakt dalin 78 vota, defekti është prej 7 votash. Pra, dikush ka votuar për 7 deputetë që s'kanë qenë prezent në sallë.

Vazhdojmë. Jo, po ju njoftoj prezenca ka qenë 71, kurse në rezultat janë 78 vota, janë 7 vota më tepër. Ju lutem mos votoni në emër të deputetëve që nuk janë prezentë në sallë.

Vazhdojmë, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, fjalën e ka Bahri Thaçi.

BAHRI THAÇI: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar deputetë,

Edhe Grupi Parlamentar i LDK-së ka shqyrtuar Raportin e Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit nr. 02/L-36 për duhanin dhe Ligjin 03/L-157 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për duhanin.

Është konstatim se ky ligj po zbatohet pjesërisht, gjegjësisht moszbatimi i këtij ligji vërehet në çdo hap, duke filluar në institucionet më të larta shtetërore, deri te ato lokale, në shkolla, në rrugë e në vende të tjera.

Brengos shumë pirja e duhanit nëpër familje, dihet se në tymin e duhanit ka mbi 4000 substanca që e dëmtojnë shëndetin e nga këto mbi 50 janë substanca me veti kancerogjene. Është e trishtueshme që pa fajin e tyre të goditen fëmijët e porsalindur edhe ata që ende s'i kanë marrë këmbët që të mund të ikën nga kjo e keqe.

Andaj, Grupi Parlamentar i LDK-së përkrah rekomandimin e Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, që të plotësohet dhe ndryshohet Ligji për duhanin dhe t'i jepet një rëndësi e veçantë mbrojtjes së fëmijëve nga pirja e duhanit në familje. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Në emër të "Vetëvendosjes", deputetja Aurora Bakalli e ka fjalën.

AURORA BAKALLI: Faleminderit, zoti kryetar!

Duke pasur parasysh rëndësinë e Ligjit për duhanin dhe duke pasur parasysh pasojat e shumta shëndetësore për shkak të konsumimit të duhanit, Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale e ka parë të arsyeshme që nëpërmes të grupit punues pesë anëtarësh të bëjë monitorimin e këtij ligji.

Kolegët nga komisioni gjatë punës së mbikëqyrjes së këtij ligji kanë identifikuar një sërë problemesh të cilat janë paraqitur në këtë raport dhe si rrjedhojë kanë ardhur në përfundim me dhjetë rekomandime, të cilat ne i vlerësojmë si të arsyeshme. Prandaj, Grupi Parlamentar i "Vetëvendosjes" e përkrah këtë raport për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për duhanin dhe për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për duhanin. Ju faleminderit!

KRYETARI: Në emër të Grupit Parlamentar të Aleancës, Time Kadrijaj.

TIME KADRIJAJ: Faleminderit, kryetar!

Edhe Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës e ka shqyrtuar raportin dhe në parim do ta përkrahë. E kam një vërejtje shtesë gjatë punës tonë si grup punues për monitorimin e Ligjit për duhanin, s'kemi pasur edhe trysninë e gazetarëve me pyetjen- pse nuk po respektohet Ligji i duhanit në Kuvendin e Kosovës, sepse e kanë vërejtur se ky ligj nuk respektohet as nga deputetë dhe as nga stafi tjetër i Kuvendit të Kosovës. Faleminderit!

KRYETARI: Në emër të Grupit Parlamentar Koalicionit Kosova e Re, Gëzim Kelmendi e ka fjalën.

GËZIM KELMENDI: Faleminderit, i nderuari kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë dhe deputete,

Po dyshim që Koalicioni për Kosovë të Re përkrahë këto rekomandime të nxjerra nga grupi punues i Komisionit për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale. Njëherësh, duke qenë vetë pjesë e këtij grupi punues dhe gjatë vizitave që kemi bërë së bashku me kolegët tjerë në terren pa dyshim që kemi hasur shumë në mangësi dhe parregullsi duke e filluar nga vetë ligji aktual i cili është në Kosovë për duhanin, dhe një herrit nga praktika në zbatimin e këtij ligji.

Duke marr parasysh që jemi shtet i ri dhe në tranzicion dhe niveli shëndetësorë është më i ulët se vendet e rajonit, një herrit edhe numri i përdoruesve të duhanit është shumë më i madh se vendet e rajonit dhe bashkimit evropian. Në këtë rast ne duhet të japim shumë përparësi preventivës edhe pa

dyshim edhe trajtimit të pasojave të duhanit por Fondi për Ministrinë e Shëndetësisë duke pasur parasysh se nuk është i madh dhe në këtë aspekt është i mangët që të luftoj këto pasoja, ne pa dyshim që duhet të merremi me preventivë në luftimin e pasojave të duhanit.

Gjithashtu duhet cekur se vendet në zhvillim në rajon, qoftë në nivelin e Bashkimit Evropian, qoftë vendet e rajonit i kanë dhënë shumë rëndësi komponentës preventive për parandalimin e pasojave të duhanit dhe duke pasur parasysh faktin që ata kanë një fond shëndetësor shumë më të madh se ne dhe japin shumë rëndësi preventives, pa dyshim që ne duhet të ndjekim këtë hap dhe t'i japim më shumë rëndësi preventivës.

Ligji për duhanin, krahas mangësive të cekura nga deputetët tjerë është, ndër mangësitë kryesore, parasheh edhe ndarjen fizike të objekteve e cila ndarje është padyshim në kundërshtim me praktikën e vendeve të Bashkimit Evropian dhe vendeve të rajonit, ngase askund në asnjë vend nuk është një ndarje e tillë 30% për duhanpirës dhe 70% për jo duhan pirës. Dhe, kjo padyshim e cenon shëndetin e gjithë atyre prezentë. Njëherit ne rekomandojmë që kjo të definohet qartë dhe të ndjekin praktikën e vendeve të rajonit dhe Bashkimit Evropian që kjo të eliminohet nga ky ligj nga se nuk bënë të jetë një ndarje e tillë.

Në anën tjetër gjithashtu edhe gjopa na vjen nga 20 euro gjopë shumë e ulët dhe nuk ndikon pozitivisht në ndalimin e duhanit në vendet e ndaluara. Pa dyshim kur është fjala te gjopa duhet të jetë një sensibilizim shumë më i madh i faktorëve që merren me këtë, përveç Inspektoratit duhet të kemi edhe një angazhim të mirëfilltë edhe pjesëtarëve të Policisë së Kosovës, ngase në vendet të tjera në zhvillim për persona juridikë merret Inspektorati, ndërsa për personat fizikë, kryesisht këtë punë e kryen pjesëtarët e policisë. Prandaj, edhe ne këtë duhet ta bartim këtë praktikë në vendin tonë në vendin e Kosovës.

Njëherit mungesa e Laboratorit për testimin e produkteve të duhanit pa dyshim që është një mangësi dhe nuk na jap një pasqyrë të qartë se çfarë produkte po importohen në Kosovë.

Faktor tjetër i cili ndikon në rënien e pirjes së duhanit nga ana e konsumatorëve pa dyshim është edhe akciza dhe ne dimë se rritja e akcizës pa dyshim shkakton në uljen e vlerave të përdorimit të duhanit, por duhet pasur parasysh që në këtë bashkëpunim me Ministrinë e Financave, duke i harmonizuar qëndrimet nga se ne e dimë se çdo rritje e akcizës mund të shkaktoj edhe një invazion kontrabandë nga vendet e rajonit, për atë arsye duhet shqyrtuar mirë dhe duhet shikuar çdo mundësi minimale për rritjen e akcizës e cila parandalon pirjen e duhanit.

Aktivitet tjetër i cili ndikon në uljen drastike të duhanit është aktiviteti në nivel qendror dhe lokal çka deri tash në vendin tonë nuk kemi pasur aktivitete të mirëfillta, por duhet përshëndetur dhe lavdëruar aktivitetin e mbështetur nga USAID-i që është bërë kohë më parë sa i përket parandalimit dhe pasoja negative të duhanit.

Vend- hapësirë tjetër për eliminimin e këtyre pasojave pa dyshim që kanë edhe mediat, qoftë elektronike, qoftë ato të shkruara ku duhet pasur parasysh se sidomos te programet vendore që të mos dalin para kamerave, para programeve televizive personat të cilët pinë duhanin ngase ajo është një pasqyrë e keqe për vetë qytetarët, për vetë fëmijët dhe për vetë Kosovën në përgjithësi.

Ne në parim si Koalicion për Kosovë të Re i përkrahim këto rekomandime dhe mirëpresim hapat e mirëfilltë nga Qeveria. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Në emër të Grupit të SLS-së, fjalën e ka deputeti Sasha Millosavleviq.

SAŠA MILOSAVLJEVIĆ: Hvala, gospodine predsedniče!

Parlamentarna grupa SLS je razmotrila izveštaj Komisije za zdravstvo, rad i socijalna pitanja o nadgledanju sprovođenja Zakona o duvanu i Zakon o izmeni i dopuni Zakona o duvanu i smatramo da su preporuke dobre i mi podržavamo izmene i dopune ovog zakona.

KRYETARI: Faleminderit!

Në emër të Grupit “6+”, deputetja Duda Balje e ka fjalën.

DUDA BALJE: Zahvaljujem!

Parlamentarna grupa „6+“, podržava izveštaj i preporuke Komisije za zdravstvo i smatra da je od vrlo velike važnosti da se preduzmu svi potrebni koraci da se ispoštuje Zakon o duvanu u praksi. Zahvaljujem!

KRYETARI: Faleminderit!

Prej deputetëve e kem të lajmëruar deputetin Salihe Mustafa.

SALIHE MUSTAFA: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar kolegë,

Unë si anëtare e grupit punues për Ligjin e duhanit, nuk dua të zgjas shumë, sepse shumica e të gjeturave dhe rekomandimeve u thanë nga kolegët e mi të Komisionit për Shëndetësi. Ne kemi monitoruar komunat, institucionet qendrore dhe lokale, kanë dalluar diku më shumë e diku më pak, është implementuar Ligji për duhanin. Dhe, ne kemi konstatuar se siç u tha edhe më herët se Ligji për duhanin nuk po implementohet për shkak të mos efikasitetit të organeve përgjegjëse, por edhe për shkak të mangësive në ligj.

Unë kam një sugjerim për kolegët e mi deputetë, sepse ndërkohë na kanë arritur edhe Projektligji për akcizën për duhanin dhe Projektligji për prodhimin, grumbullimin dhe tregtimin e duhanit, dhe kërkoj që këto dy projektligje të harmonizohen me Ligjin e duhanit, sepse gjatë leximit dhe shqyrtimit kam hasur se në disa nene këto ligje bien ndesh. Gjithashtu është edhe një nevojë e veçantë që drejtoratet komunale të shëndetësisë dhe të arsimit të bashkëpunojnë mesë veti dhe të mbajnë ligjërata edukative në shkolla për dukuritë negative ku do të hyjë edhe Ligji për duhanin, përderisa të mos harmonizohet dhe mos të nxirret një udhëzim administrativ, mos të rregullohet ndryshe me ligj, kisha kërkuar nga drejtoritë komunale dhe drejtoritë e arsimit në komuna, sepse kjo është shumë me rëndësi. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Të lajmëruar tjerë nuk kemi.

Atëherë, e vë në votim Raportin e Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale për mbikëqyrjen dhe zbatimin e Ligjit për duhanin.

Në sallë janë të pranishëm 75 deputetë.

Votojmë tash: Faleminderit!

Konstatohet se më 67 vota “për”, 2 “kundër” dhe një abstenim.

Shumë jeni pa kartel po më duket. Atëherë po bëjnë 73 “për”, 2 “kundër” dhe një abstenim.

Unë dua ta korrigjoj vetveten tani menjëherë, votimi i parë ka qenë, e kam marrë me tekst dhe është konform prezencës që ka qenë në sallë.

E kemi edhe një njoftim:

18. Njoftimi me vendimin e Grupit Parlamentar të SLS-së për zëvendësimin e kryetarit të Grupit Parlamentar të SLS dhe të kryetarit të Komisionit për të Drejtat, Interesat e Komuniteteve dhe për Kthim

Edhe ju njoftoj se Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike, pas dorëheqjes së Xhavit Halitit, në Komisionin at-hoc për reformë zgjedhore, ka vendosur deputetin Behar Selimin.

Ju njoftoj se Grupi Parlamentar i SLS-së ka marrë vendim për zëvendësimin e kryetarit të Grupit Parlamentar të SLS, kështu që në vend të deputetit Sasha Rashiq, kryetar i Grupit do të jetë deputeti Sasha Millosavleviq, ndërsa kryetari i Komisionit për Komunitete dhe Kthim, do të jetë deputeti Goran Marinkoviq.

Mirupafshim, në seancën e radhës!

Përgatiti:

Njësia e e Transkripteve dhe e Lekturës e Kuvendit të Kosovës

